



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 63

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 3 maj 2018

PËRMBAJTJA

Ligj nr. 21/2018
datë 12.4.2018

Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit European për Programin Interreg V-B Adriatiko-Jonian (ADRION) 2014-2020.....

Faqe

3787



LIGJ
Nr. 21/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË
FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË
ITALISË DHE KOMISIONIT EUROPIAN
PËR PROGRAMIN INTERREG V-B
ADRIATIKO-JONIAN (ADRION) 2014-2020**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit European për programin Interreg V-B Adriatiko-Jonian (ADRION) 2014-2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.4.2018

**Shpallur me dekretin nr. 10773, datë 23.4.2018
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**

**MARRËVESHJE FINANCIMI
për Programin “Interreg V-B Adriatik-
Jonian”
CCI 2014TC16M4TN002**

KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si **“Komisioni”**, i cili vepron në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si **“Unioni”**, nga njëra anë, dhe

Qeveria e Shqipërisë, në vijim e referuar si **“përfituesi IPA II”**, ose **“Shqipëria”**, e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave nga ana tjetër, dhe

Republika Italiane, në vijim e referuar si **“Italia”**, e përfaqësuar nga Rajoni Emilia-

Romagna, që vepron si Autoriteti Menaxhues i programit të bashkëpunimit transkombëtar “Interreg V-B Adriatik- Jonian” (ADRION), si palë e tretë, bien dakord si më poshtë:

**Neni 1
Programi**

1) Unioni bie dakord të financojë dhe Shqipëria bie dakord të pranojë financimin e Programit transkombëtar të bashkëpunimit, siç përcaktohet në shtojcën I të miratuar nga Vendimi për Zbatim i Komisionit me nr. CRIS 2015/7147, të datës 20 shtator 2015, dhe korrigjuar nga Fleta e Korrigjimeve të Gabimeve të Shtypit nr. CRIS 2017/ 12529, të datës 1 mars 2017:

Programin “Interreg V-B Adriatic-Ionian”
CCI: 2014TC16M4TN002

më poshtë referuar si “Programi”.

2) Ky Program financohet nga Buxheti i Unionit mbi bazën e akteve themelore:

Rregullorja e BE-së me nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe Rregullorja e Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013, që përcaktojnë dispozitat e përgjithshme për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit, Fondin Evropian Bujqësor për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Fondi Evropian për Sektorin Detar dhe Peshkimin, që përcaktojnë dispozitat e përgjithshme për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit, Fondin Evropian Bujqësor për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Fondi Evropian për Sektorin Detar dhe Peshkimin, që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) me nr. 1083/2006¹ (Rregullorja e Dispozitave të Përgjithshme, “CPR”) dhe të akteve të miratuara lidhur me këtë.

Rregullorja e BE-së me nr. 1299/2013 e Parlamentit Evropian dhe Rregullorja e Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013 mbi dispozitat e përgjithshme për mbështetje nga Fondi Evropian për Zhvillimin Rajonal drejt qëllimit evropian për bashkëpunim territorial² (Rregullorja ETC) dhe të akteve të miratuara lidhur me këtë.

Neni 9 (3) e Rregullores së BE-së me nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe Rregullorja e Këshillit, e datës 11 mars 2014, që përcakton

¹ GZ L 347, 20.12.2013, f. 320.

² GZ L 347, 20.12.2013, f. 259.



Instrumentin për Asistencën Paraanëtarësimit (IPA II)³ (“Rregullorja IPA II”, “IPA II”).

3) Kostoja totale e vlerësuar e këtij Programi është 117,918,198 euro dhe kontributi maksimal i Unionit në kuadër të IPA II për këtë Program është përcaktuar në vlerën 15,688,887 euro si kontribut nga Titulli 4.

Kontributi i Unionit do të ndahet në angazhime vjetore në përputhje me shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje Financimi. Asnjë pikë në këtë Marrëveshje nuk mund të interpretohet se nënkupton një angazhim financiar të Unionit në lidhje me kreditë, të cilat ende nuk janë miratuar me miratimin e buxhetit të BE-së. Komisioni e informon me shkrim autoritetin menaxhues për miratimin e çdo angazhimi financiar vjetor të parashtruar në shtojcën II.

Ky Program kërkon kontribute financiare si nga përfituesi IPA II, ashtu edhe nga Unioni. Ndarja e kontributeve përkatëse financiare përcaktohet në shtojcën III.

Neni 2

Periudha e ekzekutimit dhe periudha e verifikimit të ligjshmërisë (pranueshmërisë)

1) Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi fillon nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe përfundon 12 vjet pas kësaj date.

2) Në Shqipëri shpenzimet do të jenë të pranueshme për një kontribut nga asistencë⁴ e ERDF-së nëse janë bërë nga një përfitues dhe janë paguar ndërmjet 1 janarit 2014 dhe 31 dhjetorit 2023.

Neni 3

Interpretimi

1) Dispozitat në këtë Marrëveshje dhe shtojcat e saj interpretohen si mbështetëse dhe plotësuese të dispozitave të kuadrit rregullator të parashikuara në nenin 1.

2) Nëse ekzistojnë kundërshtime midis dispozitave në Kushtet e Veçanta të kësaj

Marrëveshjeje dhe në shtojcat e saj, dhe sidomos në dispozitat e shtojcës IV (“Kushtet e Përgjithshme”), dispozitat në Kushtet e Veçanta të kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

Nëse ekzistojnë kundërshtime mes dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe dispozitave në aktet bazë të nenit 1(2) apo akteve të miratuara lidhur me këtë, dispozitat e këtij kuadri rregullator do të kenë përparësi dhe kjo Marrëveshje do të ndryshohet ose korrigjohet në përputhje me nenin 73 të Kushteve të Përgjithshme.

3) Në bazë të dispozitave të shprehura në kundërshtim në këtë Marrëveshje, termat e përdorur në këtë Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim me atë të atribuuar në aktet themeltare të renditura në nenin 1(2).

4) Në bazë të dispozitave të shprehura në këtë Marrëveshje, referencat në këtë Marrëveshje janë referenca për Marrëveshje të tillë të amenduar, të plotësuar apo të zëvendësuar në çdo kohë.

5) Referencat në këtë Marrëveshje dhe shtojcat për instrumentet e Bashkimit Evropian i referohen instrumenteve të ndryshuara, mbështetëse apo të zëvendësuar herë pas here.

6) Titujt në këtë Marrëveshje dhe shtojcat e saj nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretim.

Neni 4

Shfuqizimi i pjesshëm dhe boshllëqet e paqëllimshme

Në rast se një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është e shfuqizuar ose shfuqizohet, ose në rast se kjo Marrëveshjeje përmban boshllëqe të paqëllimshme “lacuna”, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Në përputhje me nenin 73 të Kushteve të Përgjithshme, palët do të zëvendësojnë ose do të plotësojnë boshllëqet e paqëllimshme me një dispozitë tjetër të vlefshme që i afrohet qëllimit dhe synimit të dispozitës së pavlefshme.

Neni 5

Adresat dhe komunikimi

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Financimit bëhen me shkrim, i referohen shprehimisht këtij Programi, siç përcaktohet në nenin 1(1) dhe dërgohen në adresat e mëposhtme:

³ OJ L 77, 15.03.2014, f. 11.

⁴ Shih përkufizimin në pikën (i) të nenit 1(1) të shtojcës IV të kësaj Marrëveshjeje Financimi: “Asistencë e ERDF” nënkupton mbështetjen e Unionit për Programin nga linjat buxhetore të Fondit Evropian për Zhvillimin Rajonal, si kontributin nga zëri buxhetor 1b (kohezioni ekonomik, social dhe territorial) edhe kontributin nga zëri buxhetor 4 (Evropa Globale) (IPA II).

(a) **për Komisionin**

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Rajonale dhe Urbane

B- 1049 Bruksel– Belgjikë

E-mail: REGIO-TRANSNATIONAL-AND-INTERREGIONAL-COOPERATION@ec.europa.eu;

(b) **për Republikën e Shqipërisë**

Ministria e Integrimit Evropian

Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, sheshi “Nënë Tereza” 1010, Tiranë, Shqipëri

E-mail: daniela.cekani@integrimi.gov.al; ana.xhilaga@integrimi.gov.al; cbc@integrimi.gov.al

(c) **për Republikën Italiane**

Rajoni i Emilia- Romagna

Autoriteti Menaxhues i Programit “Interreg V-B Adriatiko-Jonian”

Viale Aldo Moro, 18 - 40127 Bolonja, Greqi

E-mail: MAdrion@Ragione.Emilia-Romagna.it

Neni 6

Marrëveshja Kuadër nën IPA II

Në përputhje me nenin 8, pika 6, të Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e Asistencës Financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), e cila hyri në fuqi më 16 prill 2015 (në vijim e referuar si “Marrëveshja Kuadër”), rregullat për zbatimin e Programit përcaktohen në këtë Marrëveshje Financimi. Rrjedhimisht, Programi zbatohet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Financimi ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë.

Kjo Marrëveshje Financimi plotësohet me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër, në veçanti në ato raste kur kjo Marrëveshje Financimi nuk përmban dispozita të veçanta mbi një çështje të caktuar.

Në rast mospërputhjeje, nga njëra anë, ndërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe, nga ana tjetër, të dispozitave të Marrëveshjes Kuadër, kjo Marrëveshje Financimi do të ketë përparësi.

Neni 7

Shtojcat

Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:

a) këto Kushte të Veçanta;

b) shtojcat e mëposhtme, të cilat formojnë një pjesë integrale të saj:

i. Shtojca I: Programi i Bashkëpunimit Transkombëtar “Interreg V-B Adriatiko-Jonian”;

ii. Shtojca II: Plani financiar (pjesë e angazhimeve/detyrimeve vjetore financiare);

iii. Shtojca III: Plani financiar (pjesë e kontributeve financiare të Unionit dhe përfituesve të IPA II sipas aksit prioritar), siç është korrigjuar në Fletën e Korrigjimeve të Gabimeve të Shtypit nr. CRIS 2017/ 1529, të datës 1 mars 2017;

iv. Shtojca IV: Kushtet e Përgjithshme.

Neni 8

Dispozitat që përcaktojnë kushtet e zbatueshme për zbatimin e programit në përputhje me nenin 26 të Rregullores Evropiane të Bashkëpunimit Territorial (ETC)

Dispozitat që plotësojnë shtojcën IV:

a) Në plotësimin e nenit 14 të shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse bien dakord që përfituesi kryesor për një veprim në Program mund të vendoset në një përfitues IPA II, siç përcaktohet në seksionin 9.4 të Programit.

b) Në plotësimin e nenit 23 të shtojcës IV, lidhur me tavanin e asistencës teknike, duke marrë në konsideratë faktin që alokimi i Asistencës Teknike është bërë ndaras për titullin 1b (kohezioni ekonomik, social dhe territorial) dhe titulli 4 (Evropa Globale) (IPA II), shuma e caktuar e asistencës teknike nën IPA II është 1,500,000 euro, siç parashikohet në nenin 23 për programet me një alokim total që nuk tejkalon 50,000,000 euro.

Neni 9

Dispozitat Plotësuese të Shtojcës IV

Dispozitat që plotësojnë shtojcën IV:

a) në plotësim të nenit 12, pika 2, të shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse (Shtete Anëtare) në Program kanë rënë dakord të zbatojnë opsionet e shkronjës (d);

b) në plotësim të nenit 33, pika 1, të shtojcës IV, përfituesi IPA II ka zgjedhur për të përdorur Udhëzuesin Praktik për Procedurat Kontraktuese për Veprimet e Jashtme të BE-së;

c) në plotësim të nenit 34, pika 1, të shtojcës IV, këto Kushte të Veçanta nuk lejojnë pjesëmarrjen në thirrjen për propozime të subjekteve pa personalitet juridik;

d) në plotësim të nenit 34, pika 5, të shtojcës IV, pranueshmëria sipas këtij neni është e kufizuar më tej në lidhje me kombësinë, vendndodhjen



gjeografike ose natyrën e aplikantëve, ku kufizime të tilla rrjedhin nga natyra e veçantë dhe objektivat e veprimit, dhe kur ato janë të nevojshme për zbatimin me efektivitet të tij;

e) në plotësim të nenit 40, pika 1, të shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse në Program dhe përfituesi IPA II nuk e kanë autorizuar autoritetin e auditimit për të kryer direkt funksionet e tij në të gjithë territorin. Ata nuk kanë specifikuar se kur autoriteti i auditimit duhet të shoqërohet nga një auditues i një Shteti Anëtar ose një përfituesi IPA II;

f) në plotësim të nenit 41, pika 2, të shtojcës IV, përfituesi IPA II nuk e ka autorizuar autoritetin e auditimit për të kryer direkt funksionet e parashikuara në nenin 127 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 në të gjithë territorin e mbuluar nga programi i bashkë-punimit;

g) në plotësim të nenit 44, të shtojcës IV, Koordinatori kombëtar IPA ka deleguar rolin e tij drejtues për koordinimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në Program në Strukturën Operative të Bashkëpunimit Territorial në kuadër të Ministrisë së Integritetit Evropian;

h) në plotësim të nenit 48, të shtojcës IV, shkalla e bashkëfinancimit dhe shuma maksimale e asistencës ERDF për aks prioritar, për kontribut nga buxheti Kreu 1b dhe për kontribut nga buxheti Kreu 4 (IPA II) vendoset siç është përcaktuar në shtojcën III;

i) në plotësim të nenit 56, pika 3, të shtojcës IV, metoda e zgjedhur për këtë Program është ajo e përmendur në pikën (b) opsionin e dytë të nënparagrafit të parë të atij neni;

j) në plotësim të nenit 67, pika 3, të shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse kanë vendosur të mos e mbulojnë një shumë të paguar padrejtësisht në rast se shuma që do të mbulohet nga përfituesi, pa përfshirë interesin, nuk i kalon 250 euro nga kontributi i asistencës së ERDF-së.

Neni 10

Marrëveshja dypalëshe shtesë

Italia dhe Shqipëria kanë rënë dakord që marrëveshjet e detajuara mes tyre nuk duhet të jenë pjesë e kësaj Marrëveshje Financimi në formën e një shtojce të veçantë, për shkak se të gjitha çështjet janë të mbuluara në mënyrë të mjaftueshme në Program, në Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta, në Manualin e Zbatimit të Projektit dhe Manualin e Asistencës Teknike dhe përshtkrimin e

sistemit të menaxhimit dhe kontrollit, si dhe çdo dokument tjetër specifik implementimi të miratuar nga Komiteti Monitorues.

Këto marrëveshje të detajuara kanë përcaktuar në mënyrë shteruese të gjitha rregullat që rregullojnë marrëdhëniet përkatëse ndërmjet autoritetit menaxhues (që përfshin sekretariatit teknik), autoritetin certifikues dhe autoritetin e auditimit të Programit dhe autoritetet përkatëse në përfituesin IPA II.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi hyn në fuqi në datën në të cilën Komisioni merr një njoftim nga përfituesi IPA II që konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të përfituesit IPA II të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi. Komisioni informon përfituesin IPA II për datën e marrjes së këtij njoftimi.

Kjo Marrëveshje Financimi është hartuar në tri kopje në gjuhën angleze, një kopje i dorëzohet Komisionit, një kopje për Shqipërinë dhe një kopje për Italinë.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË:

Znj. Klajda Gjoshaj

Ministër i Integritetit Evropian
Koordinator Kombëtar IPA

Nënshkrimi

Tiranë, / / 2017

PËR KOMISIONIN:

Z. Marc Lemaître

Drejtor i Përgjithshëm
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Rajonale
dhe Urbane

Nënshkrimi

Bruksel, / / 2017

PËR REPUBLIKËN ITALIANE:

Z. Francesco Raphael Frieri

Menaxher i Përgjithshëm

Rajoni i Emilia- Romagna

Nënshkrimi:

Bolonjë, / / 2017

**BASHKËPUNIMI TERRITORIAL EUROPIAN**

ADRION

Interreg V-B

ADRIATIKO- JONIAN

PROGRAM BASHKËPUNIMI

2014-2020

Amendamenti i 3-të pas dorëzimit të programit të bashkëpunimit

në Komisionin Europian

28 gusht 2015

Hartimi i dokumentit të Programit është bashkëfinancuar nga Programi për Europën Juglindore

CCI	2014TC16M4TN002
Titulli	Interreg V-B program bashkëpunimi Adriatiko-Jonian 2014-2020
Versioni	2-të
Viti i parë	2014
Viti i fundit	2020
Në fuqi nga	1 janar 2014
Në fuqi deri më	31 dhjetor 2023
Numri i vendimit të KE-së	
Data e vendimit të KE-së	
Numri i vendimit të amendimit të MS-së	
Data e amendimit të MS-së	
Data e hyrjes në fuqi të vendimit të amendimit të MS-së	
Rajonet NUTS që mbulohen nga Programi i Bashkëpunimit	EL11 Ανατολική Μακεδονία, Θράκη (Anatoliki Makedonia, Thraki) EL12 Κεντρική Μακεδονία (Kentriki Makedonia) EL13 Δυτική Μακεδονία (Dytiki Makedonia) EL14 Θεσσαλία (Thessalia) EL21 Ήπειρος (Ipeiros) EL22 Ιόνια Νησιά (Ionia Nisia) EL23 Δυτική Ελλάδα (Dytiki Ellada) EL24 Στερεά Ελλάδα (Sterea Ellada) EL25 Πελοπόννησος (Peloponnisos) EL30 Αττική (Attiki) EL41 Βόρειο Αιγαίο (Voreio Aigaio) EL42 Νότιο Αιγαίο (Notio Aigaio) EL43 Κρήτη (Kriti) HR03 Jadranska Hrvatska HR04 Kontinentalna Hrvatska ITC4 Lombardia ITF1 Abruzzo ITF2 Molise ITF4 Puglia ITF5 Basilicata ITF6 Calabria ITG1 Sicilia



	ITH1	Provincia Autonoma di Bolzano/Bozen
	ITH2	Provincia Autonoma di Trento
	ITH3	Veneto
	ITH4	Friuli-Venezia Giulia
	ITH5	Emilia-Romagna
	ITI2	Umbria
	ITI3	Marche
	SI01	Vzhodna Slovenija
	SI02	Zahodna Slovenija
	AL	Shqipëri
	BA	Bosnja dhe Hercegovina
	ME	Mali i Zi
	RS	Serbia

Akronime

AA	Autoriteti i auditimit
ADRION	Programi Adriatiko-Jonian
CA	Autoriteti certifikues
CP	Program bashkëpunimi
ENI	Instrumenti European i Fqinjësisë
ERDF	Fondi European për Zhvillimin Rajonal
ETC	Bashkëpunimi Territorial European
EUSAIR	Strategjia Europiane për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit
Shtetet Partnere të ERDF-së	Kroaci, Greqi, Itali, Slloveni
ICT	Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit
IP	Prioriteti i investimeve
IPA	Instrumenti për Asistencë Para Anëtarësimit
Shtetet Partnere të IPA-s	Shqipëri, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia
JS	Sekretariati i përbashkët
MA	Autoriteti menaxhues
MC	Komiteti monitorues
NCP	Pikë kontakti kombëtare
PA	Aksi prioritar
Shtetet Partnere	Kroaci, Greqi, Itali, Slloveni, Shqipëri, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia
SEA	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
RIS3	Strategjitë e kërkimit dhe inovacionit për specializimin e mençur
SEE	Programi i Europës Juglindore 2007-2013
SME	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
SO	Objektivi specifik
SWOT (analiza)	(Elementet e forcës, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet)
TA	Asistenca teknike
TO	Objektivi tematik

Partneri kryesor dhe Përfituesi kryesor janë përdorur si sinonime

Partneri i Projektit dhe Përfituesi i Projektit janë përdorur si sinonime



Seksioni 1. Strategjia për kontributin e programit të bashkëpunimit në strategjinë e bashkimit evropian për zhvillimin “E MENÇUR”, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës dhe në arritjen e kohezionit ekonomik, social dhe territorial

Referenca: Neni 27, pika 1, të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, shkronja (a) e nenit 8, pika 2, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit dhe pika 5, të Rregullores (BE) nr. 1301/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit.

1.1 Strategjia për kontributin e programit të bashkëpunimit në strategjinë e Bashkimit Evropian për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe në arritjen e kohezionit ekonomik, social dhe territorial

1.1.1. Përshkrimi i strategjisë së programit të bashkëpunimit për të kontribuar në ofrimin e strategjisë së Bashkimit Evropian për zhvillimin “e mençur”, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, dhe për arritjen e kohezionit ekonomik, social dhe territorial.

Programi Interreg V-B Adriatik-Jon 2014-2020 (më poshtë referuar si ADRION), ngritur në kuadër të Bashkëpunimit Territorial Evropian (ETC) - politikat e kohezionit - një nga objektivat përfshin 31 rajone nga katër shtete partnere të ndryshme ERDF dhe katër shtete partnere IPA (në vijim të gjitha të referuara si shtetet partnere).

Për periudhën 2014-2020, buxheti i përgjithshëm i Programit arrin në 117.918.197 euro, duke përfshirë Fondin Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF) - 83.467.729 euro - të Instrumentit të Para Anëtarësimit (IPA II) - 15.688.887 euro - dhe kontributet kombëtare - 18.761.581 euro.

Objekti i përgjithshëm i Programit ADRION është të veprojë si një drejtues energjik i politikave dhe novator i qeverisjes që nxit integrimin evropian ndërmjet shteteve partnere si (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Greqia, Italia, Mali i Zi, Serbia, Sllovenia), duke përfutur nga burimet e pasura natyrore, kulturore dhe njerëzore përreth deteve Adriatik dhe Jon dhe rritjen e kohezionit ekonomik, social dhe territorial në zonën e Programit.

Programi merr parasysh përvojën e programeve operacionale 2007-2013, në veçanti programin

transkombëtar të Europës Juglindore (SEE) dhe programin IPA Adriatik bashkëpunimi ndërkufitar, zonat e pranueshme të të cilit përkojnë pjesërisht me ato të programit ADRION; merr gjithashtu në konsideratë rezultatet e programit (SEE) në vlerësim të vazhdueshëm (itinerare) dhe arritjet e përgjithshme programore të periudhës së mëparshme të programimit.

Pas vendimit të Komisionit Evropian që harton listën e rajoneve dhe zonave të pranueshme për fillesat transkombëtare të Bashkëpunimit Territorial Evropian (ETC), Programi ADRION mbulon fushat e mëposhtme:

a) Shtetet Partnere ERDF:

-IT Italia: 12 rajone dhe 2 provinca;

-SI Sllovenia: 2 rajone;

-EL Greqia: 13 rajone;

-HR Kroacia: 2 rajone;

b) Shtetet Partnere IPA:

-AL Shqipëria;

-BA Bosnja dhe Hercegovina;

-ME Mali i Zi;

-RS Serbia.

Për më tepër, sipas nenit 20 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, në kuadër të programeve të bashkëpunimit dhe në raste të justifikuara siç duhet, Autoriteti Menaxhues mund të pranojë që një pjesë e operacionit të zbatohet jashtë pjesës së Unionit të zonës së programit, me kusht që të plotësohen kushtet e nenit 20 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013.

Shuma totale e alokuar në kuadër të programit të bashkëpunimit për operacionet e vendosura jashtë pjesës së Unionit të zonës së programit nuk duhet të tejkalojë 20% të mbështetjes nga ERDF në nivel programi.

Konteksti i programit

Programi i ADRION-it përfaqëson kuadrin e gjerë të politikave që drejton përpjekjet e zhvillimit në nivelet makrorajonale dhe kombëtare. Procesi i hartimit u drejtua kryesisht në përputhje me qëllimet dhe prioritetet e identifikuar në strategjitë multitematike në nivelet makrorajonale dhe të BE-së:

Strategjia Europa 2020 (EU2020), një instrument për të koordinuar nivelet e politikave kombëtare dhe të BE-së për të përgatitur dhe për të ruajtur zhvillimin evropian, fokusohet në tri shtyllat e nocionit të zhvillimit: të mençur, të



qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Mekanizmi i nevojshëm për të arritur qëllimet e mësipërme përfshin Programet e Reformës Kombëtare, objektivat e të cilit ndjekin objektivat EU2020 në nivel kombëtar.

Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian - EUSAIR përshkruhet në 2 dokumente:

(1) Komunikata nga Komisioni Europian drejtuar institucioneve të tjera të BE-së (COM (2014) 357 final i datës 17.6.2014);

(2) Plani i Veprimit, në lidhje me Strategjinë e Bashkimit Europian për Rajonin e Adriatikut dhe të Jonit, e cila plotëson Komunikatën ((SWD – Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit (2014) 190 final i datës 17.6.2014).

Strategjia fokusohet në katër (4) Shtylla: 1. *Zhvillimi/ose Rritja Blu*, 2. *Lidhjet e Rajonit*, 3. *Cilësia e Mjedisit*, 4. *Turizmi i qëndrueshëm*. Plani i Veprimit është një nga produktet e Strategjisë. Qëllimi i tij është për të shkuar nga “fjalët në veprime”, duke identifikuar prioritetet konkrete për rajonin makro. Ai është strukturuar në mënyrë të tillë që të reflektojë të katër shtyllat, si edhe temat e përzgjedhura nën secilën prej tyre, duke përfshirë edhe një listë treguese të aksioneve dhe shembujve të pranueshme të projektit.

Struktura e qeverisjes EUSAIR do të përcaktohet për të identifikuar dhe mbështetur veprimet/aksionet dhe projektet me vlerë makrorajonale. Në kuadër të Planit të Veprimit, struktura e qeverisjes duhet të identifikojë veprimet dhe projektet me vlerë makrorajonale dhe burimet e financimit, duke konsideruar edhe fondet e tjera në dispozicion të zonës (instrumenteve financiare të BE-së, kombëtare, rajonale dhe publike, kredi dhe fonde private). Programi ADRION mbështet qeverisjen dhe zbatimin e EUSAIR kryesisht nën Objektivin Tematik (OT) nr. 11. Mekanizmi koordinues i Strategjisë EUSAIR do të jetë i pranueshëm për mbështetje institucionale dhe administrative nga Programi ADRION.

Strategjia e Europës Juglindore 2020 (SEE 2020), e lançuar nga vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2011, pranon se bashkëpunimi i ngushtë mund të përshpejtojë arritjen e qëllimeve në sektorët kyç. Frymëzuar nga Strategjia e BE-së 2020, SEE 2020 është duke ndjekur objektiva të ngjashëm duke marrë parasysh specifikat rajonale. Strategjia ofron udhëzime të rëndësishme për vendet nga Ballkani Perëndimor, në arritjen e një

shkallë më të lartë të konvergencës me qëllimet e EU2020.

Strategjia makrorajonale për rajonin Alpin (EUSALP), që aktualisht është duke kaluar nëpër një proces konsultimi, mbështetet mbi tri shtylla të përgjithshme të veprimit: 1. Përmirësimi i konkurrueshmërisë, prosperitetit dhe kohezionit të rajonit alpin; 2. Garantimi i aksesit dhe ndërlidhjes për të gjithë banorët e rajonit alpin; 3. Kthimi i rajonit alpin në një rajon ekologjikisht të qëndrueshëm dhe tërheqës.

Në këtë kuadër janë identifikuar tri (3) shtylla tematike: Shtylla 1. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe promovimi i inovacionit në Alpe: nga teoria në praktikë, nga qendrat kërkimore të ndërmarrjet. Shtylla 2. Ndërlidhja për të gjithë: në kërkim të një zhvillimi të balancuar territorial përmes modeleve të lëvizshmërisë miqësore me mjedisin, sistemet e transportit dhe shërbimet e komunikimit dhe infrastrukturave. Shtylla 3. Sigurimi i qëndrueshmërisë në rajonin alpin: ruajtjen e trashëgimisë alpine dhe promovimin e një përdorimi të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe kulturore.

Strategjia e Rajonit të Danubit (EUSDR), zhvilluar në vitin 2010, trajton një gamë të gjerë çështjesh të cilat janë të ndara ndërmjet katër (4) shtyllave dhe 11 fushave prioritare. Plani i Veprimit dhe struktura qeverisëse kanë për qëllim të nxitin veprime të përbashkëta, koherente dhe reciprokisht mbështetëse që tregojnë përfitime të menjëhershme dhe të dukshme për njerëzit, trajtimin e sfidave të përbashkëta në rajoni - makro (ose në një pjesë të rëndësishme të tij).

Përgjigjet strategjike nga programi për të kontribuar në BE 2020

Siç u tha më herët, në vitin 2010, Bashkimi Europian dhe Shtetet Anëtare lançuan strategjinë EU2020 si një udhërrëfyes dhjetë vjeçar. Ajo përbën një kuadër të përgjithshëm strategjik që parashtron tri prioritet reciprokisht përforcuese (përcaktuar nga pesë objektivat e BE-së):

- Zhvillimi “i mençur”: për zhvillimin e një ekonomie të bazuar në dije dhe inovacion;

- Zhvillimi i qëndrueshëm: për promovimin e një ekonomie më të efektshme, të gjelbër dhe konkurruese të burimeve;

- Zhvillimi gjithëpërfshirës: për nxitjen e një ekonomie me punësim të lartë, që ofron kohezionin social dhe territorial.

Lidhja e Programit ADRION me synimet e strategjisë EU2020 sigurohet nga përcaktimi i



Objektivave Tematike (OT) (Neni 9 i Rregullores (BE) nr. 1303/2013) dhe nga kërkesa për përqendrimin tematik (neni 6 i Rregullores (BE) nr. 1299/2013). OT-të zbërthehen më tej në Prioritete Investimi (PI) (neni 5 i Rregullores (BE) nr. 1301/2013) dhe neni 7 i Rregullores (BE) nr. 1299/2013) dhe në Objektivat Specifike (OS). Akset Prioritare (AP) përcaktohen për të kombinuar PI-të që mbulojnë një ose më shumë OT (në rastet e një konteksti tematikisht koherent).

Programi ADRION përfshin një zonë të gjerë transkombëtare me më shumë se 70 milionë banorë dhe ka karakteristika të dallueshme fizike, mjedisore, social-ekonomike dhe kulturore. Për këtë arsye, ai trajton të tria dimensionet e qëndrueshmërisë, duke përfshirë aspektet sociale, ekonomike dhe mjedisore, por edhe elementet institucionale.

Ai do të organizohet (strukturohet) në katër Akse Prioritare (AP) që kanë për qëllim të zhvillojnë politika dhe veprime të koordinuara në zonën e Programit me synim përfundimin e arritjeve të strategjisë EU2020 drejt një zhvillimi të zgjuar, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Duke marrë parasysh rolin potencial të Programit ADRION si një mekanizëm koordinues për Instrumentet, përpunimi i tij është bërë duke iu referuar Marrëveshjeve të Partneritetit të Shteteve Partnere të përfshira/Fondeve strukturore kombëtare/rajonale të programeve operacionale, IPA II - Dokumentet Strategjike të vendit dhe multivendeve të Shteteve Partnere dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare të nënshkruara për zhvillimin e Ballkanit Perëndimor (p.sh.: Traktati i Komunitetit të Energjisë http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME~HEAD=pobj).

Mësimet e nxjerra

Sipas Raportit të 3-të të Vlerësimit (nëntor 2013) të Programit të Evropës Juglindore (SEE), rezultatet më të rëndësishme të programit kanë të bëjnë me partneritetet e krijuara dhe shkëmbimin e përvojës - (progresi i mirë me standardet e përbashkëta të zhvilluara nën të gjitha akset prioritare); përveç kësaj, raporti thekson:

- shpërndarja e mirë e asistencës për sektorin privat në fushën e inovacionit - është arritur tashmë tejkalimi domethënës i objektivave në numrin e SME-ve dhe sektorit privat;

- dëshmia mbi masat e zbatuara me sukses dhe shërbimet për mbrojtjen e mjedisit, parandalimin e rrezikut dhe efikasitetin e burimeve.

Veç kësaj, vlerësimi i rezultateve të programit (në bazë të projekteve të përfunduara sipas thirrjes së 1-rë) tregon një numër faktorësh të cilët pengojnë arritjen e rezultateve dhe zvogëlojnë kontributet e pritshme, të tilla si:

- Vështirësitë për të arritur te përfutjesit fundorë (të gjitha akset prioritare, përveç aksit prioritar nr. 2);

- Vështirësitë për të bashkëpunuar me administratën publike (aksi prioritar nr. 1);

- Vështirësitë për të përfshirë sektorin privat (aksi prioritar nr. 3);

- Vështirësitë për të promovuar rezultatet për administratat publike (aksi prioritar nr. 3).

Mësimet e nxjerra nga programi MED gjatë periudhës së programimit të mëparshëm 2007-2013, nxjerrja në pah e vështirësive në gjenerimin e projekteve në fusha të veçanta të ndërhyrjes si transporti, siguria detare dhe rreziqet natyrore. Nga ana tjetër, aktivitetet që lidhen me inovacionin, por edhe me çështjet e mjedisit kanë qenë mjaft të suksesshme dhe luajnë një rol të rëndësishëm në Aksin 1 (OT1) dhe Aksin 3 (OT6) të programit MED 2014-2020.

Kur është fjala për mësimet e nxjerra nga programi IPA CBC Adriatik, ne mund t'i referohemi vetëm raportit të parë të vlerësimit në vazhdim e sipër të 2011: në bazë të konkluzioneve të tij, shumica e 33 projekteve të miratuara (56%) kanë për qëllim zhvillimin e mjeteve të përbashkëta, 25% ndajnë ose përdorin objektivin e përpunimit të strategjive dhe politikave të përbashkëta, ndërsa pjesa e mbetur prej 19% ka për qëllim zbatimin e aksioneve pilot.

Konkluzionet kryesore në kontekstin ekonomik, territorial dhe social të zonës ADRION

- Ky seksion jep një përshkrim të përfundimeve kryesore të zonës ADRION.

- **Demografia:** Zona e Adriatikut karakterizohet nga një mosbalancim i fortë në zhvillimin rajonal (kohezioni territorial i dobët), kombinuar me plakjen e popullsisë dhe shpopullimin në zonat malore dhe rurale; migrimi i brendshëm është gjithashtu një çështje e rëndësishme për këtë zonë.



- **Ekonomia dhe tregu i punës:** Të gjitha shtetet partnere të përfshira në Programin ADRION janë prekur nga kriza ekonomike globale.

- Pjesa më e madhe e shteteve partnere ERDF të përfshira në Programin ADRION përballen me probleme të mëdha ekonomike dhe kanë burime publike të limituara:

- PBB dhe nivelet e punësimit që nuk janë kthyer ende në nivelet e parakrizës;

- Nivelet e larta të papunësisë, varfërisë dhe përjashtimit;

- Të ardhurat e reduktuara të familjes, që zvogëlon konsumin dhe importet;

- Nivelet e paprecedenta të borxhit publik dhe nevoja për konsolidimin fiskal.

Përkundrejt këtij sfondi, programet e ardhshme të kohezionit do të vënë theks të veçantë në rritjen e zhvillimit dhe të investimeve për krijimin e vendeve të punës. Vetëm një rimëkëmbje e qëndrueshme dhe e fortë mund të zvogëlojë shkallën e papunësisë. Kjo është arsyeja pse Komisioni Evropian propozon që të përqendrohen burimet në disa fusha të rëndësishme si punësimi (veçanërisht për të rinjtë), trajnimi dhe arsimimi, përfshirja sociale, inovacioni dhe SME-të, për një ekonomi me karbon të ulët dhe efikasitet të lartë të energjisë, dhe që është e hapur për ta zgjeruar të Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), infrastrukturës dhe masat digjitale të rritjes.

Mjedisi: Zona ADRION ka një ekosistem të jashtëzakonshëm mjedisor, shumë delikat, subjekt i një sërë presionesh që lidhen me bujqësinë, industrinë, aktivitetet portuale, veçanërisht në cilësinë e ujit dhe zonat bregdetare. Zona ADRION preket edhe nga turizmi sezonal dhe urbanizimi njëdimensional, që çojnë, *ndër të tjera*, në humbjen e biodiversitetit dhe fragmentizimin e ekosistemit; Investimet në infrastrukturën mjedisore, teknologjitë e reja për parandalimin e rreziqeve natyrore dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë janë të ulëta. Për më tepër, niveli i avancimit në *acquis* të BE-së të vendeve kandidate partnere tregon përparime të moderuara, duke theksuar nevojën për forcimin e kapaciteteve institucionale, në të gjitha nivelet, për të zbatuar legjislacionet dhe politikat që synojnë nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe një përdorim më të ekuilibruar të burimeve natyrore të mjedisit.

Faqe | 3796

- **Uji:** Aksionet strategjike duhet të ndërmerren në një nivel ndërkufitar/makrorajonal për të promovuar balancimin ndërmjet kërkesës dhe ofertës, përveç përmirësimit të cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të ujit (reduktimin e humbjeve të ujit dhe rritjen e efikasitetit në bujqësi). Veç kësaj, zhvillimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve ujore jokonvencionale të tilla si ripërdorimi i ujërave të përdoruara të trajtuara duhet të rritet në mënyrë të konsiderueshme.

- **Mbetjet:** Menaxhimi i mbetjeve në zonën e Programit tregon një nivel të ulët të qëndrueshmërisë. Zhvillimi i mëtejshëm i sistemeve të integruara të administrimit të mbetjeve, si dhe mbështetje për kërkimin, inovacionin dhe transferimin e teknologjisë në lidhje me trajtimin e mbeturinave/mbetjeve dhe riciklimin janë të nevojshme.

- **Cilësia e ajrit:** Zona e Programit po përballlet me probleme për sa i përket ndotjes së ajrit (në veçanti grimcat (PM) NO₂ (dyoksidit të azotit) dhe SO₂ (dyoksidi i squfurit) për shkak të transportit dhe djegies së lëndëve djegëse të ngurta për ngrohje të brendshme/shtëpie).

- **Biodiversiteti:** Zona e Programit karakterizohet nga një larmi e madhe e habitateve dhe specieve tokësore dhe ujore. Topografia e ndryshme, ndryshimi klimatik dhe veprimtaria e njeriut kanë çuar në një rrezatim evolucionist të jashtëzakonshëm. Do të zbulohen më shumë se 25.000, gjysma e të cilave konsiderohet të jenë endemike, duke e bërë zonën një “Pikë të Nxehtë Biodiversiteti Global”. Rrjetet e EMERALD-it dhe më pas të NATURA-s janë një hap i parë i rëndësishëm në përpjekjen për t’u përputhur me detyrimet ndërkombëtare dhe të BE-së që kanë të bëjnë me mbrojtjen e diversitetit (shumëllojshmërisë) biologjike, burimet gjenetike, speciet dhe ekosistemet. Megjithatë, niveli i tyre i zbatimit nuk është i kënaqshëm, sepse mungojnë kapacitetet efektive të menaxhimit. Gjithashtu, ndikimi i njeriut për shkak të ndotjes, përdorimit të tokës, aktivitetëve të lira etj., është në rritje veçanërisht në zonat shumë të brishta, si ekosistemet bregdetare.

- **Menaxhimi i integruar i zonës bregdetare.** Brigjet e Adriatikut dhe Jonit po përballen me një proces të madh të urbanizimit dhe presionin e shkaktuar nga peshkimi dhe akuakultura mekanike; kjo ka një



ndikim të rëndësishëm mjedisor që rezultojnë në humbjen e biodiversitetit, fragmentimit të ekosistemit, shkretimit, ndërhyrjes së ujit të kripur dhe mbipopullimit. Menaxhimi i integruar i zonës bregdetare në nivel ndërkufitar duhet të forcohet, edhe duke përmirësuar politikën e integritetit të zonës bregdetare me zhvillimin social-ekonomik territorial në mënyrë të qëndrueshme. Vlerësimi strategjik i zonës bregdetare për të rritur fleksibilitetin bregdetar dhe për të parandaluar ndikimet negative të rreziqeve natyrore (vërshimet, erozioni, ndërhyrjet e ujit të kripur) të shkaktuara nga ndryshimi i klimës, gjithashtu, duhet të promovohet.

- *Parandalimi i riskut*: Vendet e përfshira në Program duhet të përballen me mungesën e të dhënave homogjene dhe të krahasueshme për planifikim hapësinor/territorial që trajtojnë politikën e parandalimit të rreziqut, strategjitë dhe planet. Si rezultat, një investim i nivelit të përshtatshëm për të mbështetur zbatimin ndërkufitar dhe testimin e teknologjive të reja për parandalimin e rreziqeve natyrore dhe rreziqeve teknologjike duhet të sigurohet.

- *Energjia*: Pjesa e energjisë nga burimet e rinovueshme (në % të konsumit final bruto të energjisë) në këtë zonë është mbi mesataren (rreth 24%), së bashku me Shtetet Partnere IPA që llogarisin aksione më të larta, edhe pse hendeuku mund të jetë i njëanshëm me të dhëna disi të vjetëruara. Viti 2012 vërejti një ndryshim në bilancin e investimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë botërore: ekuilibri në investimet e përgjithshme ndryshoi nga afërsisht në dy të tretat - në një e treta ndërmjet ekonomive të zhvilluara dhe më pak të zhvilluara në atë që ishte shumë më afër 50:50. Brenda zonës Adrion, shtrydhja e subvencioneve në Itali shkaktoi një rënie të investimeve (-53% investime të reja në energjinë e rinovueshme - RE - në vitin 2011) dhe recesioni ngadalësoi skemën sllovene për mbështetje financiare e filluar në vitin 2002 dhe e përditësuar në vitin 2009. Investimet janë të nevojshme për të përmbushur objektivin e rinovueshme, por sfida qëndron për të investuar në llojin e drejtë të rinovueshmes. E njëjta gjë vlen edhe për Greqinë dhe Kroacinë, siç raportohet së fundmi në planet e tyre kombëtare të miratuara nga qeveritë në vitin 2013, së bashku me nevojën për të përshpejtuar licencimin e projekteve. Në Shtetet Partnere,

instrumentet kryesore të financimit për efikasitetin e energjisë - EE- dhe - RE - janë të siguruar nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe të BE-së, dhe janë në dispozicion si kredi që mund të arrihen/aksesohen nëpërmjet bankave lokale. Sistemet e energjisë në rajon janë të fragmentuara; shumica e vendeve që kanë tregje të vogla, të cilat mund të jenë më pak tërheqëse për investitorët. Koordinim më të mirë dhe rritje të tregtimit të energjisë mund të zvogëlojë kërkesat për investime për prodhimin e energjisë elektrike me rreth 10% deri në vitin 2020, në bazë të Studimit për Investime në Prodhimin e Energjisë, kryer për Bankën Botërore (Banka Botërore, 2007).

Topografia dhe përdorimet e tokës

Zona e Programit ADRION karakterizohet nga një sipërfaqe e konsiderueshme malore (Shqipëria, Greqia, Mali i Zi dhe Sllovenia janë disa nga zonat më malore në Evropë). Diversiteti topografik në vende të veçanta (llogaritja në bazë të formës gjeografike dhe variacionit të lartësisë) dhe zona në tërësi është shumë e lartë; përjashtime nga rregulli përbëjnë Italia dhe Serbia me rrafshinat/fushat në veri dhe verilindje, dhe vargmalet e moderuara në anën jugore.

Zona ka një shkallë relativisht të lartë të mbulimit pyjor (edhe pse përqindjet ndryshojnë ndërmjet burimeve të ndryshme për shkak të metodave të ndryshme të përdorura), e cila është gjithsesi nën kërcënim. Bujqësia është faktor përcaktues i rëndësishëm i peizazhit, duke ndikuar kështu biodiversitetin dhe atraktivitetin e zonës. Megjithatë është sektor i rëndësishëm ekonomik, në shumë raste është edhe faktor i rëndësishëm presioni mjedisor në zona të tilla si në luginën Po në Itali, Vojvodinën në Serbi ose Maqedoninë Qendrore dhe Thesalisë në Greqi për shkak të shkarkimeve të lëndëve ushqyese dhe pesticideve. Përdorimi i ujërave të ëmbla/të freskëta ndryshon konsiderueshëm nga 2% në Serbi në 89% në Greqi; ndryshimi duhet të konsiderohet për shkak të rëndësisë së bujqësisë në ekonomi (p.sh., në Shqipëri), varësia e bujqësisë për ujitjen dhe reshjet, por edhe shkalla e specializimit dhe sofistikimi i fermave bujqësore (p.sh., serrat dhe pambuku në Itali dhe Greqi).

Për sa i përket nxjerrjes së ujërave të freskëta në sipërfaqe për frymë në zonën e Programit, vëllimet më të larta janë vërejtur në Greqi (521 m³ në vitin 2007) dhe në Serbi (506 m³ në 2011); ndërsa më të



ulëtat janë regjistruar në Kroaci (133 m³ në 2011). Shteti Partner ERDF me nxjerrjen më të lartë të ujit të freskët për frymë ishte gjithashtu Greqia (327 m³ në vitin 2007) (Burimi: Eurostat (2014) kod i të dhënave *online*: env_wat_abs); ndërsa dendësia e popullsisë nuk ndryshon në mënyrë të konsiderueshme (Italia dhe Mali i Zi bëjnë përjashtime), ka dallime shumë më të mëdha në vetë vendet, të tilla si Greqia (Athinë dhe Selanik), Itali (Lombardia, Veneto, Emilia-Romagna, Puglia) dhe Serbia (Beograd). Vendet më të vogla, më policentrike, si Bosnja dhe Hercegovina dhe Sllovenia kanë një numër më të lartë të popullsisë rurale dhe popullsisë që jeton në qytete më të vogla. Këto modele kanë implikime të rëndësishme si në nivelin e presionit të njeriut në fusha të veçanta, por edhe në raport me ekzistencën e habitateve të pacopëtuara dhe zonat natyrore.

Shtetet Partnere ADRION praktikojnë qasje të ndryshme për menaxhimin e ujit. Përveç konsumit të lartë të ujit në tërësi, i cili shkaktohet pjesërisht nga çmimet e ulëta të ujit dhe normat e ulëta të mbledhjes, problemet e tjera në sistemin e furnizimit me ujë përfshijnë mungesën e ujit, veçanërisht në rajonet bregdetare gjatë sezonit të verës, si dhe nivelin e pamjaftueshëm të mbulimit të zonave rurale me sistemet publike të furnizimit me ujë (me kontroll të dobët të cilësisë së ujit për ujërat nga sistemet rurale të furnizimit me ujë dhe burime të tjera). Cilësia e ujit të pijshëm monitorohet rregullisht për sistemet publike të furnizimit me ujë dhe kërkesat e cilësisë janë në përputhje me standardet e OBSH-së dhe të BE-së. Një problem tjetër është mungesa e paratrajtimit të ujërave të ndotura industriale të shkarkuara në sistemet publike të kanalizimit, si dhe niveli i ulët i lidhjes së banesave me kanalizimet, veçanërisht në zonat e thella.

Në fushën e **gjenerimit të mbetjeve**, zona karakterizohet nga nivele më të ulëta të mbetjeve sesa në EU28, por me rritje të shpejtë të niveleve për frymë dhe përgjithësisht mekanizma të dobët koordinimi për menaxhimin mbetjeve, me struktura të kufizuara të riciklimit dhe mbështetje të madhe depozitimi/venddepozitimet (shpesh të pakontrolluara).

Ka pasur dallime të konsiderueshme midis vendeve, si në sasinë e mbetjeve të gjeneruara në vitin 2010 dhe aktivitetet që kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në prodhimin e

mbetjeve. Shuma totale e mbetjeve të prodhuara varionte ndërmjet 3.158 tonë në Kroaci dhe 158.628 mijë tonë në Itali, që është më shumë se Greqia, Kroacia, Sllovenia dhe Serbia së bashku. Lidhur me prodhimin e mbetjeve nga aktiviteti, të ndërtimit llogariten për pjesën më të madhe të mbeturinave të gjeneruara. Industria e përpunimit llogaritet për pjesën më të madhe të mbetjeve të gjeneruara në Slloveni (29%) dhe Kroaci (20%).

Duke pasur parasysh menaxhimin e mbetjeve, studimet e fundit i kanë grumbulluar vendet në nivele të ndryshme të performancës:

- Vendet me performancë të lartë, të cilat në përgjithësi kanë përmbushur apo tejkaluar objektivat e legjislacionit të BE-së për mbetjet;

- Vendet me performancë të mesme/tranzitore (përfshirë Italinë, Slloveninë) zakonisht karakterizohen nga riciklimi i nivelit të mesëm, rreth 25-30%, dhe depozitimit (venddepozitimet) ndërmjet 35-50%. Janë bërë ndryshime të rëndësishme në Slloveni krahasuar me praktikën e para-BE për menaxhimin e mbetjeve, por ende është nën investigim nëse dhe në çfarë mase duhet të mbështeten nga kornizat politike, ekonomike dhe infrastrukturore. Për shumë nga vendet me performancë të mesme është e nevojshme vënia në fokus e ngritjes së kuadrit të duhur politik, ekonomik dhe të infrastrukturës për të shmangur largimin e mbeturinave nga depozitimi/venddepozitimi te djegia në vend të riciklimit;

- Vendet me performancë më të ulët/të kufizuar (përfshirë edhe Greqinë) në përgjithësi ende kanë nivele jashtëzakonisht të larta të depozitimit/venddepozitimit, që është niveli më i ulët i hierarkisë së mbetjeve dhe për këtë arsye nuk është në përputhje as me frymën ose letrën e legjislacionit të BE-së. Nivelet e riciklimit dhe kompostimit mbeten shumë të ulëta.

Veç kësaj, vendet me performancë më të ulët shpesh nuk kanë apo kanë vetëm skema shumë të dobëta në funksionim, qoftë për të zbatuar elementet e përgjegjësisë së prodhuesit sipas direktivave të riciklimit apo detyrimin e banesës/familjes për grumbullimin e mbeturinave ose për të nxitur trajtimin në nivelet më të larta të hierarkisë së mbetjeve nëpërmjet depozitimeve/venddepozitimeve dhe taksat për djegien apo tatimet.



Aksesibiliteti⁵

Një nga karakteristikat kryesore që karakterizojnë zonën e Programit është mosbalancimi në zhvillimin e infrastrukturave dhe mënyrat e transportit, si midis të dy brigjeve të detit Adriatik edhe ndërmjet Shteteve Partnere, për shkak të dobësive strukturore, nivelit të ulët të mirëmbajtjes dhe investimeve të vogla në infrastrukturat. Veç kësaj, mungesa e lidhjeve ndërmjet zonave bregdetare dhe në brendësi të çon në presion të lartë në rrugët bregdetare dhe ngushtimet e rrugëve. Faktikisht, transporti rrugor është mënyra më e zakonshme e transportit si për mallrat edhe për udhëtarët në të gjithë zonën. Transporti detar është rritur në Malin e Zi (+ 19%), Slloveni (+ 11%) dhe Kroaci (+ 9%); transporti ajror i udhëtarëve është rritur shumë, edhe pse me ritme të ndryshme; ndërsa transporti hekurudhor ka rënë pothuajse në të gjithë zonën e bashkëpunimit. Mungesa e të dhënave të transportit ujor në brendësi thekson edhe një herë mungesën e të dhënave dhe treguesve të përbashkët për infrastrukturat dhe shërbimet e transportit veçanërisht në nivel rajonal.

Mbledhja e të dhënave të përbashkëta dhe metodologjia e përpunimit nevojiten për të monitoruar kushtet e transportit dhe aksesibilitetit dhe në fund për të kapërcyer ndërprerjet përtej kufijve, për përmirësimin e shërbimeve aktuale dhe zhvillimin e infrastrukturës ekzistuese në sistemet multimodale. Në këtë mënyrë, është e këshillueshme të forcohen kapacitetet administrative (në veçanti në transportin detar, atë ujor në brendësi dhe në logjistikë) dhe të mbështeten investimet rajonale në infrastrukturat, rrjetet e transportit multimodal dhe mjetet e transbordimit. Kjo e fundit do të ndihmojë edhe në përafrimin e legjislacionit të Shteteve Partnere IPA me standardet evropiane, përfshi sigurinë dhe liberalizimin e tregut.

⁵ Informacion më të hollësisht dhe të dhënat për aksesibilitetin në Evropën Juglindore janë mbledhur dhe përpunuar nga projektet e SEE-së dhe janë në dispozicion këtu: http://www.southeast-europe.net/en/achievements/outputs_library/. Në veçanti shih arritjet dhe rezultatet e projektit SEETAC <http://www.seetac.eu/download/results.aspx> dhe Projektit SETA <http://www.seta-project.eu/index.php/start> dhe WATERMODE <http://www.watermode.eu/> dhe RAIL4SEE <http://rail4see.eu/downloads/deliverable/>.

Efikasiteti i logjistikës dhe zhvillimi ekonomik

Rrjetet/zinxhirët e zhvillimit të logjistikës lidhen rigorozisht me proceset ndërkombëtare të integritetit ekonomik, meqë zinxhirët e logjistikës lidhin prodhimin dhe shpërndarjen e mallrave nëpërmjet këtyre sistemeve të transportit në gjendje për të garantuar shërbime të besueshme.

Sot, shkëmbimi kryesor tregtar midis zonës ADRION dhe BE-së i paraqet vendet e Ballkanit më aktive në importin e industrisë përpunuese kundrejt lëndëve të para dhe të eksportit bujqësor dhe ushqimor, me një lidhje të qartë, të paequilibruar transporti.

Ky mund të jetë një dëm për aktivitetet e transportit meqenëse kthimi i zbrazët mund të ketë ndikim negativ në koston përfundimtare të mallrave në treg.

Organizimi më i mirë intermodal dhe pajisjet ndihmojnë për të reduktuar kostot e transportit dhe performancat mjedisore kryesisht referuar transportit rrugor, në saje të një përdorimi racional të flotës së kamionëve dhe përmirësimit progresiv të standardeve operacionale nga ana e automjetit ekzistues në përdorim, të cilat janë ekonomikisht konkurruese në performancat mjedisore në humbje.

Në të njëjtën kohë, cilësia e shërbimit hekurudhor drejtohet kryesisht në plotësimin e transportit të mallrave me vlerë të ulët apo ato të cilat nuk kërkojnë shpejtësi të lartë tregtare.

Procesi i integritetit ekonomik i BE-së të zonës ADRION mund të nxisë me siguri një zhvillim më të mirë të sektorit të transportit për sa kohë që vendet që kanë zgjedhur integritetin në BE do të jenë në gjendje të riorganizojnë sistemet e tyre të transportit të brendshëm, në mënyrë efikase dhe konkurruese; më në përgjithësi, kostoja e thjeshtë e transportit nuk është mënyra për të qenë konkurrues në tregun e transportit të BE-së.

Duke konsideruar ndërhyrjet e qëndrueshme në lidhje me burimet në dispozicion, mund të supozohet se intermodaliteti në zonën ADRION mund të përfitojë nga rritja e efikasitetit të njeve intermodale - portet, *fshatrat* e mallrave, *oborret* e mallrave - duke ndërhyrë në grykat/ngushticat e tyre të hyrjes, të magazinimit dhe zonat e parkimit, si dhe efikasitetin e teknologjive intermodale të transferimit.

Gjithashtu, çështjet për lehtësimin e tregtisë dhe mbështetja për modernizimin e rrjeteve që lidhen



me transportin, doganat dhe pikat e kalimit kufitar dhe shërbimeve portuale dhe operacionet janë pikat e vëmendjes për zonën.

Trashëgimia kulturore

Përveç biodiversitetit të saj të pasur, zona e Programit përfaqëson një nga rajonet më të pasura në Europë në aspektin e diversitetit kulturor, me tradita të dallueshme, të gjuhëve, feve dhe monumenteve arkitekturale, duke filluar që nga antikiteti deri në kohët moderne.

Trashëgimia kulturore e pranuar në masë të madhe në zonën e Programit ka një numër të madh të vendeve nën mbrojtje. Ndodhen 62 *site* të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në zonë (55 kulturore, 5 natyrore dhe 2 të përziera), që mbulojnë një total prej 347.000 hektarë, duke krijuar së bashku një destinacion shumë tërheqës për turizmin. Prej këtyre, 23 gjenden në rajonet italiane, 19 në Greqi, 7 në Kroaci, 4 në Serbi dhe pjesa tjetër në vendet e tjera.

Megjithatë, niveli i kushteve, aksesibilitetit dhe prezantimit ndryshon në mënyrë të konsiderueshme midis vendeve. Për të vlerësuar siç duhet këto asete përmes turizmit nevojiten përpjekje të mëtejshme për përmirësimin e menaxhimit të *site*-ve, si në aspektin e ruajtjes, ashtu edhe në aplikimin e metodave të qëndrueshme të shfrytëzimit.

Programi ADRION mund të ofrojë kornizën optimale për koordinimin e veprimeve të tilla dhe të mbështesë zhvillimin e strategjive transnacionale për promovimin së bashku të rajonit si një destinacion turistik.

Diversiteti kulturor mund të përfaqësojë një potencial të lartë për zhvillimin; bashkëjetesa e grupeve të shumta etnike, gjuhësore dhe fetare krijon terrenin për komunikimin më të lehtë dhe bashkëpunimin më intensiv. Kjo është edhe më e forcuar nga numri i madh i emigrantëve të përqendruar përreth qyteteve kryesore të rajonit, përveç azilkërkuesve dhe përfituesve të tjerë të mbrojtjes ndërkombëtare, numrat e të cilave në rajon janë gjithnjë e më të rëndësishme.

Mjedisi specifik i multikulturalizmit përbën një burim për zhvillimin e krijimtarisë kulturore dhe rritjen e industrive kreative, një sektor dinamik i cili mund të rrisë atraktivitetin e rajonit dhe të *kontribuojë në më shumë vende pune më të mira si në kulturë dhe turizëm*.

Turizmi

Duke qenë një nga sektorët më të rëndësishëm në zonën ADRION, turizmi ka një lidhje të fortë me rritjen ose zhvillimin në Shtetet Partnere, megjithëse është ende i përqendruar në resortet bregdetare dhe karakterizohet nga sezonaliteti i lartë. Në fakt, e gjithë zona e bashkëpunimit ka potencial të lartë për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit kulturor në qytetet kryesore, shumica e të cilave janë pjesë e trashëgimisë UNESCO, dhe të turizmit të qëndrueshëm në lidhje me pasuritë mjedisore.

Pavarësisht potencialit të tij të madh, turizmi vuan nga një sërë dobësish, që duhet të trajtohen dhe nga disa rreziqe që gjenerojnë ndikime negative në mjedis, që duhet të shmangen ose të menaxhohen si duhet, të tilla si kongjestioni (mbipopullimi, dyndja) në masë të turizmit sezonal. Është e këshillueshme të promovohen masat për integrimin e politikave të qëndrueshme për mbrojtjen dhe përmirësimin e burimeve natyrore, peizazhit dhe trashëgimisë kulturore, në kuadër të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm. Nxitja e partneriteteve institucionale dhe publike-private, përveç përfshirjes së komuniteteve lokale, mund të kontribuojë për të kapërcyer modelet e dobëta shumënivelshe/ shumëdimensionale të qeverisjes për planifikimin hapësinor dhe strategjik dhe për të zhvilluar një kuadër më të integruar, miqësor dhe mjedisor.

Zona ka mijëra kilometra (km) plazhe të pacenuara, mbi 10.000 ishuj (në Greqi, Kroaci, Itali), si edhe peizazhe mahnitëse malore, lumenj të rëndësishëm (Danubi, Po, Axios, Ardas-Evros me potencial të madh për zhvillimin e turizmit të lumenjve), një shumëllojshmëri të gjerë të vendpushimeve SPA dhe burimeve termale, dhe, mbi të gjitha, disa parqe dhe zona të mbrojtura.

Gjithashtu, oferta kulturore e zonës ADRION është shumë e rëndësishme: qindra vjet sundime/dominime të ndryshme kanë ndikuar në mënyrë të pashmangshme kulturën dhe arkitekturën e pjesës më të madhe të rajoneve të zonës, të cilat kanë qytete të jashtëzakonshme dhe të gjalla/aktive, manastiret mesjetare, artet, *site*-et e shumta arkeologjike dhe traditat. Për të theksuar këtë trashëgimi të gjerë, zona ADRION krenohet me 62 *site*-et e gdhendur në Listën e UNESCO-s, që përfaqësojnë 16% të *site*-eve të UNESCO-s europiane.



Trashëgimia e larmishme etno-gastronomike dhe ajo popullore artizanale është gjithashtu pjesë e burimeve turistike të zonës ADRION. Shumica e rajoneve pjesëmarrëse kanë një traditë të gjatë kulinarie dhe në disa raste produktet e tyre tipike (bujqësore dhe zejtarie) shkaktojnë flukse të rëndësishme turistike të vendit.

Për fat të keq, ky ekosistem i jashtëzakonshëm mjedisor dhe trashëgimia kulturore e zonës ADRION vuajnë nga dy probleme të kundërta dhe të ndryshme: në disa pika bregdetare, presioni i tepruar aplikohet nga të njëjtat vendbanime turistike; në disa pjesë të tjera destinacionesh të vogla, trashëgimia natyrore dhe kulturore ende nuk është përmirësuar mjaftueshëm ose ngandonjëherë është e paarrtshme (nuk ka transport publik ose ka shenja të pamjaftueshme rrugore), apo edhe mbyllur për publikun, ose ka mungesë infrastrukture “ndriçimi” (sinjalistika e rrugëve, pikat e informacionit etj.). Gjithashtu, shërbimet e specializuara të nevojshme për të kënaqur jo vetëm pushuesit e organizuar (individët), por edhe disa segmente të veçanta të tregut (turistët aktivë), që janë të dhënë pas sporteve, si: ekskursionet, udhëtimet e gjata në këmbë, kalërimin, çiklizmin, mungojnë tërësisht.

Kërkimi dhe inovacioni

Zona është duke luftuar për ndërtimin e sistemeve efikase të kërkimit dhe inovacionit. Intensiteti i K&Zh është në përgjithësi në rritje (rreth 0.75% në Kroaci, 2.47% në Slloveni, 1.25% në Itali, 0.60% në Greqi dhe një mesatare prej 0.3% në shtetet partnere të IPA-s), por kërkohen ende përpjekje për të rritur investimet në K&Zh, veçanërisht investimet e biznesit, për ndërtimin e kapaciteteve në fushat kryesore të teknologjisë dhe për të përmirësuar konkurrencën ndërkombëtare dhe të tregtisë duke prodhuar më shumë mallra të orientuara drejt teknologjisë-intensive për të dyja tregjet të brendshme dhe të jashtme. Për shkak të nevojës së hapjes së tregjeve të modeleve më konkurruese dhe më inovative, veçanërisht për të përballuar efektet e krizës, është e nevojshme të zhvillohen politika që nxisin kërkimin dhe inovacionin (K&I) dhe u japin prioritet investimeve në firmat të lidhura direkt me K&I. Skemat e bashkëpunimit midis institucioneve territoriale, sektorit të biznesit dhe universiteteve, institutet teknologjike, parqeve teknologjike, institutet kërkimore duhet të mbështeten, ndërsa bashkë-

punimi sistematik ndërmjet kërkimit dhe kompanive private/publike duhet të përforcohet. Strukturat mbështetëse të tilla si inkubatorët dhe sistemet e grupeve duhet të përmirësojnë bashkëpunimin teknologjik dhe ekspertizën ndërmjet SME-ve. Forcimi i shoqërisë së informacionit të njohurive dhe zhvillimi i TIK-ut mund të kontribuojnë për të përmbushur objektivat e zhvillimit që lidhen me kërkimin dhe inovacionin.

Pikat kryesore nga analiza e K&I dhe indikatorëve të performancës të SME-ve janë si më poshtë:

- Me përjashtim të Sllovenisë, të gjitha Shtetet Partnere ADRION FERS alokojnë pjesë në mënyrë të konsiderueshme më të ulëta të **PBB-së** për **K&Zh (GERD= Shpenzimet Bruto për Kërkimin dhe Zhvillimin)** në krahasim me mesataren e BE-së; në mënyrë të ngjashme pjesa për biznesin në **GERD** është më pak se mesatarja e BE-së (përsëri Sllovenia është më afër standardeve të BE-së); gjithashtu, Shtetet Partnere IPA kanë një GERD shumë të ulët.

- **Normat e aplikimit për patentim** janë të ulëta në Greqi, Kroaci, Serbi dhe Shqipëri; Italia dhe Sllovenia performojnë më mirë, por ende shumë poshtë standardeve të BE-së;

- Greqia dhe Kroacia janë nën nivelet mesatare të BE-së në lidhje me **punësimin në sektorët me teknologji - të lartë**; Italia dhe Sllovenia veçanërisht të performojnë më mirë (kjo e fundit mbi mesataren e BE-së);

- Të gjitha Shtetet Partnere ADRION ERDF paraqesin tregues mesatarë të rëndësishëm për punësimin në **shërbimet e njohurive - intensive**;

- Performanca e **konkurrueshmërisë së SME-ve** të Sllovenisë është e krahasueshme me mesataren e BE-së; Italia dhe Greqia mbeten pas (kjo e fundit deri tani);

- Greqia dhe Kroacia paraqesin norma ndjeshëm më të ulëta të **punësimit**; Italia dhe kryesisht Sllovenia paraqesin norma mesatare të krahasueshme të BE-së; shkallët e **papunësisë** në Kroaci dhe në veçanti në Greqi janë mjaft mbi mesataren e BE-së;

- **Investimet** në Greqi janë nën mesataren e BE-së; Sllovenia, Kroacia dhe Italia performojnë më mirë;



- Fuqia punëtore e Sllovenisë është e orientuar drejt **industrisë, TIK-ut dhe shërbimeve financiare**; Italia dhe Kroacia ndjekin këtë model në një nivel mesatar të BE-së; fuqia punëtore e Greqisë është më pak të punësuar në këta sektorë;

- **Rajonet sllovene** karakterizohen si “rajone të përparuara prodhuese” dhe “rajone teknologjikisht të avancuara” dhe “rajone shkencore”;

- **Rajonet e pranueshme italiane Adrion** kanë profile shumë të ndryshme (nga “rajonet me teknologji të ulët” në “rajone të përparuara prodhuese” dhe “rajone me shërbime të përparuara” dhe nga “rajone me kërkime intensive” në “rajone pa asnjë specializim në aktivitetet e dijes”);

- **Rajonet greke** karakterizohen si “teknologji e ulët”; “rajone që nuk kanë specializime në aktivitetet e dijes” dhe “rajone jointeraktive”; Megjithatë, disa prej tyre duket të jenë në procesin e diversifikimit të modelit të tyre të prodhimit (“zonë me diversifikim të mençur dhe krijues”).

Qeverisja EUSAIR

Vëmendje e veçantë i është kushtuar analizës së nevojave paraqitur nga Komisioni Evropian në kuadër të hartimit të Strategjisë EUSAIR sa i përket sistemit të qeverisjes që do të miratohet për

zbatimin e EUSAIR-it. Analiza e nevojave të palëve të interesuara u bazua në rezultatet e konsultimeve publike dhe seminareve të organizuara që nga viti 2013. Disa nga konkluzionet kryesore janë përmbledhur më poshtë:

- duhet të forcohet roli i **koordinatorëve kombëtarë** si “iniciatorë” të veprimeve operacionale;

- duhet të institucionalizohet **përfshirja e palëve** të interesuara për të siguruar subsidiaritetin të Strategjia. Duhet të merret parasysh krijimi i një forumi të përhershëm (virtual ose fizik), i cili do të shërbejë si koleksionist i nevojave të shoqërisë civile dhe do t'i vërë ato në vëmendjen e vendimmarrësve;

- duhet të forcohen **aksionet e komunikimit** që të jenë pjesë e qartë e qeverisjes së përgjithshme. Komunikimi duhet të trajtohet për të rritur nivelin e përfshirjes së të gjithë aktorëve, por edhe për të promovuar në kohë dhe si duhet Strategjinë si një mjet i dobishëm për bashkëpunimin;

Së fundi, nga një perspektivë e përgjithshme dhe jashtë fushëveprimit të qeverisjes EUSAIR duhet të parashihet **koordinimi ndërmjet të gjitha strategjive** (veçanërisht makrorajonalet).



Analiza SWOT e zonës ADRION

Rritja e zgjuar

	Pikat e forta	Pikat e dobëta	Mundësitë	Kërcënimet
Kërkimi shkencor, zhvillimi teknologjik dhe inovacioni	-Disa rajone lider në R & D - Disa sektorë me aftësi të larta industriale (bujqësia, agrobiznesi, kimikatet, materialet...) -Objektet kërkimore të zhvilluara relativisht mirë në disa shtete -Aktivitetet dhe praktikatat inovative të mirë-zhvilluara në fushën e industrive kulturore dhe kreative -Sisteme të mira të certifikimit të cilësisë të produktit, objekte të mira dhe laboratorë me akreditim ndërkombëtar	-Investim i ulët në R & D -Proporcion i ulët në personelin kërkimor në kompani -Numri i vogël i kërkesave të autorizuar për t'u komercializuar -Mbrojtje dobët e Pronës Intelektuale në lidhje edhe me akademitë dhe të ndërmarrjet -Aktivitete të dobëta për transferimin e teknologjisë dhe bashkëpunim i kufizuar i parqeve të teknologjisë dhe shkencës, inkubatorëve dhe grupeve -Modelet e bazuara të inovacionit më tepër të diversifikimi, sesa inovacioni i përparuar -të industrive kulturore dhe kreative ende të parealizuar -Nuk ka rregulla të veçanta në fushën e sipërmarrjes së kapitalit/fondeve të kapitalit privat në disa vende -Rënie e zonave urbane si pole për inovacion -Aftësi sipërmarrëse të ulëta dhe njohuri të ulëta për risi	-Rritja e investimeve në R & D -Rritje e lehtë e kërkesave të autorizuar gjatë viteve të fundit -Specializime R & D në agrobiznes, marinë dhe turizëm -Transferimi i hulumtimit nga universitetet/laboratorët në sektorin privat -Rritja e aftësive në kërkime përmes mbështetjes financiare dhe mundësive të trajnimit në fushën e krijimit të ndërmarrjeve, transferimit të teknologjisë, organizimit dhe menaxhimit të inovacionit -Një komunitet divers dhe me risi në rrjet (parqe shkencore dhe teknologjike dhe inkubatorë) -Inovacion social dhe i hapur si potencial -Aktivitete hulumtuese dhe produkte të reja në fushën e industrisë së qëndrueshme të ndërtimit dhe të industrive kreative	-Ekonomia është e prekur seriozisht nga kriza ekonomike dhe e borxheve -Rritja e konkurrencës nga vendet jugore dhe lindore -Shpërndarja e investimeve R & D dhe mungesa e prioritetëve -Migrimi i fuqisë punëtore shumë të aftë -Dallime të konsiderueshme ndërmjet rajoneve në lidhje me potencialet R & D
Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit	-Zgjerimi i mbulimit të internetit me brez të gjerë me shpejtësi të lartë -Rritja e përdorimit të TIK-ut nga individë dhe biznese	-Qasje e kufizuar në brezat e gjerë në të gjithë zonën e ADRION-it veçanërisht në zonat periferike -Aftësi më të ulëta TIK të individëve se në rajonet e tjera të BE-së -Oferta dhe përdorime të kufizuara të shërbimeve publike <i>online</i>	-Zhvillimi i brezit të gjerë me shpejtësi të lartë financiar nga fondet e tjera -Sektorë R & D e specializuar në TIK -Brezi i ri me informacion të lartë në IT -Përdorimi i TIK-ut, si sektor që krijon mundësi dhe si një mjet për të përfshirë qytetarin në modelin e spirales së katërfishtë (p.sh., laboratorët e gjallë)	-Pabarazi të mëdha mes rajoneve dhe territoreve lidhur me përdorimin e TIK-ut
Konkurrueshmëria	-Kërkesa e zonës Adrion, e cila është	-Ndikimi i fortë i biznesit tradicional (sektorët e	-Krijimi i një shkalle të lartë biznesi në	-Recesion i rëndë në



	Pikat e forta	Pikat e dobëta	Mundësitë	Kërcënimet
e SME-ve	thelbësore për turizmin -Rajone shumë konkurruese -Rezultatet pozitive të mbështetjes së politikave për biznese (inovacionit të biznesit dhe të konkurrencës)	teknologjisë së ulët dhe të mesme) -Risi në rritje që japin vlera të shtuara të kufizuara te SME-të -Produktiviteti i ulët i biznesit -Shumica e SME-ve nuk janë të integruara mjaftueshëm në rrjetet ndërkombëtare -Pabarazi të gjera rajonale dhe rajone me konkurrencë të ulët -Kuptueshmëri e kufizuar për rëndësinë e pronësisë intelektuale -Specializime sektoriale/ndërsektoriale të kufizuara	disa rajone të ADRION-it -Rritja e grupimit të SME-ve	shumicën e rajoneve ADRION -Vështirësitë e bizneseve për të pasur akses në financa

Rritja e qëndrueshme

	Pikat e forta	Pikat e dobëta	Mundësitë	Kërcënimet
Ekonomia e ulët e karbonit dhe sektorit të energjisë	-Kushtet e favorshme për prodhimin e energjisë së rinovueshme (klima, burimet natyrore) -Rritja e ndërgjegjësimit për nevojën për një ndryshim drejt një ekonomie të ulët karboni	-Treguesi i gazit serrë shumë më i lartë se mesatarja e BE-së -Zhvillimi i pamjaftueshëm i energjisë së rinovueshme -Shkallë relativisht e lartë e varësisë energjetike -Efikasiteti ulët i energjisë në krahasim me mesataren e BE-së	-Potencial për zhvillimin e energjisë së rinovueshme nuk shfrytëzohet plotësisht -Vendet ADRION të angazhuara për të ulur emetimet e gazrave	-Rritje e konsiderueshme në koston e energjisë së ulët të karbonit
Ndryshimet dhe rreziqet klimatike	-Ekzistenca e një kuadri evropian dhe politikave kombëtare për reduktimin e emetimeve CO2	-Zona ADRION është përballur fuqishëm me rreziqet natyrore (përmblytjet, thatësitat, zjarrin, stuhitë, tërmetet) -Kapaciteti i ulët për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike -Ndërveprim i ulët i organizatave të Mbrojtjes Civile	-Rritja e angazhimit për zhvillim të qëndrueshëm -Dalja e teknologjive efektive me kosto të ulët për paralajmërim të hershëm të rrezikut, komunikim dhe ndërveprim (p.sh., zbulimi në largësi) -Rritja e angazhimit të shoqërisë civile në menaxhimin e rrezikut dhe gatishmërisë emergjente dhe reagimit	-Rritja e rrezikut të fatkeqësive natyrore për shkak të efektit të ndërsjellë nxitës të rreziqeve (p.sh., ndryshimet klimatike, përmblytjet, thatësitat, zjarret në pyje dhe erozioni) -Kosto të larta lidhur me riparimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore
Mbrojtja e mjedisit, trashëgimisë	-Trashëgimi shumë e pasur mjedisore dhe kulturore (deti, malet, pyjet,	-Degradimi i zonave të brishta, peizazheve, zonave kryesisht bregdetare, eutrofikimit dhe	-Masat për zhvillimin e mbrojtjes së mjedisit (zonat e mbrojtura)	-Rrezik për rritjen e ndotjes së mjedisit për shkak të rritjes së



	Pikat e forta	Pikat e dobëta	Mundësitë	Kërcënimet
natyrore dhe kulturore	kënetat, peizazhet kulturore) -Shumë zona të mbrojtura (Natura 2000 dhe rëndësia globale UNESCO)	ndotjes së zonave detare -Rritje e humbjes së prodhimit shtëpiak -Riciklimi i mbeturinave mbetet më i ulët se mesatarja e BE-së -Rritja dhe shtrirja urbane duke theksuar trashëgiminë natyrore dhe kulturore -Cilësi e ulët e ajrit dhe përqendrime të larta të grimcave, ozonit, SO₂ dhe NO₂ në qytete	-Potencial NATURA dhe Emerald Networks ende për t'u shfrytëzuar plotësisht në mënyrë operative -Investimet në cilësinë e ajrit duke dhënë përfitime të shumta siç tregohet në paketën e politikës Clean Air (p.sh., për ekosistemet, turizmin, trashëgiminë kulturore, prodhimin bujqësor etj.) -Zhvendosja nga përpunimi tradicional mbetjeve drejt metodave më të pastra -Rritja e ndërgjegjësimit veçanërisht në mesin e popullatës së re -Kërkesat dhe çmimet e larta mund të nxisin ripërdorimin dhe renovimin e aksioneve ekzistuese të ndërtimit -Ruajtja / Restaurimi dhe ripërdorimi duhet të kenë përparësi mbi ndërtimet e reja	aktiviteteve të turizmit dhe bujqësisë -Cilësi gjithnjë e më e dobët e ajrit -Rritje e mungesës së burimeve ujore -Rritje e shtrirjes urbane -Rritje kostos së riciklimit të mbeturinave dhe metodave të ripërdorimit për shkak të kompleksitetit të produkteve -Përdorimi i gjerë i dorës së njeriut veçanërisht në hapësirën bregdetare dhe detare për rekreacion, strehim, transport dhe peshkim/akuakulturë -Rritje dhe presion i akumuluar mbi biodiversitetin
Transportet	-Nivel i mirë i infrastrukturës rrugore, veçanërisht në drejtëm veri-jug në Shtetet Anëtare të BE-së, ndërsa përmirësimet janë të nevojshme në Shtetet Partnere -Rrjet i madh i qyteteve të portit edhe nëse vetëm disa prej tyre janë të pajisura mirë për t'ia dalë me fluksin e udhëtarëve dhe mallrave -Vendndodhje strategjike gjeografike midis Evropës Lindore, Mesdheut dhe Azisë	-Dallim i lartë të aspektin e aksesit të kënaqshëm: për shtetet anëtare IPA janë alokuar burime të ulëta për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore -Fragmentim dhe izolim gjeografik i territoreve të shumta (ishujt, zonat e largëta) -Zhvillim i keqmenaxhuar urban, veçanërisht në zonat bregdetare duke u bazuar në trafikun e motorizuar individual -Densitet i rrjetit hekurudhor më i ulët sesa mesatarja e BE-së -Akses i ulët multimodal -Zhvillimi i pamjaftueshëm i trafikut detar bregdetar	-Pozicioni i mirë i ishujve dhe rajoneve ADRIAN si qendra për turistë dhe tregti -Zhvillimi i sistemeve të transportit multimodal -Përf forcimi i rrjetit hekurudhor ekzistues -Mjetet e TIK-ut për transport multimodal të qëndrueshëm dhe efikas “në kohë reale”	-Mungesë koordinimi evropian të sistemit të komunikimit -Copëzimi i peizazhit të transportit në varësi të procesit të anëtarësimit në BE të Shteteve Partnere -Dominimi i transportit rrugor



Rritja përfshirëse

	Pikat e forta	Pikat e dobëta	Mundësitë	Kërcënimet
Mobiliteti i punësimit dhe punës	-Mobilitet i lartë i studentëve -Numri i lartë i të vetëpunësuarve -Kultura e mobilitetit të punës	-Niveli i ulët punësimi, veçanërisht për të rinjtë dhe gratë -Pabarazi të lartë territoriale për nivelet e papunësisë -Shkalla e lartë e papunësisë afatgjatë	-Mobilitet i thjeshtuar i punës brenda dhe ndërmjet shteteve ADRION -Mundësi që ofrohen nga Rritja Blu dhe turizmi për punësim lokal	-Pasojat e krizës financiare -Rritje e fuqishme e shkallës së papunësisë me krizën ekonomike -Largimi i burimeve njerëzore, veçanërisht të rinjtë në drejtim të vendeve të tjera të BE-së
Përfshirja sociale dhe lufta kundër varfërisë	-Solidariteti tradicional mes brezave -Rol të rëndësishëm ka luajtur ekonomia sociale dhe solidariteti	-Një përqindje e madhe e popullsisë në rrezik nga varfëria dhe përjashtimi social -Tërheqje e sistemeve shtetërore të sigurisë ose për shkak të krizës (EL, IT) ose për shkak të një ndryshimi paradigme (veçanërisht shtetet joanëtare)	-Rëndësi në rritje për zhvillimin rrjeteve sociale joformale -Zhvillimi i paradigmes së novacionit social dhe aktivizimi i shoqërisë sociale -Mundësi për zhvillimin endogjen (Rritja Blu dhe e gjelbër dhe turizmi)	-Efekte njerëzore dhe sociale alarmuese të krizës dhe shpërbërja e strukturës shoqërore -Dobësimi i lidhjeve sociale dhe familjare -Ngritja e barrierave dhe pengesave ndaj pjesëmarrjes në shfrytëzimin e mundësive (barrierat ligjore, pengesat financiare), e cila mund të çojë në një theksim të pabarazisë në shoqëri
Aftësitë dhe edukimi	-Arsimi i lartë i vlerësuar nga ana kulturore -Gamë e madhe për kualitet të lartë dhe trajnim falas -Zgjedhje e mirë për trajnim profesional -Njohuri dhe aftësi të pasura tradicionale	-Niveli i lartë i braktisjes së shkollës në moshë të re në krahasim me mesataren e BE-së -Institute arsimore të larta që renditen poshtë me disa përjashtime (p.sh., Athina, Milano etj.) -Mospërputhje midis ofertës së arsimit dhe kërkesës së SME-ve	-Ulje progresive në normën e personave që lënë shkollën para kohe -Rritja e njohjes së rëndësisë së sistemeve të vlerësimit të aftësive -Trajnimi i aftësive në artet tradicionale, veprat artizanale, muzikë dhe në produkte dhe shërbimeve të tjera të veçanta tradicionale (trashëgimia kulturore jomateriale)	-Emigrimi i trurit -Tendencë e dobët e SME-ve për të investuar në trajnimin profesional dhe të dyfishtë



Sfidat dhe nevojat kryesore të Programit ADRION janë:

	Sfidat kryesore	Nevojat kryesore
Zhvillimi mençur “i	-Kapja e mesatares së BE-së dhe arritja e objektivave të BE-së 2020; -Grumbullimi i infrastrukturave ekzistuese dhe të planifikuara në lidhje me shpërndarjen e objekteve partnere të kërkimit/hulumtimit; -Sigurimi i mjedisit transkombëtar dhe lehtësimi i zbatimit të Planit të Veprimit EUSAIR (inovacioni dhe dimensionimi i hulumtimit/kërkimit lidhet kryesisht me shtyllën 1 dhe 3); -Shfrytëzimi në mënyrë të qëndrueshme i mundësive që rrjedhin nga qasjet e zhvillimit blu dhe të gjelbër në lidhje me avantazhet krahasuese të zonës; -Zhvillimi i komuniteteve të inovacionit ADRION dhe rrjetet në lidhje me statusin e inovacionit të secilit rajon (nga e “teknologjisë së ulët” deri në “lider i tregut veçanërisht në kontekstin e zonave të reja të inovacionit dhe qasjeve; -Shfrytëzimi i vijës bazë të ofruar nga Strategjitë e Kërkimit dhe Inovacionit për Specializimin “E mençur” (RIS3) zhvilluar në shtetet partnere FERS dhe identifikimi i temave mbi specializimin “e mençur” dhe i sinergjive me shtetet partnere të IPA-s	-Duhet miratimi i rritjes së inovacionit dhe teknologjive nga SME-të: trajtimi i kësaj nevoje është në përputhje me objektivin ADRION të promovimit të investimeve të biznesit në Kërkim & Inovacion (R&I). -Rritja e bashkëpunimit në mes kërkimit dhe industrisë, në përputhje me objektivin ADRION për zhvillimin e lidhjeve dhe sinergjive ndërmjet ndërmarrjeve, institucioneve kërkimore dhe të arsimit të lartë, si dhe mbështetjen e rrjeteve, shkencës dhe teknologjisë, parqeve dhe inkubatorëve, grupimeve dhe inovacionit të hapur. -Fokusimi në çështjet e sigurisë ushqimore; -Komericializimi/shfrytëzimi i hulumtimit (inovacionit), në përputhje me objektivin ADRION për mbështetjen e produktit dhe zhvillimin e shërbimeve, si dhe në përputhje me RIS3; kërkimi teknologjik dhe i aplikuar, linjat pilot, veprimet e hershme për vlefësimin e produktit. -Zhvillimi i strategjive të specializimit të mençur dhe shqyrtimi i sinergjive midis vendeve dhe rajoneve të ndryshme, në përputhje me objektivin ADRION për përdorimin e rezultateve RIS3. -Më shumë theks në zonat e reja të inovacionit dhe qasjet (ekoinovacionet, prokurimi publik për inovacionin, industria kreative, industria e shërbimit, inovacioni social dhe i hapur, prokurimi dhe inovacioni social), në përputhje me objektivin ADRION për të shfrytëzuar inovacionin social, ekoinovacionin, aplikimet për shërbimin publik dhe masa të tjera të reja mbështetëse për inovacionin. -Shkëmbimi i praktikave më të mira të teknologjive të administratës publike në e-qeverisje. -Mbështetja për menaxhimin e inovacionit (këshillimi IP, transferimi teknologjik, realizimi i prototipit, demonstruesit etj.), në përputhje me objektivin e ADRION për mbështetjen e produktit dhe zhvillimin e shërbimit; kërkimi teknologjik dhe i aplikuar, linjat pilote, veprimet e hershme për vlefësimin e produktit. -Zhvillimi i aktiviteteve të transferimit të teknologjisë në disa vende të zonës ADRION, si dhe rritja e gatishmërisë nga ana e sipërmarrësve për investime.
Zhvillimi i qëndrueshëm	-Përfundimi i temave të reja në agjendën e rajoneve ADRION, që të veprojnë si një platformë largpamësie dhe demonstrimi, duke rritur ndërgjegjësimin, p.sh., në kushtet e kuadrit joteknik për RES ose vlerësimi i qëndrueshëm i trashëgimisë. -Identifikimi i një emëruesi të përbashkët për shkëmbimin e përvojës në radhë të parë p.sh., në lidhje me domosdoshmërinë për të trajtuar presionet e njeriut në mjedis në lidhje me ekosistemet detare.	-Duhet kthimi drejt një ekonomie me lëndë djegëse fosile dhe nivel të ulët karboni që lejon shtetet partnere FERS të përqendrohen më tej në ndarjen ose shkëputjen e ekonomive të tyre, ndërkohë duke ndihmuar shtetet partnere IPA për të zotëruar tranzicionin e ekonomive të tyre në këtë drejtim. -Diversifikimi i potencialit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë përmirësimi i qasjeve lokale. -Duhet të qetësohet trendi i prodhimit të energjisë me qëllimin e mbrojtjes së natyrës, peizazhit dhe



	Sfidat kryesore	Nevojat kryesore
	- Zhvillimi i mjeteve transkombëtare në trajtimin e aspekteve konkrete në nivel të zonës së programit ku bashkëpunimi transkombëtar është një koeficient i forcës p.sh., në lidhje me vulnerabilitetin e mjedisit, fragmentimin e habitateve dhe peizazheve, menaxhimin e rrezikut, përdorimi i tokës dhe konsumimi i burimeve etj. -Prezantimi, testimi dhe vlerësimi i koncepteve të reja, p.sh., në shërbimet e ekosistemit, zhvillimi/Rritja Blu dhe e Gjellbër në praktikën e zhvillimit dhe politikës së kohezionit, duke lehtësuar arritjen e standardeve të BE-së dhe në përgjithësi rritjen e potencialeve të qeverisjes së mirë edhe në kontekstin e EUSAIR. -Mbështetja për zgjerimin/shumëllojshmërinë dhe specializimin e ofertës territoriale dhe të akomodimit. -Rritje e njohurive mbi tendencat e tregut dhe aftësinë e marketingut për turizmin lokal të SME-ve. -Shfrytëzimi i potencialeve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore si një aset i zhvillimit; -Integrimi më i mirë midis planifikimit të zhvillimit të turizmit, objektivave mjedisore dhe sistemit të menaxhimit të mallrave mjedisore. -Optimizimi i rrjetit të transportit multimodal në drejtim të dinamikave më të sigurta të transportit të gjellbër dhe efikasitetit të infrastrukturave të transportit nëpërmjet përdorimit të sistemeve të informimit dhe stimujve të bazuar në treg. -Nxitja e krijimit të sistemeve logjistike nëpërmjet zbatimit të rrjeteve të integruara, të ndërlidhura, homogjene terminale për logjistikën. -Trajtimi i interkonjeksionit të dobët midis porteve dhe nyjave të brendshme intermodale dhe logjistike (intermodale: ujqor-hekurudhor, hekurudhor-rrugor). -Menaxhimi i pikut sezonal të turistëve për të shmangur bllokimet e trafikut, duke siguruar një rezervë të lëvizshmërisë së integruar në sajë të TIK-ut - ITS (Sistemet Inteligjente Transportit) - mjetet e tij të reja të shtrira në rajonin e Adriatikut. -Përforsimi i ndërlidhjes (interkonjeksionit) mes aeroporteve ADRION.	biodiversitetit, me interesat turistike dhe interesave të ndryshëm të banorëve lokalë. -Domosdoshmëri për të mobilizuar peisazhin kulturor dhe pasurinë e biodiversitetit si asete kryesore të zonës që sigurojnë cilësi të lartë të jetës dhe atraktivitet global. -Domosdoshmëri për të menaxhuar vulnerabilitetin e lartë mjedisit. -Domosdoshmëri për të menaxhuar në mënyrë efektive dhe për të mbrojtur diversitetin biologjik, burimet gjenetike, llojet dhe ekosistemet në nivel transkombëtar. -Domosdoshmëri për të menaxhuar rritjen e konsumimit të tokës dhe burimeve. -Domosdoshmëri për të zvogëluar rrezikun e mjedisit duke pakësuar emetimet/nxjerrjet nga anijet në det ose në port dhe të infrastrukturës portuale (p.sh., makineritë e lëvizshme të mëdha) në përputhje me EUSAIR; -Duhet të integrohen shërbimet e ekosistemit, parimet e rritjes blu dhe të gjellbër në planifikimin e zhvillimit rajonal dhe të vendoset vlerësimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore dhe kulturore si asete të rritjes/zhvillimit. -Duhet të përpunohet indikatorët dhe statistikën e përbashkëta për të matur kërkesën dhe ofertën e turizmit. -Domosdoshmëri për të ndarë mjete të përbashkëta për të matur ndikimin mjedisor të aktiviteteve turistike (uji, toka, mbeturinat/mbetjet). -Domosdoshmëri për forcimin e kapaciteteve administrative, veçanërisht në fushat detare, transportit në brendësi të ujit dhe logjistikës. -Domosdoshmëri për të shkëmbyer e ndarë metodologjitë për mbledhjen e të dhënave dhe treguesve të përbashkët për të monitoruar kushtet e transportit dhe të aksesibilitetit. -Domosdoshmëri për të lehtësuar procedurat e transportit detar dhe për të harmonizuar legjislacionin kombëtar të transportit në brendësi (përmirësim ndërkufitar). -Domosdoshmëri për të përmirësuar portgjellbërimin (sistemin e monitorimit për cilësinë e emisioneve/nxjerrjeve nga aktivitetet e anijeve të transportit të mallrave, miratimin e standardeve të përbashkëta të cilësisë etj.).
Zhvillimi gjithëpërfshirës	-Parashikimi i pasojave të ndryshimeve demografike për ekonominë, punësimin dhe cilësinë e jetës (plakja e popullsisë). -Pranimi i rritjes së vështirësive për përfshirjen social-ekonomike të të rinjve, veçanërisht në kohën e krizës. -Lejimi i të gjitha pjesëve të shoqërisë për të marrë pjesë në shfrytëzimin e mundësive dhe ndarjen e shpërblimeve.	-Duhet promovuar më mirë risitë/inovacioni social në lidhje me sektorët kyç social-ekonomikë (agro-ushqimorë, turizmi, energjia, transportet, kultura). -Duhet marrë më mirë në konsideratë çështjet social-ekonomike dhe nevojat e përdoruesve përfundimtarë në konceptimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm (mjedisi, energjia, transporti).



Strategjia e Programit transkombëtar ADRION

Objektivi i përgjithshëm i Programit

Strategjia e përgjithshme e Programit është formuluar në përgjigje të drejtpërdrejtë të strategjisë EU2020 për zhvillimin e mençur, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, dhe rishikimet e saj të mëtejshme. *Zhvillimi i mençur* do të thotë përmirësimi i performancës së BE-së në arsim, kërkim/ inovacion dhe shoqërinë digjitale. *Zhvillimi i qëndrueshëm* do të thotë ndërtimi i një ekonomie më konkurruese që emeton karbon të ulët dhe bën përdorim efikas dhe të qëndrueshëm të burimeve. *Zhvillimi gjithëpërfshirës* do të thotë rritje e nivelit të punësimit në Evropë - më shumë punë dhe vende pune më të mira, veçanërisht për gratë, të rinjtë dhe punëtorët më të vjetër, duke ndihmuar njerëzit e të gjitha moshave për të rritur shkallën e punësimit. Në kuadër të Strategjisë EU2020, BE-ja ka vendosur objektiva ambiciozë që të arrihen deri në vitin 2020, në pesë fusha kryesore:

- **Punësimi:** 75% e moshës 20-64 vjeç të punësohet;

- **Kërkimi dhe zhvillimi:** 3% e GDP-së së BE-së të investohet në K&Zh;

- **Ndryshimet klimatike dhe qëndrueshmëria e energjisë:** emetimet e gazit serë 20% (apo edhe 30 për qind) më të ulëta se në vitin 1990; 20% e energjisë nga burimet e rinovueshme, 20% rritje në efikasitetin e energjisë;

- **Arsimi:** Reduktimi i përqindjes së atyre që lënë shkollën herët nën 10% dhe të paktën 40% e 30-34-vjeçarëve që mbarojnë arsimin e nivelit të tretë;

- **Luftimi i varfërisë dhe përjashtimit social:** të paktën 20 milionë më pak njerëz në rrezik të varfërisë dhe përjashtimit social.

Për të arritur objektivat e parashikuar EU2020, të gjitha rajonet europiane duhet të jenë të përfshira në mënyrë aktive. Në këtë kontekst, Korniza e Përbashkët Strategjike (CSF) e politikës së kohezionit të BE-së (neni 10 dhe shtojca I të Rregullores (BE) nr. 1303/2013) siguron kornizën e nevojshme të investimeve dhe të sistemit të shpërndarjes.

Objektivi i përgjithshëm i Programit ADRION është të veprojë si një drejtues i politikave dhe qeverisjes novatore që nxit integrimin europian midis FERS dhe shteteve partnere IPA, duke përfutur nga burimet e pasura natyrore, kulturore

dhe njerëzore që rrethojnë detet Adriatik dhe Jon dhe që përmirëson kohezionin ekonomik, social dhe territorial në zonën e Programit.

Komisioni Europian në Rregulloren e tij nr. 1299/2013 përcakton në hyrje se: “bashkëpunimi transnacional duhet të synojë në forcimin e bashkëpunimit me anë të veprimeve ose aksioneve që çojnë në zhvillimin e integruar territorial lidhur me prioritetet e politikës së kohezionit të BE-së”.

Për zhvillimin e mençur, Programi ADRION do t'i kushtojë vëmendje të veçantë promovimit të inovacionit në një numër fushash (p.sh., rritja ose zhvillimi blu dhe i gjelbër, energjia, transporti, turizmi), që përshkruan përparësitë e rëndësishme konkurruese të zonës. Ai do të mbështesë partneritetet me qëllim forcimin e grupeve, rrjeteve, sektorët ekonomikë, zinxhirët e vlerës dhe për të rritur ndërveprimin midis aktorëve në shtetet partnere.

Lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm, duke marrë parasysh presionin e vërejtur në zonat urbane, ultësirat dhe zonat bregdetare Adriatik dhe Jon, programi ADRION do të kërkojë të qetësojë kërkesën dhe presionin e përdorimeve të ndryshme, të nxitë kontributet/aktivitetet e emetimeve të ulëta, të shfrytëzojë në mënyrë të qëndrueshme burimet e rinovueshme, të zvogëlojë ndikimin e aktiviteteve njerëzore mbi burimet natyrore dhe të përmirësojë mbrojtjen e biodiversitetit dhe habitateve detare dhe tokësore. Në këto fusha, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet koordinimit me programet kombëtare dhe rajonale të BE-së për të përdorur kontributet ekzistuese dhe për të shpërndarë rezultatet e projekteve Adrion. Në këtë aspekt, partnerët e projekteve transkombëtare do të duhet të jenë të vetëdijshëm për nevojat e rajonit dhe të propozojnë mënyra për të shpërndarë rezultatet e tyre në drejtim të programeve rajonale të rregullta. Kyç në këtë aspekt është përgatitja e tokës përmes aksioneve transkombëtare, veçanërisht në zonat ku bashkëpunimi transkombëtar është absolutisht i nevojshëm, siç është rasti i ndërhyrjeve detare gjysmë të mbyllura. Në këtë drejtim, Planifikimi Hapësinor Detar, menaxhimi i integruar i zonës bregdetare, siguria detare, transporti, energjia ose ndotja e deteve Adriatik dhe Jon në lidhje me Direktivën e Kornizës së Strategjisë Detare të BE-së dhe parimet e UNEP MAP dhe Konventës së Barcelonës mund të luajnë një rol të rëndësishëm.



Programi ADRION trajton zhvillimin gjithëpërfshirës përmes vlerësimit të avantazheve konkurruese dhe krijimin e mundësive të punësimit së bashku me rritjen e mundësive të lidhjes dhe mbrojtjen e mallrave publike mjedisore.

Ndër shtatë iniciativat e spikatura të identifikuar nga strategjia EU2020, objektivat e programit ADRION do të përputhen me Inovacionin e BE-së për të përmirësuar kuadrin e kushteve për kërkimin dhe inovacionin, në burimet efikase të Europës për të ndihmuar ndarjen e rritjes ekonomike nga përdorimi i burimeve.

Bashkëpunimi transkombëtar megjithatë karakterizohet nga disa sfida të qenësishme, të cilat mund të përmbledhen si:

- Mbulimi i zonave të mëdha me diversitet të lartë të rajoneve dhe shpesh me interesa kontradiktore;

- Buxhetet e kufizuara në lidhje me zonën e mbuluar, popullsia dhe afati kohor, të cilat shpesh janë në kundërshtim me qëllimin dhe objektivat e iniciativave të bashkëpunimit;

- Ofrimi i rezultateve kryesisht të pakapshme.

Në rastin e Programit ADRION, ai ka gjithashtu për të trajtuar dimensionin politik të integritetit të Ballkanit Perëndimor në BE.

Për këto arsye dhe për shkak të rrisë së Programit, ADRION:

- do të fokusohet në një numër të kufizuar të OT-ve;

- do të vërë theksin në formimin e partneriteteve që mbështesin integrimin e të gjitha shteteve partnere;

- do të optimizojë plotësisht sinergjitë dhe komplementaritetet mes OT-ve të zgjedhura, për t'i harmonizuar ato me shtyllat e EUSAIR-it dhe për të përgatitur aktivitetet pasuese që zbatohen nën etiketën Adrion.

Për më tepër do të merren parasysh nevojat dhe sfidat territoriale që rrethojnë zonën transnacionale të Programit.

Objekti i është të identifikojë më mirë potencialin e zhvillimit dhe pengesat në sektorë të veçantë (inovacioni, mjedisi, turizmi, aksesueshmëria dhe ndërlidhjet mes tyre) në nivel transkombëtar, për të mbështetur grupet e interesit që promovojnë qasjet e reja dhe shkëmbimin e njohurive.

Lloji i kontributit që pritet nga Programi ADRION

Si program i bashkëpunimit transkombëtar, kontributi i tij kryesor do të jetë shkëmbimi dhe transferimi i përvojave ndërmjet rajoneve, mbështetja për ndërhyrjet transkombëtare dhe ngritja e kapaciteteve, si dhe siguri se rezultatet shpërndahen dhe përdoren përtej partnerëve të projektit duke arritur të një numër i madh përdoruesish fundorë.

Programi në veçanti do të mbështesë përbërjen e ekipeve shumënivelshe dhe ndërsektoriale të punës dhe partneritetet për të kapërcyer pengesat administrative dhe sektoriale, me përfshirjen e qytetarëve dhe të organeve rajonale/ lokale/ kombëtare/ndërkombëtare. Në nivelin territorial, çështje kyçe do të jetë reduktimi i konflikteve lidhur me përdorimin e tokës që përbën një aspekt kryesor të strategjive të zhvillimit të qëndrueshëm (promovimi i energjisë së rinovueshme, mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, reduktimi i emetimeve të karbonit etj.).

Ndër kushtet kuadrë për zbatimin e aksioneve, palët e interesuara duhet të mbajnë në mend se projektet nuk kanë për qëllim t'iu përgjigjen nevojave të një numri të kufizuar partnerësh, por të kontribuojnë për kushte më të mira të jetesës në territoret ADRION (aktivitete ekonomike, cilësia e mjedisit, siguria etj.), duke u përqendruar kështu më shumë në aktivitetet dhe rezultatet.

Nga pikëpamja e aksionit dhe rezultatit, duke marrë parasysh strategjinë e tij, Programi ADRION ofron kryesisht:

- Strukturat e rrjetit;

- Sistemet e përbashkëta të menaxhimit dhe marrëveshjet e bashkëpunimit;

- Strategjitë dhe planet e veprimt;

- Metodologjitë dhe mjetet;

- Aksionet pilot.

Si program i bashkëpunimit transkombëtar, programi ADRION nuk do të mbështesë as investimet e rënda si zhvillimin e infrastrukturave të mëdha, as kërkimet shkencore dhe teknologjisë. Investimet të pajisjet e shkallës së vogël ose tek infrastrukturat mund të mbështeten në raste të justifikuar siç duhet, si në rastin e projekteve pilot dhe përvojave territoriale. Programi ADRION do të mbështesë në veçanti aksionet e paprekshme ose të “buta”, të cilat potencialisht mund të kenë një ndikim afatgjatë dhe të kontribuojnë për



vizibilitetin e Programit (studime dhe hulumtime, krijime rrjetesh, përhapje e njohurive dhe të dhënave etj.).

Lidhur me zbatimin e aksioneve ka një dallim të qartë midis “përfituesve” dhe “grupeve të synuara” ose “përdoruesve fundorë”. Në kuadër të Programit, përfituesit janë organet dhe organizatat të cilat do të përfshihen drejtpërdrejt në projektet e financuara nga Programi dhe do të jenë ato që do të konceptojnë, diskutojnë dhe zhvillojnë produktet e përshkruara më sipër. “Grupet e synuara” ose “përdoruesit fundorë” janë organet, grupet dhe individët të cilët do të përdorin rezultatet e projekteve ose do të provojnë një ndryshim në aktivitetet dhe jetët e tyre për shkak të rezultateve të Programit.

Objektivat tematikë të zgjedhur, prioritetet e investimeve dhe objektivat specifike

Për çdo objektiv tematik (OT) është parapërcaktuar një grup i prioritetëve specifike të investimeve (PI), që reflekton sfidat me të cilat përballen rajonet e programit ADRION

Thelbësore për zgjedhjen e OT-ve dhe PI-ve është:

- Diagnoza/ose përcaktimi i saktë dhe nevojat e identifikuar për zonën ADRION;
- Mësimet e nxjerra nga periudha 2007-2013;
- Zbatimi i përqendrimit tematik në një numër të vogël të prioritetëve siç përcaktohet në rregulloren e Bashkëpunimit Territorial (ETC);
- Komplementariteti me EUSAIR dhe strategjitë e tjera makrorajonale të BE-së, programet rajonale dhe tematike;
- Specifikimet e programeve të bashkëpunimit transkombëtar.

Për Programin ADRION janë përzgjedhur katër (4) OT-të dhe pesë (5) PI-të e mëposhtme:

Aksi prioritar 1: Rajoni inovativ dhe i mençur

OT 1: Forcimi i kërkimit shkencor, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit sipas:

PI 1b: Promovimi i investimeve të biznesit në K&I, që zhvillon lidhjet dhe sinergjitë ndërmjet ndërmarrjeve, qendrat e kërkimit dhe zhvillimit dhe sektorin e arsimit të lartë, në veçanti promovimi i investimeve në zhvillimin e produktit dhe shërbimeve, transferimin e teknologjisë, në inovacionin social, ekoinovacionin, aplikimet e shërbimit publik, stimulimin e kërkesës, krijimin e

rrjeteve, grupimet dhe inovacionin e hapur (...);

OS 1.1: *Mbështetje për zhvillimin e një sistemi të inovacionit rajonal për zonën e Adriatik-Jonit*”.

Aksi prioritar 2: Rajoni i qëndrueshëm

OT 6: Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit, si dhe promovimi i efikasitetit të burimeve nga:

PI 6c: Ruajtja, mbrojtja, promovimi dhe zhvillimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore;

OS 2.1: Nxitja për vlerësimin dhe ruajtjen e qëndrueshme të pasurive natyrore dhe kulturore si asete të rritjes/zhvillimit në zonën Adriatiko-Joniane;

PI 6d: Mbrojtja dhe rivendosja e biodiversitetit dhe tokës dhe promovimi i shërbimeve të ekosistemit, duke përfshirë Natura 2000, dhe infrastrukturën e gjelbër;

OS 2.2: Rritja e kapaciteteve për trajtimin e çështjeve vulnerabël të mjedisit transkombëtar, fragmentimit dhe ruajtja e shërbimeve të ekosistemit në zonën Adriatiko-Joniane.

Aksi prioritar 3: Rajon i lidhur/i përbashkët

OT 7: Promovimi i transportit të qëndrueshëm dhe heqja e pengesave në infrastrukturën e rrjetit kryesor nga:

PI 7c: Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemeve të transportit për të qenë më të favorshëm për mbrojtjen e mjedisit (duke përfshirë zhurmën e ulët) dhe emetimin e ulët të karbonit, përfshirë rrugët ujore në brendësi dhe transportin detar, portet, lidhjet multimodale dhe të infrastrukturës së aeroportit, me qëllim nxitjen e lëvizshmërisë së qëndrueshme rajonale dhe lokale;

OS 3.1: Rritja e kapaciteteve për transportin e integruar dhe shërbimet e lëvizshmërisë dhe multimodalitetin në zonën Adriatiko-Joniane.

Aksi prioritar 4: “Mbështetje për qeverisjen EUSAIR”

OT 11: [neni 7, shkronja b, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013] - Rritja e kapaciteteve institucionale të autoriteteve publike, grupet e interesit dhe administratë publike eficiente [...];

PI 11: Rritja e kapaciteteve institucionale të autoriteteve publike, grupet e interesit dhe administratë publike efikase duke zhvilluar dhe koordinuar strategjitë makrorajonale;

OS 4.1: Lehtësimi për koordinimin dhe zbatimin e strategjisë EUSAIR duke rritur kapacitetet institucionale të administratës publike dhe aktorët kryesorë, dhe duke ndihmuar ecurinë e implementimit të prioritetëve të përbashkëta.



Informacion i hollësishëm për OS-të është dhënë në seksionin 2.

Dimensionet horizontale

Përveç orientimit tematik, Programi ADRION trajton aspektet horizontale tematike të theksuara në rregulloret e BE-së: zhvillimin e qëndrueshëm, mundësi të barabarta dhe jodiskriminimit, barazisë midis burrave dhe grave. Këto parime horizontale janë zhvilluar më tej në seksionin 8.

Për më tepër, çështjet specifike do të trajtohen në mënyrë ndërsektoriale në PI-të e ndryshme që kontribuojnë në objektivat e përgjithshëm të programit:

Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit

Zhvillimi i produkteve, shërbimeve dhe aplikimeve të TIK-ut përbën një mbështetje të rëndësishme për zhvillimin social-ekonomik, qeverisjen, krijimin e rrjeteve etj.; Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) mund të përdoret në një mënyrë transversale për të arritur objektivat e disa PI-ve.

Kohezioni social dhe inovacioni social

Në fusha të ndryshme të ndërhyrjes do t'i kushtohet vëmendje projekteve që përfshijnë partnerë ose që marrin masa që kanë efekte pozitive në kohezionin social. Ky është veçanërisht rasti kur përfshin ndërmarrjet shoqërore ose gjatë zbatimit të veprimeve/aksioneve që synojnë përmirësimin e kushteve të grupeve vulnerabël (ballafaquar me vështirësitë e integritetit ekonomik dhe social).

Të dhënat dhe menaxhimi i njohurive

Çdo projekt dhe secili partner i projektit duhet të vërë në dispozicion të publikut të dhënat e përdorura për projektet apo të krijuara nga projekti për të përmirësuar shpërndarjen e përvojave dhe

rezultateve. Projektet inkurajohen të ofrojnë grupe të dhënash në përputhje me parimin “të dhëna të hapura”, për të përmirësuar përhapjen dhe ripërdorimin e të dhënave ndërmjet institucioneve publike, partnerëve dhe publikut të gjerë.

Qasja territoriale dhe ekosistemi

Në çdo territor të synuar (urban, bregdetar, ishujt dhe zonat e largëta) projektet do të duhet të përfshijnë aktorët përkatës të sektorëve dhe institucioneve nga fushat e ndërhyrjes së projektit. Qasjet duhet të jenë “të integruara” ose “ekosistemi”, në mënyrë që rezultati të mos mbetet në propozime të izoluar që funksionojnë në aspekte të kufizuara të turizmit, energjisë apo transportit për shembull, por të jetë një përpjekje për koordinimin që insiston në kontributin e këtyre fushave për zhvillimin e qëndrueshëm të territoreve (duke marrë parasysh mjetet në dispozicion, perspektivat ekonomike, politikat publike në vazhdimësi, kufizimet mjedisore etj.).

Partnerët do të duhet të eksplorojnë se si t'i detyrojnë aktorët përkatës nga fushat e mbrojtjes së mjedisit, turizmit, transportit etj. të punojnë së bashku. Me këtë qasje bashkëpunimi transkombëtar do të kontribuojë në zhvillimin e aspekteve të planifikimit strategjik.

1.1.1 Arsyetimi për zgjedhjen e objektivave dhe prioriteteve tematike përkatëse të investimeve, duke pasur parasysh Strukturën e Përbashkët Strategjike të bazuar në një analizë të nevojave brenda zonës së programit në tërësi dhe strategjisë së zgjedhur në përgjigje të nevojave të tilla, trajtimin kur është e përshtatshme, lidhjet që mungojnë në infrastrukturën ndërkufitare, duke marrë parasysh rezultatet e vlerësimit ex-ante

Tabela 1: Një pasqyrë sintetike e arsytimit për përzgjedhjen e objektivave tematikë dhe prioriteteve të investimeve

Objektivi i përzgjedhur tematik	Prioriteti i përzgjedhur i investimit	Arsyetime për përzgjedhjen
OT 1 Forcimin e kërimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit (...)	PI 1b Promovimin e investimeve të biznesit në risi dhe kërkimin dhe zhvillimin e lidhjeve dhe sinergiive ndërmjet ndërmarrjeve, institucioneve kërkimore dhe arsimit të lartë (...)	- Nevoja për të përmirësuar kapacitetet e inovacionit, konkurrencës dhe ndërkombëtarizimit të SME-së përballë me konkurrencën ndërkombëtare në disa sektorë kyç si turizmi, agrobiznesi, industritë krijuese, peshkimi, energjia. - Nevoja për të përmirësuar kapacitetet e inovacionit përmes një përdorimi të përbashkët më efikas të infrastrukturës kërkimore dhe njohurive dhe kompetencave për bashkëpunim më të mirë ndërkombëtar nëpërmjet biznesit, kërimit dhe edukimit. - Nevoja për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të spirales së katërfishtë, veçanërisht në mesin e grupeve të hulumtimit dhe ndërmarrjeve të biznesit, qendrat e arsimit të lartë R & D; dhe mbështetjen e rrjeteve, grupimeve dhe risi të hapur. - Nevoja për të mbështetur zonat dhe qasjet e reja të inovacionit (ekoinovacionin; prokurimin publik për inovacion, industrinë krijuese; industrinë e shërbimit dhe inovacionit social). - Nevoja për të zhvilluar strategji të zgjuara të specializimit nga përdorimi i rezultateve RIS3. - Nevoja për të nxitur mbështetjen e menaxhimit të inovacionit (këshillimi i pronësisë intelektuale, transferimit të teknologjisë, prototipin, demonstruesit etj.).
OT 6 Mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e efikasitetit të burimeve	PI 6c Ruajtjen, mbrojtjen, promovimin dhe zhvillimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore	- Burimet e mëdha kulturore dhe mjedisore në rajonet ADRION kërcënohen nga aktivitetet njerëzore dhe ndryshimet e mjedisit (veçanërisht ndryshimet klimatike). - Potencial i plotë i trashëgimisë natyrore dhe kulturore si mjete të zhvillimit të pashfrytëzuara ende. - Presioni i lartë i aktiviteteve turistike dhe urbanizimit, veçanërisht në zonat bregdetare ADRION (turizmi i qëndrueshëm). - Rritja e presionit mbi burimet ujore nga një pikë sasiore dhe cilësore e parë.
	PI 6d Mbrojtja dhe rivendosja e biodiversitetit, mbrojtja e tokës dhe restaurimi, promovimi i shërbimeve të ekosistemit, duke përfshirë NATURA 2000 dhe infrastrukturën e gjelbër	- Presion në rritje mbi biodiversitetin dhe zhvillimin e specieve që sulmojnë - Presion mbi cilësinë e ujit me pasoja të drejtpërdrejta mbi biodiversitetin - Rol vendimtar i mjedisit në zhvillimin turistik dhe ekonomik të rajoneve ADRION - Nevoja për të trajtuar cënueshmërinë e mjedisit, për të përmirësuar kapacitetin e menaxhimit të rrezikut, për të mbështetur përdorimin optimal të tokës dhe konsumit të burimeve etj.



Objektivi i përzgjedhur tematik	Prioriteti i përzgjedhur i investimit	Arsyetimi për përzgjedhjen
OT 7 Promovimi i transportit të qëndrueshëm dhe heqja e pengesave në infrastrukturën kryesore të rrjetit	PI 7c Zhvillimi dhe përmirësimi i mjedisit të favorshëm (duke përfshirë zhurmën e ulët) dhe të sistemit të ulët të karbonit në transport, duke përfshirë rrugët ujore në brendësi dhe transportin detar, lidhjet portuale multimodale dhe infrastrukturën e aeroportit, me qëllim nxitjen e lëvizshmërisë së qëndrueshme rajonale dhe vendëse	- Nevoja për të reduktuar ndikimin mjedisor të transportit duke rritur multimodalitetin dhe duke u zhvendosur në metoda të transportit më të përshtatshme dhe më miqësore me mjedisin. - Nevoja për të përmirësuar pikën e kalimit transit kufitar për jo të gjitha kufijtë e BE-së, ku pengesat administrative dhe organizative sjellin vonesa të konsiderueshme në udhëtimet e caktuara. - Nevoja për të investuar në menaxhimin e TIK-ut për të gjitha aktivitetet e transportit të mallrave. - Nevoja për të përmirësuar platformat ujore - hekurudhore intermodale si për portet detare dhe për portet e brendshme të ujërave. - Nevoja për të përforcuar zbatimin e TIK-ut për të bërë më të hapur dhe më të lehtë qasjen e informacioneve të transportit dhe të zbatojë të gjitha mundësitë intermodale për lëvizjen e udhëtarëve. - Përdorimi i energjive të rinovueshme më të ulëta se mesatarja e BE-së.
OT 11 Rritja e kapaciteteve institucionale të autoriteteve publike dhe grupeve të interesit dhe efikasitetit të administratës publike	PI 11 (neni 7 (b) të Rregullores të BE-së 1299/2013) Rritja e kapaciteteve institucionale të autoriteteve publike dhe grupeve të interesit dhe efikasitetit të administratës publike duke zhvilluar dhe koordinuar strategjitë makrorajonale dhe të basenit detar	- Nevoja për të siguruar një qeverisje të mirë të EUSAIR-it. - Nevoja për të vënë në vend mekanizmat e mirë dhe të qëndrueshëm të qeverisjes dhe të mbështetur nga koordinatorët kombëtarë. - Nevoja për të siguruar përfshirjen e aktorëve kryesorë (kombëtarë, rajonale, lokale) në ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e strategjisë. - Nevoja për të forcuar kapacitetin për analizë territoriale në bazë të mbledhjes së të dhënave të harmonizuara. - Nevoja për të mbështetur idetë e projektit për të bërë projekte të duhura ndërkombëtare. - Nevoja për identifikimin dhe koordinimin e të gjitha burimeve të mundshme të financimit të projekteve të përbashkëta, meqë palët e interesuara kanë tendencë të kenë mungesë njohurie në lidhje me burimet e ndryshme të financimit. - Nevoja për bashkërendim me strategjitë e tjera ekzistuese dhe të ardhshme makrorajonale.

⁶ Të gjitha programet ESIF, përfshirë ETC, Fondi i Kohëzimit, IPA, programet sektoriale të BE-së (Horizon 2020), LIFE, Cosme, Connecting Europe Facility, programet kombëtare, rajonale, institucionet financiare ndërkombëtare (EIB, Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) etj.), bankat, financuese private, donatorët etj.

**Arsyetimi i alokimeve financiare**

Buxheti i përgjithshëm i Programit kap vlerën 117.918.197 euro, duke përfshirë Fondin Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF) - 83.467.729 EUR - Instrumentin e Paraanëtarësimit (IPA II) - 15.688.887 EUR - dhe kontributet kombëtare - 18.761.581 EURO siç përshkruhet në nenin 3.

Alokimi financiar për OB-të e përzgjedhura pasqyrojnë:

- Madhësinë e vlerësuar financiare të projekteve të parashikuara në çdo Aks Prioriteti (AP), aksin bazuar në përvojën e periudhës 2007-2013;

- Koherencën me nevojat e shteteve partnere;
- Mendimet e shprehura gjatë raundeve të konsultimit; dhe
- E fundit, por jo e parëndësishme, shprehja e zgjedhjeve strategjike të aktorëve ADRION.

Kur të vlerësohen alokimet financiare për OT, nënkuptohet një buxhet mesatarisht 2 milionë euro për operacion. Alokimi financiar për AP është si vijon:

- AP 1 (OT 1): Alokimi i planifikuar i buxhetit (fondet e Unionit) për AP 1 është 19.691.658 EUR, që korrespondon me 20% të totalit. Alokimi financiar për këtë prioritet është në përputhje me theksin e vendosur për inovacion, transferimin e teknologjisë dhe sipërmarrjes nga të gjitha shtetet partnere ERDF dhe IPA, orientimin e EUSAIR-it dhe konsultimet e ndërmarra gjatë procesit të programimit.

- AP 2 (OT 6): Alokimi i planifikuar i buxhetit (fondet e Unionit) për AP 2 është 45.472.376 EUR, që korrespondon me 46% të totalit. Ky alokim financiar reflekton madhësinë e pritur të veprimeve që lidhen me vlerësimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe nevojat për rritjen e ndërgjegjësimit, harmonizimin e qasjeve të menaxhimit, për të lehtësuar transferimin e njohurive dhe nxitjen e potencialeve dhe përgjegjësi të përbashkëta në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të riskut.

- AP 3 (OT 7): Alokimi i planifikuar i buxhetit (fondet e Unionit) për AP 3 është 17.708.524 EUR, që korrespondon me 18% të totalit. Alokimi financiar për këtë prioritet është në përputhje me theksin e vendosur për lidhjet, lëvizshmërinë e transportin efikas dhe miqësor me mjedisin brenda të gjitha shteteve partnere si parakusht për shtyllat e EUSAIR-it. Ajo gjithashtu reflekton kërkesën e ulët relative në orientimin tematik të shprehur gjatë periudhës 2007-2013 dhe gjatë konsultimeve aktuale të programimit.

- AP 4 (OT 11): Alokimi i planifikuar i buxhetit (fondet e Unionit) për AP 4 është 9.775.995 EUR, që korrespondon me 10% të totalit. Kjo rrjedh nga nevoja për të trajtuar sfidat e qeverisjes dhe zhvillimin në zonën ADRION duke investuar në qeverisje shumë-nivelëshe dhe shumëkombëshe në detyrat, përqasjet, shërbimet dhe proceset e administratës publike dhe të aktorëve kyç në kuadrin e zbatimit të EUSAIR-it.



Tabela 2: Përmbledhje e strategjisë së investimit të programit të bashkëpunimit

Aksi prioritar	Mbështetja e ERDF (EURO)	Ndarja e mbështetjes totale të Unionit në Programin e Bashkëpunimit (sipas fondit) ⁷			Objektivi tematik ⁸	Prioritetet e investimeve ⁹	Objektivat specifikë	Treguesit e rezultatit që korrespondojnë me objektivin specifik
		ERDF	ENI (ku aplikohet)	IPA (ku aplikohet)				
1.	16.693.547	20%		19%	1. Forcimi i kërkimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacion	PI 1.b Promovimi i investimeve në biznes R&I, zhvillimi i lidhjeve dhe sinergjive mes ndërmarrjeve, qendrave kërkimore dhe zhvillimore, si dhe arsimit të lartë (...)	Mbështetje e zhvillimit të një sistemi inovativ rajonal për zonën Adriatik- Jon	Niveli i kapacitetit të aktorëve kryesorë inovativë që do të përfshihen në mënyrë efektive në aksionet transnacionale për zhvillimin e sistemit inovativ rajonal
2.	38.395.155	46%		45%	6. Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i eficiencës së burimeve	PI 6.c Ruajtja, mbrojtja, promovimi dhe zhvillimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore	Promovim të vlerësimit të qëndrueshëm dhe ruajtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore si aset zhvillimi në zonën Adriatik- Jon	Niveli i kapacitetit për palët e interesuara në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe turizmit për të vlerësuar në mënyrë të qëndrueshme trashëgiminë natyrore dhe kulturore si një aset zhvillimi
						PI 6.d Mbrojtja dhe restaurimi i biodiversitetit të tokës, si dhe promovimi i shërbimeve të ekosistemit përmes Natura 2000 dhe infrastrukturës së gjelbër	Përmirësimi i kapaciteteve në ndjekjen transnacionale të rrezikut të mjedisit, ndarja dhe ruajtja e shërbimeve të ekosistemit në zonën Adriatik- Jon	Niveli i kapacitetit të organizatave të përfshira në veprimet transnacionale, duke ofruar shërbime dhe menaxhim lidhur me rrezikun në mjedis, ndarjen dhe ruajtjen e shërbimeve të ekosistemit

⁷ Prezentimi i ndarjes që korrespondon me shumat e ENI-it dhe IPA-s varet nga opsioni i zgjedhur i menaxhimit.⁸ Titulli i objektivit tematik nuk aplikohet për asistencën teknike.⁹ Titulli i prioritetit të investimit nuk aplikohet për asistencën teknike.



3	15.024.191	18%		17%	7. Promovimi i transportit të qëndrueshëm dhe heqja e ngushtimeve të rrugës në infrastrukturën kyçe të rrjetit	PI 7.c Zhvillimin dhe përmirësimin e sistemeve të transportit miqësor me mjedisin (përfshirë zhurmën e ulët) dhe me karbon të ulët, duke përfshirë rrugët ujore në brendësi dhe transportin detar, portet, lidhjet multimodale dhe infrastrukturën e aeroportit, me qëllim nxitjen e lëvizshmërisë së qëndrueshme rajonale dhe lokale	Përmirësim të kapacitetit për shërbimet e transportit dhe lëvizshmërisë dhe multimodalitetit në zonën Adriatik-Jon	Niveli i kapacitetit të organizatave në fushën e transportit dhe lëvizshmërisë për të planifikuar në nivel transnacional dhe për të zbatuar në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të fushës së transportit multimodal e mundësive të lëvizshmërisë
4.	8.346.773	10%		9%	11. Përmirësimi i kapaciteteve institucionale të autoriteteve publike dhe palëve të interesuara (...)	PI 11 Neni 7 (b) Rreg. nr. 1299/2013 Rritja e kapaciteteve institucionale të autoriteteve publike dhe palëve të interesuara dhe administratës efikase publike përmes zhvillimit dhe koordinimit të strategjive makrorajonale dhe të baseneve detare	Lehtësim të koordinimit dhe zbatimit të EUSAIR-it përmes rritjes së kapaciteteve institucionale të administratës publike dhe palëve kyçe të interesuara dhe përmes ndihmës në progresin e zbatimit të prioritetëve të përbashkëta	Statusi i kapaciteteve menaxhuese të strukturave të qeverisjes EUSAIR për të zbatuar në mënyrë efikase EUSAIR dhe planin e saj të veprimit, për arritjen e objektivave dhe qëllimeve të tyre
Asistenca teknike	5.008.063	6%			E pazbatueshme	E pazbatueshme	E pazbatueshme	E pazbatueshme

**SEKSIONI 2: Akset prioritare**

(Referenca: pikat (b) dhe (c) të nenit 8(2) të Rregullores BE me nr. 1299/2013)

SEKSIONI 2.A Përshkrimi i akseve prioritare përveç asistencës teknike

(Referenca: pikat (b) të nenit 8(2) të Rregullores ETC)

2.A.1 Aksi prioritar 1

ID	Aksi prioritar 1
Titulli	Rajone të reja dhe inteligjente

- ☐ I gjithë aksi prioritar do të zbatohet vetëm përmes instrumenteve financiare.
- ☐ I gjithë aksi prioritar do të zbatohet vetëm përmes instrumenteve financiare të përcaktuara në nivel të Bashkimit Evropian.
- ☐ I gjithë aksi prioritar do të zbatohet përmes zhvillimit vendës i udhëhequr nga komuniteti.

2.A.2 Arsyetimi për krijimin e një aksi prioritar që mbulon më shumë se një objektiv tematik

(Referenca: neni 8(1) të Rregullores së ETC-së)

Nuk aplikohet

2.A.3 Fondi dhe baza e përlogaritjes për mbështetjen e Bashkimit Evropian

Fondi	ERDF+ IPA
Baza e llogaritjes (shpenzimet në total të zbatueshme)	19.691.658 EURO

2.A.4. Prioriteti i investimit 1.b

(Referenca: pikat (b)-(a) të nenit 8(2) të Rregullores BE me nr. 1299/2013)

Prioriteti i investimit 1.b
Promovimi i investimeve të biznesit në R & I, zhvillimi i lidhjeve dhe sinergjisë ndërmjet ndërmarrjeve, qendrat e kërkimit dhe të zhvillimit dhe sektorit të arsimit të lartë, në veçanti promovimin e investimeve në prodhimtari dhe në zhvillimin e shërbimeve, transferimin e teknologjisë, inovacionin social, ekoinovacionin, aplikimet në shërbimin publik, stimulimin e kërkesës, krijimi i rrjeteve, grupimet e hapura dhe të inovacionit përmes specializimit të zgjuar, dhe mbështetjen teknologjike dhe të aplikuar, linjat pilote, veprime të hershme për vlefshmërinë e produktit, aftësi të përparuara të prodhimit dhe të prodhimit të parë, veçanërisht në teknologjinë kyçe që mundëson dhe përhapjen e teknologjive me qëllim të përgjithshëm.

2.A.5. Objektiv specifik që korrespondon me prioritet e investimeve dhe rezultateve të pritshme

(Referenca: pikat (b)-(i) dhe (iii) të nenit 8(2) të Rregullores BE me nr. 1299/2013)

ID	1.1
Objektivi specifik	Mbështetje për zhvillimin e një sistemi inovativ rajonal për zonën adriatiko-joniane
Rezultatet e pritshme	Zona ADRIION karakterizohet nga një performancë e ulët e inovacionit (modelet e inovacionit më shumë bazohen në diversifikim, sesa në rrugëdaljet e inovacionit), kapacitetin e kufizuar të SME-ve, bashkëpunimit të pamjaftueshëm



3500 karaktere maks.	midis kompanive, qendrave kërkimore dhe agjencive publike, mungesa e skemave mbështetëse dhe kapitalit burimor, aplikime të vjetra teknologjike, mungesa e fokusit në çështjet specifike që mund të jetë avantazh konkurrues për zonën (<i>p.sh., rritjen blu</i>), specializime të kufizuara sektoriale dhe ndër-sektoriale, mungesa e shërbimeve me vlerë të lartë të shtuar, të kuptuarit të papërshtatshëm për rëndësinë e pronësisë intelektuale etj. - Nga ana tjetër ka një numër të grupeve kërkimit dhe të inovacionit shumë aktiv dhe konkurrues, edhe pse me aktivitet të paktë të përbashkët brenda rajonit veçanërisht në aksin lindje-perëndim. Një pikë tjetër e fortë është ekzistenca e RIS3. Këto ofrojnë mundësinë e fokus tematik në njërën anë dhe ofrimin e një modeli të procesit nga ana tjetër, veçanërisht për shtetet partnere me IPA-n. – Megjithatë, qeverisja e inovacionit në nivel ndërkombëtar mbetet e dobët. - Në kuadër për sa më sipër, rajoni ka një seri të fushave të përbashkëta të interesit, ku bashkëpunimi ndërkombëtar mund të përqendrohet për të zhvilluar një masë kritike. Zonat treguese janë: Sektorët tradicionalë, të tillë si: ndërtimi i anijeve, logjistika dhe peshkimi. - Sektorët në zhvillim, të tillë si: teknologjitë blu, duke përfshirë bioteknologjinë detare dhe akuakulturën, robotikën, materialet, monitorimin e detit, për lëvizshmërinë në detin e gjelbër, burimet në thellësi të detit, biosigurinë dhe bioteknologjinë etj. - Teknologjitë mjedisore dhe të energjisë (“teknologjia e pastër” dhe “teknologjia mjedisore”, BRE, e-shërbimet). - Turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore (inovacione e produktit dhe të procesit, menaxhimi i qëndrueshëm i rrjedhës turistike, kërkesat për vizitorët e mundshëm dhe të tanishëm, industritë krijuese, inovacioni social, njohuritë tradicionale për aftësitë). -E-qeverisja dhe e-mjetet për menaxhimin e prokurimit dhe shërbimeve ndaj qytetarëve. Rezultatet e pritshme mund të shihet në: - Mirëkuptimin e përbashkët nëpërmjet shteteve partnere me Adrion në fushat e mundshme të veprimeve të inovacionit ndërkombëtar dhe nxitjen e përhapjes dhe marrjes së inovacionit. - Rritjen e kompetencave dhe aftësive të palëve të përfshira. - Përmirësimin e kushteve strukturore (ndërgjegjësimit dhe largpamësinë, aspektet ligjore dhe ekonomike, qeverisjen risi, çështjet organizative, zgjidhjet e politikave, vlerësimet e ndikimit të teknologjisë). - Mobilizimin e palëve të interesuara në fushat e kërkimit, inovacionit dhe shfrytëzimit me qëllim rritjen e transferimit të njohurive në biznes, te përdoruesit, grupet akademike dhe të administratës (qasje e spirales së katërfishtë helix). - Identifikimi i mundësive të zhvillimit të tregut në lidhje me avantazhet konkurruese në zonën e programit, në fushat e EUSAIR-it dhe strategjitë e zgjuara të specializimit të rajoneve në mënyrë që të zhvillohet një “masë kritike” ADRION. - Koordinim më i mirë në politikat e inovacionit dhe të strategjive, p.sh., në nivel RIS.
-------------------------------------	---

**Tabela 3: Treguesit specifikë të rezultatit të programit (sipas objektivit specifik)**

(Referenca: pika (b) (ii) të nenit 8 (2) të Rregullores (BE) me nr. 1299/ 2013)

Një (nëse është e mundur) dhe jo me shumë se dy tregues të rezultatit duhet të përdoren për secilin objektin specifik.

ID	Treguesi i rezultatit	Njësia e matjes	Vlera bazë	Viti bazë	Vlera e synuar ⁷ (2023) <i>Maks. 100 karaktere</i>	Burimi i të dhënave <i>Maks. 200 karaktere</i>	Shpeshtësia e raportimeve <i>Maks. 100 karaktere</i>
1b.1	Niveli i kapaciteteve të palëve kryesore të inovacionit që janë të përfshirë në mënyrë efektive në veprimet ndërkombëtare për zhvillimin e një sistemi rajonal të inovacionit	%	60,19%	2014	Rritje	Sondazh	2018 2020 2023

⁷ Vlerat e synuara mund të jenë cilësore ose sasiore**2.A.6. Veprimet që do të mbështeten nën prioritetin e investimeve**

2.A.6.1 Një përshkrim i llojit dhe shembujve të veprimeve që do të mbështeten dhe kontributi i tyre në objektivat specifikë, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, identifikimin e grupeve kryesore të synuara, teritore të veçanta të synuara dhe llojet e përfituesve.

(Referenca: pika (b)(iii) të nenit 8(2) të Rregullores (BE) me nr. 1299/2013)

Prioriteti i investimit 1.b	Promovimi i investimeve të biznesit në R&I, zhvillimi i lidhjeve dhe sinergjive nëpërmjet ndërmarrjeve, qendrave të kërkimit dhe zhvillimit, dhe sektorit të arsimit të lartë (...)
------------------------------------	---

Veprimet treguese që duhet të mbështeten, janë:

Krijimi i rrjeteve ndërkombëtare të inovacionit në mënyrë që të parashikohen veprimet e mundshme për bashkëpunim në fushën ADRION, për të identifikuar sektorët përkatës të interesit të përbashkët, kërkimit e hartës ekzistuese dhe burimeve të inovacionit dhe koordinimit të sigurt me EUSAIR-in, strategjitë rajonale dhe kombëtare RIS3, iniciativat e qeverisjes risi dhe rrjetet e kompetencave.

Analiza e kushteve strukturore për inovacionin (ligjor, financiar, administrativ, teknik, social, kulturor dhe mjedisor) në mënyrë që të përcaktojnë “fushën e zbatimit” si një risi në fushën ADRION.

Zhvillimi i strukturave lidhur me konsultimin mbi pronën ligjore dhe intelektuale, çështjet teknike dhe financiare dhe ofrimin e shërbimeve të lidhura veçanërisht për SME-të (duke përfshirë edhe bizneset e reja, prodhimet dytësore, bashkëpunimet), të tilla si mbështetje për skemat identifikuese të qasjes për inxhinierinë financiare si një dëshmi të mekanizmave konceptuale për bizneset e reja.

Zhvillimi i veprimeve për ngritjen e kompetencave dhe aftësive të palëve të interesuara, veçanërisht duke u fokusuar në përfshirjen e partnerëve nga vendet candidate dhe potencialisht candidate, duke përfshirë konceptet e arsimit dhe të trajnimit për marrjen dhe përhapjen e inovacionit dhe njohurive të menaxhimit duke promovuar fleksibilitetin e kandidatëve për kërkime dhe doktoraturë në rajonin ADRION.

Zhvillimi i platformave për shkëmbimin e njohurive (njohuritë e komuniteteve të reja, retë e të dhënave) dhe krijimin e rrjeteve funksionale të objekteve kërkimore të përbashkëta të shpërndara.

Zhvillimi i grupimeve ndërkombëtare “spiralja e katërfishtë” në fusha të interesit të përbashkët që trajtojnë të gjitha fazat e ciklit të inovacionit, duke përfshirë idetë e gjeneratës, konceptim dhe prototipin, transferim, patentimin, komercializim etj.

Zhvillimi i modeleve ndërkombëtare për projektim, testim, rritjen e cilësisë, krahasimin dhe vlerësimin e inovacioneve (politikat, mjetet, proceset, aktorët, organizatat dhe ndërfaqet).



Zhvillimi i produkteve të projektuara ndërshtetërore, shërbimet, modelet e investimeve dhe instrumenteve mbështetëse të financimit të qendrave për mbështetjen e biznesit, dhomën e tregtisë, administratës publike dhe institucioneve të financimit.

Zhvillimi i strategjive, skemave dhe mjeteve për përmirësimin e krijimtarisë dhe qasjeve të reja në të gjithë spektrin e shoqërisë, duke përfshirë arsimin, shërbimet sociale shëndetësore, organizatat vullnetare dhe ndërmarrjet shoqërore.

Ndërtimin e rrjeteve transnacionale për transferimin e njohurive në mesin e administratës publike për zgjidhje teknologjike.

Lehtësimin e studimit të politikave duke integruar edhe rezultatet e gjeneruara përmes iniciativave të mëparshme të BE-së që lidhen me inovacionin dhe mbështetjet e grupeve të interesit, për shembull rajonet e njohurive (FP7), në të cilat promovohet bashkëpunimi i gjerë evropian në mes të qendrave kërkimore publike dhe private, ndërmarrjeve dhe autoriteteve dhe grupimeve rajonale që mbështesin kërkimet.

Promovimi i zhvillimit të teknologjive të ekoinovacionit në lidhje me cilësinë e ajrit dhe kontrollin e emetimeve (instalimet e brendshme të djegies, teknologjitë e kalimit të emetimit të karburantit ose furnizimit me energji elektrike nga bregu për anije në porte të qëndrueshme).

Grupet e synuara

Publiku i gjerë;

Grupet e renditura më poshtë nën titullin “llojet treguese të përfituesve”;

Institucionet financiare, bankat;

Ndërmarrjet, duke përfshirë edhe SME-të.

Llojet treguese të përfituesve

Autoritetet publike vendore;

Autoritetet rajonale publike;

Autoritetet publike kombëtare;

Agjencitë;

Organizatrat ndërkombëtare;

Organizatrat hulumtuese;

Ofruesit e shërbimeve (publike);

Institucionet e arsimit të lartë;

Qendrat e arsimit dhe trajnimit;

Organizatrat mbështetëse të biznesit;

Grupet e interesit, duke përfshirë OJQ-të dhe organizatat kulturore dhe qytetare.

2.A.6.2 Parimet drejtuese për përzgjedhjen e operacioneve

(Referenca: pika (b)(iii) të nenit 8(2) të Rregullores (BE) me nr. 1299/2013)

Prioriteti i investimit 1.b	Promovimi i investimeve të biznesit në R&I, zhvillimi i lidhjeve dhe sinergjive nëpërmjet ndërmarrjeve, qendrave të kërkimit dhe zhvillimit, dhe sektorit të arsimit të lartë (...)
Përzgjedhja e projekteve do të kryhet në përputhje me nenin 12 të Rregullores ETC, duke ndjekur një procedurë të standardizuar të vlerësimit, qëllimi i të cilave përfshin: Vlerësimin e rëndësisë së një projektpropozimi; Vlerësimin e fizibilitetit të qasjes së propozuar;	



Përcaktimin e një bazë transparente dhe objektive për vendimet e marra për propozimet e refuzuara ose të miratuara;

Sigurimin e një baze për komunikim dhe përmirësim mes organeve të Programit dhe aplikuesve.

Vlerësimi do të kryhet duke përdorur grupet e mëposhtme të kriterëve:

Kriteri i vlerësimit strategjik

Këto kriterë shqyrtojnë:

Rëndësinë, koherencën dhe kontributin e secilit projektpropozimi me objektivat e Programit ADRION dhe veçanërisht në lidhje me SO;

Kontributi në rezultatet e parashikuara për IP;

Saktësinë e konceptit dhe demonstrimin e nevojës për ndërhyrjen e propozuar në kontekstin e tij tematik dhe territorial;

Vlerën e shtuar të bashkëpunimit ndërkombëtar;

Rëndësia e propozuar partneritetet më lart;

Rëndësia dhe koherenca e projektit me strategjinë EUSAIR dhe kontributin në arritjen e objektivave të tij;

Rëndësia dhe koherenca e projektit me strategjitë e tjera përkatëse të BE-së dhe ose politikave.

Kriteret e vlerësimit operacional

Këto kriterë shqyrtojnë:

Përshtatshmërinë e dispozitave të menaxhimit në drejtim të strukturave, procedurave dhe kompetencave;

Cilësinë dhe efektivitetin e dispozitave të komunikimit;

Cilësinë e Planit të Punës në lidhje me qartësinë dhe koherencën e objektivave operativë, aktivitetet dhe mjetet, fizibilitetin, efikasitetin e projektit dhe rezultatet e tij të mundshme për marrjen dhe rivendosjen e procedurave operative të partnerëve të përfshirë;

Përshtatshmërinë e dispozitave buxhetore për të garantuar zbatimin e projektit dhe që të gjenerojë vlerë monetare.

Koherenca me kriteret e parimeve horizontale

Këto kriterë shqyrtojnë shkallën në të cilën projektet kanë integruar brenda logjikës së tyre të ndërhyrjes:

Parime horizontale PA1, të tilla si: promovimi i energjisë, efikasitetit të burimeve, shqyrtimin e parimeve të inovacionit të hapur;

Dimensionet ndërlidhëse të programit ADRION, siç përcaktohet në nenin 1; mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimi, barazia ndërmjet burrave dhe grave, kohezionin social dhe inovacioni social, të dhënat dhe menaxhimi i njohurive, përdorimi i TIK-ut, qasje territoriale dhe ekosistematike.

Elementet e mësipërme nuk duhet të konsiderohen si një “listë kontrolli”, por duhet më tepër të inkurajojnë projekte që në mënyrë aktive të zhvillojnë idetë e tyre të projektit brenda logjikës së Programit.



Këto tri kritere janë paraqitur në mënyrë të rëndësishme për projektin. Kriteret e Vlerësimit Strategjik shqyrtojnë rëndësinë e propozimit të projektit; kështu ato mbajnë primatin absolut mbi dy kriteret e tjera. Kriteret e Vlerësimit Operacional sigurojnë përçimin e suksesshëm të rezultateve; kështu ato kanë më shumë peshë se Kriteret e Parimeve Horizontale dhe Koherencës, të cilat janë të orientuara drejt integritetit të një propozimi “të zbatueshëm dhe të realizueshëm” në logjikën Adrion.

Kriteret e detajuara të vlerësimit do të përcaktohen dhe të vihen në dispozicion të aplikantëve të mundshëm në manualin në lidhje me programin.

Shpenzimet përgatitore do të jenë të zbatueshme në bazë të fondeve PA 1.

2.A.6.3 Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare

(Referenca: pika (b)(iii) të nenit 8(2) të Rregullores (BE) me nr. 1299/2013)

Prioriteti i investimit 1.b	Promovimi i investimeve të biznesit në R&I, zhvillimi i lidhjeve dhe sienergji nëpërmjet ndërmarrjeve, qendrave të kërkimit dhe zhvillimit, dhe sektorit të arsimit të lartë (...)
Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare	
Mundësia e përpunimit dhe zbatimit të instrumenteve financiare do të diskutohet gjatë zbatimit të programit	

2.A.6.4 Përdorimi i planifikuar i projekteve madhore

(Referenca: pika (b)(iii) të nenit 8(2) të Rregullores ETC)

Nuk është e zbatueshme.

2.A.6.5 Treguesit e rezultateve

(Referenca: pika (b)(iv) të nenit 8(2) të Rregullores (BE) me nr. 1299/2013)

Tabela 4: Treguesit e përbashkët dhe rezultatet specifike të programit

ID	Treguesi i rezultatit	Njësia e matjes	Vlera e synuar (2023)	Burimi i të dhënave 200 karakt. maks.	Shpeshtësia e raportimit 100 karakt. maks.
COI_1	Numri i ndërmarrjeve që bashkëpunojnë me institucionet kërkimore	Ndërmarrjet (Numri)	1000	Monitorimi	Në bazë vjetore
OI_1b.1_1	Numri i rrjeteve dhe grupimeve që mbështesin bashkëpunimin ndërkombëtar	Numri	8	Monitorimi/ Raportet e projektprogresit	Në bazë vjetore
OI_1b.1_2	Numri i strategjive dhe planeve të veprimit të zhvilluara nga rrjetet dhe grupimet transnacionale të inovacionit	Numri	12	Monitorimi/ Raportet e projektprogresit	Në bazë vjetore



2.A.7. Korniza e performancës

(Referenca: pika (b)(v) e nenit 8(2) të Rregullores ETC dhe aneksit II të CPR-së)

Tabela 5: Korniza e performancës së aksit prioritar

Aksi prioritar	Lloji i indikatorit (hapi kyç i zbatimit, financiar, rezultati ose, kur është e nevojshme, tregues i rezultatit)	ID	Indikatori ose hapi kyç i zbatimit	Njësia e matjes, ku është e përshtatshme	Vlera e synuar për 2018	Vlera përfundimtare (2023)	Burimi i të dhënave	Shpjegim i relevancës së indikatorit, ku është e përshtatshme
1	Financiar		Financiar	EUR	1.969.166	19.691.658	Monitorim	
1	Rezultati	OI_1b.1_2	Numri i strategjive dhe planeve të veprimit që janë zhvilluar nga rrjetet dhe grupet inovative transnacionale	Numër	2	12	Raportet e progresit të projektit/monitorimi	

2.A.1. Aksi prioritar 2

ID	AKSI PRIORITAR 2
Titulli	Rajoni i qëndrueshëm

☐ I gjithë aksi prioritar do të zbatohet vetëm përmes instrumenteve financiare.

☐ I gjithë aksi prioritar do të zbatohet vetëm përmes instrumenteve financiare të përcaktuara në nivelin e Unionit.

☐ I gjithë aksi prioritar do të zbatohet përmes zhvillimit lokal të drejtuar nga komuniteti.

2.A.2. Arsyetimi për krijimin e një aksi prioritar që mbulon më shumë se një objektiv tematik

(Referenca: Neni 8 (1) i Rregullores BTE)

Nuk aplikohet.

2.A.3 Fondi dhe baza e përlogaritjes për mbështetjen e Unionit

Fondi	ERDF+ IPA
Baza e përlogaritjes (shpenzimet totale të lejuara)	45.472.376 EUR

2.A.4. Prioritet i investimeve 6c

(Referenca: pika (b) (i) e nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

PRIORITET I INVESTIMEVE 6C

Ruajtja, mbrojtja, promovimi dhe zhvillimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore

2.A.5. Objektiv i specifik që korrespondon me prioritetin e investimeve dhe rezultateve të pritshme

(Referenca: pikat (b) (i) dhe (ii) të nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

ID	2.1
Objektivi specifik	Nxitja e vlerësimit dhe ruajtjes së qëndrueshme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore si asete të rritjes në zonën ADRIION
Rezultatet e pritshme 3500 karaktere maks.	Zona ADRIION ndërthur trashëgiminë e disa prej qytetërimeve më të ndritura të historisë dhe krenohet me një mjedis të larmishëm me peizazhe dhe elemente natyrore (Adriatiku, Joni dhe Deti Egje, Alpet, ishujt, rrafshina e Danubit etj.). Kombinimi i diversitetit të pasur kulturor dhe natyror e bën zonën unike dhe një vend tërheqës në nivel global.



Ekulibri i duhur midis ruajtjes/mbrojtjes dhe avancimit është një nga sfidat kryesore. Trashëgimia natyrore dhe kulturore është një përbërës i rëndësishëm i aseteve turistike të zonës. Hulumtimi i Organizatës Botërore të Turizmit të OKB-së tregon se interesi për mjedisin, kulturën dhe trashëgiminë është një motivim kryesor për më shumë se 50% të udhëtimeve. Prandaj, mobilizimi i peizazheve kulturore dhe pasuria e natyrës është çelësi për krijimin e një “emri marke” të veçantë në zonën e programit.

Koncepti i duhur për këtë qëllim është vlerësimi i qëndrueshëm, me fjalë të tjera, integrimi burimeve të fshehura apo të dukshme (rezervat natyrore, zakonet kulturore, njohuritë e pakufizuara, dhe kualifikimet ekzistuese) në zinxhirin e vlerës së shtuar, pa rrezikuar ose shkatërruar kapitalin natyror, social dhe kulturor.

Një element i rëndësishëm në këtë drejtim është turizmi, pasi është duke përdorur trashëgiminë kulturore dhe natyrore si prodhim, është një nga aktivitetet kryesore të rritjes së shpejtë ekonomike dhe kontribuues në GDP. Megjithatë, potenciali i tij në këtë zonë nuk është shfrytëzuar plotësisht. Pak aktorë të turizmit në këtë zonë i përmbahen një modeli të qëndrueshëm të turizmit bazuar në produkte dhe shërbime turistike të reja me cilësi të lartë, me gjurmë të lehta ekologjike.

Trashëgimia kulturore dhe natyrore në këtë zonë është e rrezikuar për shkak të:

- rritjes së vënies dorë nga njeriu në veçanti në hapësirën bregdetare dhe detare për argëtim, strehim, transport dhe peshkim/akuakulturë;
- paradigmës turistike dominuese të paqëndrueshme;
- rritjes së konsumit të burimeve dhe energjisë nga banorët dhe vizitorëve që sjellin emetime, mbeturina, derdhje etj., në një masë më të madhe nga ç'mund të përthithë zona;
- rritjes së tokës me funksion urban; dhe, e fundit por jo nga rëndësia,
- ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Rezultatet e pritshme janë:

- Mirëkuptim i përbashkët midis shteteve partnere të ADRION-it në fushat potenciale të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e turizmit dhe ndërtimit të konsensusit për përmbajtjen e vlerësimit të qëndrueshëm dhe turizmit mbi një markë ADRION.
- Përforsimi i kompetencave/aftësive të partive të aktorëve përkatës në fushën e vlerësimit të qëndrueshëm dhe turizmit.
- Përforsimi i “trupit të dijes” nëpërmjet kërkimit, pilotimit, mjeteve dhe eksperimenteve ndërkombëtare;
- Zhvillimi i një identiteti të mirëpërcaktuar ndërkombëtar dhe ndërgjegjësimi mbi trashëgiminë e përbashkët në zonën adriatiko-joniane, si një kuadër orientues për veprimtaritë individuale.
- Përfshirja e përmirësuar e aktorëve të turizmit, vizitorëve dhe shoqërisë për zhvillimin një qasjeje të dakordësuar shfrytëzimi.
- Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, dhe vlerësimi brenda markës së zonës së programit.
- Diversifikimi i produkteve turistike sipas temës, sezonit, grupeve të synuara dhe ndikimit mjedisor dhe social.



Tabela 3: Treguesit e rezultateve specifike të programit *(sipas objektivit specifik)*

(Referenca: pika (b) (ii) e nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Duhet të përdoret një (nëse është e mundur) dhe jo më shumë se dy tregues rezultati për çdo objektiv specifik.

ID	Treguesi i rezultatit	Njësia e matjes	Vlera bazë	Viti bazë	Vlera e synuar (2023)	Burimi i të dhënave <i>200 karaktere maks.</i>	Frekuenca e raportimit <i>100 karaktere maks.</i>
6c.1	Niveli i kapacitetit për palët e interesuara në fushat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe turizmit për të vlerësuar në mënyrë të qëndrueshme trashëgiminë natyrore dhe kulturore si një aset rritjeje.	%	67,5%	2014	Rritje	Studim	2018 2020 2023



2.A.6. Veprimet që do të mbështeten në bazë të prioriteteve të investimeve

2.A.6.1 Një përshkrim i llojit dhe shembujve të veprimeve që do të mbështeten dhe kontributi i tyre i pritshëm ndaj objektivave specifike, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, identifikimin e grupeve kryesore të synuara, territoret e veçanta të synuara dhe llojet e përfituesve

(Referenca: pika (b) (iii) e nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Prioriteti i investimeve 6.c	Ruajtja, mbrojtja, promovimi dhe zhvillimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore
	-Veprimet treguese që do të mbështeten janë: - Krijimi i rrjeteve ndërkombëtare dhe grupeve të punës për përcaktimin e parimeve të vlerësimit të qëndrueshëm kulturor/natyror dhe turistik të ADRION-it, si dhe zhvillimin e një marke ADRION. - Mbështetja për shkëmbimin e praktikave më të mira për identifikimin e sfidave dhe prirjeve në sektorin e turizmit, duke përfshirë marketingun, menaxhimin e flukseve të rritjes së turizmit, duke përfshirë analizën e përbashkët të turizmit, tendencat dhe ndikimin e tyre potencial, qasjen e përbashkët në tregjet e reja të turizmit, mundësitë e biznesit dhe shpërndarjen e teknologjive të reja dhe njohuritë teknike. - Zhvillimi i veprimeve për rritjen e kompetencave/aftësive në ruajtjen e trashëgimisë kulturore për turizmin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e turizmit të aktorëve, duke u fokusuar veçanërisht në përfshirjen e aktorëve nga vende dhe objekte të vogla turistike. - Formulimi i strategjive të zbatimit, ngritja dhe testimi i grupimeve dhe modeleve për të ruajtur më mirë, kapitalizuar dhe përtërirë trashëgiminë kulturore dhe natyrore ose të bëhet kombinimi i tyre me turizmin, ose ruajtja e tyre për vlerën e tyre të brendshme nga ndërmarrjet, institucionet kërkimore, organizatat joqeveritare dhe popullatat lokale duke përdorur shkëmbimin e përvojave, të mësuarit e përbashkët dhe aktivitetet pilote. - Ndërtimi i rrjeteve ndërkombëtare dhe grupeve të punës dhe zhvillimi i mjeteve dhe pilotëve për të monitoruar, vlerësuar dhe zbutur presionet mjedisore dhe sociale, dhe ndikimet, dhe rreziqet për dhe nga turizmi. - Ngritja, testimi dhe zbatimi i negociatave, ndërmjetësimit, modeleve të pjesëmarrjes dhe të zgjidhjes së konflikteve në kontekstin e turizmit, ruajtja e kulturës, nevojat lokale dhe rritja ekonomike në kontekstin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, veçanërisht për përdorimin e tokës në zonat bregdetare. - Organizimi i transferimit të njohurive, shkëmbimi i shembujve të mirë praktikë, rrjetëzimi dhe zhvillimi i inovacioneve që kanë të bëjnë gjithashtu me trashëgiminë jomateriale kulturore dhe që lidhen me industritë kreative. - Zhvillimi i produkteve të ndryshme dhe të shumëllojshme turistike, të tilla si: grupimet dhe rrugët e turizmit tematik ndërkombëtar (p.sh., rrugët e manastireve, trashëgimia e lashtë, rrugët e verës, rrugët e zonës së Adriatik-Jonit etj.); variacionet sezonale të ofertës turistike (p.sh.: ardhjet jashtë sezonit për turizmin pranveror dhe vjeshtor për grupet e moshuara edhe në kontekstin e ndryshimeve klimatike); ofertat për grupet e veçanta të interesit (p.sh., lundrimi, zhytja, alpinizmi, pasionantët e historisë, tërheqja e vizitorëve në destinacione të brendshme etj.); përdorimi i aplikacioneve të IT-së për të zgjuar interes mbi trashëgiminë e rajonit; promovimi i rrugëve detare ndërkombëtare dhe i strategjive të reja për marina në drejtim të shërbimeve dhe të lidhjeve të tyre në zonat e thella. - Zhvillimi i një qasjeje të integruar dhe të koordinuar për turizmin trashëgimor dhe kulturor. - Zhvillimi i modeleve të turizmit të qëndrueshëm që fokusohet në karbonin e ulët, në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe rënien e emetimeve të PM-së dhe NO₂, gjurmëve e ulëta



ekologjike, “ushqimin e ngadalshëm”, përfshirjes së të rinjve dhe vullnetarëve dhe ofertave të tjera alternative në harmoni me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në pajtim me markën ADRION.

- Investimet në shkallë të vogël dhe projektet demonstruese për sigurimin e shërbimeve dhe produkteve të reja në sektorin turistik, për forma të veçanta të turizmit, si turizmi kulturor, turizmi tematik, shërbimet e qytetarëve të moshuar etj.

Grupet e synuara

- Publiku i gjerë;
- Grupet e renditura me titullin “llojet treguese të përfituesve”;
- Ndërmarrjet, duke përfshirë edhe NVM-të.

Llojet tregues përfituesve

- Autoritetet publike;
- Organizatrat ndërkombëtare;
- Agjencitë;
- Institucionet kërkimore;
- Institucionet e arsimit të lartë;
- Shkollat, qendra e edukimit/trajnitimit;
- Turizmi dhe/ose organizatat kulturore publike ose private (duke përfshirë SME-të);
- Organizatrat mbështetëse të biznesit;
- Grupet e interesit, duke përfshirë OJQ-të dhe shoqatat kulturore/qytetare.

2.A.6.2. Parimet udhëzuese për përzgjedhjen e operacioneve

(Referenca: pika (b) (iii) e nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Prioriteti i investimeve 6.c	Ruajtja, mbrojtja, promovimi dhe zhvillimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore
Përzgjedhja e projekteve do të kryhet në përputhje me nenin 12 të rregullores BTE, pas një procedure vlerësimi të standardizuar, objektivat e të cilave përfshijnë: -Vlerësimi i rëndësisë së një projektpropozimi; -Vlerësimi i fizibilitetit të qasjes së propozuar; -Përkufizimi i një bazë transparente dhe objektive për vendimmarrjen për refuzimin ose miratimin e propozimit; -Sigurimi i një baze komunikimi dhe përmirësimi mes organeve të Programit dhe aplikuesve. -Vlerësimi do të kryhet duke përdorur kriteret e mëposhtme: Kriteret e vlerësimit strategjik Këto kritere do të shqyrtojnë: -Rëndësinë, koherencën dhe kontributin e secilit projektpropozimi me objektivat e Programit ADRION dhe veçanërisht OS-në përkatëse të trajtuar; -Kontributi për të rezultatet e parashikuara për IP; -Saktësia e konceptit dhe demonstrimi i nevojës për ndërhyrjen e propozuar në kontekstin e tij tematik dhe territorial; -Vlera e shtuar e bashkëpunimit ndërnacional; -Përshtatshmëria e partneritetit të propozuar me atë më sipër; -Sinergjitë me prioritetet e investimeve 6D duke pasur parasysh se objektivat që lidhen me	

trashëgiminë kulturore dhe natyrore dhe zgjerimin e turizmit të qëndrueshëm janë të përshtatshme për Natura 2000 dhe zona të tjera të mbrojtura në rajon;

-Rëndësia dhe koherenca e projektit me strategjinë EUSAIR dhe kontributin për arritjen e objektivave të tij;

-Rëndësia dhe koherenca e projektit me strategjitë e tjera përkatëse të BE-së dhe ose politikave.

KRITERET E VLERËSIMIT OPERACIONAL

Këto kritere do të shqyrtojnë:

-Përshtatshmërinë e dispozitave të menaxhimit në drejtim të strukturave, procedurave dhe kompetencave;

-Cilësinë dhe efektivitetin e dispozitave të komunikimit;

-Cilësinë e planit të punës në lidhje me qartësinë dhe koherencën e objektivave operativë, aktivitetet dhe mjetet, fizibilitetit, efikasitetit të projektit dhe rezultateve të tij, potencialit për marrjen dhe futjen në procedurat operative të partnerëve të përfshirë;

-Mjaftueshmërinë e dispozitave buxhetore për të garantuar zbatimin e projektit dhe gjenerimin e vlerave për para.

Koherenca për kriteret e parimeve horizontale

Këto kritere do të shqyrtojnë shkallën në të cilën projektet kanë të integruar brenda logjikës së tyre të ndërhyrjes:

-AP 2 Parimet e horizontale, të tilla si promovimi e eficiencës së energjisë dhe burimeve, dhe shqyrtimi i parimeve të qasjes së hapur ndaj përfitimeve të inovacionit dhe riprodhueshmërisë.

-Dimensionet ndërsektoriale ADRION, siç përcaktohet në seksionin 1; mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimi, barazia ndërmjet burrave dhe grave, kohezioni social dhe inovacioni social, menaxhimi i njohurive dhe të dhënave, përdorimi i TIK-ut, qasja territoriale dhe ekosistemi.

-Elementet e mësipërme nuk duhet të konsiderohen një “listë kontrolli”, por duhet të inkurajojnë projektet për të zhvilluar në mënyrë aktive idetë e tyre të projektit brenda logjikës së Programit.

Këto tri kritere janë paraqitur sipas radhës së rëndësisë për projektin. Kriteri i vlerësimit strategjik shqyrton rëndësinë e projektpropozimit; kështu ato kanë përparësi absolute mbi dy kriteret e tjera. Kriteret e vlerësimit operacional sigurojnë shpërndarjen e suksesshme të rezultateve; kështu ato kanë më shumë peshë sesa Koherenca e Krieteve të Parimeve Horizontale, të cilat në thelb janë të orientuara drejt integritetit të një propozimi “të përshtatshëm dhe të mundshëm” sipas logjikës ADRION.

Kriteret e detajuara të vlerësimit do të përcaktohen dhe vihen në dispozicion të aplikantëve potencialë në manualin përkatës të programit.

Kostoja e përgatitjes do jetë e pranueshme në bazë të fondeve të AP 2.

2.A.6.3. Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare

(Referenca: pika (b) (iii) e nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Prioriteti i investimeve 6.c	Ruajtja, mbrojtja, promovimi dhe zhvillimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore
Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare	
Mundësia e përpunimit dhe zbatimit të instrumenteve financiare do të diskutohet gjatë zbatimit të programit	

**2.A.6.4 Përdorimi i planifikuar i projekteve të mëdha**

(Referenca: pika (b) (iii) e nenit 8 (2) të Rregullores BTE)

*Nuk aplikohet.***2.A.6.5. Treguesit e rezultateve**

(Referenca: pika (b) (iv) e nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Tabela 4: Treguesit e rezultateve të përbashkëta dhe programit specifik *(sipas prioriteteve të investimeve)*

ID	Treguesi i rezultateve	Njësia matëse	Vlera e synuar (2023)	Burimi i të dhënave 200 karaktere maks.	Frekuenca e raportimit 100 karaktere maks.
OI_6c.1_1	Numri i rrjeteve të bashkëpunimit ndërkombëtare të mbështetura	Numri	20	Monitorimi / raportet e progresit të projektit	Në bazë vjetore
OI_6c.1_2	Numri i strategjive dhe planeve të veprimit të zhvilluara në fushën e trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe turizmit	Numri	30	Monitorimi / raportet e progresit të projektit	Në bazë vjetore
OI_6c.1_3	Numri i investimeve në shkallë të vogël dhe projekteve demonstruese	Numri	10	Monitorimi / raportet e progresit të projektit	Në bazë vjetore
COI_2	Rritja e numrit të pritshëm të vizitave në faqet e mbështetura të trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe atraksionet	Vizita/vit	20.000	Monitorimi / raportet e progresit të projektit	Në bazë vjetore

2.A.4. Prioriteti i investimeve 6d

(Referenca: pikat (b) (i) të nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

PRIORITETI I INVESTIMEVE 6.d**Mbrojtja dhe restaurimi i biodiversitetit dhe tokës dhe promovimi i shërbimeve të ekosistemit, duke përfshirë Natura 2000 dhe infrastrukturën e gjelbër.****2.A.5. Objektivi specifik që korrespondon me prioritetin e investimeve dhe rezultatet e pritshme**

(Referenca: pikat (b) (i) dhe (ii) të nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)



ID	2.2
Objekti Specifik	Rritja e kapacitetit në trajtimin ndërkombëtar të cenueshmërisë së mjedisit, fragmentimit dhe ruajtjes së shërbimeve të ekosistemit në zonën ADRION
Rezultatet e pritshme 3500 karaktere maks.	Zona ADRION është e pasur me biodiversitet dhe ka një rrjet të dendur të zonave të mbrojtura, edhe pse me potencial dhe mbrojtje të ndryshme. Tipari kryesor i ADRION-it kryesisht është deti gjysmë-mbyllur. Kështu, ai është i pambrojtur ndaj ndotjes, pasi ujërat nuk ndërrohen shpesh. Rreziqet e njohura mjedisore që lidhen me ndryshimet klimatike kryesisht përfshijnë thatësitat dhe përmytjet. Ekziston nevoja e shumëfishtë për të trajtuar dhe për të menaxhuar sfidat e ruajtjes dhe fragmentimit, rreziqet dhe adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe integrimin e shërbimeve të ekosistemit, parimet e Rritjes Blu dhe të Gjellbër në planifikimin e zhvillimit rajonal. Prandaj topografia dhe gjeografia kontribuojnë në cenueshmëri të lartë mjedisore, e cila tashmë është prekur fuqishëm nga dy kërcënime reciprokisht përforcuese: presion i njeriut dhe ndryshimet klimatike globale. Cenueshmëria e kombinuar me kapacitetet e ulëta për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, ndërveprimin e ulët të organizatave dhe praktikave për mbrojtjen qytetare si, për shembull, në sektorin e mbeturinave dhe të ndërtimit, rritjen e nivelit të rrezikut. Shërbimet e ekosistemit janë thelbësore për kushtet e jetesës të popullsisë rezidente dhe për sektorin e turizmit si “të dhëna të ndërmjetme”, aty ku ato janë pjesë e “ofertës turistike”. Për më tepër, ato janë plotësisht pjesë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Prandaj, ndërhyrjet nën PI 6D duhet të respektojnë dhe të integrojnë dy aspekte: - o mbrojtjen dinamike dhe menaxhimin e riskut (mbrojtja, ruajtja dhe lidhjen e “ekosistemeve”); dhe - o përdorimin e qëndrueshëm dhe parandalimin e rrezikut (integrimi i shërbimeve të ekosistemit). Rezultatet e pritshme janë: - Mirëkuptim i përbashkët i shteteve partnere të ADRION-it për gjendjen aktuale, kuadrin ndërkombëtar dhe të BE-së dhe nevojat e mbetura të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të biodiversitetit, shërbimeve të ekosistemit dhe adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike. - Rritja e kompetencave/aftësive të grupeve të interesit dhe palëve të përfshira. - Rritja e disponueshmërisë së të dhënave dhe informatave për të dhënë përgjigje të bazuara në fakte përmes ndërveprimit dhe monitorimin sistematik. - Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar, shkëmbimit dhe komunikimit ndërmjet autoriteteve dhe organizatave të shoqërisë civile. - Infrastruktura e harmonizuar, strukturat e menaxhimit dhe mekanizmat e reagimit ndaj rrezikut. - Rritja e numrit të mjeteve të menaxhimit dhe planifikimit të “situatës aktuale”.

**Tabela 3: Treguesit e rezultateve specifike të programit** *(sipas objektivit specifik)*

(Referenca: pika (b) (ii) të nenit 8 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Duhet të përdoret një (nëse është e mundur) dhe jo më shumë se dy tregues rezultatesh për secilin objektiv specifik

ID	Treguesi i rezultatit	Njësia matëse	Vlera bazë	Viti bazë	Vlera e synuar ¹⁰ (2023) 100 karaktere maks.	Burimi i të dhënave 200 karaktere maks.	Shpeshtësia e raportimit 100 karaktere maks.
IP 6.d SO 2.2	Niveli i kapaciteteve të organizatave të përfshira për të vepruar në mënyre ndërkombëtare, duke ofruar shërbime dhe menaxhim në lidhje cënueshmërinë, fragmentimin e mjedisit, dhe ruajtjen e shërbimeve të ekosistemeve	%	77%	2014	Rritje	Studim	2018 2020 2023

¹⁰Vlerat e synuara mund të jenë cilësore apo sasiore.



2.A.6 Veprimet që do të mbështeten në prioritetet e investimeve

Llojet dhe shembujt e aksioneve, si dhe kontributi pritshëm në OS-të: Lista e mëposhtme e aksioneve të mundshme është vetëm një listë treguese dhe mund të plotësohet me aksione të tjera të rëndësishme që kontribuojnë në qëllimet OS-ve. OS 5.1: Aksionet për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin në menaxhimin dhe zbatimin e Programit ADRION Në përputhje me nenin 59 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, aksionet brenda objektivit të OS-së 5.1, përgatitjes, menaxhimit, monitorimit, vlerësimit, informacionit dhe komunikimit, rrjeteve, kontrollit dhe detyrave të auditimit të programit. Për më tepër, aksionet që i referohen këtij OS-je gjithashtu trajtojnë uljen e barrës administrative për përfituesit. Aksionet indikative, të mbështetura nën OS 5.1, janë të renditura më poshtë dhe i referohen parimeve dhe detyrave të parashikuara në nenet 5.3 dhe 7: - Ngritja dhe menaxhimi i një Sekretariati të Përbashkët (SP), që mbështet Autoritetin Menaxhues/Autoritetin Certifikues (AM/AC) dhe që ndihmon Komitetin Monitorues (KM) dhe, kur është e nevojshme, Autoritetin e Auditimit (AA) dhe Grupi i Audituesve (GA) në zbatimin dhe menaxhimin ditë pas dite të Programit. - Përgatitja dhe zbatimi i thirrjeve për propozime, duke përfshirë zhvillimin e dokumenteve udhëzuese që përcaktojnë kriteret për mbështetjen e operacioneve. - Ngritja dhe zbatimi i procedurave për vlerësimin e cilësisë, monitorimin dhe kontrollin e operacioneve të zbatuara në kuadrin e Programit ADRION, po ashtu duke përdorur ekspertë të jashtëm kur është e nevojshme dhe për kontributin në uljen e barrës administrative për përfituesit. - Mbledhja e të dhënave në lidhje me ecurinë e Programit për arritjen e objektivave të tij, si dhe të dhënat financiare dhe të dhënat që lidhen me treguesit dhe arritjet, dhe raportimi te KM-ja dhe Komisioni Europian. - Hartimi dhe zbatimi i strategjisë së komunikimit të Programit, duke përfshirë ngritjen dhe zbatimin e	



masave për informacion dhe komunikim, dhe mjetet në përputhje me nenin 115 të Rregullores (BE) 1303/2013.

- Hartimi dhe zbatimi i planit të vlerësimit të Programit dhe ndjekja e rezultateve të vlerësimeve të pavarura të programit.

- Ngritja, drejtimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të kompjuterizuar për të regjistruar dhe ruajtur të dhënat në çdo operacion, të nevojshme për monitorimin, vlerësimin, menaxhimin financiar, kontrollin dhe verifikimin, në përputhje me kërkesat e zbatueshme elektronike të shkëmbimit të të dhënave dhe të kontribuojnë në uljen e barrës administrative për përfituesit.

- Ngritja e një rrjeti të kontrollorëve kombëtare të nivelit të parë, të koordinuar nga AM/SP, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira në nivel ndërkombëtar.

- Organizimi dhe kryerja e auditimeve për sistemin e menaxhimit dhe kontrollimit të Programit si dhe për operacionet.

- Trajnim për organet e Programeve.

- Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare.

OS 5.2: Aksionet për të përmirësuar mbështetjen ndaj aplikantëve dhe përfituesve dhe për të forcuar përfshirjen e partnerëve përkatës në Programin ADRION

Në përputhje me nenin 59 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, aksionet brenda objektivit të OS 5.2, përforcimit të kapaciteteve të aplikantëve dhe përfituesve për të aplikuar dhe për të përdorur fondet, si dhe përfshirjen e partnerëve përkatës, duke përfshirë shkëmbimin e praktikave të mira midis partnerëve.

Aksionet indikative mbështetur në SO 5.2 janë të renditura më poshtë dhe ato i referohen parimeve dhe detyrave të parashikuara në nenin 5.

- Hartimi i dokumenteve të informacionit për aplikantët dhe përfituesit për t'i udhëzuar ato në përgatitjen e aplikimeve dhe zbatimin, vlerësimin, kontrollin dhe komunikimin e operacioneve të miratuara.

- Organizimi i konsultimit, informacionit, trajnimit dhe shkëmbimit të aktiviteteve për të forcuar kapacitetin e aplikantëve për të zhvilluar aplikime që kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në OS-të e Programit dhe rezultatet e pritshme.

- Organizimi i trajnimeve për çështje të caktuara të zbatimit, të tilla si menaxhimi i projektit dhe menaxhimi financiar, raportimin, kontrollin, auditimin, komunikimin dhe krijimin e rrjeteve për të forcuar kapacitetin e përfituesve për të zbatuar operacionet e miratuara.

- Organizimi i vizitave monitoruese në drejtimin e projekteve të realizuara nga SP me qëllim kryerjen, kur është e nevojshme, të vlerësimit të cilësisë së produkteve/rezultateve, me mundësinë për të kërkuar përmirësime.

- Zhvillimi i mjeteve të informacionit dhe shkëmbimit (p.sh., dokumente analitike, takime bilaterale, aktivitete të synuara etj.) dhe organizimi i eventeve transnacionale dhe kombëtare për të forcuar përfshirjen e partnerëve përkatës në zbatimin e programit (duke përfshirë edhe autoritetet e përfshira në zhvillimin ose zbatimin e strategjive makrorajonale, organet e përbashkëta ligjore që veprojnë në këtë zonë (EGTC-të...) dhe organizatat ombrellë në nivel të BE/ndërkombëtar).

- Koordinimi i një rrjeti të PKK-ve të zgjedhura ose të emëruara në bazë të kriterëve të vendosura bashkërisht.

- Kryerja e studimeve, raporteve dhe anketave për çështjet strategjike që lidhen me programin që mund të kontribuojë në qëndrueshmëri dhe trajtimin e rezultateve dhe arritjeve në politika, strategji, investime ose që janë të interesit publik, duke futur ekspertët kur është e nevojshme. Shpenzimet e përgatitjes për projektin mbulohen nga fondet e AP 5. Aksionet për asistencë teknike do të zbatohen nga të gjitha autoritetet e përfshira në menaxhimin e Programit, të renditura në nenin 5.3.

**2.B.5.2. Indikatorët e rezultatit, të pritshme për të kontribuar në rezultate**

(Referenca: pikat (c)(iv) të nenit 8(2) të Rregullores (BE) me nr. 1299/2013)

Tabela 11: Indikatorët e rezultatit (sipas aksit prioritar)

ID	Indikatori	Njësia e matjes	Vlera e synuar (2023) (e padetyrueshme)	Burimi i të dhënave
	Thirrjet për propozime u hapën dhe u mbyllën me sukses	S'ka	2	Vëzhgimi
	Operacionet miratohen pas thirrjeve për propozime	S'ka	40	Sistemi i Monitorimit Elektronik të Programit
	Progresraportet periodike të operacioneve në monitorim dhe të financuara	S'ka	300	Sistemi i Monitorimit Elektronik të Programit
	Strategjia e komunikimit të programit u hartua dhe miratua	S'ka	1	Vëzhgim Raporti vjetor i programit
	Vlerësimet e pavarura të programit miratohen (<i>ex-ante</i> dhe gjatë zbatimit të programit)	S'ka	2	Vëzhgim
	Sistemi e-Monitorimit të Programit u zhvillua dhe zbatua	S'ka	1	Vëzhgim
	Rrjeti i kontrollorëve kombëtarë u krijua	S'ka	1	Vëzhgim
	Auditimet për menaxhimin e programit dhe sistemin e kontrollit, si dhe operacionet	S'ka	-	Sistemi e-Monitorimit të Programit
	Konsultimi, informimi, trajnimi dhe seminareve të shkëmbimit për aplikantët dhe përfituesit janë organizuar	S'ka	-	Vëzhgim
	Pikat e kontaktit kombëtar janë krijuar	S'ka	8	Vëzhgim
	Numri i punonjësve (FTE)	S'ka	-	Vëzhgim

2.B.6. Kategoritë e ndërhyrjes

(Referenca: pikat (c)(v) të nenit 8(2) të Rregullores ETC)

Tabela 12-14: Kategoritë e ndërhyrjes

Tabela 12: Dimensioi 1: Fusha e ndërhyrjes		
Aksi prioritar	Kodi	Shuma në EURO
5	121: Përgatitja, monitorimi i zbatimit dhe inspektimi	5.206.450
5	122: Vlerësimi dhe studimet	650.806
5	123: Informacioni dhe komunikimi	650.806



Tabela 13: Dimensioni 2: Forma e financimit

Aksi prioritar	Kodi	Shuma në EURO
5	01: Grant jo i shlyeshëm	6.508.063

Tabela 14: Dimensioni 2: Lloji i territorit

Aksi prioritar	Kodi	Shuma në EURO
5	07: Jo i aplikueshëm	6.508.063

Seksioni 3 PLANIFIKIMI FINANCIAR

(Referenca: shkronja (d) e nenit 8(2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

3.1. Ndarja financiare nga ERDF dhe IPA

(Referenca: shkronja (d) (i) të nenit 8, pika 2, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Tabela 15

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Totali
ERDF (Fondi Europian për Zhvillim Rajonal)	0	10.185.116	8.632.718	15.685.599	15.999.312	16.319.297	16.645.687	83.467.729
Shumat nga IPA (nëse nevojitet)	0	1.914.430	1.622.636	2.948.320	3.007.287	3.067.432	3.128.782	15.688.887
Shumat nga ENI (nëse nevojitet) <i>ENI-Instrumenti i Fqinjësisë</i>)								0
Totali		12.099.546	10.255.354	18.633.919	19.006.599	19.386.729	19.774.469	99.156.616

3.2. A. Ndarja totale financiare nga ERDF + IPA

(Referenca: shkronja (d) (ii) të nenit 8, pika 2, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Tabela 16: Planifikimi financiar

Aksi prioritar	Fondi	Baza për llogaritjen e asistencës BE	Mbështetje BE (a)	Homologu kombëtar (b) = (c) + (d)	Ndarja indikative e homologut kombëtar		Financimi total (e) = (a) + (b) (2)	Norma e bashkëfinancimit (f) = (a)/(e)	Për informim	
					Financimi publik kombëtar (c)	Financimi privat kombëtar (l) (d)			Kontributet nga vendet e treta	Kontributet nga EIB= (Banka Europiane e Investimeve)
Aksi prioritar 1	ERDF		16.693.547	2.946.736	2.356.736	590.000	19.640.283	85,00%		
	IPA		2.998.111	529.079	423.263	105.816	3.527.190	85,00%		
Aksi prioritar 2	ERDF		38.395.155	6.775.616	6.098.054	677.562	45.170.771	85,00%		
	IPA		7.077.221	1.248.921	1.123.121	125.800	8.326.142	85,00%		
Aksi prioritar 3	ERDF		15.024.191	2.651.328	2.121.062	530.266	17.675.520	85,00%		
	IPA		2.684.333	473.706	378.965	94.741	3.158.039	85,00%		
Aksi prioritar 4	ERDF		8.346.773	1.472.960	1.472.960		9.819.733	85,00%		
	IPA		1.429.222	252.216	252.216		1.681.438	85,00%		
Aksi prioritar 5	ERDF		5.008.063	2.146.313	2.146.313		7.154.376	70,00%		
	IPA		1.500.000	264.706	264.706		1.764.706	85,00%		
Totali	ERDF		83.467.729	15.992.953	14.195.125	1.797.828	99.460.682	83,92%		
	IPA		15.688.887	2.768.628	2.442.271	326.357	18.457.515	85,00%		
Totali	Totali i gjithë Fondeve		99.156.616	18.761.581	16.637.396	2.124.185	117.918.197	84,09%		

**3.2. B. Ndarja sipas aksit prioritar dhe objektivit tematik**

(Referenca: shkronjat (d) (ii) të nenit 8, pika 2, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Tabela 17

Aksi prioritar	Objektivi tematik	Asistenca e BE-së	Homologu kombëtar	Financimi total
Aksi prioritar 1	Objektivi tematik 1	19.691.658	3.475.815	23.167.473
Aksi prioritar 2	Objektivi tematik 6	45.472.376	8.024.537	53.496.913
Aksi prioritar 3	Objektivi tematik 7	17.708.524	3.125.034	20.833.558
Aksi prioritar 4	Objektivi tematik 11	9.775.995	1.725.176	11.501.171
Aksi prioritar 5*	Asistenca teknike	6.508.063	2.411.019	8.919.082
TOTALI		99.156.616	18.761.581	117.918.197

* Rritja për Shtetet Partnere IPA në përputhje me nenin 17 të Rregullores ETC (Bashkëpunimit Territorial European)

Tabela 18: Shuma indikative e asistencës për t'u përdorur për ndryshimet klimatike(Referenca: Neni 27, pika 6, të Rregullores (BE) nr. 1303/2013)¹²

Aksi prioritar	Shuma indikative e asistencës për t'u përdorur për qëllimet e ndryshimit të klimës (EURO)	Total - Përqindja e alokimit për programin (%)
Aksi prioritar 1	1.969.166	1,99%
Aksi prioritar 2	14.551.160	14,67%
Aksi prioritar 3	7.083.410	7,14 %
Totali	23.603.736	23,80%

¹² Kjo tabelë gjenerohet automatikisht bazuar në tabelat për kategoritë e ndërhyrjes të përfshira nën secilin prej akteve prioritare.



SEKSIONI 4. QASJA E INTEGRUAR PËR ZHVILLIMIN TERRITORIAL

(Referenca: Neni 8(3) i Rregullores (BE) me nr. 1299/2013)

Strategjia e programit trajton sfidat e përbashkëta territoriale në fushën e bashkëpunimit dhe lëvrimin të potencialeve të tij zhvilluese, duke reflektuar nevojat dhe potencialet që mund të ndiqen me efikasitet. Vijueshmëria logjike dhe përputhshmëria e strategjisë me Marrëveshjet kombëtare të Partneritetit mes Shteteve Anëtare në ERDF dhe Dokumenteve Kombëtare Strategjike të Shteteve Anëtare në IPA është verifikuar, duke synuar koordinimin me programet e qëllimit “Investim për Zhvillim dhe Punësim”. Marrëveshjet kombëtare të Partneritetit njohin tre OT të përzgjedhur për Programin ADRION si të përshtatshme, duke vendosur theksin në rolin e RTC-së në këto fusha tematike. Strategjia e programit promovon rritje inteligjente, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse nëpërmjet një përqasjeje të integruar që kombinon dimensionet tematike dhe territoriale në hartimin e AP, siç dhe është përmbledhur më poshtë. Për pasojë, operacionet e mbështetura do të duhet të reflektojnë këtë përqasje territoriale të integruar:

- Prioriteti 1 (OT 1): Fuqia ekonomike është shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në zonë me investime R&D të përqendruara në pak pole zhvillimi (kryesisht rajonet e mëdha dhe aglomeratet) si dhe rajonet/zonat periferike me konkurrueshmëri të ulët dhe migrim të trurit. Në veçanti, rajonet moderne përballen me lidhje të dobëta mes aktorëve të sistemit inovativ. Prioriteti mbledh dallimet rajonale duke forcuar këto lidhje brenda dhe mes rajoneve nëpërmjet mbështetjes së rrjeteve inovative dhe grupeve, si dhe nëpërmjet luftimit të migrimit të trurit dhe përjashtimit shoqëror.

- Prioriteti 2 (OT 6): Trashëgimia natyrore dhe kulturore janë faktorë rajonalë zhvillimi në rrezik përkeqësimi (p.sh., nëpërmjet fragmentimit të habitateve, humbjes së biodiversitetit, ndotjes) dhe përdorimit të paqëndrueshëm. Vihen re konfliktet për shfrytëzimin e tokës dhe rënia e përhapjes urbane dhe mjedisit urban. Prioriteti ndjek këto çështje duke përmirësuar kapacitetet për përqasje të integruar të menaxhimit, duke

nxitur shfrytëzimin e qëndrueshëm të trashëgimisë dhe burimeve natyrore dhe kulturore, si dhe një cilësi të përmirësuar të mjedisit urban.

- Prioriteti 3 (OT 7): Zona karakterizohet nga rajone kryesore që aksesohen lehtësisht dhe rajone periferike me lidhje të limituara. Dallimet në cilësinë e shërbimeve të transportit publik vihen re dhe kanë ndikime mjedisore negative dhe sociale. Ky prioritet ndjek këto çështje duke përmirësuar koordinimin e sistemeve të transportit të udhëtarëve Brenda rajoneve dhe jashtë kufijve, duke krijuar lidhje më të mira mes rajoneve periferike dhe rrjeteve të transportit kombëtar dhe europian, si dhe duke përmirësuar koordinimin mes palëve të transportit të mallrave për transport mallrash multimodal e miqësor me mjedisin.

- Aksi prioritar 4 (OT 11): Ky AP do të veprojë vetëm në nivel qeverisës për të lehtësuar zbatimin e EUSAIR-it dhe për pasojë nuk lidhet me sfidat territoriale specifike. Pavarësisht, mbështetja do të ofrohet për zbatuesit kyç të strategjisë dhe përfitues do të jenë territoret e përfshira nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve institucionale për zgjidhjen e çështjeve territoriale.

4.1 Zhvillimet lokale të drejtuara nga komuniteti

(Referenca: pika (a) e nenit 8(3) të Rregullores ETC)

Nuk aplikohet.

4.2 Aksionet e integruara për zhvillim të qëndrueshëm urban

(Referenca: pika (b) e nenit 8(3) të Rregullores (BE) me nr. 1299/2013)

Nuk ka zona specifike urbane të identifikuar për zbatimin e zhvillimit të qëndrueshëm urban. Partnerët e të gjitha zonave urbane që ndodhen në rajone të lejueshme nga Programi ADRION mund të marrin pjesë në projektet ADRION duke ndjekur rekomandimet e dhëna në akset prioritare dhe në thirrjet për projekte.

4.3 Investimet Territoriale të Integruara (ITI)

Referenca: pika (c) e nenit 8(3) të Rregullores (BE) me nr. 1299/2013)

Megjithëse fokusi për zonat urbane dhe zonat e tjera specifike konsiderohet i rëndësishëm nga Shtetet Partnere, sistemi i Investimeve Territoriale të Integruara (ITI) nuk është tërësisht i



përshtatshëm për bashkëpunimin transnacional për arsyet e mëposhtme:

Programi ADRION nuk orientohet drejt investimeve edhe nëse ai do të mund të mbështeste përgatitjen e investimeve të mëdha.

Ai kërkon identifikimin e zonave specifike të ndërhyrjes në zonën e përgjithshme të programit ADRION, shumë komplekse dhe që merr kohë për përgatitje e programeve të bashkëpunimit transnacional.

Zonat e përzgjedhura do të mbulonin vetëm pjesërisht rajonet e lejueshme apo vendet e lejueshme.

ITI duhet të zbatohet nga organet që mbështeten nga të paktën dy shtete të ndryshme. Krijimi i organeve të tilla përbën sfidë në nivel transnacional, veçanërisht për shkak se partneriteti transnacional përbëhet mesatarisht nga 10-12 partnerë që vijnë nga vende të ndryshme.

Për këto arsye dhe duke marrë në konsideratë faktin se zhvillimi i integruar territorial konsiderohet si rrugë ndërkufitare në secilin AP, programi nuk mund të zbatohet ITI-në.

4.4 Kontributi i ndërhyrjeve të planifikuara drejt strategjive makrorajonale dhe të baseneve detare, subjekt i nevojave të zonës së programit, siç identifikohet nga Shtetet Anëtare dhe duke marrë në konsideratë, ku aplikohet, projektet me rëndësi strategjike të identifikuar në strategjitë

(Referenca: pika (d) e nenit 8(3) të Rregullores (BE) me nr. 1299/2013)

Strategjia e programit trajton sfidat e përbashkëta territoriale përgjatë rajoneve të zonës së bashkëpunimit dhe lëvron potencialet e tyre zhvilluese.

Ai është zhvilluar me kontributin e palëve të interesuara, kërkimet e ekspertëve dhe punën përgatitore për përcaktimin e Planit të Veprimit EUSAIR. Nevojat dhe sfidat e identifikuar janë filtruar duke pasur parasysh kapacitetin real dhe fondet në dispozicion të Programit ADRION.

Koherenca me Marrëveshjet e Partneritetit dhe Strategjinë e Zgjerimit të Shteteve Partnere ERDF dhe Shteteve Anëtare IPA përkatëse është verifikuar me qëllim koordinimin me të gjitha ndërhyrjet ESIF dhe IPA II; orientimi tematik i Programit ADRION reflekton konsensusin e përgjithshëm për Prioritetet Tematike në Shtetet

Partnere, përkatësisht: inovacion, mjedis, aksesueshmëri dhe e fundit, por jo pak e rëndësishme, qeverisja.

Strategjia ADRION është në përputhje me EU 2020 për të promovuar rritje inteligjente, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse nëpërmjet një përqasjeje të integruar që kombinon dimensionet tematike dhe territoriale në tri Akset Prioritare (AP 1, AP 2 dhe AP 3). AP 4 mbështet qeverisjen e EUSAIR bazuar në strategjinë e integruar të zhvillimit territorial.

Projektet e zbatuara me mbështetjen e programit të bashkëpunimit ADRION duhet të bashkohen me zhvillimet e integruara territoriale gjithashtu.

AP 1 (OT 1) fokusohet në inovacion dhe ka për qëllim promovimin e avantazheve unike konkurruese të zonës së programit në mënyrë që të rrisë konkurrueshmërinë dhe të nxisë krijimin e vendeve të reja të punës. Siç dhe analiza territoriale tregon, zona ADRION po has vështirësi në krijimin e sistemeve efikase të kërkimit dhe inovacionit pavarësisht ekzistencës së poleve inovative në periferi (Itali, Greqi dhe Slloveni). Intensiteti R&D po rritet në përgjithësi (rreth 0.75% në Kroaci, 2.47% në Slloveni, 1.25% në Itali, 0.60 në Greqi dhe mesatarisht 0.3% në Shtetet Anëtare), por ende nevojiten përpjekje. Për këtë arsye, Aksi do t'i kushtojë rëndësi specifike Rritjes Blu dhe gjithë aktivitetëve që kanë lidhje të forta me detin (si për shembull, industritë detare dhe mjedisore, energji, turizëm dhe lidhjet kulturore).

AP 2 (OT 6) pohon trashëgiminë e pasur natyrore dhe kulturore të zonës së ADRION-it si aset i zhvillimit të turizmit, por dhe si vlerë për vendin. Programi ADRION synon të kombinojë interesat e ndryshëm të turistëve, banorëve dhe operatorëve ekonomikë duke promovuar turizëm të qëndrueshëm, vlerësim të trashëgimisë dhe e fundit, por jo pak e rëndësishme, mbrojtjen e mjedisit si kusht për qëndrueshmërinë e turizmit dhe shfrytëzimin e trashëgimisë. Kjo qasje trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë dimensionet territoriale si mundësi për zonat rurale dhe ato më pak të zhvilluara për t'u zhvilluar, por dhe si platformë për debatin për përdorimin hapësinor në zonat me trafik të dendur dhe zonat bregdetare më të frekuentuara.

AP 3 (OT 7) përmban një dimension

territorial duke trajtuar lidhje në kontekstin e dallimeve hapësinore ndërmjet perëndimit dhe lindjes, por dhe përgjatë deteve dominuese Adriatik dhe Jon në zemër të zonës së ADRION-it. Programi fokusohet në multimodalitetin, logjistikën dhe lëvizshmërinë e transportin miqësor me mjedisin dhe karbon të ulët, duke kontribuar kështu në përputhjen e përdorimeve të ndryshme dhe nevojave mes rajoneve dhe përdoruesve.

Programi ADRION mbulohet nga një strategji të dedikuar makrorajonale e BE-së, EUSAIR dhe kapërcen pjesërisht me Strategjinë e BE-së për rajonin e Danubit (EUSR), e cila është hartuar me kohë dhe është relativisht e peshuar (menduar mirë), si dhe Strategjinë e BE-së për rajonin alpin (EUSALP), e cila është në zhvillim. Për shkak të mbulimit gjeografik, Programi ADRION mund të luajë një rol të rëndësishëm në shfrytëzimin e sinergjive mes makrorajoneve të sipërpërmendura (dhe veçanërisht EUSR, për shkak të ngjashmërive në përbërjen e Shteteve Partnere dhe mundësive për të mësuar nga mësimet), duke kontribuar në mënyrë aktive në integrimin territorial përtej nivelit makrorajonal.

Hartimi i strategjisë së Programit ADRION është përafëruar me shtyllat e EUSAIR-it dhe në veçanti:

AP 1 për inovacion i drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë shtyllës I mbi Rritjen Blu, por gjithashtu përfshin elemente të tri shtyllave të tjera;

- AP 2 për trashëgiminë natyrore dhe kulturore, si dhe biodiversitetin trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë Shtyllën 4 mbi Turizmin e Qëndrueshëm nëpërmjet PI 6c, por dhe shtyllën 1 mbi Rritjen Blu dhe Shtyllën 3 mbi Cilësinë Mjedisore nëpërmjet PI 6d;

- AP 3 për lëvizshmërinë dhe transportin e qëndrueshëm i drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë Shtyllës 2 mbi lidhjen e rajonit dhe në mënyrë të tërthortë Shtyllës 3 nëpërmjet promovimit të transportit miqësor me mjedisin dhe me karbon të ulët, si dhe shtyllës 4 si kërkesë për turizmin;

- AP 4 fokusohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në aspektet e qeverisjes së EUSAIR-it e kështu duke vepruar si një ombrellë për të 4 shtyllat.

SEKSIONI 5: DISPOZITAT ZBATUESE PËR PROGRAMIN E BASHKËPUNIMIT

(Referenca: Neni 8(4) i Rregullores (BE) me nr. 1299/2013)

5.1 Autoritetet dhe organet përkatëse

(Referenca: Neni 8(4) i Rregullores (BE) me nr. 1299/2013)

Tabela 21: Autoritetet programore

(Referenca: pika (a)(i) e nenit 8(4) të Rregullores (BE) me nr. 1299/2013)

Autoriteti/Organi	Emri i Autoritetit/Organit dhe Departamentit ose Njesisë	Drejtori i Autoritetit/Organit
Autoriteti menaxhues/ Autoriteti certifikues	Rajoni Emilia-Romagna <i>Direzione Generale, Programmazione territoriale e negoziata. Intese. Relazioni internazionali ed europee</i> (Drejtoria e Përgjithshme, Planifikimi territorial dhe i negociuar. Marrëveshjet. Marrëdhëniet Europiane dhe Ndërkombëtare) Itali	Drejtori i Përgjithshëm aktual: Z. Enrico Cocchi



Autoriteti auditues	Agrea (Agjencia e Rajonit Emilia-Romagna) Itali	Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm Z. Donato Metta
----------------------------	---	--

Organi të cilit Komisioni do t'i kryejë pagesat është:

(Referenca: pika (b) e nenit 8(4) të Rregullores (BE) me nr. 1299/2013)

X	Autoriteti menaxhues	
	Autoriteti certifikues	

Tabela 22: Organi ose organet që kryejnë kontrollin dhe detyrat e auditimit

(Referenca: pika (a)(ii) dhe (iii) e nenit 8(4) të Rregullores (BE) me nr. 1299/2013)

Autoriteti/Organi	Emri i Autoritetit/Organit dhe Departamentit ose Njesisë	Drejtori i Autoritetit/Organit
Organi ose organet që do të kryejnë kontrollin dhe detyrat e auditimit	Organet kombëtare përgjegjëse të caktuara për sistemet e centralizuara dhe decentralizuara të kontrollit, siç parashikohet në nenin 125 (4) (a) të Rregullores (BE) me nr. 1303/2013 (CPR) dhe nenit 23 (4) të Rregullores (BE) me nr. 1299/2013 (ETC) Shqipëri Ministria e Integrimit European, Drejtoria e Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Transnacional, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, sheshi “Nënë Tereza” 1010, Tiranë Bosnje-Hercegovina Ministria e Financave dhe Thesarit BH, Sektori për Financimin e Programeve dhe Projekteve të Asistencës së BE-së, Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit (CFCU) Trg BH 1, 71000 Sarajevë Kroaci Agjencia për Zhvillimin Rajonal të Republikës së Kroacisë (ARD), Drejtoria për Kontabilitetin dhe Menaxhimin Financiar/Shërbimi i Kontrollit të Nivelit të Parë, Vlaška 108, 10 000 Zagreb Greqi Autoriteti Certifikues dhe Verifikues, Njësia e Kontrollit të Nivelit të Parë, Navarchou Nikodimou 11, GR-105 58 Athinë Itali Agjencia për Kohezion Territorial nëpërmjet Sicilisë, 162/c IT – 00187 Romë	Drejtori i Drejtorisë së Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Transnacional Ndihmësministri Drejtori i Shërbimit të KNP Drejtori i Njesisë së KNP Struktura do të përcaktohet Zëvendësministri i Financave dhe Kontraktimit të Fondeve të Asistencës së BE-së (CFCU), përgjegjës për



	Mal i Zi Ministria e Financave, Drejtoria për Financat dhe Kontraktimin e Fondeve të Asistencës së BE-së (CFCU) Stanka Dragojevića 2, 81000 Podgoricë, Mal i Zi Serbia Ministria e Financave, Departamenti për Kontraktimin dhe Financimin e Programeve që Financohen nga BE-ja (CFCU), Divizioni për KNP Sremska 3-5, 11000 Beograd Slloveni Zyra Qeveritare për Politikën e Zhvillimit dhe Kohezionit Europian (GODC), Divizioni i Kontrollit- Programet ETC, IPA dhe IFM, Kotnikova 5, 1000 Lubjanë	detyrat e kontrollit Drejtori i Divizionit të KNP
Organi ose organet që do të kryejnë kontrollin dhe detyrat e auditimit	Organet kombëtare përgjegjëse të caktuara, që marrin pjesë në grupin e auditorëve, siç parashikohet në nenin 25 (2) të Rregullores (BE) me nr. 1299/2013 (ETC) Shqipëri Agjencia për Auditimin e Sistemit të Zbatimit të Programeve të Bashkimit Europian, Rruga e Elbasanit, godina e ish-trikotazhit kati 4, Tiranë Bosnje-Hercegovina Ministria e Financave dhe Thesarit të Bosnje-Hercegovinës, Departamenti i Fondit Kombëtar, Trg BH 1, 71000 Sarajevë Kroaci Agjencia për Auditimin e Sistemit të Zbatimit të Programeve të Bashkimit Europian, 4/V Rruga “Alexandera von Humboldta”, 10000 Zagreb Greqi Ministria Helenike e Financave, Zyra e Përgjithshme e Kontabilitetit, Komiteti i Auditit Financiar, Panepistimiou 57, GR – 105 64 Athinë Itali Do të komunikohet më vonë Mal i Zi Autoriteti Auditues i Malit të Zi, Beogradska 24b, 81000 Podgoricë	Drejtori i Agjencisë Ndihmësministri Drejtori i Agjencisë Presidenti i Komitetit të Auditit Financiar Audituesi i Përgjithshëm Drejtori i Zyrës së Autoritetit Auditues të Fondeve Europiane



	Serbi Zyra e Autoritetit Auditues të Fondeve Europiane të Qeverisë së Republikës Serbe, Nemanjina 11, 11000 Beograd Slloveni Ministria e Financave, Zyra e Mbikëqyrjes së Buxhetit të Republikës së Sllovenisë, Fajfarjeva 33, 1000 Lubjanë	Drejtori i Zyrës së Mbikëqyrjes së Buxhetit
--	---	---

5.2 Procedura për ngritjen e Sekretariatit të Përbashkët (SP)

(Referenca: shkronja “a” (iv) e nenit 8, pika 4, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Sekretariati i Përbashkët ngrihet pas konsultimeve mes Shtetet Partnere nën përgjegjësinë e Autoritetit Menaxhues (AM).

SP-ja do të mbledhet pranë ambienteve të Ervet SpA, organ i brendshëm i rajonit Emilia-Romagna, dhe do të vendoset në Bari (Itali).

SP-ja ndihmon Autoritetin Menaxhues (përfshirë funksionin e tij si AC) dhe AM-në në kryerjen e detyrave të tyre përkatëse. Ai gjithashtu siguron informacion për të gjithë përfituesit potencialë për mundësitë e financimit të ADRION-it dhe ndihmon përfituesit kryesorë në zbatimin e propozimeve të projekteve të zgjedhura.

AM nis procedurën e përzgjedhjes për rekrutimin e stafit të SP-së përmes konkurrimit të hapur, duke marrë parasysh termat e referencës të miratuar.

Procedurat kontraktuese me kandidatët e përzgjedhur zbatohen në përputhje me legjislacionin italian përkatës dhe sigurojnë një trajtim të barabartë për të gjithë stafin e SP-së. Këto rekrutime janë të hapura për kandidatë nga çdo shtet anëtar në BE dhe IPA dhe nga çdo vend pjesëmarrës në Programin ADRION.

Parimet e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit ndërmjet meshkujve dhe femrave merren në konsideratë gjatë rekrutimit të stafit të SP-së.

5.3 Përkrahimi përmblidhës i menaxhimit dhe i marrëveshjeve të kontrollit

(Referenca: shkronja “a” (v) e nenit 8, pika 4, e Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Paragrafi i mëposhtëm përshkruan strukturën e zbatimit të Programit ADRION dhe veçanërisht organet që veprojnë si Autoriteti

Menaxhues (AM), Autoriteti Certifikues (AC), Autoriteti i Auditimit (AA) dhe Sekretariati i Përbashkët (SP). Ai gjithashtu përcakton detyrat e secilit prej organeve të përfshira, përfshi KM-në dhe përshkruan marrëdhëniet e tyre në proceset e ndryshme të nevojshme për zbatimin e Programit.

Gjuha e Programit është gjuha angleze.

Italia, Kroacia, Greqia, Sllovenia, Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, si shtete anëtare të Programit ADRION, priten të krijojnë një sistem të përbashkët të menaxhimit për të menaxhuar, koordinuar dhe mbikëqyrur zbatimin e Programit ADRION.

Menaxhimi i këtij Programi ndjek strukturën e menaxhimit të zbatueshëm për një Program të Fondeve Strukturore. Për sa i përket vendeve pjesëmarrëse të IPA-s, ai zbaton nenin 26 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013. Bazuar në këtë, parimet e përgjithshme për marrëveshjet e menaxhimit dhe kontrollit specifikohen në nenin 72 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Strukturat e përbashkëta të zbatimit dhe ndarjet e detyrave mes organeve të ndryshme.

Komiteti i Monitorimit (KM)

Funksionet kryesore të KM-së janë të specifikuara në nenin 49 dhe në nenin 110 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Në përputhje me nenin 47 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, shtetet partnere në marrëveshje me AM krijojnë Komitetin e Monitorimit (KM) brenda tre muajve nga data e njohimit të vendimit të Komisionit për miratimin e Programit.

Anëtarët e KM-së do të përfaqësojnë shtetin anëtar dhe vendet pjesëmarrëse të Programit në nivelin politik dhe administrativ, si edhe për të siguruar një qasje transparente.

**Përbërja e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit**

Në përputhje me nenin 48, pika 1, të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, është rënë dakord nga shtetet anëtare për përbërjen e KM-së. Çdo shtet përfaqësohet në mënyrë të barabartë dhe në përputhje me parimin e partneritetit për menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e propozimeve të projektit në të gjitha fazat e zbatimit të Programit.

KM-ja kryesohet nga një përfaqësues i Shteteve Partnere ose nga Autoriteti Menaxhues sipas parimit të rotacionit, i cili mbetet për t'u përcaktuar.

KM-ja përbëhet nga:

Deri në dy përfaqësues për çdo Shtet Partner në nivelin e duhur qeverisës;

Një përfaqësues i Komisionit European në kapacitet këshillues;

AM/AC në kapacitet këshillues;

SP në kapacitet këshillues dhe në rolin e mbështetjes së sekretariatit ndaj KM-së;

AA si vëzhgues i pavarur;

Përfaqësues nga strukturat e qeverisjes së EUSAIR-it mund të marrin pjesë si vëzhgues;

Nëse BEI kontribuon në Program, ajo mund të përfaqësohet në punën e komitetit monitorues si vëzhgues;

Partnerët ndërkufitarë ekonomikë dhe socialë dhe organizatat transnacionale joqeveritare mund të marrin pjesë si vëzhgues, sipas kodit të sjelljes së partneritetit;

Përfaqësuesit e projektit strategjik të Aksit Prioritar 4 ose ndonjë ekspert tjetër mund të ftohet nga KM-ja për të marrë pjesë në mbledhje sipas agjendës në rolin e vëzhguesit;

Në parim, vendimet e KM-së merren me konsensus ku çdo Shtet Partner ka një votë. KM-ja harton dhe zbaton Rregulloren e tij.

KM mbledhet të paktën një herë në vit. Vendimet mund të merren nëpërmjet procedurës së shkruar.

Roli dhe detyrat e Komitetit të Monitorimit

KM-ja, në përputhje me nenin 49 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, shqyrton zbatimin e Programit dhe progresin e tij në arritjen e objektivave dhe, veçanërisht, kryen funksionet e tij në përputhje me nenin 110 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

KM-ja miraton metodologjinë, kriteret për përzgjedhjen e projekteve dhe rregullat e përshtatshmërisë para fillimit të çdo thirrjeje për propozime. KM-ja përzgjedh propozimet e projektit që do të financohen nga Programi ADRION në përputhje me nenin 12 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013. KM-ja kontrollon vlefshmërinë e përshkrimit të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit që formon bazën për përcaktimin e Autoriteteve të Programit sipas nenit 124, pika 2 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, përpara paraqitjes së sistemit të AA për mendim.

Vendimet e KM-së nuk mbajnë anën e asnjë pale dhe nuk duhet të ndikohen nga persona politikë apo interesa të organizatave të anëtarëve të KM-së.

Autoriteti menaxhues me funksione shtesë të autoritetit certifikues (AM/ AC)

Autoriteti Menaxhues ndihmohet nga Sekretariati i Përbashkët dhe është përgjegjës për menaxhimin dhe zbatimin e Programit ADRION në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar. AM-ja kryen funksionet e përshkruara në nenin 125 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013.

KM/AC, sipas nenit 24 të rregullores (BE) nr. 1299/ 2013, do të kryejë gjithashtu funksionet e parashikuara në nenin 126 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

AM/AC vepron për të mirën e të gjithë Programit dhe, në përputhje me rolin e tij koordinues, siguron që të gjitha organet e Programit ndërveprojnë rrjedhshëm. Ai vepron në zbatimin e detyrave të tij, në përputhje të plotë me dispozitat italiane institucionale, ligjore dhe financiare.

Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për transmetimin e informacionit dhe të dhënave të Komitetit i Monitorimit dhe të Komisioni Evropian, përfshirë të dhënat financiare dhe të dhënat në lidhje me indikatorët dhe arritjet, si dhe të dhënat që lidhen me ecurinë e Programit të Bashkëpunimit në arritjen e objektivave dhe rezultateve të tij.

KM/AC, pas konsultimeve me Shtetet Partnere, krijon SP-në, siç përshkruhet në paragrafin 5.2.

KM/AC:



- Është përgjegjës për hartimin dhe paraqitjen pranë Komisionit Europian aplikimet për pagesa dhe është përgjegjës për certifikimin se rezultojnë nga sisteme të besueshme llogarie, bazohen në dokumente mbështetëse të verifikueshme dhe janë subjekt i verifikimeve nga KM/AC para se të paraqiten pranë Komisionit Europian.

- Është përgjegjës për krijimin e llogarive vjetore, duke certifikuar plotësimin e tyre, saktësinë dhe cilësinë, si dhe siguron që shpenzimet e futura në llogaritë përputhen me rregulloren kombëtare dhe atë që aplikohen në BE, si edhe merr përsipër, lidhur me projektet e zgjedhura, financimin në përputhje me kriteret e zbatueshme për programin e bashkëpunimit dhe në përputhje me rregulloren kombëtare dhe të BE-së.

- Ndërmerr masa efektive dhe proporcionale kundër mashtrimeve dhe korrupsionit që marrin në konsideratë rreziqet e identifikuar (Rregullorja e BE) nr. 1303/ 2013, neni 125 (4) (c)). Ai siguron: kontrolle kundër mashtrimeve, të kryera në bashkëpunim me përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse në Program (p.sh., PKK-të). Lidhur me këtë, ai shtjellon shënime udhëzuese dhe linjë kontrollesh. Duke pasur parasysh temat specifike do të shtjellohen për të siguruar vijueshmërinë e kontrolleve dhe trajtimin e barabartë të të gjithë partnerëve. Kontrollat kundër mashtrimeve zbatohen vetëm për ato projekte të cilat me shumë gjasa do t'i propozohen KM-së për financim.

- Verifikon praninë e financimit të dyfishtë nëpërmjet pyetjeve të *posaçme* në Formularin e Aplikimit dhe shkëmbimin e informacioneve me të paktën programet e bashkëpunimit ndërkufitar që operojnë plotësisht/pjesërisht në zonën gjeografike të Programit ADRION.

- Verifikon që prania eventuale e konfliktit të interesave do të trajtohet në Rregulloren e KM-së.

KM-ja kryen gjithashtu funksione të AC-së. Në rolin e KM/AC-së:

- Siguron hartimin dhe paraqitjen e aplikimeve për pagesa pranë Komisionit Europian;

- Siguron se aplikimet e pagesave në Komisionit Europian rezultojnë nga sisteme të besueshme llogarie dhe bazohen në dokumente mbështetëse të verifikueshme;

- Siguron se informacioni si në pikën e mësipërme është verifikuar nga KM-ja duke pasur

parasysh plotësimin, saktësinë dhe cilësinë e llogarive vjetore dhe siguron që shpenzimet e futura në llogaritë përputhen me rregulloren kombëtare dhe atë që aplikohen në BE, si edhe merr përsipër, lidhur me projektet e zgjedhura, financimin në përputhje me kriteret e zbatueshme për programin e bashkëpunimit dhe në përputhje me rregulloren kombëtare dhe të BE-së;

-Paraqet AM-së, sipas nenit 112, pika 1 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, më 31 janar, 31 korrik dhe 31 tetor të çdo viti informacionin e mëposhtëm për AP-në:

-Shpenzimet totale dhe publike të projekteve dhe numri i projekteve të përzgjedhura për mbështetje;

-Shpenzimet e përgjithshme të deklaruara nga përfituesit, që sigurojnë se në dorëzimin që do të kryhet nga 31 janari, të dhënat të ndahen sipas kategorisë së ndërhyrjes; informacion i tillë përmbush kërkesat shtesë për të dhënat financiare, siç përcaktohet në nenin 20.2 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013;

- Siguron se kalimi të kryhet nga 31 janari dhe 31 korrik, gjithashtu të përmbajë një parashikim të shumës për të cilën AM-ja pret që të dorëzojë aplikimin për pagesë për vitin aktual financiar dhe atë pasardhës; dhe që afati i fundit për dorëzimin e të dhënave i referohet fundit të muajit pararendës të muajit të dorëzimit;

-Dorëzon të gjitha të dhënat përkatëse në përputhje me nenin 2 dhe aneksin II të Rregullores Zbatuese (BE) nr. 1011/2014;

- Siguron AM-në që çdo shumë e paguar si pasojë e një parregullsie të rikupërohet nga partnerët kryesorë (Neni 27 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013);

- Siguron që hartimi dhe dorëzimi i mëtejshëm i aplikimit të pagesës kanë marrë parasysh rezultatet e auditimeve të kryera në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nën përgjegjësinë e AA;

- Mban një llogari të shumave të rikuperueshme dhe të shumave të tërhequra pas anulimit të të gjithë ose të një pjesë të kontributit për një projekt. Shumat e kthyera do t'i kthehen Komisionit Evropian përpara mbylljes së programit operacional duke zbritur ato nga deklaratat e mëvonshme të shpenzimeve;

- Parandalon, zbulon dhe korrigjon parregullsitë që kalojnë 10.000 euro dhe rikupëron shumat e tepërta të paguara, së bashku



me një interes mbi pagesat e vonuara; informon për progresin në të gjitha procedurat administrative dhe ligjore; komunikon rastet e falimentimit, si dhe rastet e dyshimta të mashtrimit;

- Siguron se dorëzimi i aplikimeve të pagesave është paraprirë nga marrja e informacionit të duhur nga AM-ja mbi procedurat dhe verifikimet e kryera në lidhje me shpenzimet;

Harton, deri më 15 shkurt të vitit të ardhshëm financiar, dhe në bazë të nenit 137 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 dhe 59.9 të Rregullores Financiare, llogaritë për shpenzimet e bëra, duke përfshirë shumat e parafinancimit dhe shumat për të cilat procedurat e rikuperimit janë në proces ose kanë përfunduar. Informacioni do të shoqërohet nga deklarata e menaxhimit. Ajo duhet të vërtetojë plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e llogarive dhe se shpenzimet lidhur me projektet e financuara vlerësohen sipas kriterëve të miratuara të përzgjedhjes apo nga projektet e asistencës teknike të zbatuara nga PKK-të;

- Konfirmon se Programi ka një sistem që regjistron dhe ruan në mënyrë elektronike të dhënat financiare për secilin operacion dhe që mbështet të gjitha të dhënat e nevojshme për hartimin e aplikimeve të pagesës dhe shumat; se sistemi përditësohet rregullisht pas anulimit të të gjithë ose të një pjesë të kontributit për një operacion apo program operacional;

- Përpunon aplikimet për pagesa (neni 131.1 i Rregullores (BE) nr. 1303/2013) duke ofruar për çdo prioritet informacion mbi totalin e shpenzimeve të lejuara, të bëra nga përfutuesit dhe të paguar në operacionet zbatuese, siç është regjistruar në sistemin financiar dhe shumën e përgjithshme të shpenzimeve publike për zbatimin e operacioneve;

- Pranon pagesat e bëra nga Komisioni Evropian (parafinancimit, pagesat e ndërmjetme dhe pagesën e bilancit përfundimtar, siç përcaktohet në nenin 77 (2) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013) dhe paguan partnerin kryesor sipas nenit 132 të Rregullores (EU) nr. 1303/2013 dhe nenin 21.2 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013;

- Dorëzon aplikimin përfundimtar për një pagesë të pjesshme nga 31 korriku, pas përfundimit të vitit paraardhës financiar dhe përpara aplikimit të parë për pagesat e pjesshme

për vitin e ardhshëm të kontabilitetit (neni 135.2 CPR) dhe pas dorëzimit të raportit vjetor të zbatimit në Komisionin Evropian;

- Ruan të dhëna financiare në mënyrë elektronike për shpenzimet e deklaruara në Komisionin Evropian dhe për kontributin publik përkatës, të paguar partnerëve të projektit.

AM dhe AC organizohen nga Drejtoria e Përgjithshme, planifikimin territorial dhe të negociuar, marrëveshjet, marrëdhëniet europiane dhe ndërkombëtare dhe i përgjigjen të dyja Drejtorit të Përgjithshëm. Strukturat e AM-së dhe AC-së funksionojnë të ndara dhe janë të pavarura nga njëra-tjetra. Të dyja strukturat do të kenë personel të posaçëm. Do të sigurohet ndarja e funksioneve.

- Në kuadër të AM-së duhet të sigurohet ndarja e funksioneve në lidhje me përzgjedhjen e operacioneve (neni 125.3 i Rregullores (BE) nr. 1303/2013) dhe menaxhimin financiar, si dhe kontrollin e programit të bashkëpunimit (neni 125.4). Funksionet do të zbatohen nga zyrtarë të ndryshëm. Ndarja e funksioneve do të përshkruhet në përshkrimin e sistemit të menaxhimit dhe të kontrollit.

Autoriteti i auditimit

Autoriteti i Auditimit kryen funksionet e tij në përputhje me nenet 123, 124, 127 dhe 128 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 dhe të neneve 21 dhe 25 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013.

Autoriteti i Auditimit siguron se auditimet kryhen nëpërmjet funksionimit të duhur të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të Programit të Bashkëpunimit dhe sipas modelit të duhur të punëve në bazë të shpenzimeve të deklaruara. AA harton një opinion të auditimit mbi llogaritë vjetore për vitin paraprak të kontabilitetit dhe një raport vjetor të kontrollit, që përcakton rezultatet e auditimeve të kryera gjatë vitit të kontabilitetit të mëparshëm.

Autoriteti i Auditimit përgatit, brenda tetë muajve të miratimit të Programit ADRION, një strategji auditimi për performancën dhe auditimet. Strategjia e auditimit përcakton metodologjinë e auditimit, metodën e modelit për auditimet në projekte dhe planifikimin e auditimeve në raport me vitin aktual të kontabilitetit dhe dy vitet pasuese të kontabilitetit.

Në përputhje me nenin 25, pika 2, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, Autoriteti i



Auditimit asistohet nga një Grup i Auditorëve (GA) i përbërë nga përfaqësues të organeve përgjegjëse të secilit Shtet Partner, pjesëmarrës në Programin ADRION, që kryejnë detyrat e renditura më sipër, të detajuara në nenin 127 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013. Përfaqësuesit duhet të jenë të pavarur nga anëtarët e KM-së dhe çdo kontrollues, e përcaktuar sipas nenit 23, pika 4, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 dhe nga çdo aktivitetet dhe financa të projektit. GA do të krijohet brenda tre muajve nga vendimi për miratimin e Programit ADRION, jo më vonë se koha e specifikuar. Ai harton rregulloren e vet të procedurës dhe kryesohet nga Autoriteti i Auditimit.

Kur auditimet dhe kontrollat kryhen nga një organ tjetër ndryshe nga Autoriteti i Auditimit, ky i fundit siguron që këto organe të kenë pavarësinë e nevojshme për të vepruar. Vendimi për organin që kryen auditime të sistemit dhe kontrollat mbi shpenzimet merret nga Autoriteti i Auditimit dhe Grupi i Auditorëve gjatë procesit të hartimit të strategjisë së auditimit të Programit të Bashkëpunimit.

Çdo Shtet Partner është përgjegjës për auditimet e kryera në territoret e tij.

Autoriteti i Auditimit vepron, në zbatimin e detyrave të tij, në përputhje të plotë me dispozitat institucionale, ligjore dhe financiare.

Sekretariati i Përbashkët (SP)

Sipas nenit 23 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, Sekretariati i Përbashkët (SP) ndihmon Autoritetin Menaxhues (AM) me funksione shtesë të AC-së dhe KM-së në kryerjen e funksioneve të tij. Sekretariati i Përbashkët siguron informacion për përfituesit potencialë në lidhje me mundësitë e financimit në kuadër të Programit ADRION dhe asiston përfituesit në zbatimin e punës. SP-ja krijon dhe mban kontakte me Përfituesit Kryesorë dhe partneritetet e tyre.

Më konkretisht, Sekretariati i Përbashkët siguron koordinimin në nivelin transnacional, ndjekjen dhe promovimin e aktiviteteve dhe ofron mbështetje teknike për përgatitjen e takimeve dhe eventeve në nivelin e programit dhe projekteve (Mbledhjet e KM-së, konferenca dhe grupe pune transnacionale, seminare për Përfituesit Kryesorë, takime të tjera të veçanta tematike).

Sekretariati i Përbashkët lehtëson, vlerëson dhe siguron që përzgjedhja e projekteve është e drejtë dhe transparente. SP-ja mbledh të dhëna financiare, fizike dhe statistikore që janë të nevojshme për monitorimin e programit, si dhe për vlerësimet e përkohshme dhe përfundimtare. Ai verifikon pretendimet e pagesës në mënyrë që të shihet pagesa te Përfituesit Kryesorë.

Planet dhe raportet vjetore të punës së SP-së kërkojnë miratim nga KM-ja pas vlerësimit paraprak nga AM-ja. Ngritja dhe funksionimi i SP-së, përfshirë aktivitetet e tij, financohen nga buxheti i asistencës teknike (AT).

Pikat Kombëtare të Kontaktit (PKK)

Çdo Shtet Partner do të krijojë dhe menaxhojë një Pikë Kombëtare të Kontaktit për Programin ADRION, detyra kryesore e të cilit është të përfaqësojnë Programin në vendin përkatës. PKK-të do të përmbushin aktivitetet e SP-së në Shtetet Partnere dhe mund të kryejnë aktivitete të tjera specifike në nivel kombëtar. SP-ja do të koordinojë rrjetin e PKK-ve të Programit ADRION.

Detyrat kryesore detyruese të PKK-ve adriatiko-joniane janë:

- Të ndihmojnë SP-në në procesin e zbatimit të Programit;
- Të kontribuojnë për të maksimizuar informacionin dhe mekanizmat e publicitetit në vendet përkatëse;
- Të mbështesin komitetet kombëtare ose procedurat kombëtare korresponduese në përmbushjen e detyrave të tyre transnacionale;
- Të shërbejnë si pikë kontakti për aplikantët e projekteve, partnerët dhe palët e interesuara në nivel kombëtar duke ofruar ndihmën në gjenerimin e programit.

Përgjegjësitë e Shteteve Partnere

Shtetet Partnere kanë tri përgjegjësi kryesore lidhur në Programin ADRION:

- Si autoritete kombëtare, ato emërojnë përfaqësues të KM-së dhe sigurojnë një PKK në mënyrë që të kontribuojnë në zbatimin dhe koordinimin e Programit në territorin e tyre, si dhe kanë përgjegjësi financiare në lidhje me çka përshkruhet në paragrafin 5.4;
- Si kontrollues kombëtarë, ato janë përgjegjës për verifikimin e shpenzimeve të përfituesve të vendosur në territorin e tyre në nivelin e duhur qeverisës;



- Si anëtarë të GA-së, ato marrin pjesë në aktivitetet e auditimit dhe janë përgjegjëse për auditimet e kryera në territorin e tyre.

Të gjitha Shtetet Partnere bien dakord që të zbatojnë parimin e partneritetit siç përcaktohet në nenin 5 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 dhe të bashkëpunojnë për menaxhimin optimal dhe kontrollin e Programeve, si dhe mirëmbatimin e tyre.

Shtetet Partnere mund të caktojnë në formë të shkruar rregullat për rregullimin e marrëdhënieve të tyre me AM-në dhe AA, marrëdhëniet ndërmjet autoriteteve të tilla, si dhe marrëdhëniet e këtyre autoriteteve me Komisionin Europian.

Shtetet Partnere në Programin ADRION garantojnë se autoritetet zbatuese do të pajisen me të gjithë informacionin e lejuar ligjor për kryerjen e përgjegjësisë të tyre.

Organizimi i vlerësimit dhe përzgjedhjes së operacioneve

Aplikimet e projektit mund të dorëzohen pas akordimit të drejtpërdrejtë të procedurës ose thirrjeve për propozim, kushtet e të cilave do të publikohen në faqen e internetit të Programit ADRION. Do të jepen mbështetje dhe udhëzime për aplikantët mbi llojet e operacioneve, si dhe mbi procedurat e aplikimit dhe zbatimit) nëpërmjet dokumenteve specifike të informacionit, si dhe ngjarjeve dhe trajnimeve të kryera nga AM dhe SP në bashkëpunim me PKK-të. Detajet e procedurës së përzgjedhjes do të jenë në dispozicion për të gjithë aplikuesit përmes Manualit të Programit. Aplikacionet e dorëzuara do t'u vihen në dispozicion anëtarëve KM-së.

Një grup kriteresh të pranueshmërisë, duke përfshirë masat kundër mashtrimit, do të përcaktohen për të siguruar përmbushjen e kërkesave formale të kërkesave të paraqitura dhe të miratuara nga KM-ja. Tërësia e kriterëve të përshtatshmërisë do të përfshijë edhe ndërkombëtarizimin e partneritetit (duke përfshirë përfitues nga të paktën tri vende pjesëmarrëse në Program, të paktën njëri prej të cilave do të jetë nga një Shtet Partner i BE-së).

SP-ja kontrollon aplikimet kundrejt kriterëve të përshtatshmërisë. Propozimet që nuk janë të pranueshme refuzohen me vendim të KM-së.

Kriteri i vlerësimit

Vlerësimi i aplikacioneve nga SP-ja dhe miratimi i projektit nga KM-ja kryhen në bazë të kriterëve objektive të përcaktuara në rregullat e vlerësimit të miratuara nga KM-ja dhe të shpjeguara në manualin e Manualit Programit.

Kriteret e vlerësimit do të përcaktohen me qëllim për të maksimizuar qasjen e orientuar nga rezultati, që do të aplikohen nga Programi ADRION për projekte që mund të japin rezultate konkrete dhe të dukshme, në përgjigje të sfidave të miridentifikuara, që ndikojnë në zonën e Programit dhe që trajtojnë nevojat e zhvillimit në mënyrë të integruar.

Të gjitha projektet që marrin fonde duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme të cilësisë:

- Rëndësinë Ndërkombëtare;
- Rëndësinë e Partneritetit;
- Rezultatet konkrete dhe të matshme;
- Rezultatet dhe produktet e qëndrueshme;
- Qasje koherente;
- Strategji dhe mjete komunikimi të mira të projektit;
- Menaxhim efektiv;
- Buxhet të qëndrueshëm.

KM-ja vazhdon me përzgjedhjen e projekteve. AM-ja informon me shkrim dhe në përputhje me parimin e-kohezionit çdo Aplikant Kryesor në lidhje me rezultatet e procesit të përzgjedhjes. Rezultatet do të shpërndahen edhe nëpërmjet internetit, siç është vendosur në nenin 115 (2) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Zgjidhja e ankesave

Procedurat e vendosura për zgjidhjen e ankesave janë të ndryshme në përputhje me objektin e ankesës;

a) Ankesat në lidhje me vlerësimin dhe përzgjedhjen:

- Aplikantët Kryesorë të projekt do të informohen me shkrim për arsyet pse një kërkesë nuk është pranuar ose nuk është konsideruar me cilësi për t'u miratuar. Çdo ankesë në lidhje me vlerësimin duhet të dorëzohet nga Aplikuesi Kryesor pranë AM/SP, të cilat, në bashkëpunim me KM-në, do të shqyrtojnë dhe të mbajnë qëndrimin e tyre në lidhje me meritat e ankesës. KM-ja mund të ngrejë një grup pune apo një nënkomision për t'u marrë me ankesat.

b) Ankesa lidhur me vendimet e marra nga AM/SP gjatë zbatimit të projektit:



- Çdo ankesë në lidhje me vendimet e marra nga AM/SP gjatë zbatimit të projektit ose nga vendimet e KM-së në bazë të kontratës së subvencionit do të dorëzohet nga Partneri Kryesor i Projektit të AM/SP, që do të shqyrtojë dhe të japë një përgjigje (në bashkëpunim me KM-në nëse është e nevojshme).

c) Ankesat që lidhen me sistemin e kontrollit kombëtar:

- Partnerët Kryesorë të projektit ose partnerët që kanë ankesa lidhur me sistemin e kontrollit kombëtar të ngritur në përputhje me nenin 23 (4) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, mund të paraqesin një ankesë pranë organit koordinues kombëtar të kontrollit të shtetit partner përkatës për të ndjekur procedurat kombëtare të përcaktuara në përputhje me nenin 74 (3) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Informacione të mëtejshme mbi procedurën për parashtrimin e ankesave do të përcaktohen në dokumentet përkatëse të Programit dhe të komunikohet në mënyrë të rregullt si për aplikuesit, ashtu edhe për përfituesit.

Procedurat e kontraktimit

Pas vendimit të KM-së për të pranuar aplikimet e rekomanduara për financim pas vlerësimit të cilësisë teknike të kryer nga AM/SP, AM dhe Partneri Kryesor nënshkruajnë kontratën individuale të subvencionit për çdo projekt. Kontrata përmban edhe fonde IPA të alokuara për veprimtarinë.

Mosdiponueshmëria e fondeve IPA nuk ka pasoja për miratimin e partnerëve ERDF në të njëjtin projekt. Projekti do të zbatohet nga partnerët ERDF pa partnerët e IPA-s, nëse është i prekur nga mosdiponueshmëria e përmendur e fondeve.

AM-ja do të përdorë një model standard për kontratën e subvencionit të miratuar nga KM-ja dhe të zhvilluar në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Italisë dhe parimet e institucionit që mirëpret AM-në.

Kontrata e subvencionit i drejtohet Partnerit Kryesor, i emëruar nga partneriteti, në përputhje me nenin 13 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, dhe nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i institucionit Partner Lead dhe nga AM-ja.

Kontrata e subvencionit parashtron të gjitha rregullimet e nevojshme zbatuese për funksio-

nimin. Ajo gjithashtu do të përfshijë masat ligjore në rast të procesit gjyqësor.

Dokumentet e miratuara të aplikimit, duke përfshirë edhe formën përfundimtare të miratuar të aplikimit dhe komunikimin e vendimit të miratimit nga AM-ja, do të përbëjnë një pjesë integrale të kontratës së subvencioneve.

Marrëveshja për verifikimin e menaxhimit dhe kontrollit përkatës të cilësisë

Në kuadër të menaxhimit financiar dhe kontrollit, Shtetet Partnere do të garantojnë që sistemet e tyre të kontrollit dhe menaxhimit janë ngritur në përputhje me dispozitat e përcaktuara në rregulloret e BE-së dhe se sistemet funksionojnë në mënyrë efektive dhe të duhur.

Shteti partner që merr pjesë në Programin ADRION vërteton se produktet dhe shërbimet e bashkëfinancuara janë dorëzuar dhe se shpenzimet e deklaruar nga përfituesit janë paguar dhe se janë është në përputhje me Unionin, Programin dhe ligjin kombëtar në fuqi, si dhe kushtet për mbështetjen e funksionimit (Art. 25 (4) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013).

Shteti partner do të caktojë organin ose personin përgjegjës për kryerjen e verifikimeve të tilla në lidhje me përfituesit në territorin e tij (“kontrolluesit”) dhe do të jetë përgjegjës për verifikimet e kryera në territorin e tij.

Për Programin ADRION, verifikime të tilla kryhen nga kontrolluesit e caktuar në bazë të çdo sistemi kontrolli të shtetit partner (të centralizuar apo të decentralizuar).

Shtetet Partnere duhet gjithashtu të sigurojnë që shpenzimet i një përfituesi mund të verifikohen brenda një periudhe prej tre muajsh nga paraqitja e dokumenteve nga ana e përfituesit në fjalë.

AM do të garantojë që shpenzimet e çdo përfituesi që merr pjesë në një operacion janë verifikuar nga një kontrollues i caktuar.

Në mënyrë për të lehtësuar procedurën administrative dhe për të përmirësuar menaxhimin e programit, AM-ja do të promovojë harmonizimin dhe koordinimin e aktiviteteve përmes miratimit të niveleve të përbashkëta të standardeve dhe aktiviteteve të koordinimit midis sistemeve kombëtare të kontrollit, duke krijuar, me mbështetjen e SP-së, një rrjet organesh /autoritetesh përgjegjëse për kontrollin e shkallës së parë.



Pas këtyre verifikimeve, SP-ja merr nga çdo projekt raportin e rregullt të progresit të hartuar nga Partneri Kryesor, duke përfshirë një kërkesë për pagesë në bazë të afateve të paracaktuara.

SP-ja kryen të gjitha kontrollet e nevojshme për të garantuar ekzistencën e projektit dhe përputhshmërinë e tij me aplikimin e miratuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kontratën e subvencionit. Për më tepër, AM-ja kontrollon saktësinë e pretendimeve të pagesave dhe përcakton shumën e kontributit që do të paguhet në lidhje me shumën totale të shpenzimeve të verifikuara dhe të certifikuara. AM-ja, në funksionet e saj shitesë të AC-së, vërteton pretendimin e pagesës dhe miraton të gjitha masat e nevojshme në rast parregullsish ose mashtrimesh.

Funksionimi efektiv i sistemit të kontrollit i përcaktuar nga çdo Shtet Partner do të verifikohet me anë të llojeve të ndryshme të kontrolleve dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Rimbursimi i partnerëve kryesorë nga autoriteti menaxhues

Në përputhje me nenin 13 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, për çdo projektoperacioni partnerët do të emërojnë një Partner Kryesor. Partneri Kryesor duhet të marrë përgjegjësi të plotë për aplikimin dhe zbatimin e të gjithë operacionit, duke përfshirë trajtimin e fondeve të Unionit.

Bashkëfinancimi kombëtar për operacionet duhet të sigurohet nga partnerët e projektit në bazë të mekanizmave të tyre përkatës kombëtar. Të gjitha operacionet duhet të jenë parafinancuar nga partnerët e projektit.

KM-ja mund t'i japë mandatin AM-së për të shqyrtuar mundësinë e një mekanizmi të parafinancimit për projekte.

Bazuar në kontrollet e raporteve të ndërmarra nga SP dhe në përputhje me Nenin 21 (2) të Rregullores (BE) Nr. 1299/2013 dhe Nenin 132 të Rregullores (BE) Nr. 1303/2013, AM do t'i sigurojë pagesat Partnerit Kryesor i cili është përgjegjës për transferimin e kontributit të Unionit për partnerët që marrin pjesë në operacion.

Në përputhje me nenin 80 të Rregullores së (BE) Nr. 1303/2013 dhe me nenin 28 të Rregullores (BE) Nr. 1299/2013, shumat e përcaktuara në Programin e paraqitur nga Shtetet

partnere dhe pasqyrave të shpenzimeve, do të shprehen në euro. Të gjitha pagesat për Partnerëve Kryesorë do të bëhen në Euro.

Kontributi i Shteteve Partnere për financimin e asistencës teknike

Në nivel programi, asistenca teknike (AT) është e financuar bashkërisht nga shtetet partnere. Në përputhje me nenin 17 të Rregullores (BE) Nr. 1299/2013, AT financohet nga një maksimum prej 6% të shumave totale të ERDF. Sa i përket Shteteve Partnere IPA dhe duke iu referuar nenit 26 të Rregullores (BE) Nr. 1299/2013, do të zbatohet Neni 17 i të njëjtit Rregullores. Detaje mbi buxhetin e AT-së janë të paraqitura në Seksionin 3.

Çdo Shtet Partner do të transferojë pjesën e vetë kombëtare të bashkë-financimit për AT-në në llogarinë e AM-së. Bashkë-financimi kombëtar i buxhetit të AT është dhënë si pagesë paradhënie jo më vonë se 2015 në bazë vjetore në raport me pjesën individuale të totalit të fondeve IPA dhe ERDF të shteteve partnere.

Një raport mbi gjendjen e pagesës do të jepet nga ana e AM për KM rregullisht. Përdorimi i interesit të ngritur nga fondet e Bashkimit (pas zbritjes së detyrimeve për transaksionet transnacionale) dhe llogarive bankare për kontributet kombëtare ex-ante, zbatojnë vendimin e KM.

Hollësi i mëtejshme teknike dhe financiare do të përcaktohen në manualin e AT.

Informimi dhe komunikimi

Në përputhje me nenet 115 dhe 116 të Rregullores (BE) Nr. 1303/2013, do të hartohet një strategji komunikimi dhe do të paraqitet pranë KM-SW jo më vonë se 6 muaj pas miratimit të Programit për të siguruar transparencën dhe informimin e partnerëve dhe palëve të interesuara përkatëse.

Strategjia do të përcaktojë objektivat specifike të komunikimit, audiencat e synuara, mesazhet si edhe taktikat dhe mjetet për të mbështetur arritjen e qëllimeve më të gjera të Programit. Ajo do të marrë në konsideratë rregullat e detajuara në lidhje me masat e informacionit dhe të komunikimit, siç përcaktohet në nenin 115 dhe në Aneksin XII të Rregullores (BE) Nr. 1303/2013. Strategjia do të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e programimit, e plotësuar nëpërmjet planeve vjetore të punës.



Programi dhe të gjitha aktivitetet komunikimit të projekteve duhet të jenë në përputhje me një markim të koordinuar të paraqitur mbi një bazë vullnetare nëpërmjet programeve BTE për periudhën 2014-2020.

Gjithë përgjegjësia për komunikimet i takon AM-së dhe SP-së. Megjithatë, në nivel kombëtar dhe rajonit, PKK-të luajnë një rol të rëndësishëm në plotësimin e aktiviteteve ndërkombëtare dhe evropiane. Operacionet e miratuara luajnë një tjetër rol kyç në komunikimin e arritjeve të projektit në të gjitha nivelet.

Shtetet Partnere do të mbështetnin AM-në për të siguruar aplikimin efektiv të kërkesave të informimit dhe publicitetit duke marrë hapat e duhur për të shpërndarë informacion dhe do të sigurojnë publicitet brenda territorit të tyre.

Vlerësimi i programit

Programi ka qenë subjekt i një vlerësimi paraprak të vlerësuesve të pavarur me qëllim përmirësimin e cilësisë së programit dhe për të optimizuar alokimin e burimeve buxhetore. Rekomandimet e këtij vlerësimi janë marrë parasysh gjatë hartimit të këtij programi.

Në përputhje me nenin 56 dhe 114 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, AM-ja do të hartojë një plan vlerësimi, që do të miratohet nga KM-ja në përputhje me dispozitat, siç përcaktohet në nenin 110 (2) (c) të Rregullores (EU) nr. 1303/2013. Në përputhje me nenin 56 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, vlerësimet do të kryhen për të vlerësuar efektivitetin, efikasitetin dhe ndikimin e Programit. Gjatë periudhës së programimit, vlerësimi do të vlerësojë se si ka kontribuar sporti nga fondet në objektivat për çdo AP dhe gjithashtu mbulimin territorial të zonës së Programit. Të gjitha vlerësimet, rekomandimet dhe veprimet përcjellëse do të shqyrtohen dhe miratohen nga KM-ja.

Në përputhje me nenin 57 të Rregullores së (BE) nr. 1303/2013, vlerësimi paraprak është përgjegjësia e Komisionit Evropian.

Shkëmbimi i kompjuterizuar i të dhënave

Siç përcaktohet në nenet 74 dhe 112 të Rregullores së (BE) nr. 1303/2013, shkëmbimi i të dhënave me Komisionin Evropian do të kryhet në mënyrë elektronike përmes një sistemi monitorimi elektronik (e-MS).

E-MS duhet të sigurojë të dhëna dhe informacione të nevojshme për të përmbushur kërkesat e menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit.

Në përputhje me nenin 122 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, Programi ADRION do të garantojë që jo më vonë se data 31 dhjetor 2015 të gjitha shkëmbimet e informacionit ndërmjet përfituesve dhe AM/AC dhe AA do të kryhen me anë të sistemit elektronik të shkëmbimit të të dhënave.

AM ADRION do të përpiqet për të arritur digjitalizimin e plotë të Programit gjithashtu në përputhje me zhvillimin e rregullave të IPA-s për këtë çështje administrative.

E-MS do të jetë në përputhje me aspektet e mëposhtme:

- integritetin e të dhënave dhe konfidencialitetin;

- Autentifikimin e dërguesit brenda kuptimit të Direktivës 1999/93 / EC4108;

- Ruajtjen në përputhje me rregullat e ruajtjes, përcaktohet në nenin 140 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013; transferimi i sigurt i të dhënave;

- Disponueshmërinë gjatë dhe jashtë orarit standard të zyrës (me përjashtim të aktiviteteve të mirëmbajtjes teknike);

- Aksesueshmërinë e-MS nga përfituesit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një ndërfaqeje për sinkronizim automatik dhe regjistrimin e të dhënave me sistemet kombëtare, rajonale dhe lokale të menaxhimit të kompjuterit;

- Mbrojtjen e privatësisë së të dhënave personale për individët dhe konfidencialitetin tregtar për personin juridik;

- Për të transferuar të dhëna në Komisionin Evropian, sistemi i administrimit të e-MS do të lehtësojë ndërveprimin me kornizat e Unionit, siç kërkohet nga neni 122 (3) i Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Sistemi kompjuterik i përdorur duhet të përmbushë standardet e pranura të sigurisë dhe besueshmërisë. Procedurat e pranura që sigurojnë besueshmërinë e kontabilitetit, monitorimin dhe informacione, raportimit financiar në formë të kompjuterizuar do të zbatohen.



5.4 Shpërndarja e detyrimeve midis Shteteve Partnere në rast të korrigjimeve financiare të vendosura nga autoriteti menaxhues ose Komisioni Evropian

(Referenca: pika (a) (vi) të nenit 8 (4) të Rregullores BTE)

Pa cenuar Shtetet Partnere për zbulimin dhe korrigjimin e parregullsive, si dhe për kthimin e shumave në mënyrë të padrejtë, sipas nenit 122 (2) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, AM-ja do të garantojë që çdo shumë e paguar si rezultat i një parregullsie është korrigjuar nga projekti nëpërmjet Partnerit Kryesor. Sipas nenit 27 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, partnerët e projektit do t'i shlyejnë Partnerit Kryesor çdo shumë të paguar tepër.

AM-ja gjithashtu do të rimarrë fonde të plota ose të pjesshme nga Partneri Kryesor (dhe partneri kryesor nga partnerët e projektit) pas një ndërprerjeje të kontratës së subvencioneve në bazë të kushteve të përcaktuara në kontratën e subvencioneve.

Nëse Partneri Kryesor nuk ka sukses në sigurimin e shlyerjes nga një partner tjetër i projektit ose nëse AM-ja nuk ka sukses në sigurimin e shlyerjes nga partneri kryesor pavarësisht të gjitha masave të marra, shteti Partner, në territorin e të cilit partneri i projektit në fjalë është i vendosur, do t'i rimbursojë AM-së çdo shumë të paguar padrejtësisht ndaj atij partneri, në bazë të nenit 27 (3) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013.

AM-ja është përgjegjëse për rimbursimin e shumave të rimarra në buxhetin e përgjithshëm të Unionit, në përputhje me ndarjen e detyrimeve midis Shteteve Partnere (ju lutemi, shihni më poshtë). AM-ja do të rimbursojë fondet e Komisionit Evropian sapo shumat të jenë mbuluar nga Partneri Kryesor/Partneri i Projektit/Shteti Partner.

Detajet mbi procedurën do të përfshihen në përshkrimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të themeluar në përputhje me nenin 72 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Paralelisht me/pas rimbursimit të shumës së pariparueshme nga Shteti Partner ndaj AM-së, shteti Partner ka të drejtë për të siguruar shlyerjen nga partneri i projektit të vendosur në territorin e tij, nëse është e nevojshme me anë të veprimit juridik.

Për këtë qëllim, AM-ja dhe Partneri Kryesor do të përcaktojnë të drejtat e tyre që rrjedhin nga kontrata e subvencionit dhe marrëveshja e partneritetit me shtetin në fjalë Partner (partneri ERDF, si dhe partneri IPA II).

Në rastin e parregullsive të zbuluara nga ana e Gjykatës Evropiane të Audituesve ose nga Komisioni Evropian, të cilat rezultojnë në shpenzime të caktuara duke u konsideruar të papërshtatshme dhe me një korrigjim financiar, duke qenë subjekt i një vendimi të Komisionit Evropian në bazë të neneve 144 deri 147 të Rregullores (EU) nr. 1303/2013, pasojat financiare për shtetin partner përcaktohen në seksionin më poshtë “detyrimet dhe parregullsitë”. Çdo shkëmbimin lidhur me korrespondencën mes Komisionit Evropian dhe shtetit Partner do të kopjohet për MA/ SP; kjo e fundit do të informojë AA-në dhe Grupin e Audituesve.

Ndarja e detyrimeve midis shteteve partnere

Shtetet Partnere do të mbajnë përgjegjësi në lidhje me përdorimin e fondeve të Programit ERDF dhe IPA, si më poshtë:

- Për shpenzimet lidhur me projektin që u janë dhënë partnerëve të projektit të vendosur në territorin e tij, përgjegjësia do të mbahet në mënyrë individuale nga secili shtet pjesëmarrës në program.

- Në rast të ndonjë parregullsie sistematike apo korrigjimi financiar (ky i fundit i vendosur nga Komisioni Evropian), Shtetet Partnere do të mbajnë pasojat financiare në raport me parregullsitë përkatëse që janë zbuluar në territorin përkatës pjesëmarrës të Shtetit. Aty ku parregullsitë ose korrigjimi financiar nuk mund të lidhet me një territor të caktuar të Shtetit Partner, Shtetet Partnere do të jenë përgjegjëse në raport me kontributin e ERDF/IPA që u është paguar partnerëve përkatës të projektit kombëtar të përfshirë.

- Për shpenzimet AT të shkaktuara nga AM, përgjegjësia lidhur me parregullsitë administrative do të përballohet nga AM-ja.

Nëse AM/AC, SP ose çdo Shtet Partner është i vetëdijshëm për parregullsitë, pa asnjë vonesë do të informojë shtetin përgjegjës apo AM-në në funksionet e saj të tjera të AC-së, të cilat do të sigurojnë transmetimin e informa-



cionit në AA/GA, kur është e nevojshme.

Në përputhje me nenin 122 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, çdo Shtet Partner është përgjegjës për raportimin e parregullsive të kryera nga përfituesit që ndodhen në territorin e tyre në Komisionin Evropian dhe në të njëjtën kohë në AM. Nëse Shteti Partner nuk është në përputhje me detyrimet e tij që rrjedhin nga këto dispozita, AM-ja ka të drejtë të pezullojë pagesat për të gjithë partnerët e projektit që ndodhen në territorin e vendit të prekur.

Marrëveshja e financimit me shtetet partnere IPA duhet të deklarojë qartë se çdo vend përfitues që pret një partner projekti do të jetë përgjegjës për parandalimin, zbulimin, marrjen e vendimeve dhe korrigjimin e parregullsive të bëra nga publiku, privati, si dhe partnerë privatë.

Programi i ADRION-it kërkon që kur shpenzimet e fondeve ERDF me anë të kontratës/ koncesioneve publike, organet publike dhe organet ekuivalente publike të shteteve Partnere ERDF të respektojnë rregullat e prokurimit publik të BE-së dhe në veçanti: (i) Direktivën 2004/18/ KE dhe 2004/17/ KE, (ii) Direktivën 2014/23/ BE, 2014/24/BE dhe 2014/25/BE pasi të jenë transpozuar në legjislacionin kombëtar; (iii) Direktivat 89/665/ KEE dhe 92/13/KEE dhe (iv) parimet e përgjithshme të prokurimit publik që rrjedhin nga Traktati mbi Funksimin e BE-së. Prokurimet publike në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbisë duhet të jenë në përputhje me rregullat e ndihmës së jashtme të BE-së.

5.5 Përdorimi i euros

(Referenca: Neni 28 i Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Në përputhje me nenin 28 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 dhe me anë të derogimit të nenit 133 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, shpenzimet e kryera në një monedhë ndryshe nga euro do të konvertohen në euro nga përfituesit, duke përdorur kursin e këmbimit të kontabilitetit mujor të Komisionit Evropian gjatë muajit në të cilin janë paraqitur shpenzimet për verifikim në AM apo te kontrolluesi (opsioni b i krijuar nga neni 28 i Rregullores (BE) nr. 1299/2013. Konvertimi do të verifikohet nga kontrolluesi në shtetin partner ku partneri ndodhet.

5.6 Përfshirja e partnerëve

(Referenca: pika (c) e nenit 8 (4) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Veprimet e ndërmarra për të përfshirë partnerët në përgatitjen e programit të bashkëpunimit, si dhe roli i këtyre partnerëve në përgatitjen dhe zbatimin e programit të bashkëpunimit, duke përfshirë edhe përfshirjen e tyre në komitetin monitorues (autoritetet rajonale dhe lokale, organet kompetente urbane dhe autoritet e tjera publike, partnerët ekonomikë dhe socialë, organet përkatëse që përfaqësojnë shoqërinë civile (duke përfshirë edhe partnerët e mjedisit), organizatat joqeveritare dhe organet përgjegjëse për promovimin e përfshirjes sociale, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit).

Përmbledhje e procesit të përgatitjes së programit të bashkëpunimit

Programi ADRION është përpunuar sipas kodit të sjelljes të përgatitur nga Komisioni Evropian.

Në gusht të vitit 2013 Komisioni Evropian, për të siguruar koherencën me EUSAIR-in e ardhshëm, vendosi të ripërcaktojë shtrirjen gjeografike të programit për Portën Juglindore, me qëllim lidhjen e saj me strategjinë: Zona e re e Programit ADRION ishte përshtatur për 8 vendet e përfshira në Strategji.

Procesi i përgatitjes së programit të bashkëpunimit zgjati rreth një vit, duke filluar në gusht të vitit 2013. Task-Forca u riorganizua dhe rifokusua në Programin ADRION, i cili është i përbërë nga 8 vendet e strategjisë së ardhshme makrorajonale.

Task-Forca e rirregulluar miratoi Rregulloren e Brendshme të procedurës duke krijuar misionin, procesin e vendimarrjes dhe përbërjen e Task-Forcës.

Për të siguruar një koherencë të përgjithshme të përmbajtjes së programit të bashkëpunimit me kuadrin rregullator evropian, plani indikativ i kohës së procesit të programimit përditësohej vazhdimisht duke marrë parasysh evolucionin e projektregulloreve të BE-së dhe proceset e konsultimit.

Task-Forca nisi një thirrje për aplikime kundrejt institucioneve të gatshme për të vepruar si AM të ardhshme: procedura u mbyll në muajin maj të vitit 2014 me emërimin e Rajonit Emilia-Romagna si AM i ardhshëm për Programin ADRION.



Task-Forca ka ngritur një grup të kufizuar pune të ngarkuar me shoqërimin e përgatitjeve të AP 4 përqendruar në OT11, duke trajtuar mbështetjen për qeverisjen dhe zbatimin e EUSAIR-it nën koordinimin e Sllovenisë. Anëtarët e saj janë emëruar nga shtetet partnere, si dhe nga AM, punonjësi i Komisionit Evropian dhe një përfaqësues i INTERAKT-it si vëzhgues të jashtëm.

Një numër total prej 8 takimesh Task-Force u zhvillua gjatë gjithë procesit të përgatitjes.

Përshkrimi i përfshirjes së partnerëve

Qëllimi i procesit ka qenë vlerësimi i zgjedhjes strategjike (përqendrimit tematik) për Programin ADRION dhe për të mbledhur kontributet shtesë dhe sugjerimet, si dhe ide mbi veprimet e mundshme ndërkombëtare që do të mbështeten. Për përgatitjen e Programit ADRION, partnerët kanë qenë të përfshirë me një konsultim të nisur në nivel programi.

Programi i ADRION-it ka lançuar në faqen e tij konsultimin e tij publik *online* mbi prioritetet e tij midis 27 qershorit dhe 17 korrikut 2014, rezultatet e të cilit janë paraqitur pranë Task-Forcës në 21 korrik 2014, në Bolonjë (Itali).

Në kuadrin e procesit të programimit Task-Forca gjithashtu ka organizuar edhe dy aktivitete tematike ndërkombëtare në Itali (Ancona - 3 shtator 2014) dhe Kroaci (Split - 5 shtator 2014), që kishin për qëllim mbledhjen e kontributeve nga publiku në lidhje me pritjet e tyre nga Programi ADRION dhe rezultatet dhe veprimet shtesë të mundshme për rregullimet e vogla të strategjisë së programit. Seminaret tematike janë organizuar në një seancë të plotë dhe 3 seanca pune paralele, duke u fokusuar në Programin Pas (Rajonin Novator dhe të Zgjuar: Rajonin e Qëndrueshëm, Rajoni i Lidhur).

Bazuar në listën e postimeve të përdorura për konsultim *online*, 2.611 persona kanë marrë ftesën me rendin e ditës dhe një formular regjistrimi (të dyja dokumentet kanë qenë gjithashtu në dispozicion në faqen e internetit të Programit SEE www.southeast-europe.net). Më shumë se 200 aktorë morën pjesë në 2 aktivitete (142 në Itali dhe 66 në Kroaci, përkatësisht).

Pjesëmarrësit përfaqësonin sfone të ndryshme, p.sh.: akademike, autoritete lokale, agjencitë e zhvillimit dhe privatë. Pjesëmarrësit kanë qenë aktivë dhe kanë kontribuar me

mendime dhe ide për të gjithë përbërësit e programit. Këto të dhëna janë përkthyer në rishikimin konkret të versionit të hartuar të programit të bashkëpunimit dhe janë fokusuar kryesisht në:

- nevojat e zonës së programit;
- fusha të tjera tematike që do të përfshihen si fokus të AP-ve;
- Disa sugjerime për përmirësimin e menaxhimit dhe zbatimit të Programit.

Të gjitha prezantimet të seancës plenare dhe të grupeve të punës, si dhe lista e pjesëmarrësve janë publikuar në faqen e internetit të Programit SEE.

Mes korrikut dhe dhjetorit 2014 u arrit konsultimi i autoriteteve të mjedisit të Shteteve Partnere lidhur me ndikimin e programit në mjedis.

Përzgjedhja e partnerëve

Konsultimet në kuadër të Programit ADRION kanë ndjekur “Parimet e përgjithshme dhe standardet minimale për konsultim të palëve të interesuara nga Komisioni” (“Drejt një kulture të përfunduar të konsultimit dhe dialogut - Parimet e përgjithshme dhe standardet minimale për konsultimin e palëve të interesuara nga Komisioni Evropian”. Bruksel, 2002/12/11 COM (2002) 704 përfundimtar). Kështu, Programi ka bërë të mundur që parimet e transparencës dhe llogaridhënies, efektshmërisë dhe koherencës të jenë aplikuar pas konsultimeve me palët e tij të interesuara.

Ka pasur katër lloje palësh të interesuara për t’u konsultuar:

- a) Palët e interesuara të përfshira në listat kombëtare/rajonale të ofruara nga shtetet partnere;
- b) SEE dhe partnerët e projektit IPA CBC Adriatik;
- c) Grupet e synuara të programit që kanë një mundësi për t’u lidhur me faqet e internetit (programin, rajonet, shtetet);
- d) Zbatuesit kryesorë të strukturës së qeverisjes EUSAIR.

Njoftimi për anketim është dërguar me *e-mail* për 2.611 adresat.

Lista e partnerëve të përfshirë në procesin e konsultimit

Hulumtimi ka nisur më 2 korrik deri 18 korrik 2014 (16 ditë), përmes një mjeti në internet të ofruar nga ekipi i hartimit.



Ftesa i është dërguar 2.611 grupeve të interesit. Lista postare është bazuar në dy kontribute të marra nga anëtarët e Task-Forcës, mbi bazën e të dhënave të PEJ-së dhe në regjistrimin *online*.

Shkalla e përgjigjes ishte normale, duke pasur parasysh një afat kohor shumë të shkurtër: 322 të anketuar iu përgjigjën studimit, i cili është rreth 12%. Raporti i të anketuarve/popullsisë së rajoneve të pranueshme konfirmon bilancin e përgjithshëm brenda zonës përfituese në lidhje me pjesëmarrjen.

Për sa i përket normës së pjesëmarrjes për kategorinë e të anketuarve (tabela 2), 31% janë nga organet kërkimore dhe të arsimit, 23% AP nga qendrore/rajonale, 14% nga autoritetet publike lokale, 13% nga agjencitë e zhvillimit/OJQ-të, 8% nga dhomat, sindikatat dhe shoqatat, 7% janë me drejtim fitimprurës dhe në fund të 4% përfaqësojnë të anketuar jashtë zonës së Programit.

Bilanci i përgjithshëm i normës së kthimit për kategori siguron që të dhënat mund të krahasohen në mënyrë të drejtë, por përqindja e lartë e qendrore/rajonale AP (OT6) dhe hulumtimet dhe institucionet e arsimit (OT1) kanë ndikuar sigurisht renditjen e OT-ve dhe PI-ve.

Veprimet e ndërmarra për të lehtësuar pjesëmarrjen e partnerëve

Programi ADRION ka informuar partnerët në lidhje me nisjen e procesit të konsultimit në faqen e internetit SEE dhe autoritetet kombëtare të informuara nëpërmjet faqeve të tyre institucionale, organeve përkatëse, autoriteteve dhe partnerëve në vendet e tyre përkatëse.

Aktorët e përfshirë në listat e dhëna nga shtetet partnere, partnerët e projektit, abonentët e buletinit ADRION dhe organet e programit janë ftuar për t'iu përgjigjur anketës nëpërmjet një *e-maili*. *E-maili* ka përfshirë një shënim të shkurtër shpjegues dhe *link-un* në faqen e internetit të programit për hyrje në konsultim. Janë rikujtuar disa herë gjatë periudhës së konsultimit.

Vlera kryesore e shtuar e partneritetit në përgatitjen e programit të bashkëpunimit

Në përgatitjen e programit të bashkëpunimit, vlera kryesore e shtuar e partnerëve ka qenë të sigurojë informacion të detajuar mbi prioritetet dhe veprimet koherente të pranueshme në nivel territorial për një gamë të gjerë të institucioneve

dhe organeve. Ajo ndihmon për të identifikuar prioritetet dhe për të renditur çështjet që duhet të merren në konsideratë në strategjinë e programit.

Partnerët ndihmuan gjithashtu për të identifikuar më mirë llojet e veprimeve, si dhe veprimet që duhet të mbështeten në çdo IP. Kjo ishte e nevojshme për të propozuar llojet e veprimeve operationale dhe të bazuara në nevojë, në gjendje të gjenerojnë rezultate konkrete dhe të matshme.

Rezultatet kryesore të konsultimit me partnerët

Renditja e Objektivave Tematikë (OT) është në përgjithësi në përputhje me paraseleksionimin e kryer nga Task-Forca, OT1 (kërkimi), OT6 (mjedisi), i cili konsiderohet tepër i rëndësishëm për zonën ADRION, ndjekur nga OT10 (arsimimi) dhe OT7 (transportet), të cilat renditen të 3-të dhe të 4-t.

OT4 (i karbonit të ulët) është pozicionuar si objektivi i 7-të, por konsiderohet shumë më tepër i rëndësishëm nga të anketuarit. Duhet të theksohet se, edhe pse OT9 (përfshirja sociale) renditet e fundit, diferenca midis kreut dhe fundit të listës është rreth 5%, pasi asnjë prej OT-ve nuk konsiderohet disi relevant apo i padobishëm.

OT11 (qeverisja) renditet e 5-ta në lidhje me veprimet e propozuara, disa tema janë identifikuar si “përmirësimi i kapaciteteve administrative dhe të qeverisjes” ose “forcimi i rolit të grupimeve tematike” dhe “rritja e qeverisjes së shumë niveleve” në një total prej 16 kontribute të veçanta, ndërsa vëmendja për “trajnimin dhe arsimimin” (OT11) për ngritjen e kapaciteteve është çmuar e rëndësishme nga palët e interesuara.

Në lidhje me preferencat e prioriteteve të investimeve (PI-ve), rezultatet për kategori janë në përgjithësi në përputhje me zgjedhjet e bëra nëpërmjet pyetjes në lidhje me zgjedhjen e OT-ve:

OT1 - Kërkimi: PI 1.a dhe 1.b: pavarësisht nga të anketuarit nga kategoria “të tjera”, inovacioni renditet i pari, si agjencitë e kërkimit, arsimit dhe zhvillimit/OJQ-të në veçanti. Diferenca midis dy PI-ve është kufizuar në (8% mesatarisht).

OT4 - Karboni i ulët: PI 4.c dhe 4.e: Rezultatet janë pak më të ndryshme. Efikasiteti është renditur i pari në krahasim me PI urbane, por janë identifikuar disa dallime midis kategorive të



të anketuarve të orientuar si të anketuarit e fitimit, mesatarisht, PI urbane identifikohet si më e rëndësishme se efikasiteti një dhe, për të anketuarit jashtë zonës së Programit, të dy PI-të janë njëlojtë të rëndësishme.

OT6 - Mjedis PI 6.c, 6.d dhe 6.e: Të anketuarit priren në mënyrë të njëlojtë nga trashëgimia dhe biodiversiteti i PI-ve, ndërsa mjedisi urban renditet i dyti. Aksi Prioritar (AP) vendor, hulumtimi/kërkimi organet e arsimit dhe dhomat e tregtisë, sindikatat dhe shoqatat privilegjojnë PI e trashëgimisë, ndërsa AP qendror/rajonale, agjencitë e zhvillimit/OJQ-të, të anketuarit e orientuar nga fitimi, si dhe të tjerë kanë zgjedhur më tepër prioritetin e biodiversitetit. PI urbane nuk është renditur kurrë i pari ndër tri zgjedhjet në dispozicion, por AP vendor, kërkimi dhe organet arsimore e klasifikuan atë të dytin menjëherë pas prioritetit të trashëgimisë.

OT7 - Transporti: PI lidhur me OT7 konsiderohet tepër i rëndësishëm nga pothuajse të gjitha kategoritë e të anketuarve, përveç atyre nga autoritetet qendrore/rajonale, kërkimit dhe arsimit të zonës, të cilat e konsiderojnë të rëndësishëm.

Në përgjithësi, lista prioritare e tre (3) PI-ve përbëhet nga:

- PI 1.b inovacioni (OT1);
- PI 1.a infrastruktura (OT1);
- PI 7.c transporti (OT7), edhe pse prioriteti i vetëm në OT7, mund të ndikojë në renditjen si një zgjedhje e vetme, i disponueshëm.

Në bazë të rezultateve të konsultimit, Task-Forca ka rënë dakord të fokusohet te strategjia e programit në vetëm 3 OT dhe të përfshijë disa nga zonat e ndërhyrjes që mbulohen nga OT4 (karboni i ulët, si efikasiteti i energjisë) si fokus potencial horizontal nën AP1 dhe AP3.

Përmirësimi i kapaciteteve administrative dhe të qeverisjes, madje edhe në qoftë se trajtohen në mënyrë specifike nga OT11, do të konsiderohet si një temë e tërthortë për të gjitha Akset Prioritare si OT10.

Përkrahja e përfshirjes së partnerëve në zbatimin e programit të bashkëpunimit dhe përfshirjes në KM

Përfshirja e partnerëve përkatës në zbatimin e Programit ADRION parashikohet për arsyet e mëposhtme:

- Për të rritur pronësinë midis partnerëve të programit, në mënyrë që të përdorin njohuritë dhe ekspertizën e këtyre partnerëve, si dhe të rritjes së transparencës në proceset vendim-marrëse;

- Për të përmirësuar koordinimin me Fondet Europiane Strukturore dhe të Investimit (ESIF) dhe fondet IPA II, si edhe me instrumentet e rëndësishme të financimit nën kujdesin e Kornizës së Përbashkët Strategjike (CSF) dhe strategjitë makrorajonale.

- Për shkak të zonës së madhe të mbuluar nga programi, **pjesëmarrja** e partnerëve përkatës në program - KM - sipas neneve 5 (2) dhe 47 të Rregullores (EU) nr. 1303/2013 - **do të organizohet nëpërmjet komiteteve kombëtare të koordinimit apo mekaniz-mave/organeve të tjera** (siç parashikohet nga rregullat kombëtare përkatëse) që përgatisin dhe mbështesin anëtarët e KM-së në ekzekutimin e detyrave të KM-së, përfshi përgatitjen e thirrjeve për propozime dhe raportet e progresit të programit, si edhe monitorimin dhe vlerësimin e programit.

Seksioni 6. Koordinimi

(Referenca: pika (a) e nenit 8(5) e Rregullores BTE)

Koordinimi me fondet e tjera si ESI (ERDF, ESF, Fondi i Kohezionit, EAFRD, EMFF), veçanërisht në lidhje me programet bazë të Investimeve për Nxitjen e Zhvillimit dhe Punësimin

Në përputhje me nenin 10 dhe shtojcën I të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 duhet të ndiqet koordinimi dhe përdorimi i sinergjiave me Fondet e tjera Europiane Strukturore dhe të Investimit (ESI), si edhe me politikën, strategjitë dhe instrumentet e tjera përkatëse të Bashkimit Europian, përfshi ato në kuadër të shteteve anëtare dhe Veprimet e Jashtme të BE-së. Ky seksion jep një pasqyrë mbi parimet e ndjekura për zbatimin e Programit ADRION në mënyrë plotësuese dhe të koordinuar me instrumentet dhe fondet përkatëse, në përputhje me parimet e subsidiarititetit dhe proporcionalitetit.

Për hartimin e Programit ADRION, zgjedhja e OT-ve, PI-ve dhe OS-ve ka marrë parasysh prioritetet e theksuara në marrëveshjet e partneritetit të shteteve partnere të BE-së dhe Dokumentin Strategjik të Vendit të shteteve



partnere të IPA-s të përfshira, si edhe sfidat kryesore të identifikuar në programet rajonale dhe kombëtare të Fondit për nxitjen e Zhvillimit dhe Punësimit.

Programet e Bashkëpunimit Territorial European (BTE) kanë potencial të madh për lehtësimin e zbatimit të programeve kombëtare dhe rajonale të mbështetura nga ERDF, ESF, Fondi i Kohezionit, EAFRD dhe EMFF, duke i lejuar palët e interesuara të trajtojnë sfidat dhe nevojat e përbashkëta përtej kufijve administrativë. Koordinimi dhe komplementariteti me fondet e tjera si Fondi European Struktural dhe i Investimit (ESIF) është thelbësor, veçanërisht në aspektin e planifikimit të investimeve dhe përgatitjen, që mund të realizohet në nivel rajonal dhe vendor në bazë të operacioneve të mbështetura nga Programi ADRION.

Programi ADRION do të kërkojë koordinim nëpërmjet masave të mëposhtme:

- Aplikantët, që propozojnë veprime me fokus përgatitjen e investimeve, do të duhet të shpjegojnë se si të lidhen me programet e tjera kombëtare dhe rajonale të Fondit të Investimit për nxitjen e Zhvillimit dhe Punësimit mbështetur nga ERDF dhe ESF, si edhe me Fondin e Kohezionit, EAFRD (në veçanti referuar iniciativës Leader) dhe programet EMFF.

- Komitetet e koordinimit kombëtar (ose mekanizmat/organt e tjera, siç parashikohet nga rregullat kombëtare), që mbështesin anëtarët e KM-së (siç përshkruhet në nenin 5.6) përfshijnë përfaqësues nga institucionet që marrin pjesë në zbatimin e programeve kombëtare dhe rajonale mbështetur nga fondet e ESI-it, duke kërkuar (në shkallën më të mundshme) të arrijnë koordinimin në të gjitha fazat e jetës së programit.

- Autoriteti Menaxhues (AM) dhe Sekretariati i Përbashkët (SP), në bashkëpunim me rrjetin e Pikave të Kontaktit Kombëtar (PKK-ve) të ADRION-it do të komunikojnë përfundimet dhe rezultatet e operacioneve ADRION përmes mjeteve dhe masave përkatëse të zbatuara si në nivel transnacional edhe kombëtar, siç përcaktohet në strategjinë e komunikimit të programit.

- Për sa i përket koordinimit me fondet e tjera ESI, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mundësisë së sinergjive me programet e tjera të

objektivit të BTE-së. Në këtë drejtim, Programi ADRION do të kërkojë shkëmbime me autoritetet drejtuese të programeve të tjera BTE të mbivendosura gjeografikisht. Koordinimi efikas me këto programe fqinje transnacionale realizohet nëpërmjet:

- shkëmbimit të informacionit **gjatë vlerësimit të aplikimeve** për të zbuluar dhe për të shmangur mbivendosjet dhe dublikimet e mundshme, si edhe për të aktivizuar sinergjitë ndërmjet operacioneve plotësuese që zbatohen në fusha të ndryshme të bashkëpunimit;

- shkëmbimit të informacionit **gjatë monitorimit të zbatimit** të operacioneve të miratuara, me synimin për të përforcuar veprimet e përziera (përfshirë ngjarjet dhe trajnimet për përfituesit), të cilat lejojnë shpalosjen e sinergjive ndërmjet operacioneve që trajtojnë të njëjtat sfida dhe që trajtojnë nevojat për secilin aktor të vendosura në fusha të ndryshme të bashkëpunimit; dhe

- përdorimi i **fleksibilitetit gjeografik**, siç parashikohet në nenin 20 (2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, që lejon zhvillimin e operacioneve transnacionale me një shtrirje gjeografike që shkon përtej zonës së Programit, duke krijuar kështu lidhje, krijimin e mundësive dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm brenda dhe jashtë zonave që ndajnë tipare të përbashkëta (p.sh., korridore dhe rajone makro).

Koordinimi me Instrumentet e tjera të Bashkimit European (Horizon 2020, LIFE, CEF, COSME, Erasmus për të gjithë, Azil, Fondi për Migrimin dhe Integrimin, Programi për ndryshimet sociale dhe inovacionin etj.)

Koordinimi midis programeve BTE dhe instrumenteve të tjera të Bashkimit European ka potencialin të rrisë ndikimin e politikave të BE-së në nivelin kombëtar dhe rajonal, që mbështesin investimet vendore, rajonale dhe kombëtare dhe që në mënyrë efektive kontribuojnë në strategjinë EU 2020. Ky potencial është veçanërisht i dukshëm në fushat tematike të mëposhtme të trajtuara nga Programi ADRION:

- Kërkimi, inovacioni dhe sipërmarrja, ku operacionet e bashkëpunimit transkombëtar mund të përgatisin dhe të rrisin kapacitetet e sistemeve rajonale të inovacionit, duke hapur rrugën për ekselencën në kërkim dhe inovacion



dhe duke përgatitur kështu një terren pjellor për programet Horizon 2020 dhe Cosme. Projektet ADRION mund të përfshijnë gjithashtu edhe “aksionet e drejtpërdrejta” për të shfrytëzuar rezultatet e K&I nga Horizon 2020 dhe programet e mësipërme, me theks të veçantë në krijimin e një mjedisi miqësor për inovacionin e biznesit dhe industrisë, përfshi edhe SME-të. Për Cosme, programi parashikon “Aksione të tërthorta” për të përgatitur SME-të për të hyrë në kushte më të mira për krijimin e biznesit & zhvillimit.

- Një përshkrim më i hollësishëm do të jepet në bazë të termave të referencës të thirrjeve ADRION sipas çdo Aksi Prioritar (AP) dhe Objektivave Specifike (OS-ve). Në të njëjtën kohë, kjo do të kontribuojë në zbatimin efektiv të kornizave të politikave strategjike kombëtare dhe/ose rajonale për kërkimin dhe inovacionin në kontekstin e strategjive të specializimit.

- Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, ku operacionet e bashkëpunimit transnacional mund të ndërtojnë kapacitete dhe të përmirësojnë gatishmërinë e rajoneve për të zhvilluar dhe aplikuar zgjidhje novatore për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin, eficiencën e burimeve për zbutjen dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, duke plotësuar veprimet e programeve LIFE dhe Horizon 2020.

- Transporti, ku operacionet e bashkëpunimit transnacional mund të stimulojnë investime në lidhjet rajonale, duke mbyllur boshllëqet që po ndikojnë rajonet e largëta kur ka akses në korridoret TEN-T dhe, në këtë mënyrë, duke plotësuar veprimet e Instrumentit të Financimit (CEF). Për më tepër, duke pasur parasysh se programi ADRION synon të trajtojë çështje si transporti detar dhe infrastruktura portuale, do të verifikohet një komplementaritet i veçantë me Fondin për Sigurinë e Brendshme - Kufijtë dhe Vizat, përmes të cilit BE-ja siguron mbështetje për menaxhimin e kufirit të shteteve anëtare të BE-së dhe sistemet e mbikëqyrjes detare kufitare në rajonin e Programit.

Programi ADRION do të kërkojë koordinim nëpërmjet masave të mëposhtme:

- Kur paraqesin propozime, aplikantët do të duhet të përshkruajnë koherencën dhe komplementaritetin me instrumentet e tjera të Bashkimit European që kanë lidhje me temat e

trajtuara nga propozimet. Do të duhet të provohet dëshmia e vlerës së shtuar e sjellë nga bashkëpunimi transkombëtar në mënyrë të veçantë në lidhje me Horizon 2020, COSME, LIFE, CEF, Europa Krijuese dhe ERASMUS për të gjithë. Koherenca me instrumentet e përmendura më lart, që do të përshkruhet nga aplikantët, do të bazohet edhe në programet shumëvjeçare dhe punën vjetore, si edhe udhëzimet e zhvilluara në këto instrumente.

- Shkëmbimet me/dhe këshillat nga shërbimet e Komisionit European dhe institucionet e tjera europiane dhe kombëtare të përfshira në menaxhimin e instrumenteve të Bashkimit European do të kërkojnë nga AM dhe SP, për të shkëmbyer praktikën e mira dhe për të përhapur bashkërisht informacionin që synon palët e interesuara të përbashkëta përkatëse. Është vërejtur një potencial i veçantë për të aktivizuar sinergjitë me tematikën e DG-ve të Komisionit European (veçanërisht në fushat e K&Zh, zhvillimin e SME-ve dhe sipërmarrjes, Turizmit, Mjedisit, Energjisë) dhe me agjencitë europiane;

- Mjetet e komunikimit dhe masat do të vihen në funksionim nga ana e AM dhe SP, në bashkëpunim me rrjetin e PKK-ve për të lejuar komunikimin mbi produktet dhe rezultatet e arritura nga operacionet ADRION, për t'i vënë ato në dispozicion të palëve të interesuara tematike të trajtuara nga instrumentet e Bashkimit European. Kur është e aplikueshme, PKK-të e programeve të BE-së (p.sh., LIFE, Horizon 2020 etj.) do të përfshihen drejtpërdrejt në evenimentet kombëtare dhe transnacionale informuese të organizuara nga Programi.

- Për më tepër, Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor mund të jetë një instrument i mëtejshëm financiar që mund të përfshihet në koordinim.

Koordinimi me CEF, ENI, IPA dhe EDF

Në mënyrë që të forcojë dimensionin e tij ndërkombëtar dhe për të përmirësuar bashkëpunimin me programet e tjera, si: Balkan Med, MED, Danubi që përfshin vendet e IPA II do të merren parasysh objektivat dhe rezultatet e këtyre programeve gjatë zbatimit të aktiviteteve të kapitalizimit, projektet strategjike dhe vetëvlerësimi.

Programi ADRION do të kërkojë koordinim me ENI CBC MED dhe programin Alpine Space



nëse është e rëndësishme për disa nga zonat përfituese.

Koordinimi do të zbatohet përmes masave të mëposhtme:

- AM-të dhe SP-të e programeve ENI dhe IPA/CBC do të trajtohen nga programi ADRION për përmirësimin e shkëmbimit të informacionit mbi aplikimet dhe operacionet e miratuara, për të aktivizuar sinergjitë midis operacioneve komplementare që janë duke u zbatuar në kufijtë e jashtëm të BE-së.

- Duke marrë parasysh edhe zbatimin e ardhshëm të programeve IPA II Zhvillimi Rural (IPARD II) në Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi, programi ADRION do të sigurojë që mbivendosjet ndërmjet aktiviteteve të financuara nga programet përkatëse (ADRION nga njëra anë dhe programet IPARD në anën tjetër) të shmangen dhe të gjitha komplementaritetet potenciale të vlerësohen.

Koordinimi me instrumentet përkatëse të financimit kombëtar që kontribuojnë për objektivat e ngjashëm ose të njëjtë si programi i bashkëpunimit apo që plotësojnë ndërhyrjet e tij

Operacionet transnacionale të mbështetura nga programi ADRION kanë potencialin të përmirësojnë zbatimin e politikave kombëtare, rajonale dhe vendore.

Programi ADRION do të kërkojë koordinimin me instrumentet përkatëse kombëtare të financimit duke krijuar masat e mëposhtme:

- Kur paraqesin propozimet, aplikantët do të duhet të përshkruajnë koherencën dhe komplementaritetin me politikat kombëtare dhe instrumentet e financimit, në formatin e aplikimit, duke dhënë prova të vlerës së shtuar e sjellë nga bashkëpunimi transkombëtar.

- Komitetet e koordinimit kombëtar (ose mekanizmat/organet e tjera, siç parashikohet nga rregullat kombëtare) që mbështesin anëtarët e KM-së, do të përfshijnë në masën e mundshme përfaqësues të institucioneve të përfshirë në ngritjen dhe/ose zbatimin e instrumenteve kombëtare, rajonale dhe vendore të financimit për të garantuar informacion të ndërsjellë veçanërisht në lidhje me produktet dhe rezultatet e operacioneve transnacionale që mund të mbështesin zbatimin efektiv të politikave

kombëtare, rajonale dhe vendore dhe instrumentet e financimit.

Koordinimi me Bankën Europiane për Investim

Bashkëpunimi transnacional mund të kontribuojë në përgatitjen e rezultateve të operacioneve për përfitimin nga instrumentet e Bankës Europiane të Investimit (BEI), si në aspektin e përgatitjes teknike edhe në kryerjen e investimeve në shkallë të gjerë (d.m.th., për t'i bërë ato “të besueshme”). Sinergjitë mund të aktivizohen veçanërisht në fushat tematike të mëposhtme të trajtuara nga programi ADRION:

- Infrastruktura, ku instrumenti i BEI “Asistenca e përbashkët për të ndihmuar projektet e Rajoneve Europiane”(JASPERS) mund të mbështesë realizimin e investimeve në shkallë të madhe të përgatitura nga projekte të bashkëpunimit, veçanërisht në sektorët e transportit dhe mjedisit.

- Energjia, ku instrumenti i BEI “Asistenca Europiane për Energi Lokale”(ELENA) mund të çojë përpara arritjet e projekteve të bashkëpunimit që përgatisin efikasitet të madh të energjisë dhe projekte të energjisë së rinovueshme në nivel lokal dhe rajonal.

Përveç përgatitjes së investimeve, sinergjitë mund të aktivizohen në fushën e sipërmarrjes, ku operacionet e bashkëpunimit transkombëtar mund të lehtësojnë aksesin në instrumentin BEI “Burimet e Përbashkëta Europiane për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme” (JEREMIE) përmes dijës dhe ndërtimit të kapaciteteve të sipërmarrësve dhe institucioneve publike.

Veç kësaj, Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor mund të jetë një instrument i mëtijshëm financiar që do të përfshihet në koordinim.

Seksioni 7 - ulja e barrës administrative për përfituesit

(Referenca: pika (b) e nenit 8(5) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 dhe Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) nr. 481/2014, e 4 marsit 2014, që plotëson Rregulloren (BE) nr. 1299/2013.

Vlerësimi i barrës administrative

Një grup rregullash të lehta dhe procedura të thjeshta të administratës janë parakushte për një program efektiv që nxit ndryshimet e pritshme në



zonën e Adriatikut dhe Jonit. Kjo e bën reduktimin e barrës administrative një objektiv kyç.

Kërkesat e menaxhimit dhe kontrollit të zbatueshme për fondet strukturore kanë nevojë për një trajtim të kujdesshëm të proceseve të shpenzimeve publike dhe për këtë arsye duhet të arrihet ekuilibër i mirë ndërmjet thjeshtësisë dhe kontrollit përmes:

- Të mësuarit nga përvojat e periudhës së mëparshme të programimit nga të gjitha programet e tjera BTE;

- Shfrytëzimi deri në masën e mundshme të opsioneve të thjeshtësuara të kostos në dispozicion për periudhën 2014-2020 (nëse pranohen dhe zbatohen nga kontrolluesit kombëtarë);

- Shfrytëzimi i mjeteve të harmonizuara për zbatimin e programit (HIT) zhvilluar nga programi INTERACT në bashkëpunim me programet BTE për të thjeshtuar dhe bërë më efikas zbatimin e programit.

Veprimet e planifikuara për të zvogëluar barrën administrative do të mbështeten kryesisht në zbatimin e një sistemi për shkëmbimin e të dhënave në përputhje të plotë me kërkesat e kohezionit përshkruar në seksionin 5. Ato mbulojnë të gjitha fazat e ciklit të projektit, siç përshkruhet më poshtë.

Veprimet kryesore të planifikuara për të arritur zvogëlimin/reduktimin e barrës administrative - Pranueshmëria formale e aplikimeve

Kërkesat formale/administrative të pranueshmërisë për aplikimet sigurojnë një pjesë të konsiderueshme të aplikimeve (rreth 20%) të paraqitura në programin BTE 2007-2013 (si të papranueshme).

Thjeshtimi i procedurës së paraqitjes të aplikimit mund të zvogëlojë konsiderueshëm përqindjen e aplikimeve të papranueshme për shkaqe formale/administrative dhe për këtë arsye të rrisë efikasitetin e procesit. Kjo mund të arrihet me integrimin e informacionit udhëzues brenda formularit të aplikimit, i cili më parë jepej në dokumente të veçanta. Veç kësaj, paraqitja e kërkesave/aplikimeve dhe dokumenteve shoqëruese mund të bëhet në mënyrë elektronike, me sigurimin e kopjeve të nënshkruara vetëm kur një aplikim propozohet për financim. Modeli i

formatit të aplikimit do të mbështetet në modelin HIT, duke e bërë kështu përdorimin e tij më të lehtë për aplikantët që gjejnë forma të ngjashme të aplikimit në programe të ndryshme BTE.

Rregullat e harmonizuara të pranueshmërisë dhe linjat e buxhetit

Në periudhën e programimit 2007-2013, një nga shkaqet kryesore të barrës së lartë administrative për përfituesit ishte mungesa e rregullave të harmonizuara të pranueshmërisë dhe përcaktimit të linjës së buxhetit.

Sipas nenit 17 (1) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 dhe Rregullores të Deleguar (BE) nr. 481/2014), Komisioni Europian ka nxjerrë rregulla specifike mbi përshtatshmërinë e shpenzimeve bazuar kryesisht në një grup prej pesë linjash buxhetore të zbatueshme për të gjitha programet BTE si vijon:

1. shpenzimet e personelit;
2. shpenzimet administrative dhe zyrës;
3. shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit;
4. kostot e ekspertizës së jashtme dhe shërbimeve;
5. shpenzimet për pajisjet.

Në përcaktimin e rregullave të programit do t'i kushtohet vëmendje e veçantë “shpenzimeve të stafit”, si edhe “shpenzimeve administrative dhe të zyrës”, për të cilat janë në dispozicion disa opsione thjeshtëzimi. Veçanërisht në lidhje me shpenzimet e stafit, rregullat e mësipërme të pranueshmërisë përmbajnë opsione të konsiderueshme thjeshtimi që kanë të bëjnë me kërkesat e llogaritjes dhe dokumentacionit (neni 67 dhe 68 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013).

Veç kësaj, neni 18 (3) i Rregullores (BE) nr. 1299/2013 përcakton një hierarki të re të rregullave të pranueshmërisë, me rregullat e programit që specifikojnë se çfarë nuk është përcaktuar në rregullat në nivel kombëtar dhe të BE-së, duke specifikuar vetëm atë që nuk mbulohet nga BE ose rregullat e programit.

Duke marrë parasysh përvojën e periudhës së programimit 2007-2013, menaxhimi i shëndoshë financiar kërkon që të gjitha sistemet kombëtare të kontrollit të nivelit të parë të përdorin modelet e përbashkëta të zbatimit dhe elementet e thjeshtuara në llogaritjen e kostove.

Organet përgjegjëse për kontrollin e shkallës së parë në shtetet partnere të ndryshme mbajnë takime të rregullta koordinuese në lidhje me



zbatimin e rregullave të përbashkëta të pranueshmërisë, opsionet e thjeshtësuara të kostos dhe mjetet e harmonizuara. Këto takime mbahen për të përmirësuar cilësinë e kontrolleve dhe për të reduktuar mospërputhjet e mundshme në zbatimin e rregullave të përbashkëta.

Përmirësimi i zbatimit të projektit të monitorimit

Sipas analizës tjetër të programit BTE 2007-2013 janë vërejtur një numër mangësish në sistemin e monitorimit dhe raportimit:

- Mungesa e një sistemi të paracaktuar raportimi nga partnerët e projektit te partnerët e tyre lider (Përfituesi Kryesor), çka ndonjëherë (veçanërisht për partnerët kryesorë me më pak përvojë) ka rezultuar në zgjatjen e afateve kohore të nevojshme për hartimin e raporteve.

- Analiza e të gjitha rezultateve (përfshi edhe ato më të voglat) të operacioneve të kryera nga AM ka rezultuar në një barrë të lartë për përfituesit, me zgjatjen e kohës së nevojshme për analizimin e raporteve dhe rimbursimin pasues.

- Indikatorët e përdorur për monitorimin e progresit të operacioneve, të cilët kanë qenë të vështirë për t'u kuptuar dhe për t'u interpretuar.

- Në bazë të përvojës së kaluar dhe duke marrë parasysh faktin se qasja e "orientuar/ose vlerësuar sipas rezultatit" që karakterizon thirrjet për propozime për një vëmendje edhe më të madhe për monitorimin e arritjeve tematike të operacioneve, programi ADRION synon të ndërtojë një sistem për monitorimin e progresit të operacioneve me përmirësimet e mundshme nëpërmjet veprimeve të mëposhtme:

- Të shfrytëzohen modelet e harmonizuara të raportit të progresit (d.m.th., mjetet e harmonizuara të zbatimit) në një sistem të bazuar në internet, në mënyrë që të lejohen në shkallë maksimale përdoruesit e shumtë;

- Të fokusohet te analiza e rezultateve kryesore të operacioneve, duke zhvendosur analizën e rezultateve më të vogla (p.sh., agjendat e takimeve) kryesisht te kontrollorët kombëtarë;

- Të kufizohet në masën maksimale numri dhe kompleksiteti i indikatorëve që përdoren për raportimin mbi progresin e operacioneve;

- Të organizohen trajnime të posaçme për përfituesit mbi raportimin e operacioneve, kontrollin dhe auditimin.

Veprimet për përmirësimin e monitorimit të progresit të operacioneve do të vihen në përdorim që nga fillimi i zbatimit të programit, mundësisht në kohën e miratimit të operacioneve të paraqitura në kuadër të thirrjes së parë për propozime.

Seksioni 8 - Parimet horizontale

(Referenca: Neni 8(7) i Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

8.1 Zhvillimi i qëndrueshëm

Zhvillimi i qëndrueshëm risillet dhe integrohet në AP2 si një parim horizontal në Programin ADRION. Ai do të respektohet gjatë tërë ciklit të programit (programim, zbatim, monitorim dhe vlerësim). "Zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre" (ËCDE, ËCED) do të jetë përkufizimi themelor që do të përdoret për zgjerimin e pikëpamjes nga thjesht mjedisore në një qasje më të gjerë, që përfshin brenda socialen dhe barazinë ndër breza, aspekte të trashëgimisë kulturore, si dhe efikasitetin ekonomik. Aktivitetet e programit do të kenë lidhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm - OKB (që vijnë pas Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit në vitin 2015) dhe do të ngrihet një sistem monitorimi.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) dhe vlerësimi *ex-ante* kanë dhënë kontribut për të siguruar që programi ADRION respekton parimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Programi ka për qëllim përmirësimin dhe harmonizimin e kërkesave të mbrojtjes së mjedisit, efikasitetin e burimeve, zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe adaptimin ndaj tyre, sistemet për parandalimin dhe përballimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore në të gjithë vendet e partnerëve. Lufta kundër pasojave të ndryshimeve klimatike, ulja e ndikimit të aktiviteteve njerëzore mbi mjedisin dhe mbrojtja e ekosistemeve dhe biodiversitetit mbështeten nga PI-të 6.c dhe 6.d.

Gjithashtu, në mënyrë të tërthortë, përfituesve u kërkohet të nxitin ekoinovacionet me qëllimin për të bërë një përdorim më të qëndrueshëm të burimeve natyrore sipas të gjitha Akseve Prioritare (AP-ve). Më saktësisht, përfituesve u kërkohet të përshkruajnë në projektpropozimet e tyre përpjekjet që ata do të ndërmarrin për të



zvogëluar “gjurmë të karbonit” (sasia e dyoksidit të karbonit të emetuar nga konsumimi i lëndëve djegëse fosile) në projekt. Organet e Programit (KM, AM, SP, PKK-të) do të trajtojnë këtë çështje në lidhje me zbatimin e detyrave të tyre.

Në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, zbatimi i projekteve vlerësohet duke përdorur kriteret e mëposhtme:

- Projektet të cilat kanë një efekt pozitiv në mjedis ose të cilat konservojnë, rrisin apo rehabilitojnë kapacitetet ekzistuese, do të preferohen më shumë se ato që janë neutrale nga kjo perspektivë;

- Projektet që kanë një efekt potencialisht të dëmshëm në mjedis do të përjashtohen;

- Veprimet e përcaktuara për të rritur ndërgjegjësimin dhe pajtueshmërinë me mjedisin si brenda sektorëve ekonomikë dhe administrativë, dhe midis publikut të gjerë, përfshi edhe pranimin se një nivel i lartë i performancës mjedisore mund të sigurojë avantazh konkurrues afatgjatë, do të mbështeten.

Për procesin e vlerësimit të projektit do të konsiderohen si udhëzim aspektet e mëposhtme:

- Kontributi për efikasitetin e përdorimit të burimeve (p.sh., efikasiteti i energjisë, përdorimi i energjisë së rinovueshme, reduktimi i gazit serrë (GHG), furnizimi eficient i ujit, trajtimi i ujërave të zeza dhe ripërdorimi i ujit, përdorimi i qëndrueshëm i tokës, menaxhimi i mbetjeve/mbeturinave dhe riciklimi, reduktimi i grimcave (PM dhe NO₂ etj.);

- Kontributi në zhvillimin e infrastrukturave të gjelbra;

- Kontributi për zhvillimin e qëndrueshëm e të integruar urban dhe rajonal;

- Kontributi për ndërgjegjësimin më të mirë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe parandalimin e rrezikut;

- Promovimi i mundësive për punësim, arsimim, trajnim dhe shërbime mbështetëse në kontekstin e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Formulari i kërkesës përmban një mjet vetëvlerësimi për të vlerësuar ndikimet mjedisore të projekteve përgjatë procesit të tyre të përzgjedhjes. Projektet me ndikim të rëndësishëm negativ mjedisor mund të përjashtohen nga vlerësimi i mëtejshëm. Temat e identifikuara

mjedisore janë objekt i monitorimit duke pasur parasysh specifikat dhe qëllimet e bashkëpunimit transkombëtar.

Nëse projektet kanë të bëjnë drejtpërdrejt me çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm ose jo, ata ftohen të zbatojnë veprime/ose të marrin masa specifike për të reduktuar ndikimin mjedisor. Kjo mund të përfshijë, për shembull:

- Përdorimin e videokonferencave për të reduktuar udhëtimin/lëvizjen;

- Publikimet mbi certifikimin nga FLC (Këshilli për Mbikëqyrjen e Pyjeve);

- Përdorimin e procedurave të prokurimit publik “të gjelbër” dhe prokurimin inovativ publik sipas rastit;

- Përdorimin e zinxhirëve të shkurtër të furnizimit në realizimin e aktiviteteve të projekteve;

- Rritjen e ndërgjegjësimin të partnerëve, përfituesve dhe grupeve të synuara për çështjet e qëndrueshmërisë;

- Promovimin e aktiviteteve me përdorim të kufizuar të energjisë dhe burimeve natyrore.

Teknika të ngjashme merren në konsideratë në nivel programi për menaxhimin dhe monitorimin e aktiviteteve.

Veç kësaj, masat lidhur me thjeshtësimin dhe reduktimin e pengesave administrative të përmendura në pjesën 7.2 të programit të bashkëpunimit kanë mundësi të pakësojnë ndikimin mjedisor të programit përmes përdorimit të komunikimit elektronik dhe reduktimit të konsumit të letrës.

Udhëzime më të hollësishme se si të interpretohen parimet kryesore të përshkruara në ThP mund të sigurohen në Termat e Referencës së çdo thirrjeje për propozime.

8.2 Mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimi

Mosdiskriminimi mbulon jo vetëm femrat (dhe meshkujt), por çdo diskriminim në bazë të origjinës racore apo etnike, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual. Ndonëse legjislacioni antidiskriminues është një aspekt i kërkuar i sistemeve ligjore të BE-së, zbatimi praktik i praktikave antidiskriminim mbetet prapa. Qasja e barabartë në informacion dhe kontrollet nëse kërkesat e barazisë dhe të mosdiskriminimit janë duke u përmbushur është gjithashtu një çështje.



Strategjia e Programit vë theksin në shkëmbimin e njohurive, praktikave të mira dhe parimin e qasjes së barabartë në informacion. Kjo përfshin grupe të ndryshme shoqërore të synuara në mënyrë adekuate; heqjen e pengesave në komunikimin e Programit (p.sh., media, gjuha etj.), që promovojnë qasjet pa pengesë etj.

Ky orientim strategjik i Programit do të rritet nga përzgjedhja e synuar e operacioneve. Kur shqyrtohen propozimet, duhet të vlerësohet - sipas rastit – “pyetja udhëzuese” e mëposhtme: *A po kontribuon operacioni në promovimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit?* Kujdes do t'i vihet mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit përmes përfshirjes së treguesve përkatës lidhur me profilin e personave të përfshirë në projekte, p.sh., të gjinisë, prejardhjes etnike, moshës, profesioni dhe niveli i arsimimit, aftësive të kufizuara etj.

Megjithatë nuk do të ketë dënim për projektet që promovojnë jo në mënyrë aktive mosdiskriminimit dhe mundësitë e barabarta, operacionet e tyre do të analizohen në bazë të konkluzioneve të monitorimit dhe identifikimit të pengesave të hasura.

Ky orientim strategjik i programit ADRION mund të rritet nga përzgjedhja e synuar e operacioneve. Kur shqyrtohen propozimet, duhet të vlerësohet - sipas rastit – “pyetja udhëzuese” e mëposhtme: *A po kontribuon operacioni në promovimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit?*

Vlerësimi i cilësisë së propozimeve të pranueshme të projektit do të bazohet në një sërë kriteresh të cilësisë që janë të përbashkëta për të gjitha AP-të dhe PI-të. Në përzgjedhjen e projekteve, si udhëzues për vlerësuesit mund të konsiderohen aspektet e mëposhtme indikative:

- Shqyrtimi i nevojave të ndryshme dhe ndikimi i qëllimshëm dhe i paqëllimshëm i projektit mbi grupe të ndryshme (p.sh., njerëzit me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe migrantët, njerëzit e besimeve të ndryshme fetare dhe njerëzit e orientimeve të ndryshme seksuale etj.);

- Shqyrtimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit në zbatimin e projektit si, p.sh., në lidhje me krijimin e një plani veprimi të mundësive të barabarta, përcaktimi i objektivave të mundësive të barabarta, sigurimi i mundësive të barabarta të trajnimit ose kurse të ndryshme menaxhimi, sigurimi i shërbimeve mbështetëse;

- Dispozitat për një qasje të barabartë në rezultatet e operacionit dhe përfitime për të gjithë anëtarët e shoqërisë.

8.3 Barazia midis burrave dhe grave

Qëllimi i barazisë midis grave dhe burrave është një nga vlerat themelore të Bashkimit Europian dhe është i përcaktuar në Traktatin e Bashkimit Europian (neni 8, Versioni i Konsoliduar i Traktatit për funksionimin e Bashkimit Europian, Gazeta zyrtare e Bashkimit Europian C 83/49 e 30.3.2010). Këto vlera themelore duhet të respektohen në rregulloret dhe zbatimin e programit, siç tregohet nga nevoja për të “siguruar se barazia midis burrave dhe grave dhe [se] përfshirja e perspektivës gjinore promovohen në përgatitjen dhe zbatimin e programeve” dhe se “[do të ndërmerren] ... hapat e duhur për të parandaluar çdo diskriminim në bazë të gjinisë, prejardhjes racore apo etnike, fesë ose besimit, paafësisë, moshës ose orientimit seksual gjatë përgatitjes dhe zbatimit të programeve” (neni 7, Rregullorja (BE) nr. 1303/2013, COM (2011) 615 final/2, Bruksel, 2012/03/14, f. 34).

Duhet t'u kushtohet vëmendje çështjeve themelore gjinore të ndjeshme, si p.sh.:

- Marrja parasysh e numrit të grave dhe burrave që marrin pjesë në projekte;

- Vlerësimi i numrit të grave dhe burrave që përfitojnë nga fondet;

- Vlerësimi se sa mbështetje dhe për cilat projekte gratë dhe burrat marrin fonde (e ndarë sipas llojeve të projektit/PI).

Vlerësimi i cilësisë së propozimeve të pranueshme të projektit do të bazohet në një sërë kriteresh të cilësisë që janë të përbashkëta për të gjithë Objektivet Tematikë (OT) dhe Prioritetet e Investimit (PI). Në përzgjedhjen e projekteve, si udhëzues për vlerësuesit mund të konsiderohen aspektet e mëposhtme të integritetit gjinor:

- Shqyrtimi i qëndrimeve të ndryshme fillestare të grupeve të synuara (ekzistenca dhe shtrirja e dallimeve midis grave dhe burrave dhe implikimet e këtyre dallimeve për fushën specifike të politikave etj.) dhe ndikimi i qëllimshëm dhe i paqëllimshëm i operacionit për këto grupe.

Vlerësimi se si dhe pse dallimet dhe pabarazitë janë të rëndësishme për ndërhyrjen e propozuar, duke identifikuar se ku ka mundësi për të ngushtuar këto pabarazi.



Seksioni 9. Elemente të veçanta

9.1 Projekte të mëdha që do të zbatohen gjatë periudhës së programimit

(Referenca: pika (e) e nenit 8(2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Nuk aplikohet.

9.2. Korniza e performancës së programit të bashkëpunimit

Tabela 24: Korniza e performancës së programit të bashkëpunimit (automatikisht i përfunduar në sistem)

AKSI PRIORITAR	ID	HAPI KYÇ I ZBATIMIT OSE INDIKATORI	NJËSIA E MATJES	ARRITJET TOTALE PËR 2018	OBJEKTIVI PËRFUNDIMTAR (2023)
AP 1	1.b.1	Financiar	EURO	1.969.166	19.691.658
AP 1	OL1 b	Numri i strategjive dhe planeve të veprimit të zhvilluara nga rrjetet dhe grupet transkombëtare të inovacionit	Numër	2	12
AP 2	6.c.d	Financiar	EURO	4.547.238	45.472.376
AP 2	6c.1	Numri i strategjive dhe planeve të veprimit të zhvilluara në fushën e trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe turizmit	Numër	3	30
AP 2	6d	Numri i strategjive dhe planeve të veprimit të zhvilluara në fushën e mbrojtjes së mjedisit.	Numër	2	15
AP 3	7c.1	Financiar	EURO	1.770.852	17.708.524
AP 3	OL7 c	Numri i strategjive dhe planeve të veprimit të zhvilluara në fushën e sistemeve të transportit të mjedisit të favorshëm dhe karbonit të ulët.	Numër	2	12,
AP 4	11.a	Financiar	EURO	977.599	9.775.995
AP 4	OL11	Numri i eventeve dhe takimeve të strukturave të qeverisjes EUSAIR dhe ngjarjet dhe takimet me autoritetet dhe palët e interesuara për të lehtësuar zbatimin EUSAIR	Numër	12	120



9.3. Partnerët përkatës të përfshirë në përgatitjen e programit të bashkëpunimit

Në total, 2.611 palë të interesuara dhe partnerë kanë marrë pjesë në procesin e konsultimit ADRION për përgatitjen e programit të bashkëpunimit. Këshillimet janë zbatuar me anë të një sondazhi *online* dhe nga dy evente tematike transnacionale.

Grupet e interesit, nga një gamë e gjerë prejardhjesh, u përfshinë në konsultime. Institucionet kërkimore dhe universitetet, si edhe autoritetet kombëtare/rajonale dhe publike vendore përbënin rreth 67% të të anketuarve të sondazheve transnacionale *online*. Në konferencën transnacionale të palëve të interesuara, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve kishin ardhur nga organizatat kërkimore, autoritetet publike, si dhe kompanitë private.

Veç kësaj është kryer një konsultim në zbatim të Direktivës VSM 2001/42/KE dhe me kërkesat përkatëse kombëtare (shih shtojcën A).

Detajet mbi konsultimin e partnerëve mund të gjenden në seksionin 5.6.

Vendet:	2611
Shqipëri	56
Bosnja & Hercegovina	83
Kroaci	264
Greqi	184
Itali	984
Slloveni	289
Serbi	216
Mali i Zi	275
Jashtë	260

Kategoritë:	2611
AP Qendror/Rajonal	874
AP Lokal/i brendshëm	310
Kërkimi dhe arsimi	586
Agjenci të zhvillimit/OJQ-të	438
Dhomat e Tregtisë, Sindikatat, Shoqatat (interesi ekonomik)	212
Ndërmarrje e orientuar drejt fitimit	130
Tjetër	61



9.4. Kushtet e zbatueshme të zbatimit të programit që rregullojnë menaxhimin financiar, programimin, monitorimin, vlerësimin dhe kontrollin e pjesëmarrjes së vendeve të treta në programet trans-kombëtare dhe ndërrajonale nëpërmjet kontributit të ENI-it dhe burimeve të IPA-s

(Referenca: Neni 26 i Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Në përgjithësi, rregullat e zbatueshme për përfituesit ERDF zbatohen edhe për përfituesit e IPA-s në lidhje me kushtet zbatuese për menaxhimin financiar, programimin, monitorimin, vlerësimin dhe kontrollin. Elementet e mëposhtme do të merren parasysh:

- Marrëveshjet e Financimit ndërmjet Komisionit Europian, AM-së dhe qeverive të Malit të Zi, Bosnje dhe Hercegovinës, Serbisë dhe Shqipërisë do të nënshkruhen lidhur me zbatimin e asistencës së IPA-s integruar në Programin ADRION;

- Marrëveshjet e lartpërmendura do të marrin parasysh rregullat specifike që do të zbatohen në përputhje me nenin 26 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013;

- Akti plotësues dhe dispozitat lidhur me procedurat kontraktuale për veprimet e jashtme të KE-së;

- Fondet IPA mund të shpenzohen vetëm në ose në dobi të shteteve partnere të IPA-s;

- Partnerët e IPA-s mund të bëhen Partnerë Kryesorë në projektet Adrion.

Autoritetet e programit, me mbështetjen e autoriteteve/organeve në vendet e IPA-s, sipas nevojave të tyre të veçanta, do të japin:

- a) Mbështetje për aplikuesit: sigurimi i eventeve të synuara drejtuar gjeneratës së projektit dhe paraqitja e propozimeve të projektit;

- b) Mbështetje për përfituesit: seminare të synuara për zbatimin, raportimin, rregullat e pranueshmërisë financiare dhe verifikimin e shpenzimeve të projektit;

- c) Mbështetje për kontrolluesit kombëtarë: dhënia e listave të plota të përbashkëta dhe seminareve të përbashkëta së bashku me kontrolluesit e shteteve të tjera partnere të përfshira në Program;

- d) Mbështetje për kapitalizimin e rezultateve.

SHTOJCAT

(të ngarkuara në SFC 2014 si skedarë të veçantë)

Projektraporti i vlerësimit *ex-ante*, me një përmbledhje ekzekutive;

(Referenca: Neni 55(2) i Rregullores (BE) nr. 1303/2013)

Raporti për Vlerësimin Strategjik Mjedisor;

Konfirmimi i marrëveshjes me shkrim për përmbajtjen e programit të bashkëpunimit;

(Referenca: Neni 8(9)) i Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Një përmbledhje e qytetarëve për programin e bashkëpunimit.

FJALOR

Vlera bazë

Çdo tregues/indikatori rezultati kërkon një bazë të vlerës (neni 6 i Rregullores (BE) nr. 1301/2013, neni 5, të Rregullores (BE) nr. 1300/2013, neni 16 i Rregullores (BE) nr. 1299/2013). Bazë është vlera e një indikatori rezultatesh në fillim të periudhës së programimit (për shembull, numri i bizneseve të themeluar rishtazi në atë vit për një prioritet që ka për qëllim të nxisë numrin e bizneseve fillestare në një rajon). Kjo mund të jetë e disponueshme nga të dhënat statistikore ose administrative ("Dokumenti udhëzues për monitorimin dhe vlerësimin - ERDF dhe fondi i kohezionit, koncepteve dhe rekomandimeve" - Komisioni i BE-së, mars 2014).

Përfituesi

Përfitues do të thotë një organ publik ose privat përgjegjës për iniciimin/fillimin ose të dyja fillimin dhe zbatimin e operacioneve (sipas nenit 2 (10) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 që përfiton nga fondet e programit).

Rritja BLU

Rritja blu është strategjia afatgjatë për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm në sektorin detar dhe atë të marinës si një e tërë. Ajo pranon se detet dhe oqeanet janë faktorë zhvillimi për ekonominë europiane, me potencial të madh për inovacionin dhe rritjen ekonomike. Është kontributi i Politikës së Integruar Detare në arritjen e qëllimeve të strategjisë BE2020 për rritjen e zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

**Ngritja e kapaciteteve**

Ngritja e kapaciteteve fokusohet në të kuptuarit e pengesave që pengojnë njerëzit, institucionet dhe autoritetet publike nga realizimi i qëllimeve të tyre të zhvillimit, duke rritur aftësitë që do t'i lejojnë ata të arrijnë rezultate të matshme dhe të qëndrueshme.

Kapitalizimi

Organizimi i të dhënave në lidhje me zbatimin e programeve, projekteve dhe me ndikimet e tyre, metodat e përdorura për të bërë përvojën e akumuluar të jetë e përdorshme për programet dhe projektet e tjera apo grupet e interesit.

Grupimet

Grupimi i biznesit është një përqendrim gjeografik i bizneseve të ndërlidhura, furnizuesve dhe institucioneve të lidhura në një fushë të caktuar. Grupimet konsiderohen për të rritur produktivitetin me të cilin kompanitë mund të konkurojnë, në nivel kombëtar dhe atë global.

Industritë kreative

Industritë që përdorin kulturën si *kontribut* dhe kanë dimension kulturor. Ato përfshijnë arkitekturën dhe projektimin/dizajnin, të cilat integrojnë elemente kreative në proceset më të gjera, si edhe nënsektorë të tillë, si: dizajni grafik, dizajni i modës ose reklamat (Grupi i Punës i ekspertëve të Shteteve Anëtare të BE-së - metoda e hapur e koordinimit - për industritë kulturore dhe kreative, 2012: Manuali i politikave).

Trashëgimia kulturore dhe burimet kulturore

Trashëgimia kulturore përbëhet nga trashëgimia materiale, që përfshin ndërtesat dhe vendet historike, monumentet etj. dhe trashëgimia kulturore jomateriale e cila i referohet praktikave, përfaqësimeve, shprehjeve, njohurive, aftësive etj. (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën – UNESCO, “Konventa për Ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale”, 2003).

Burimet kulturore përbëhen nga dy elemente, trashëgimia kulturore materiale dhe jomateriale, që përfshin kulturën e tanishme, përfshi këtu kulturën progresive, inovative dhe urbane. Këto burime mund të valorizohen ndër të tjera në industritë kulturore dhe kreative.

Operatori ekonomik

Sipas nenit 1, pika 8 të Direktivës së BE 2004/18/KE të Parlamentit European dhe të Faqe|3886

Këshillit të datës 31 mars 2004 mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të punëve publike, kontratave të furnizimit publik dhe kontratave të shërbimit publik, konsiderohet si “operator ekonomik” çdo person fizik ose juridik apo subjekt publik ose grup personash dhe/ose organe të tilla që ofron në treg, përkatësisht, ekzekutimin e punimeve dhe/ose një punë, produkte ose shërbime. Si i tillë, rregullat e konkurrencës nuk varen nga statusi ligjor i çdo institucioni të përfshirë (publik apo privat), por nga natyra e aktivitetit të realizuar.

Efikasiteti i energjisë

Përmirësimet e efikasitetit të energjisë kanë lidhje me reduktimin në energjinë e përdorur për një shërbim të caktuar (ngrohje, ndriçim etj.) apo nivelin e aktivitetit. Reduktimi i konsumit të energjisë shoqërohet zakonisht me ndryshime teknologjike, por jo gjithmonë, pasi ajo mund të rezultojë edhe nga organizimi dhe menaxhimi më i mirë apo përmirësimi i kushteve ekonomike në sektor (“faktorët joteknikë”) (Këshilli Botëror i Energjisë, “Politikat e Eficiencës së Energjisë rreth Botës: Shqyrtimi dhe Vlerësimi”, 2008).

Mbrojtja e mjedisit

Çdo aktivitet që mban ekuilibrin e mjedisit duke parandaluar kontaminimin dhe përkeqësimin e burimeve natyrore, përfshi aktivitete të tilla si: a) ndryshimet në karakteristikat e mallrave dhe shërbimeve, si dhe ndryshimet në modelet e konsumit; b) ndryshimet në teknikat e prodhimit; c) trajtimi i mbetjeve; d) riciklimi; d) parandalimi i dëmtimit të peizazhit (Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), “Përkufizime”, 2011).

Rritja e gjelbër

Rritja e gjelbër është në lidhje me nxitjen e rritjes ekonomike dhe zhvillimit ndërkohë që siguron që pasuritë natyrore të vazhdojnë të ofrojnë burimet dhe shërbimet mjedisore në të cilat mirëqenia jonë mbështetet. Për ta bërë këtë, ajo duhet të nxisë investimet dhe inovacionin që do të mbështesë rritjen e qëndrueshme dhe do të rrisë mundësitë e reja ekonomike (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) “Orientimi drejt rritjes së gjelbër, Monitorimi i Progresit, Fjalori i Termave dhe Përkufizimet”, 2011).



Indikatori

Një indikator mund të përkufizohet si një mënyrë matjeje për plotësimin e një objektivi, një burim i kryer, një efekt i përfutur, një vlerësues i cilësisë ose një kontekst variabël. Indikatorët duhet të përcaktohen nga një përkufizim.

Indikatorët e rezultateve

Indikatorët e rezultateve lidhen me aktivitetin. Ata maten në njësi fizike ose monetare (p.sh., numri i firmave të mbështetura, numri i planeve të veprimit të përpunuar etj.).

Indikatorët e rezultateve

Indikatorët e *rezultateve* lidhen me objektivat e Akteve Prioritare (AP). Ata lidhen me efektet mbi përfituesit e drejtpërdrejtë të krijuar nga një program. Ata japin informacion mbi ndryshimet, për shembull, në sjelljen, kapacitetin apo performancën e përfituesve. Indikatorët të tillë mund të jenë fizikë (reduktimi i konsumit të energjisë, rritja e kompetencës etj.) ose financiare (burime financiare shtesë të mobilizuara, ulje e një shpenzimi etj.).

Inovacioni

Inovacioni është në lidhje me krijimin e produkteve të reja, proceseve të reja, teknologjive të reja, sistemet e reja të organizimit, sistemit të ri shoqëror etj. Pra, inovacioni mund të jetë teknologjik dhe joteknologjik me objektivin për të përmirësuar funksionimin e institucioneve, efikasitetin e zbatimit të strategjive ose konkurrueshmërinë e operatorëve ekonomikë.

Aktorët kryesorë

“Aktorët kryesorë” janë institucionet apo individët të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në fushën e veprimit të projektit dhe ka mundësi të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme për realizimin e tij. Ata kanë kompetenca edhe politike, edhe administrative dhe kapacitetet teknike për të zbatuar veprimet e nevojshme për projektin.

Strategjia makrorajonale

Një strategji makrorajonale është një kornizë e integruar, miratuar nga Këshilli European, e cila mund të mbështetet nga *Fondet Europiane Strukturore dhe të Investimit* (ESIF), *ndër të tjera*, për të trajtuar sfidat e përbashkëta me të cilat përballen një zonë gjeografike e caktuar, që ka lidhje me shtetet anëtare dhe vendet e tjera të vendosura në të njëjtën zonë gjeografike. Në këtë kuadër, ata përfitojnë nga bashkëpunimi i

përforcuar që kontribuon në arritjen e kohezionit ekonomik, social dhe territorial.

Transporti multimodal

Transporti multimodal kuptohet si transporti i personave ose mallrave nga të paktën dy prej mënyrave të ndryshme të transportit. Zgjidhjet ekologjiksht miqësore të transportit janë ato që lejojnë një reduktim të ndjeshëm të emetimeve të CO₂, NO_x, si edhe të zhurmës.

Organizatë jofitimprurëse

Një organizatë jofitimprurëse (shkurtimisht e referuar si “OJF” ose “jofitimprurëse” ose “jopër-përfitim”) është një organizatë, objektivi kryesor i së cilës është të mbështesë një çështje me interes privat ose shqetësim publik për qëllime jokomerciale. Organizatat jofitimprurëse mund të fitojnë përfitime, por këto përfitime duhet të rinvestohen në veprimtarinë e saj.

Operacioni

Një projekt, kontratë, veprim apo grup projektesh të përzgjedhura nga autoritetet programore të programeve në fjalë ose nën përgjegjësinë e tyre që kontribuon në objektivat dhe prioritet apo përparësitë.

Aksionet Pilot

Një veprim/aksion pilot nënkupton zbatimin e skemave të natyrës eksperimentale për të provuar, vlerësuar dhe/ose demonstruar realizueshmërinë e tij me qëllimin për të përfituar nga këto rezultate dhe transferuar praktikën në institucionet dhe territoret e tjera.

Organi ekuivalent publik (sipas Direktivës 2004/18/KE)

Çdo organ juridik që rregullohet nga e drejta publike ose private:

- themeluar me synimin e veçantë për plotësimin e nevojave në interes të përgjithshëm, që nuk ka karakter industrial ose komercial, dhe
- që ka karakter juridik, dhe
- ose financiar, për pjesën më të madhe, nga shteti, apo autoritetet rajonale ose vendore, ose organe të tjera që rregullohen nga e drejta publike, ose në vartësi të mbikëqyrjes menaxhuese nga këto organe, ose që kanë një bord administrativ, menaxherial apo mbikëqyrës, ku më shumë se gjysma e anëtarëve emërohen nga shteti, autoritetet rajonale ose vendore apo nga organe të tjera që rregullohen nga e drejta publike.

**Spirale e katërfishtë**

Modeli i inovacionit që përfshin organet institucionale, sferën kërkimore, sektorin e biznesit dhe qytetarët në këtë proces.

Aktorët rajonalë

Aktorët rajonalë janë të gjithë aktorët kryesorë që operojnë në nivel rajonal në një fushë të caktuar tematike në mënyrë të pavarur nga statusi i tyre ligjor, që përfshin publikun, si edhe sektorin privat. Këta sektorë përfshijnë lloje të ndryshme të subjekteve të tilla, si: administratën publike, infrastrukturën, shërbimet e ofruesve dhe operatorët, agjencitë që përfshijnë AZHR, grupet e interesit, OJQ-të, qendrat kërkimore, objektet arsimore, ndërmarrjet përfshi SME-të, organizatën për mbështetjen e biznesit etj.

Burimet e rinovueshme të energjisë

Burimet e rinovueshme të energjisë janë një grup i ndryshëm teknologjik që e kapin energjinë e tyre nga flukset ekzistuese të energjisë të tilla, si: dielli, era, uji, proceset biologjike dhe flukset e ngrohjes gjeotermale.

Zona rurale

Zonat rurale janë të gjitha zonat jashtë grupimeve urbane. Grupimet urbane janë grupe qelizash të afërta të rrjetit prej 1km² me një dendësi prej të paktën 300 banorë për km² dhe një popullsi minimale prej 5000 persona (Eurostat, 2011).

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SMEs)

Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme përcaktohen sipas numrit aktual të punonjësve (stafit) dhe qarkullimit ose bilancit total vjetor.

- Një ndërmarrje e mesme përcaktohet si një ndërmarrje e cila punëson më pak se 250 persona dhe qarkullimi vjetor i së cilës nuk i kalon 50 milionë euro dhe/ose bilanci total vjetor i së cilës nuk i kalon 43 milionë euro.

- Një ndërmarrje e vogël përcaktohet si një ndërmarrje e cila punëson më pak se 50 persona dhe qarkullimi vjetor dhe/ose bilanci total vjetor i së cilës nuk i kalon 10 milionë euro.

- Një ndërmarrje mikro përcaktohet si një ndërmarrje e cila punëson më pak se 10 persona dhe qarkullimi dhe/ose bilanci total vjetor i së cilës nuk i kalon 2 milionë euro.

(Rekomandimi i Komisionit 2003/361/KE).

Strategjia e “specializimit të mençur”

Strategjia e specializimit “të mençur” (S3) nënkupton strategjitë kombëtare ose rajonale të inovacionit, të cilat vendosin prioritetet për të mbështetur avantazhin ose epërsinë konkurruese duke zhvilluar dhe përputhur pikat e forta të kërkimit dhe inovacionit me nevojat e biznesit.

Ajo i trajton mundësitë e reja dhe zhvillimet e tregut në mënyrë koherente, ndërkohë që shmang dublikimin dhe fragmentimin e përpjekjeve, dhe mund të marrë formën (apo të përfshihet), në kuadrin strategjik të politikave të kërkimit kombëtar ose rajonal dhe inovacionit (R&I).

Inovacioni social

Inovacionet sociale janë ide të reja (produkte, shërbime dhe modele) që njëkohësisht plotësojnë nevojat sociale (më efektivisht se alternativat) dhe krijojnë marrëdhënie të reja shoqërore apo bashkëpunime (Murray etj., “Libër i hapur i Inovacionit Social”, 2010). Fushat e veprimtarisë janë ndër të tjera integrimi i punës, shërbimet sociale, arsimi dhe hulumtimi, kultura dhe argëtimi, shëndetësia etj.

Zhvillimi i qëndrueshëm

“Zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre” (WCDE/WCED, 1989) - (Komisioni Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin).

Grupet/përdoruesit fundorë të synuar

Grupet e synuara apo përdoruesit fundorë kanë lidhje me individët dhe/ose organizatat të ndikuar drejtpërdrejt pozitivisht nga aktivitetet dhe rezultatet e operacioneve. Jo domosdoshmërisht marrin grant financiar dhe madje jo të përfshirë drejtpërdrejt në operacion, grupet e synuara mund të shfrytëzojnë rezultatet e projektit për përfitimet e tyre.

Vlera e synuar

Një objektiv sasior i shprehur si vlerë që do të arrihet nga një tregues/indikator - (indikator i prodhimit ose rezultatit), brenda një kohe të caktuar.



SHTOJCA IV KUSHTET E PËRGJITHSHME

Preambula

1) Në përputhje me nenin 9 (3) të Rregullores IPA II, ku zbatohet, IPA II mund të kontribuojë në programet transkombëtare të bashkëpunimit ose masat që janë krijuar dhe zbatuar nën Rregulloren (BE) nr. 1299/2013 dhe ku përfituesit e listuar në shtojcën I marrin pjesë në Rregulloren IPA II.

2) Në përputhje me nenin 26 të Rregullores ETC, kushtet që zbatohen për zbatimin e programit të cilat drejtojnë menaxhimin financiar, si dhe programimin, monitorimin, vlerësimin dhe kontrollin e pjesëmarrjes së përfituesit IPA II, nëpërmjet kontributit IPA II në programet transkombëtare dhe ndërrajonale të bashkëpunimit, do të hartohen në programin përkatës të bashkëpunimit dhe, ku aplikohet, në marrëveshjen e financimit mes Komisionit, qeverisë së përfituesit IPA II në fjalë dhe shtetit anëtar që pret autoritetin menaxhues të programit përkatës të bashkëpunimit. Kushtet e zbatimit të programit duhet të jenë në linjë me rregulloren e politikave të Unionit për kohezion.

3) Programi “Interreg V-B Adriatiko-Jonian”, me nr. CCI: 2014TC16M4TN002, në vijim i referuar si “Programi”, do të zbatohet nëpërmjet menaxhimit të përbashkët. Për pasojë, Republika e Italisë, shteti anëtar që pret autoritetin menaxhues, në vijim i referuar si “Shteti Anëtar”, dhe Komisioni do të jenë përgjegjës për zbatimin, menaxhimin dhe kontrollin e Programit.

4) Përfituesi IPA II ka konfirmuar, në formë të shkruar, miratimin për përmbytjen e Programit para se të dorëzohet në Komision. Kjo Marrëveshje gjithashtu përfshin angazhimin për të ofruar kontribut financiar ndaj përfituesit IPA II.

5) Në përputhje me nenin 3 të Kushteve të Veçanta, dispozitat e këtyre Kushteve të Përgjithshme shtojnë dhe plotësojnë dispozitat e akteve themeltare të renditura në nenin 1 (2) të Kushteve të Veçanta dhe të akteve të miratuara bazuar në to. Autoritetet e Programit në Shtetin Anëtar janë të kufizuara nga të gjitha dispozitat e akteve themeltare, edhe nëse këto Kushte të Përgjithshme mund të mos i referohen në mënyrë specifike të gjitha dispozitave të saj.

6) Autoritetet dhe organet e përfituesit IPA II do të mbështesin Shtetin Anëtar në përgjegjësitë dhe do të bashkëpunojnë ngushtë me autoritetet e një programi, veçanërisht kur vetëm autoritetet dhe organet e përfituesit IPA II mund të kryejnë detyrat në territorin e tij.

7) Qëllimi i këtyre Kushteve të Përgjithshme është që të përcaktojnë rregulloren për zbatimin e Programit, siç përcaktohet në shtojcën I, të përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e përfituesit të IPA II dhe Komisionit, përkatësisht në kryerjen e këtyre detyrave.

8) Këto Kushte të Përgjithshme do të zbatohen për detyrimet e përfituesit IPA II në lidhje me Kontributin e Unionit, të veçuara ose të kombinuara me bashkëfinancimin kombëtar të përfituesit IPA II.

9) Përfituesi IPA II do të mbetet përgjegjës për mbështetjen e autoriteteve të Programit në Shtetin Anëtar në përmbushjen e detyrimeve të saj të përcaktuara në aktet themelore, edhe nëse përfituesi IPA II nëndelegon detyra të caktuara subjekteve të tjera të identifikuara në Program. Komisioni, në veçanti, gëzon të drejtën që të ndërpresë pagesat dhe të pezullojë dhe/ose të përfundojë këtë Marrëveshje Financimi në bazë të akteve, moskryerjes së detyrave dhe/ose situatave të çfarëdo entiteti të caktuar.

Seksioni I

Kushtet dhe parimet e përgjithshme

Neni 1

Përkufizimet

1. Për qëllimet e Kushteve të Përgjithshme do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “Përfitues IPA II” nënkupton një nga përfituesit e renditur në shtojcën I të Rregullores IPA II;

b) “Vende pjesëmarrëse” nënkupton përfituesin IPA II së bashku me Shtetet Anëtare që marrin pjesë në një program shumëvjeçar për bashkëpunim transkombëtar, të hartuar bashkërisht nga vendet pjesëmarrëse;

c) “Marrëveshja kuadër” i referohet marrëveshjes specifike të lidhur ndërmjet Komisionit dhe një përfituesi IPA II, të vlefshëm për të gjitha fushat e politikave të IPA II dhe përcakton parimet e bashkëpunimit financiar mes përfituesit IPA II dhe Komisionit sipas



Rregullores IPA II, siç përcaktohet në nenin 6 të Kushteve të Veçanta;

d) “Programi” nënkupton programin e përbashkët transkombëtar të bashkëpunimit;

e) “Autoritetet” nënkuptojnë subjekte publike apo organet e një përfituesit IPA II ose të një shteti anëtar në nivel kombëtar, rajonal apo lokal;

f) “Marrëveshja e financimit” nënkupton një marrëveshje vjetore ose shumëvjeçare të arritur mes Komisionit dhe një përfituesi IPA II, si dhe Shtetit Anëtar që pret autoritetin menaxhues;

g) “Organ i së drejtës publike” nënkupton në përfituesin IPA II, në përputhje me legjislacionin kombëtar, organet ekuivalente me ato në Shtetet Anëtare (shih pikën (o) të paragrafit 2 më poshtë);

h) “Operator ekonomik” nënkupton çdo person fizik apo juridik ose subjekt tjetër që merr pjesë në zbatimin e një operacioni në kuadër të Programit, me përjashtim të një Shteti Anëtar ose një përfituesi IPA II që ushtron të drejtat e tij si autoritet publik;

i) “Asistenca ERDF” nënkupton mbështetjen e Unionit për Programin nga linja buxhetore përmes Fondit Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF), si kontributi nga zëri buxhetor 1b (kohezion ekonomik, social dhe territorial) dhe kontributi nga zëri buxhetor 4 (Evropa Globale) (IPA II), përveç nëse specifikohet ndryshe.

2. Për qëllimet e Kushteve të Përgjithshme zbatohen përkufizimet e përcaktuara në nenin 2 CPR, vetëm nëse përshtatet sipas paragrafit 1, dhe në veçanti:

j) “Programimi” nënkupton procesin e organizimit, vendimarrjen dhe shpërndarjen e burimeve financiare në disa faza, me përfshirjen e partnerëve në përputhje me nenin 5, me qëllim që të zbatojnë, në një bazë shumëvjeçare, veprimin e përbashkët nga Unioni dhe Shtetet Anëtare për të arritur objektivat e strategjisë së Unionit për rritje “të zgjuar”, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse;

k) “Operacioni” nënkupton një projekt, kontratë, veprim ose grup projektsh, të përzgjedhur nga komiteti i përbashkët i monitorimit ose autoriteti kontraktues i komitetit të monitorimit, ose nën përgjegjësinë e tij, që kontribuojnë në objektivat;

l) “Përfitues” nënkupton një organ publik apo privat, që është përgjegjës për fillimin dhe zbatimin e operacioneve;

m) “Marrëveshja e Partneritetit” nënkupton një dokument i përgatitur nga një Shtet Anëtar me përfshirjen e partnerëve në përputhje me qasjen e qeverisjes shumënivelëshe, i cili përcakton strategjinë, prioritetet dhe masat e Shtetit Anëtar për përdorimin e Fondit Evropian Struktural dhe të Investimeve në një mënyrë efektive dhe efikase, në mënyrë që të ndjekë strategjinë e Unionit për rritje “të zgjuar”, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, dhe që miratohet nga Komisioni pas vlerësimit dhe dialogut me Shtetin Anëtar në fjalë;

n) “Shpenzimet publike” nënkuptojnë çdo kontribut publik për financimin e operacioneve, që kanë burim buxhetin e autoriteteve publike kombëtare, rajonale apo lokale, buxheti i Unionit që lidhet me asistencën IPA II, buxheti i organeve të së drejtës publike ose buxheti i shoqatave të autoriteteve publike ose të organeve të së drejtës publike;

o) “Organi i së drejtës publike” nënkupton një organ të një Shteti Anëtar, që rregullohet nga e drejta publike, në kuptimin e pikës 4 të nenit 2 (1) të Direktivës 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹³ e të çdo grupimi evropian për bashkëpunim territorial (EGTC), të themeluar në përputhje me Rregulloren (KE), nr. 1082/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit¹⁴, pavarësisht nëse EGTC konsiderohet të jetë një organ i së drejtës publike ose një organ i së drejtës private sipas dispozitave përkatëse kombëtare në zbatim;

p) “Dokument” nënkupton një letër ose një informacion elektronik me rëndësi mesatare të përkatësisë në kontekstin e kësaj Marrëveshjeje të Financimit;

q) “Viti kontabël” nënkupton periudhën nga 1 korriku deri më 30 qershor, me përjashtim të vitit të parë kontabël të periudhës së programimit, që do të thotë periudhën nga data e fillimit të pranueshmërisë së shpenzimeve deri më 30

¹³ Direktiva 2014/24/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 shkurt 2014, për prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE. Teksti i lidhur me EEA, GZ L 94, 28.3.2014, f. 65.

¹⁴ Rregullorja (BE) nr. 1302/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013, që amendon Rregulloren (KE) nr. 1082/2006 për Grupimin Evropian të Bashkëpunimit Territorial (EGTC) lidhur me sqarimin, thjeshtësimin dhe përmirësimin e krijimit dhe funksionimit të grupeve të tilla, GZ L 347, 20.12.2013, f. 303.



qershor 2015; viti i fundit kontabël do të jetë nga 1 korriku 2023 deri më 30 qershor 2024;

r) “Viti financiar” nënkupton periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor;

s) “Parregullsi” nënkupton çdo shkelje të legjislacionit të Unionit ose ligjit kombëtar lidhur me zbatimin e tij, që rezulton nga një veprim ose mosveprim nga një operator ekonomik të përfshirë në zbatimin e asistencës ERDF, e cili ka, ose do të ketë, efekt në dëm të buxhetit të Unionit duke faturuar një artikull të pajustificuar shpenzimesh në buxhetin e Unionit;

t) “Parregullsi sistematike” nënkupton çdo parregullsi, që mund të jetë e një natyre periodike, me një probabilitet të lartë të shfaqjes në operacione të ngjashme, e cila është rezultat i një mangësie serioze në funksionimin efikas të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit, duke përfshirë edhe pamundësinë për të përcaktuar procedurat e duhura në përputhje me këtë Rregullore dhe rregullat specifike për Fondin;

u) “Mangësi serioze në funksionimin efikas të sistemit të menaxhimit dhe të kontrollit” nënkupton një mangësi për të cilën kërkohet përmirësim thelbësor në sistemin, që ekspozon asistencën ERDF në një rrezik të madh parregullish, si dhe ekzistenca e të cilit nuk pajtohet me një opinion të pakualifikuar të auditimit për funksionimin e sistemit të menaxhimit dhe të kontrollit;

v) “Rregullat specifike për fondin” i referohen dispozitave specifike të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 e Parlamenti Evropian dhe e Këshillit të 17 dhjetorit 2013¹⁵, të zbatueshme për Rregulloren (BE) nr. 1299/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit¹⁶ (Rregullorja Evropiane për Bashkëpunim Territorial, “Rregullorja ETC”)

¹⁵ Rregullorja (BE) nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013, që përcakton dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Evropian Social, Fondin e Kohezionit, Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillimin Rural dhe Bregdetar Evropian dhe Fondi i Peshkimit dhe që përcakton dispozitat e përgjithshme mbi Fondin e Zhvillimit Rajonal Evropian, Fondin Evropian Social, Fondin e Kohezionit dhe Bregdetar Evropian dhe Fondin e Peshkimit dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1083/2006, GZ L 347, 20.12.2013, f. 320

¹⁶ Rregullorja (BE) nr. 1299/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013, për dispozitat e veçanta për mbështetjen e Fondit Evropian të Zhvillimit Rajonal për qëllimin e bashkëpunimit territorial, GZ L 347, 20.12.2013, f. 259.

dhe Rregullorja (BE) nr. 1301/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit¹⁷.

3. Referencat në këtë Marrëveshje të Financimit për dispozitat e CPR, Rregullores ETC dhe të akteve të miratuara mbi bazën e tyre interpretohen edhe si referuar “përfituesit IPA II”, “vendeve pjesëmarrëse” dhe “asistencës ERDF”, siç përcaktohet në paragrafin 1.

Neni 2

Përlllogaritja e afateve kohore për vendimet e Komisionit

Ku, në zbatim të nenit 10 (2) dhe (5) të kësaj marrëveshjeje ose neni 107 (2) dhe 108 (3) CPR, vendoset një afat kohor për Komisionin që të miratojë apo ndryshojë një vendim, me anë të një akti interpretues, që afati kohor të mos përfshijë periudhën e cila fillon në datën pas datës së dërgimit të komenteve nga Komisioni drejt Shtetit Anëtar dhe zgjat derisa Shteti Anëtar të përgjigjet për komentet.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Asistenca ERDF do të mbështesë përfituesin IPA II në miratimin dhe zbatimin e reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike, të kërkuara në mënyrë që të jenë në përputhje me vlerat e Unionit dhe që të përafrohen në mënyrë të vazhdueshme me rregullat e Unionit, standardet, politikat dhe praktikën, me qëllim anëtarësimin në Union.

Nëpërmjet kësaj mbështetjeje, asistenca ERDF do të kontribuojë në stabilitetin, sigurinë dhe zhvillimin e përfituesit IPA II.

2. Më konkretisht, asistenca ERDF do të:

a) mbështesë reformat politike, ndër të tjera përmes bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira të fqinjësisë;

b) mbështesë zhvillimin ekonomik, social dhe territorial, me qëllim rritjen “e zgjuar”, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse; dhe

¹⁷ Rregullorja (BE) nr. 1301/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013, për Fondin Evropian për Zhvillimin Rajonal dhe për dispozitat e veçanta në lidhje me investimet për qëllimin e rritjes dhe punësimit e që shfuqizon Rregulloren (BE) nr. 1080/2006, GZ L 347, 20.12.2013, f. 289.



c) forcojë integritetin rajonal dhe bashkëpunimin territorial me përfshirjen e përfituesit IPA II dhe Shteteve Anëtare.

3. Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse do të garantojnë, duke pasur parasysh kontekstin specifik të çdo Shteti Anëtar dhe përfituesit IPA II, që asistencë ERDF të përputhet me politikat përkatëse, parimet horizontale të referuara në nenin 3, 5 dhe 6, si dhe prioritetet e Unionit, dhe që të plotësojë instrumentet e tjera të Unionit.

4. Asistencë ERDF do të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, Shtetin Anëtar dhe përfituesin IPA II në përputhje me parimin e subsidiaritetit.

5. Vendet pjesëmarrëse në nivelin e duhur territorial, në përputhje me kuadrin e tyre institucional, ligjor dhe financiar, dhe organet e caktuara prej tyre për atë qëllim, do të jenë përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e Programit dhe kryerjen e detyrave, në partneritet me partnerët përkatës referuar në nenin 7, në përputhje me këtë Marrëveshje të Financimit.

6. Rregullimet për zbatimin dhe shfrytëzimin e asistencës ERDF, dhe në veçanti burimet financiare dhe administrative, të nevojshme për përgatitjen dhe zbatimin e Programit, në lidhje me monitorimin, raportimin, vlerësimin dhe kontrollin do të respektojnë parimin e proporcionalitetit në lidhje me nivelin e mbështetjes së alokuar dhe do të marrë parasysh qëllimin e përgjithshëm për reduktimin e barrës administrative për organet e përfshira në menaxhimin dhe kontrollin e Programit.

7. Në përputhje me përgjegjësitë e tyre përkatëse, Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse do të garantojnë koordinimin ndërmjet këtij programi dhe programeve të tjera të IPA II dhe në mes të ERDF dhe politikave, strategjive dhe instrumenteve të tjera përkatëse të Unionit, duke përfshirë ato në kuadrin e veprimit të jashtëm të Unionit.

8. Pjesa e buxhetit të Unionit, e alokuar për asistencën ERDF do të zbatohet brenda kuadrit të menaxhimit të përbashkët në mes të vendeve pjesëmarrëse dhe Komisionit, në përputhje me nenin 59 të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe e

Këshillit¹⁸ (“Rregullorja Financiare”);

9. Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse do të respektojnë parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar në përputhje me nenin 30 të Rregullores Financiare.

10. Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse garantojnë efikasitetin e asistencës ERDF gjatë përgatitjes dhe zbatimit, në lidhje me monitorimin, raportimin dhe vlerësimin.

11. Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse do të kryejnë detyrat e tyre përkatëse lidhur me asistencën ERDF me qëllim reduktimin e barrës administrative për përfituesit.

Neni 4

Përputhshmëria me legjislacionin e Unionin dhe atë kombëtar

Operacionet e mbështetura nga asistencë ERDF do të jenë në përputhje me legjislacionin e Unionit dhe atë kombëtar në lidhje me zbatimin e tij (“legjislacioni i zbatueshëm”).

Neni 5

Nxitja e barazisë mes burrave dhe grave dhe mosdiskriminimi

Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse garantojnë barazinë mes burrave dhe grave e integriteti i perspektivës gjinore merret në konsideratë dhe nxitet nëpërmjet përgatitjes dhe zbatimit të Programit, përfshirë në lidhje me monitorimin, raportimin dhe vlerësimin.

Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse do të ndërmarrin masat e nevojshme për të parandaluar diskriminimin me bazë gjinore, origjinë racore dhe etnike, fetare ose besimit, aftësi të kufizuara, moshës ose orientimit seksual gjatë përgatitjes dhe zbatimit të Programit. Në veçanti, qasja e personave me aftësi të kufizuara do të merret në konsideratë gjatë procesit të përgatitjes dhe zbatimit të Programit.

Neni 6

Zhvillimi i qëndrueshëm

Objektivat e asistencës ERDF do të ndiqen në përputhje me parimin e zhvillimit të

¹⁸ Rregullorja (BE, Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 25 tetor 2012, për rregullat financiare që zbatohen për buxhetin e përgjithshëm të Unionit dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 1605/2002, GZ L 298, 26.10.2012, f. 1.



qëndrueshëm dhe me nxitjen e Unionit me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, siç përcaktohet në nenet 11 dhe 191 (1), Traktati për Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFEU), duke marrë parasysh parimin “ndotësi paguan”.

Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse do të garantojnë që kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, efienca e burimeve, zbutja dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, biodiversiteti, elasticiteti ndaj fatkeqësive, dhe parandalimi i rrezikut, si dhe menaxhimi nxiten në procesin e përgatitjes dhe zbatimit të Programit.

Neni 7

Parimi i partneritetit

1. Për Programin, vendet pjesëmarrëse, në përputhje me kuadrin institucional dhe ligjor të tyre, do të organizojnë një partneritet me autoritetet kompetente rajonale dhe vendore. Partneriteti do të përfshijë edhe partnerët e mëposhtëm:

a) autoritetet kompetente urbane dhe të tjera publike;

b) partnerët ekonomikë dhe socialë; dhe

c) organet përkatëse që përfaqësojnë shoqërinë civile, duke përfshirë edhe partnerët e mjedisit, organizatat joqeveritare dhe organet përgjegjëse për nxitjen e përfshirjes sociale, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.

Vendet pjesëmarrëse mund të përfshijnë edhe grupimet evropiane të bashkëpunimit territorial që veprojnë në fushën e programit dhe autoritetet apo organet që janë të përfshirë në zhvillimin ose zbatimin e një strategjie makrorajonale ose të basenit detar në zonën e programit, duke përfshirë koordinatorët e zonave prioritare për strategjitë makrorajonale.

Aty ku autoritetet publike, partnerët shoqërorë dhe ekonomikë, si dhe organet që përfaqësojnë shoqërinë civile kanë krijuar një organizatë ombrellë, ata mund të propozojnë një përfaqësues të vetëm për të paraqitur pikëpamjet e organizatës ombrellë në partneritet.

2. Në përputhje me qasjen e qeverisjes shumë-nivelëshe, partnerët e përmendur në paragrafin 1 do të përfshihen nga vendet pjesëmarrëse në përgatitjen e raporteve të progresit dhe gjatë përgatitjes dhe zbatimit të Programit, duke përfshirë përmes pjesëmarrjes në komitetin

e monitorimit për Programin në përputhje me nenin 15.

3. Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) nr. 240/2014¹⁹ do të zbatohet *mutatis mutandis* për elementë të ndryshëm të programimit, të përmendura në paragrafin 2.

Seksioni II

Programimi

Neni 8

Mbulimi gjeografik

Lista e rajoneve të pranueshme që do të përfshihen në program është si më poshtë:

a) në Shtetet Anëtare, Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) rajonet e nivelit 2 të renditura në shtojcën III të Vendimit Zbatues të Komisionit 2014/388/BE, datë 16 qershor 2014²⁰, duke siguruar vazhdimësinë e këtij bashkëpunimi në fusha të mëdha koherente në bazë të programeve të mëparshme, duke marrë parasysh, sipas rastit, strategjitë makrorajonale dhe të basenit detar;

b) në përfituesin IPA II, Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) rajonet e nivelit 2 ose, në mungesë të klasifikimit NUTS, zonat ekuivalente si të renditura, për qëllim informimi, në shtojcën III të Vendimit Zbatues të Komisionit 2014/388/EU, si dhe të përcaktuara në Programin e miratuar nga Komisioni.

Neni 9

Përmbajtja e programit dhe përqendrimi tematik

1. Programi do të hartohet në përputhje me parimin e partneritetit siç është përcaktuar në nenin 7 dhe në përputhje me nenin 8 të Rregullores ETC.

2. Objektivat tematikë për Programin do të dakortësohen mes vendeve pjesëmarrëse për

¹⁹ Rregullore Deleagues e Komisionit (BE) nr. 240/2014, e datës 7 janar 2014, për kodin evropian të kryerjes së partneritetit në kuadër të Fondit Evropian Struktural dhe të Investimeve, GZ L 74, 14.3.2014, f. 1.

²⁰ Vendimi Zbatues i Komisionit i 16 qershorit 2014, që përcakton listën e rajoneve dhe zonave të pranueshme për financim nga Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal nën komponentët ndërkufitarë dhe transkombëtarë të qëllimit evropian për bashkëpunim territorial, për periudhën 2014 -2020 (njoftuar me numrin e dokumentit C (2014) 3898), GZ L 183, 2014/06/24, f. 75.



secilin kufi apo grup kufijve bazuar në objektivat tematikë të përcaktuar në paragrafin e parë, të nenit 9, të CPR-së.

3. Prioritetet tematike të asistencës ERDF do të jenë ato të përcaktuara në nenin 5 të Rregullores (BE) nr. 1301/2013 dhe në nenin 7 (1) (b) të Rregullores ETC.

4. Të paktën 80% e alokimit ERDF për këtë program transkombëtar do të përqendrohet në një maksimum prej katër objektivash tematikë të përcaktuar në paragrafin e parë, të nenit 9, të CPR-së.

Neni 10

Miratimi dhe ndryshimi i Programit

1. Komisioni do të vlerësojë përputhshmërinë e programeve me Dispozitat e Përgjithshme dhe Rregulloren ETC dhe me rregullat specifike për fondin, kontributi efektiv i tyre për objektivat e përzgjedhur tematikë dhe për prioritetet e Unionit, specifike për ETC dhe ERDF, dhe për sa kohë kjo lidhet edhe me Shtetet Anëtare pjesëmarrëse, gjithashtu edhe përputhshmëria me Marrëveshjen e Partneritetit, duke marrë parasysh rekomandimet përkatëse specifike për vendin, të miratuara në përputhje me nenin 121 (2) TFEU dhe rekomandimet përkatëse të Këshillit, të miratuara në përputhje me nenin 148 (4) TFEU, si dhe vlerësimet *ex ante*. Vlerësimi do të adresojë, në veçanti, përshtatshmërinë e strategjisë së programit, objektivat, treguesit, synimet korresponduese dhe alokimin e burimeve buxhetore përkatëse.

2. Komisioni do të kryejë vëzhgime brenda tre muajve nga data e dorëzimit të programit. Vendet pjesëmarrëse do t'i sigurojnë Komisionit të gjithë informacionin e nevojshëm shtesë dhe, kur është e përshtatshme, do të rishikojnë programin e propozuar.

3. Banka Evropiane e Investimeve (EIB), me kërkesë të vendeve pjesëmarrëse, mund të marrë pjesë në përgatitjen, si dhe në aktivitete që lidhen me përgatitjen e operacioneve.

4. Komisioni mund të konsultohet me EIB para miratimit të Programit.

5. Kërkesat për ndryshimin e programit të dorëzuar nga vendet pjesëmarrëse do të jenë të arsyetuara në mënyrë të rregullt dhe do të parashtrahen, në veçanti, ndikimin e pritshëm të ndryshimeve në program për arritjen e strategjisë

së Unionit për rritje “të zgjuar”, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe objektivat specifike të përcaktuar në program, duke marrë parasysh Dispozitat e Përgjithshme dhe Rregulloren ETC, parimet horizontale të përmendura në nenet 5, 6 dhe 7, si dhe Marrëveshjen e Partneritetit. Këto kërkesa duhet të shoqërohen nga një program i rishikuar. Paragrafët 3 dhe 4 do të zbatohen për ndryshimet në Program.

Neni 11

Zhvillimi i drejtuar nga komuniteti lokal, planet e përbashkëta të veprimit dhe investimet e integruara territoriale

1. Programi mund të kryejë veprime:

a) të zhvillimeve të drejtuara nga komuniteti lokal në kuptimin e neneve 32- 35 të CPR-së;

b) të planeve të përbashkëta të veprimit në kuptimin e neneve 104-109 të CPR-së, të hartuara në përputhje me nenin 4 dhe shtojcën IV të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 2015/207²¹; dhe

c) të investimeve të integruara territoriale në kuptimin e nenit 36 të CPR-së.

2. Veprimet e përmendura në paragrafin 1 duhet të kenë parasysh nenet 9-11 të Rregullores ETC.

Neni 12

Përzgjedhja e operacioneve

1. Operacionet në kuadër të Programit do të zgjidhen nga komiteti monitorues. Komiteti monitorues mund të krijojë një komitet drejtues që vepron nën përgjegjësinë e tij për zgjedhjen e operacioneve.

2. Operacionet e përzgjedhura do të përfshijnë përfitues nga të paktën dy vende pjesëmarrëse, ku të paktën njëri prej të cilëve do të jetë nga një

²¹ Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2015/207 e 20 janarit 2015, që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për sa i përket modeleve për raportin e progresit, dorëzimin e informacionit për një projekt madhor, planin e përbashkët të veprimit, raportet e zbatimit për investime me qëllim rritjen dhe punësimin, deklaratën e menaxhimit, strategjinë e auditimit, opinionin e auditimit dhe raportin vjetor të kontrollit dhe metodologjinë për kryerjen e analizave kosto-përfitim dhe në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1299/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit lidhur me modelin për raportet e zbatimit për qëllim të bashkëpunimit territorial evropian, GZ L 38, 2015/02/13, f. 1.



shtet anëtar. Një operacion mund të zbatohet në një vend të vetëm pjesëmarrës, me kusht që të identifikohen ndikimet dhe përfitimet trans-kombëtare.

Megjithatë, shtetet anëtare pjesëmarrëse mund të vendosin në komitetin monitorues një pikat më poshtë, vetëm nëse është rënë dakord ndryshe në Programin:

a) operacionet që i nënshtrohen një thirrjeje të caktuar për propozime mund të mos përfshijnë përfitues nga përfituesi IPA II, derisa përfituesi IPA II të ketë përfunduar Marrëveshjen Financiare; ose

b) përfituesit nga përfituesit IPA II mund të marrin pjesë në një thirrje të caktuar për propozime vetëm me kusht që përfituesi IPA II të ketë përfunduar këtë Marrëveshje Financimi brenda një afati të caktuar; ose

c) autoriteti menaxhues mund të shtyjë nënshkrimin e dokumentit të grantit në lidhje me nenin 14 (7), derisa përfituesi IPA II të ketë përfunduar këtë Marrëveshje Financimi brenda një afati të caktuar; ose

d) autoriteti menaxhues mund të nënshkruajë dokumentin e grantit në lidhje me nenin 14 (7), duke shtuar një kusht në lidhje me vlefshmërinë e nënshkrimit që i referohet datës kur përfituesi IPA II ka përfunduar këtë Marrëveshje Financimi.

3. Përfituesit do të bashkëpunojnë në zhvillimin dhe zbatimin e operacioneve. Përveç kësaj, ata do të bashkëpunojnë qoftë në plotësimin me staf ose në financimin e operacioneve.

Neni 13

Lejet dhe autorizimi

Çdo lloj leje dhe/ose autorizimi i kërkuar për zbatimin e Programit duhet të sigurohet në kohën e duhur nga autoritetet kompetente të përfituesit IPA II, në përputhje me të drejtën kombëtare përpara se autoriteti menaxhues t'i dërgojë dokumentin e grantit të përmendur në nenin 14 (7) përfituesit kryesor.

Neni 14

Përfituesit

1. Në rastet kur ka dy ose më shumë përfitues për një operacion të Programit, njëri prej tyre

caktohet nga të gjithë përfituesit si përfituesi kryesor.

2. Përfituesi kryesor do të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) përcaktojë rregullimet me përfituesit e tjerë përmes një marrëveshjeje që përmban dispozitat të cilat, ndër të tjera, garantojnë menaxhim të shëndoshë financiar të fondeve të alokuara për operacionin, përfshirë rregullimet për rikthimin e shumave të paguara në mënyrë të papranueshme;

b) marrë përgjegjësinë për sigurimin e zbatimit të të gjithë operacionit;

c) sigurojë që shpenzimet e paraqitura nga të gjithë përfituesit janë kryer për zbatimin e operacionit dhe që korrespondojnë me aktivitetet e dakordësuara nga të gjithë përfituesit e që është në përputhje me dokumentin e siguruar nga autoriteti menaxhues në zbatim të nenit 12(5) të Rregullores ETC;

d) siguron që shpenzimet e paraqitura nga përfituesit e tjerë janë verifikuar nga kontroll(uesit)²², kur ky verifikim nuk kryhet nga autoriteti menaxhues në përputhje me nenin 23(1) të rregullores ETC.

3. Nëse nuk specifikohet ndryshe në marrëveshjet e përmendura në pikën (a) të paragrafit 2, përfituesi kryesor duhet të sigurojë që përfituesit e tjerë të marrin shumën totale të mbështetjes publike sa më shpejtë të jetë e mundur dhe të plotë. Nuk do të zbritet/mbahet asnjë shumë dhe nuk do të vilet asnjë taksë specifike apo taksë tjetër me efekt të njëvleftshëm e cila do të reduktonte shumat për përfituesit e tjerë.

4. Përfituesi kryesor do të jetë vendoset në një Shtet Anëtar që merr pjesë në programin e bashkëpunimit. Megjithatë, Shtetet Anëtare dhe përfituesi IPA II që marrin pjesë në një program bashkëpunimi mund të bien dakord që përfituesi kryesor të vendoset në përfituesin IPA II, që është pjesëmarrës në këtë program të bashkëpunimit, me kusht që autoriteti menaxhues të japë pëlqimin që përfituesi kryesor të kryejë detyrat e përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 dhe që të plotësohen kërkesat për menaxhimin, kontrollin dhe verifikimin.

5. Përfituesit e vetëm duhet të jenë të regjistruar në një Shtet Anëtar që merr pjesë në programin e bashkëpunimit. Megjithatë, ato

²² Siç përcaktohet në nenin 37(3).



mund të jenë të regjistruar në një Shtet Anëtar që nuk merr pjesë në program, me kusht që të plotësojë kushtet e përcaktuara në nenin 12 (3) të Rregullores ETC.

6. Pavarësisht nga neni 12 (2), një EGTC ose ndonjë organ tjetër ligjor, i themeluar sipas ligjeve të një vendi pjesëmarrës, mund të aplikojnë si përfitues i vetëm për një operacion, me kusht që ajo të jetë ngritur nga autoritetet apo organet publike e të paktën dy vende pjesëmarrëse.

7. Autoriteti menaxhues do t'i sigurojë përfituesit kryesor apo përfituesit të vetëm për secilin operacion një dokument që përcakton kushtet për mbështetjen e operacionit, duke përfshirë kushtet specifike që kanë të bëjnë me produktet apo shërbimet që do të ofrohen sipas operacionit, planin e financimit dhe afatin për ekzekutim ("dokumenti i grantit").

Dokumenti i grantit do të përcaktojë edhe metodën që do të zbatohet për përcaktimin e kostove të operacionit dhe kushtet për pagesën e grantit.

Në zbatim të vendimit të marrë nga Shtetet Anëtare pjesëmarrëse në komitetin monitorues në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit 12, autoriteti menaxhues mund:

a) të shtyjë nënshkrimin e dokumentit të grantit; ose

b) të përcaktojë në dokumentin e grantit një kusht që dokumenti i grantit të bëhet i vlefshme vetëm për sa ka të bëjë me një përfitues në përfituesin IPA II, kur përfituesi IPA II të ketë respektuar një vendim të tillë.

Seksioni III

Monitorimi, vlerësimi dhe asistenca teknike

Nënseksioni 1

Monitorimi

Neni 15

Ngritja dhe përbërja e Komitetit të Monitorimit

1. Brenda tre muajve nga data e njoftimit të Shtetit Anëtar mbi vendimin që miraton Programin, vendet pjesëmarrëse do të ngrënë Komitetin e Monitorimit (KM) sipas një marrëveshje me autoritetin menaxhues për të monitoruar zbatimin e programit.

2. KM-ja do të hartojë dhe miratojë rregulloren e saj.

3. Përbërja e KM-së duhet të dakordësohet nga vendet pjesëmarrëse dhe duhet të përfshijë përfaqësues përkatës nga këto vende. Komiteti i Monitorimit mund të ketë në përbërje përfaqësues të EGTC-së që zhvillojnë aktivitetet lidhur me Programin brenda zonës së programit.

4. Lista e anëtarëve të KM-së duhet të publikohet.

5. Komisioni do të marrë pjesë në punën e KM-së në rolin e kapacitetit mbikëqyrës.

6. Nëse EIB kontribuon në Program, ajo mund të marrë pjesë në punën e KM-së në rolin e kapacitetit mbikëqyrës.

7. KM-ja do të drejtohet nga një përfaqësues i Shtetit Anëtar ose nga autoriteti menaxhues.

Neni 16

Funksionet e Komitetit Monitorues

1. KM-ja mblidhet të paktën një herë në vit dhe shqyrton zbatimin e programit dhe progresin e bërë në arritjen e objektivave. Për të realizuar këtë, ajo duhet t'u kushtojë rëndësi të dhënave financiare, treguesve të përbashkët dhe specifike të programit, përfshirë ndryshimet në vlerën e treguesve të rezultateve dhe progresin ndaj vlerave të synuara sasiore, si dhe arritjet e përcaktuara në kornizën e performancës së përmendur në nenin 21 (1) të CPR-së dhe, ku është e përshtatshme, rezultatet e analizave sasiore.

2. Komiteti i Monitorimit shqyrton të gjitha çështjet që ndikojnë në zbatimin e programit, përfshirë përfundimet e rishikimit të performancës.

3. KM-ja shqyrton në veçanti:

a) çdo çështje që ndikon në zbatimin e programit operacional;

b) progresin e arritur në zbatimin e planit të vlerësimit dhe ndjekjen sipas të dhënave të vlerësimeve;

c) zbatimin e strategjisë së komunikimit;

d) zbatimin e planeve të përbashkëta të veprimit;

e) veprimet për të nxitur barazinë mes burrave dhe grave, mundësitë e barabarta dhe mos-diskriminimin, përfshirë qasjen e personave me aftësi të kufizuara;



f) veprimet për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

4. KM-ja shqyrton dhe miraton:

a) metodologjinë dhe kriteret e përdorura për përzgjedhjen e operacioneve;

b) raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit;

c) planin e vlerësimit për Programin dhe ndonjë ndryshim tjetër të planit të vlerësimit sipas nenit 21 (6) të CPR-së;

d) strategjinë e komunikimit për Programin dhe çdo ndryshim tjetër të strategjisë;

e) çdo propozim nga autoriteti menaxhues për ndryshime të Programit.

5. Komiteti i Monitorimit mund të kryejë vëzhgime në autoritetin menaxhues lidhur me zbatimin dhe vlerësimin e programit, përfshirë veprimet që kanë të bëjnë me reduktimin e barrës administrative për përfituesit. Komiteti i Monitorimit monitoron veprimet e ndërmarra si rezultat i vëzhgimeve të saj.

Neni 17

Raportimi

1. Deri më 31 maj 2016 dhe në të njëjtën datë të çdo viti pasardhës dhe përfshirë vitin 2023, autoriteti menaxhues duhet të dorëzojë në Komision një raport vjetor të zbatimit në përputhje me nenin 50 (1) të CPR-së.

Raporti i zbatimit i dorëzuar në 2016 duhet të mbulojë vitet fiskale 2014 dhe 2015.

2. Për raportet që do të dorëzohen në 2017 dhe 2019, afati i përmendur në paragrafin 1 do të jetë 30 qershor.

3. Raportet vjetore të zbatimit përcaktojnë informacione kyç për zbatimin e Programit dhe prioritetet e tij duke iu referuar të dhënave financiare, treguesve të përbashkët dhe specifikë të programit, përfshirë ndryshimet në vlerën e treguesve të rezultateve ku është e përshtatshme dhe, duke filluar nga raporti vjetor i zbatimit që do të dorëzohet në 2017, arritjet e përcaktuara në kornizën e performancës. Të dhënat e transmetuara duhet të lidhen me vlerat për treguesit për operacione të zbatuara plotësisht dhe gjithashtu, ku është e përshtatshme, duke pasur parasysh fazën e zbatimit, për operacionet e përzgjedhura. Ato gjithashtu duhet të përcaktojnë një sintezë të përfundimeve të të gjitha vlerësimeve të programit që janë mundësuar gjatë

vitit të mëparshëm të financimit, çdo çështje që ndikon në zbatimin e programit dhe masat e ndërmarra.

Ku është e përshtatshme, raportet vjetore të zbatimit duhet të shprehin progresin në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve madhore dhe planeve të përbashkëta të veprimit.

4. Në lidhje me raportet vjetore të zbatimit të dorëzuara në 2017 dhe 2019, zbatohet neni 14 (4) i Rregullores ETC.

5. Raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit hartohen në përputhje me nenin 8 dhe shtojcën X të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 2015/207.

Neni 18

Takim vjetor për rishikimin

1. Një takim vjetor për rishikimin do të organizohet çdo vit nga 2016 deri në dhe duke përfshirë 2023, mes Komisionit, Shtetit Anëtar dhe përfituesit IPA II, për të shqyrtuar zbatimin e Programit, duke marrë në konsideratë raportin vjetor të zbatimit dhe komentet e komisionit ku janë të zbatueshme. Takimi vjetor për rishikimin mund të mbulojë më shumë se një program.

2. Duke u shmangur nga paragrafi 1, Shteti Anëtar dhe Komisioni mund të bien dakord që të mos organizojnë takimin vjetor për rishikimin e Programit në vitet e tjera, përveç 2017 dhe 2019. Në këtë rast, rishikimi vjetor mund të kryhet me shkrim.

3. Takimi vjetor i rishikimit do të kryesohet nga Komisioni ose, nëse e kërkon Shteti Anëtar, ai mund të bashkëkryesohet nga Shteti Anëtar dhe Komisioni.

4. Shteti Anëtar dhe përfituesi IPA II duhet të garantojnë që komentet e Komisionit të ndiqen në mënyrën e duhur pas takimit vjetor të rishikimit lidhur me çështjet të cilat ndikojnë ndjeshëm në zbatimin e Programit dhe, sipas rastit, informojnë Komisionin, brenda tre muajve, rreth masave të marra.

Neni 19

Transmetimi i të dhënave

1. Deri më 31 janar, 31 korrik dhe 31 tetor të çdo viti, autoriteti menaxhues duhet të transmetojë elektronikisht në Komision për



qëllime monitorimi, për Programin dhe sipas aksit prioritar:

a) kostot totale dhe publike të pranueshme për operacionet dhe numrin e operacioneve të përzgjedhura për mbështetje;

b) shpenzimet totale të pranueshme që janë deklaruar nga përfituesit në autoritetin menaxhues.

2. Përveç kësaj, transmetimi i të dhënave, i bërë deri më 31 janar, duhet të përmbajë të dhënat e mësipërme të ndara për kategori të ndërhyrjes. Transmetimi duhet të merret në konsideratë për të përmbushur kërkesat për dorëzimin e të dhënave financiare të përmendura në nenin 50 (2) të CPR-së.

3. Parashikimi i shumës për të cilin autoriteti menaxhues pret të dorëzojë aplikimet e pagesave për vitin aktual financiar dhe vitin pasardhës financiar duhet t'i shoqërohet transmetimit që do të bëhet deri më 31 janar dhe 31 korrik.

4. Data përfundimtare për transmetimin e të dhënave nën këtë paragraf do të jetë fundi i muajit që paraprin muajin e dorëzimit.

5. Të dhënat financiare dorëzohen në përputhje me nenin 2 dhe shtojcën II të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 1011/2014²³.

Neni 20

Informimi dhe komunikimi

1. Autoriteti menaxhues është përgjegjës për aktivitetet e informimit dhe komunikimit, siç përcaktohet në nenet 115, 116 dhe 117 të CPR-së.

2. Nenet 3, 4, dhe 5 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 821/2014²⁴, që kanë të bëjnë

²³ Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 1011/2014 e 22 shtatorit 2014, që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit lidhur me modelet për dorëzimin e informacionit të caktuar në Komisionin dhe rregullat e detajuara në lidhje me shkëmbimin e informacionit ndërmjet përfituesve dhe autoriteteve menaxhuese, autoriteteve certifikuese, autoritetet e auditimit dhe trupave të ndërmjetëm, GZ L 286, 30.9.2014, f. 1.

²⁴ Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 821/2014 e 28 korrikut 2014, që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit lidhur me rregullimet e detajuara për transferimin dhe menaxhimin e kontributeve të programit, raportimin mbi instrumentet financiare, karakteristikat teknike të informacionit dhe komunikimit, masat për operacionet dhe sistemi për të regjistruar dhe ruajtur të dhënat, GZ L 223, 2014/07/29, f. 7.

me karakteristikat teknike të masave për informimin dhe komunikimin për operacionet dhe udhëzimet për krijimin e emblemës së Unionit, si dhe një përkufizim rreth ngjyrave standarde do të zbatohen.

Nënseksioni 2

Vlerësimi

Neni 21

Parimet e vlerësimit dhe vlerësimet specifike

1. Vlerësimet do të kryhen për të përmirësuar cilësinë e hartimit dhe zbatimit të programeve, si dhe për të vlerësuar efektivitetin e tyre, efikasitetin dhe ndikimin. Ndikimi i programeve do të vlerësohet, në kuadër të misionit të ERDF-së, në lidhje me objektivat nën strategjinë e Unionit për rritje “të zgjuar”, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe, duke marrë në konsideratë madhësinë e programit, në lidhje me PBB-në dhe papunësinë në zonën e programit në fjalë, ku është e përshtatshme.

2. Vendet pjesëmarrëse duhet të sigurojnë burimet e nevojshme për kryerjen e vlerësimeve dhe duhet të sigurojnë që procedurat janë aktive për të prodhuar dhe për të mbledhur të dhënat e nevojshme për vlerësimet, duke përfshirë të dhënat që lidhen me treguesit e programeve të përbashkëta dhe, ku është e përshtatshme, të programeve specifike.

3. Vlerësimet duhet të kryhen nga ekspertë të brendshëm ose të jashtëm, të cilët veprojnë të pavarur nga autoritetet përgjegjëse për zbatimin e programit. Komisioni duhet të sigurojë udhëzime për mënyrën e kryerjes së vlerësimeve, menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

4. Të gjitha vlerësimet duhet t'i mundësohen publikut.

5. Vendet pjesëmarrëse kryejnë bashkërisht vlerësime *ex ante* në përputhje me nenin 55 të CPR-së.

6. Neni 56 i CPR-së do të zbatohet për vlerësimin gjatë periudhës së programimit.

Në veçanti, autoriteti menaxhues duhet të hartojë një plan vlerësimi që do t'i dorëzohet KM-së, jo më vonë se një vit pas miratimit të Programit.

7. Neni 57 i CPR-së do të zbatohet për vlerësimin *ex post*.



Nënseksioni 3 Asistenca teknike

Neni 22 Qëllimi

Me nismën e një vendi pjesëmarrës, asistenca ERDF mund të mbështesë veprimet për përgatitjen, menaxhimin, monitorimin, vlerësimin, informimin dhe komunikimin, krijimin e rrjetit, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, kontrollin dhe auditimin. Asistenca ERDF mund të shfrytëzohet nga vendet pjesëmarrëse për të mbështetur veprimet për reduktimin e barrës administrative për përfituesit, përfshirë sistemin e shkëmbimit të dhënave elektronike dhe veprimet për të rritur kapacitetet e autoriteteve të Shtetit Anëtar, si dhe të përfituesve për të administruar dhe shfrytëzuar asistencën ERDF.

Asistenca ERDF mundet gjithashtu të shfrytëzohet për të mbështetur veprimet që kanë të bëjnë me rritjen e kapaciteteve të partnerëve përkatës (shih nenin 7 për partnerët dhe partneritetin) në përputhje me shkronjën (e) të nenit 5 (3) CPR dhe për të mbështetur shkëmbimin e praktikave më të mira ndërmjet partnerëve të tillë.

Veprimet e përmendura në këtë paragraf mund të prekin periudhat e mëparshme dhe pasardhëse të programimit.

Neni 23 Tavani

Shuma e asistencës ERDF, të alokuar për asistencë teknike do të limitohet në 6% të shumës totale të alokuar për programin e bashkëpunimit. Për programe me llokim total që nuk e kalon 50,000,000 euro, shumën e ERDF-së së alokuar për asistencë teknike do të jetë e limituar në 7% të shumës totale të alokuar për programin, por nuk duhet të jetë më pak se 1,500,000 euro dhe jo më shumë se 3,000,000 euro.

Seksioni IV Pranueshmëria e shpenzimeve dhe kohëzgjatja e operacioneve

Neni 24 Parimet e pranueshmërisë

1. Në përputhje me nenin 18 (2) të Rregullores ETC, hierarkia e rregullave të pranueshmërisë për këtë Program është përcaktuar si më poshtë:

Pa cenuar rregullat e pranueshmërisë të përcaktuara në këtë seksion ose në aktet e deleguara që janë përmendur në nenet 27 dhe 30, vendet pjesëmarrëse në KM duhet të vendosin rregulla shtesë për shpenzimet e pranueshme të Programit në tërësi.

Për çështjet që nuk mbulohen nga rregullat e pranueshmërisë, të përcaktuara në këtë seksion ose në aktet e deleguara që janë përmendur në nenet 27 dhe 30 apo në rregullat e vendosura bashkërisht nga vendet pjesëmarrëse në përputhje me nënparagrafin e dytë, do të zbatohen rregullat kombëtare të Shtetit Anëtar ose të përfituesit IPA II ku kanë ndodhur shpenzimet.

2. Një operacion mund të marrë mbështetje nën këtë Program dhe nga instrumente të tjera të Unionit, me kusht që artikujt e shpenzimeve të përfshira në aplikimin e pagesës për rimbursim nga asistenca ERDF nuk marrin mbështetje nga një instrument tjetër i Unionit ose mbështetje nga asistenca ERDF nën një program tjetër.

3. Në përputhje me nenin 3 (2) të Rregullores (BE) nr. 1301/2013, asistenca ERDF mund të mbështesë ndarjen e instrumenteve dhe burimeve njerëzore, si dhe të gjitha llojet e infrastrukturës përgjatë kufijve nën këtë Program.

4. Përveç neneve 22 dhe 23, me përjashtim të nenit 31, do të zbatohen edhe dispozitat e këtij seksioni për asistencë teknike.

Neni 25 Koha e pranimi

1. Shpenzimet janë të pranueshme për kontribut nga asistenca ERDF, si në Shtetin Anëtar dhe në përfituesin IPA II, nëse janë kryer nga një përfitues dhe janë paguar mes 1 janar 2014 dhe 31 dhjetor 2023.

2. Në rast se kostot janë rimbursuar në përputhje me shkronjat (b) dhe (c) të nënparagrafit të parë të nenit 26 (2), veprimet që përbëjnë bazën e rimbursimeve duhet të kryen mes 1 janar 2014 dhe 31 dhjetor 2023.

3. Shpenzimet që janë të pranueshme si rezultat i një ndryshimi në program do të pranohen vetëm nga data e dorëzimit në Komision të kërkesës për ndryshim ose në rast të zbatimit të nenit 10 (6), nga data e hyrjes në fuqi të vendimit që ndryshon Programin.



Neni 26

Format e mbështetjes; format e granteve dhe asistencë e shlyeshme

1. Asistenca ERDF do të përdoret për mbështetje në formën e granteve, çmimeve dhe asistencës së riparueshme ose si kombinim i tyre.

Në rast të asistencës së riparueshme, mbështetja e shlyer tek organi që e siguroi atë ose te një autoritet tjetër kompetent i Shtetit Anëtar ose përfituesit IPA II duhet të mbahet në llogari më vete ose veçmas me numër llogarie dhe e ripërdorur për të njëjtin qëllim, ose në përputhje me objektivat e Programit (neni 66 i CPR-së).

2. Grantet dhe asistenca e shlyeshme mund të marrë një nga format e mëposhtme:

a) rimbursimin e kostove të pranueshme që kanë ndodhur dhe janë paguar, së bashku me, ku është e përshtatshme, kontributet në natyrë dhe në amortizim;

b) matjet standarde të kostos për njësi;

c) shuma e përgjithshme nuk e kalon 100,000 euro të kontributit publik;

d) financim me normë të pandryshueshme, e përcaktuar nga aplikimi i përqindjes në një ose më shumë kategori të dhëna të kostove.

Mundësitë e përmendura në këtë nënparagraf mund të kombinohen vetëm kur secila mundësi mbulon kategori të ndryshme kostosh ose kur ato përdoren për projekte të ndryshme duke formuar një pjesë të një operacioni ose për faza të njëpasnjëshme të një operacioni.

3. Kur një operacion apo projekt që formon një pjesë të operacionit zbatohet drejtpërsëdrejti nëpërmjet prokurimit publik të punëve, të mirave dhe shërbimeve, do të zbatohet vetëm shkronja (a) e nënparagrafit të parë të paragrafit 2. Kur prokurimi publik për një operacion ose projekt që formon një pjesë të operacionit është e kufizuar në kategori të caktuara kostosh, mund të zbatohen të gjitha mundësitë e referuara në nënparagrafin e parë të paragrafit 2.

4. Shumat e përmendura në shkronjat (b), (c) dhe (d) të nënparagrafit të parë të paragrafit 2 do të caktohen në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) Metodë për llogaritje e drejtë, e verifikueshme dhe e arsyeshme që bazohet në:

i. të dhëna statistikore ose informacione të tjera rreth objektivave;

ii. të dhënat historike të verifikueshme të përfituesve individualë; ose

iv. zbatimin e praktikave të zakonshme për llogaritjen e kostove të përfituesve individualë.

b) Në përputhje me rregullat për zbatimin e matjeve korresponduese të kostove për njësi, shumat e përgjithshme dhe normat e pandryshueshme që zbatohen në politikat e Unionit për lloje të ngjashme operacioni dhe përfituesi.

c) Në përputhje me rregullat për zbatimin e matjeve korresponduese të kostove për njësi, shumat e përgjithshme dhe normat e pandryshueshme që zbatohen sipas skemave për grante të financuara plotësisht nga Shteti Anëtar për lloje të ngjashme operacioni dhe përfituesi.

d) Normat e pranura në këtë Marrëveshje ose rregullat specifike për Fondin.

e) Metoda të veçanta për përcaktimin e shumave, të pranura në përputhje me rregullat specifike për Fondin.

5. Lidhur me pranueshmërinë e kontributeve në natyrë, në formën e përgatitjes së punëve, të mirave, shërbimeve, vendit dhe pasurive të patundshme, do të zbatohet neni 69 (1) i CPR-së.

6. Kostot e amortizuara mund të merren si të pranueshme në përputhje me nenin 69 (2) të CPR-së.

Neni 27

Normat e pandryshueshme për kostot e tërthorta dhe kostot e personelit

1. Kur zbatimin e një operacioni sjell kosto të tërthorta, ato mund të llogariten në bazë të normës së pandryshueshme në një prej mënyrave të mëposhtme:

a) normë e pandryshueshme deri në 25% të kostove të pranueshme të drejtpërdrejta, me kusht që norma të llogaritet mbi bazën e një metode të drejtë, të arsyeshme dhe të verifikueshme llogaritjeje ose mbi bazën e një metode të zbatuar nën skemat e granteve të financuara plotësisht nga Shteti Anëtar ose përfituesi IPA II për lloje të ngjashme operacioni dhe përfituesi;

b) normë e pandryshueshme deri në 15% të kostove të drejtpërdrejta të pranueshme për staf pa ndonjë kërkesë për Shtetin Anëtar ose përfituesin IPA II që të kryejë llogaritje për të përcaktuar normën e zbatueshme;



c) normë e pandryshueshme për kostot e drejtpërdrejta të pranueshme bazuar në metodat ekzistuese dhe normat korresponduese, të zbatueshme në politikat e Unionit për lloje të ngjashme operacioni dhe përfituesi.

Nenet 20 dhe 21 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 480/2014²⁵, që kanë të bëjnë me përkufizimin e normës së pandryshueshme dhe metodat përkatëse të përmendura në shkronjën (c) të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi do të zbatohen.

Me qëllim përcaktimin e kostove të stafit për zbatimin e një operacioni, norma për orë mund llogaritet duke pjesëtuar kostot vjetore bruto të dokumentuara për punësimin me 1 720 orë.

2. Kostot e stafit të një operacioni mund të llogariten me normë të pandryshueshme deri në 20% të kostove të drejtpërdrejta, të ndryshme nga kostot e stafit të atij operacioni.

Neni 28

Shpenzimet e papranueshme

1. Asistenca ERDF nuk mbështet:

a) nxjerrjen jashtë përdorimit ose ndërtimin e stacioneve të energjisë bërthamore;

b) investimet për të arritur uljen e emetimeve të gazit serë nga aktivitetet e renditura në shtojcën I të Direktivës 2003/87/KE;

c) prodhimin, përpunimin dhe marketingun e duhanit dhe produkteve të duhanit;

d) sipërmarrjet në vështirësi, siç përcaktohet nën rregullat e ndihmës shtetërore të Unionit;

e) investimet në infrastrukturën aeroportuale, vetëm nëse ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit ose shoqërohet nga investime të nevojshme për të lehtësuar apo ulur ndikimin e tij negativ në mjedis;

f) interesat për borxhe;

g) blerjen e tokës pa ndërtime dhe tokës me ndërtime, në shumën deri 10% të shpenzimeve totale të pranueshme për operacionin në fjalë. Për pronat e braktisura dhe ato dikur për shfrytëzim industrial që përbëjnë ndërtesa, ky kufizim rritet në 15%. Në raste të jashtëzakonshme dhe të

justifikuara qartë, ky kufizim mund të rritet mbi përqindjet përkatëse pararendëse për operacionet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit;

h) taksa e vlerës së shtuar (TVSH), përveç rasteve kur ajo është e parikuperueshme nën legjislacionin kombëtar për TVSH.

2. Operacionet nuk do të përzgjidhen për asistencë ERDF kur ato janë plotësuar fizikisht ose zbatuar plotësisht përpara se aplikimi për financim nën Program të dorëzohet nga përfituesi tek autoriteti menaxhues, pavarësisht nëse të gjitha pagesat janë bërë nga përfituesi.

3. Në përputhje me shkronjën (I) të nenit 4 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 481/2014, taksat për transaksione brenda Shtetit Anëtar ose brenda përfituesit IPA II nuk janë të pranueshme.

Neni 29

Pranueshmëria në varësi të vendndodhjes

1. Operacionet, që i përjashtohen siç përmendet në paragrafët 2 dhe 3, do të pozicionohen në zonën e programit që përbën pjesën e territorit të vendeve pjesëmarrëse, siç përcaktohet në Program (“zona e Programit”).

2. Autoriteti menaxhues mund të pranojë që i gjithë operacioni ose pjesërisht të zbatohet jashtë zonës së programit, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) operacioni të jetë në përfitim të zonës së programit;

b) shuma totale e alokuar sipas Programit për operacionet jashtë zonës së programit të mos i kalojë 20% të asistencës ERDF në nivel programi;

c) detyrimet e autoriteteve të menaxhimit dhe auditimit lidhur me menaxhimin, kontrollin dhe auditimin e operacionit të përmbushen nga autoritetet e Programit ose të hyjnë në marrëveshje me autoritetet në Shtetin Anëtar ose përfituesin IPA II ku po zbatohet operacioni.

3. Për operacionet që kanë të bëjnë me asistencën teknike, aktivitetet promociionale dhe ngritjen e kapaciteteve, shpenzimet mund të kryhen jashtë zonës së programit, me kusht që të plotësohen kriteret në shkronjën (a) dhe (c) të paragrafit 2.

4. Duke pasur parasysh objektivat specifike të IPA II, të përcaktuar në nenin 3 (1) dhe (2), kontributi ERDF nga zëri buxhetor 4 (IPA II)

²⁵ Siç është amenduar nga Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 2015/616, e datës 13 shkurt 2015, që ndryshon Rregulloren Deleuese (BE) nr. 480/2014, lidhur me referencat e përdorura në vazhdim në Rregulloren (BE) nr. 508/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, GZ L 102, 21.4.2015, f. 33.



nuk duhet të shpenzohet në zonën e programit që përbën territorin e Unionit.

Neni 30

Rregullat e veçanta të pranueshmërisë për kategori të caktuara të shpenzimeve

1. Zbatohet Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) nr. 481/2014²⁶.

2. Megjithatë, pa cenuar nenin 5 (5) deri (8) të kësaj Rregulloreje, zbatohet si më poshtë:

a) Për operacionet në lidhje me asistencën teknike ose aktivitetet promocionale dhe ngritjen e kapaciteteve, shpenzimet e shkaktuara jashtë zonës së programit janë të pranueshme vetëm nëse janë kryer në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikat (a) dhe (c) të nenit 29 (2).

b) Në lidhje me persona të tjerë, nga ata që mbulohen nga pikat d) dhe e), autoriteti menaxhues mund të pranojë shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit që janë kryer në vende/ose ndërmarrje të vendosura jashtë zonës së programit, por në një përfitues IPA II si të pranueshme për kontributin ERDF nga zëri buxhetor 4 (IPA II), gjithmonë nëse ndodhin në përputhje me nenin 29(2). Kjo zbatohet edhe për kostot e transportit lokal në vendin e eventit ose të ndonjë aktiviteti jashtë zonës së programit, por brenda Unionit.

c) Në lidhje me persona të tjerë, nga ato që mbulohen nga pikat d) dhe e), autoriteti menaxhues mund të pranojë shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit që janë kryer në vende/ose ndërmarrje të vendosura jashtë zonës së programit, por në një përfitues IPA II si të pranueshme për kontributin ERDF nga zëri buxhetor 4 (IPA II), nëse ndodhin në përputhje me nenin 29 (2) dhe (4). Kjo zbatohet edhe për kostot e transportit lokal në vendin e eventit ose të ndonjë aktiviteti jashtë zonës së programit, por në një përfitues IPA II.

d) Për stafin e përfituesve të vendosur jashtë zonës së programit, por brenda Unionit, autoriteti menaxhues mund të pranojë shpenzimet e përmendura në paragrafin 1, përfshi kostot e udhëtimit për dhe nga vendndodhja e një eventi

apo një veprimtarie brenda ose jashtë zonës së programit, si të pranueshme për kontributin ERDF nga zëri buxhetor 4 (IPA II), nëse janë bërë në përputhje me nenin 29 (2).

e) Për stafin e përfituesve të vendosur jashtë zonës së programit, por në një përfitues IPA II, autoriteti menaxhues mund të pranojë shpenzimet e përmendura në paragrafin 1, përfshi kostot e udhëtimit për dhe nga vendndodhja e një eventi apo një veprimtarie brenda ose jashtë zonës së programit, si të pranueshme për kontributin ERDF nga zëri buxhetor 4 (IPA II), nëse janë bërë në përputhje me nenin 29 (2) dhe (4).

f) Për stafin e përfituesve të vendosur brenda zonës së programit, kostot e referuara në paragrafin 1 të nenit 5 të Rregullores së Delegimit të Komisionit (BE) nr. 481/2014, përfshi kostot e udhëtimit për dhe nga vendndodhja e një eventi apo një veprimtarie brenda ose jashtë zonës së programit, konsiderohen të pranueshme për asistencën përkatëse ERDF në përputhje me nenin 29 (1).

Neni 31

Operacionet që gjenerojnë të ardhura neto pas përfundimit

1. Për sa i përket operacioneve të cilat gjenerojnë të ardhura neto gjatë zbatimit të tyre, zbatohet neni 65 (8) CPR.

2. Për sa i përket operacioneve të cilat gjenerojnë të ardhura neto pas përfundimit të tyre, zbatohet neni 61 CPR dhe nënparagrafi i katërt i nenit 65 (8) CPR.

Në pajtim me nenet 1 dhe 2 të Rregullores së Delegimit të Komisionit (BE) nr. 2015/1516²⁷ vendoset një normë e sheshtë prej 20% për operacionet në sektorin e kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit, siç referohet në pikën (a) të nënparagrafit të parë.

Zbatohen nenet 15 deri 19 të Rregullores së Delegimit të Komisionit (BE) nr. 480/2014²⁸ në

²⁶ Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) nr. 481/2014, e datës 4 mars 2014, që plotëson Rregulloren (BE) nr. 1299/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me rregullat specifike për pranueshmërinë e shpenzimeve për programet e bashkëpunimit, GZ L 138, 13.5.2014, f. 45.

²⁷ Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) 2015/15 e datës 10 qershor 2015, që themelon në pajtim me Rregulloren (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit një normë të sheshtë për operacionet që financohen nga Fondet Strukturore Evropiane dhe të Investimit në sektorin e Kërkimit, Zhvillimit dhe Inovacionit, GZ L 239, 15.9.2015, f. 65.

²⁸ Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) nr. 480/2014 e datës 3 mars 2014, që plotëson Rregulloren (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, që përcakton dispozitat



lidhje me metodën për llogaritjen e të ardhurave neto të zbritura të operacioneve që gjenerojnë të ardhura neto.

Neni 32

Qëndrueshmëria e operacioneve

Në lidhje me qëndrueshmërinë ose kohëzgjatjen e operacioneve zbatohet neni 71 i CPR-së.

Seksioni V

Prokurimi nga përfituesit e IPA II

Neni 33

Rregullat e zbatueshme të prokurimit

1. Për lidhjen e kontratave të shërbimit, furnizimit dhe të punës, përfituesit nga IPA II ndjekin procedurat e prokurimit:

a) dispozitat në nenet 190 dhe 191 të kapitullit 3, të titullit IV, të pjesës së dytë të Rregullores Financiare;

b) dispozitat e neneve 260- 276 të kapitullit 3, të titullit II, të pjesës së dytë të Rregullores së Delegimit (BE) nr. 1268/2012²⁹.

Veç kësaj, përfituesi IPA II mund të zgjedhë të shfrytëzojë Udhëzuesin Praktik për Procedurat e Kontraktimit për Aktivitetet e Jashtme të BE-së (PRAG), që plotëson dispozitat sipas pikave a) dhe b) të nënparagrafit të parë. Versioni i PRAG që do të përdoret është ai që është në fuqi në kohën e inicimit të procedurës përkatëse të prokurimit.

Në përputhje me nenin 18 (5) të Marrëveshjes Kuadër, ligji kombëtar i përfituesit IPA II që transponon Direktivën 2014/24/BE konsiderohet ekuivalent me rregullat e zbatuara nga Komisioni në pajtim me Rregulloren Financiare. Komisioni informon përfituesin IPA II dhe autoritetin menaxhues në lidhje me vlerësimin e këtij ligji kombëtar dhe fikson një

datë kur ky ligj kombëtar mund të fillojë të aplikohet për zbatimin e veprimeve ose operacioneve në kuadër të Programit.

2. Procedurat e prokurimit publik në lidhje me shpenzimet e lidhura me fazën përgatitore të një operacioni dhe të nisura nga përfituesit përpara dokumentit të grantit të përmendur në nenin 14 (7) që ishin dhënë përfituesit ndjekin gjithashtu dispozitat e referuara në paragrafin 1.

3. Procedurat e prokurimit publik, në lidhje me asistencën teknike të financuar si nga zëri buxhetor 1b edhe nga zëri buxhetor 4 (IPA II) dhe të zbatuara nga autoritetet e programit të vendosura në Shtetin Anëtar, ndjekin procedurat kombëtare të prokurimit publik që transpozojnë Direktivat e BE-së.

Neni 34

Rregullat mbi kombësinë dhe origjinën

1. Pjesëmarrja në dhënien e kontratave të prokurimit, granteve dhe procedurat e tjera të financimit për veprimet e financuara në kuadrin e Programit janë të hapura për të gjithë personat fizikë që janë shtetas të (dhe/ose personat juridikë të cilët janë të vendosur në mënyrë efektive në vendet pjesëmarrëse) Shteteve të tjera Anëtare, përfituesve të tjerë IPA II, palëve kontraktuese të Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane dhe vendeve partnere që mbulohen nga Instrumenti Evropian i Fqinjësisë (më poshtë referuar si “vendet e pranueshme”) dhe për Organizatat Ndërkombëtare³⁰.

Personat juridikë mund të përfshijnë organizatat e shoqërisë civile, të tilla si organizatat joqeveritare jofitimprurëse dhe fondacione politike të pavarura, organizatat me bazë komunitare dhe agjencitë jofitimprurëse të sektorit privat, institucionet dhe organizatat dhe rrjetet e tyre në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për sa kohë pasi ata janë të aftë për të pasur të drejta dhe detyrime ligjore, në përputhje me ligjet përkatëse kombëtare.

Autoriteti menaxhues mund të lejojë pjesëmarrjen në thirrjen për propozime të subjekteve pa personalitet juridik.

e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit, Fondin Evropian të Bujqësisë për Zhvillimin Rural dhe Fondin Evropian të Marinës dhe Peshkimit, dhe që përcakton dispozitat e përgjithshme për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Evropian të Marinës dhe Peshkimit, GZ L 138, 13.5.2014, f. 5.

²⁹ Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) nr. 1268/2012, e datës 29 tetor 2012, mbi rregullat e zbatimit të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Unionit, GZ L 362, 31.12.2012, f. 1.

³⁰ Organizatat ndërkombëtare janë organizatat ndërkombëtare të sektorit publik të përcaktuara nga marrëveshjet ndërqeveritare, agjencitë e specializuara të ngritura nga organizatat të tilla dhe organizatat e tjera jofitimprurëse asimiluar në organizatat ndërkombëtare me vendim të Komisionit.



2. Të gjitha pajisjet e blera sipas një kontrate të prokurimit ose në përputhje me një marrëveshje granti, financiar nën IPA II vijnë ose fillojnë nga një vend i pranueshëm.

Megjithatë, ato mund të vijnë nga çdo vend kur sasia e pajisjeve që do të blihet është nën pragun për përdorimin e procedurës konkurruese me negociata³¹. Për qëllime të këtij neni, termi “origjina” është përkufizuar në nenet 23 dhe 24 të Rregullores së Këshillit (EEC) nr. 2913/92³².

3. Rregullat sipas këtij neni nuk zbatohen dhe nuk krijojnë kufizime të kombësisë për personat fizikë të punësuar ose përndryshe kontraktuar në mënyrë të ligjshme nga një kontraktues i lejueshëm ose, kur është e zbatueshme, nënkontraktuesi.

4. Me qëllim promovimin e kapaciteteve lokale, tregjeve dhe blerjeve, prioritet do t'i jepet kontraktuesve lokalë dhe rajonalë kur Rregullorja Financiare parashikon dhënien në bazë të tenderit të vetëm. Në të gjitha rastet e tjera, pjesëmarrja e kontraktuesve lokalë dhe rajonalë promovohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores Financiare.

5. Pranueshmëria siç përcaktohet në këtë nen mund të kufizohet më tej në Kushtet e Veçanta të kësaj Marrëveshjeje Financimi në lidhje me kombësinë, vendndodhjen gjeografike apo natyrën e kandidatëve, ku kufizime të tilla kërkohen nga natyra specifike dhe objektivat e veprimit dhe ku ato janë të nevojshme për zbatimin efektiv të tij, në mënyrë të veçantë për pjesëmarrjen në procedurat e dhënies në rast të veprimeve të bashkëpunimit.

6. Ofertuesit, aplikuesit dhe kandidatët nga vendet jo të pranueshme ose, pa cenuar nënparagrafin e dytë të paragrafit 2, mallrat me origjinë jo të pranueshme mund të pranohen si të pranueshme nga autoriteti menaxhues, në rast urgjence apo mospasjes së produkteve dhe shërbimeve në tregjet e vendeve në fjalë, ose në raste të tjera të arsyeshme, kur zbatimi i rregullave të përshtatshmërisë do të bëjë realizimin e një

projekti, programi apo veprimi të pamundur apo shumë të vështirë.

7. Personat fizikë dhe juridikë të cilëve u janë dhënë kontratat përputhen me legjislacionin e mjedisit në fuqi, duke përfshirë marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore, si edhe standardet themelore të pranuara ndërkombëtarisht të punës³³.

Neni 35

Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Kontratat e lidhura me përfituesit e vendosur në vendin përfitues të IPA II financiar sipas kësaj Marrëveshjeje Financimi sigurojnë që përfituesi IPA II të marrë të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale të nevojshme në lidhje me teknologjinë e informacionit, studime, ilustrime, plane, publicitet dhe çdo material tjetër të bërë për qëllime të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit.

2. Përfituesi IPA II garanton që autoriteti menaxhues, Komisioni ose dikush apo ndonjë person i autorizuar nga Komisioni të ketë akses dhe të drejtën për të përdorur një material të tillë. Komisioni do të përdorë materiale të tilla vetëm për qëllimet e veta.

Seksioni VI

Menaxhimi, kontrolli dhe përcaktimi

Nënseksioni 1

Përcaktimi dhe funksionet e autoriteteve të programit

Neni 36

Përcaktimi i autoriteteve

1. Vendet pjesëmarrëse në Program kanë daktuar, për qëllimet e nenit 123 (1) CPR, një autoritet të vetëm menaxhimi; për qëllim të nenit 123 (2) CPR, një autoritet të vetëm certifikues, dhe për qëllim të nenit 123 (4) CPR, një autoritet të vetëm të auditimit, siç është përcaktuar në tabelën 21 të nenit 5.1 të Programit.

2. Autoriteti menaxhues nuk është përgjegjës për kryerjen e funksioneve të autoritetit

³¹ Shih pikën (b) (ii) të nenit 267 (1) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE, Euratom) nr. 1268/2012: kontratat me vlerë më të vogël se 100 000 euro.

³² Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 2913/92, 12 tetor 1992, që vendos Kodin Doganor të Komunitetit dhe legjislacionin tjetër të Komunitetit, që rregullon origjinën jopreferenciale, GZ L 302, 19 tetor 1992, f. 1.

³³ Standardet themelore të punës - Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), konventat për lirinë e shoqërive dhe negociatat kolektive, eliminimin e detyrueshëm të punës së detyruar, eliminimin e diskriminimit në lidhje me punësimin dhe profesionin dhe heqjen e punës së fëmijëve.



certifikues. Autoriteti certifikues merr pagesat e bëra nga Komisioni dhe si rregull i përgjithshëm bën pagesat për përfituesin kryesor në përputhje me nenin 132 CPR.

3. Procedura për përcaktimin e autoritetit menaxhues dhe, sipas rastit, i autoritetit certifikues, e përcaktuar në nenin 124 CPR, kryhet nga Shteti Anëtar në të cilin autoriteti është i vendosur.

Neni 37

Funksionet e autoritetit menaxhues

1. Pa cenuar paragrafin 2 të këtij neni, autoriteti menaxhues i Programit kryen funksionet e përcaktuara në nenin 125 CPR dhe në nenin 23.

2. Meqë autoriteti menaxhues nuk kryen verifikime sipas pikës (a) të nenit 125 (4) CPR në të gjithë zonën e programit, çdo Shtet Anëtar ose secili përfitues IPA II cakton organin ose personin përgjegjës për kryerjen e verifikimeve të tilla në lidhje me përfituesit në territorin e vet (“kontrollor (ët)”), siç përcaktohet në tabelën 22 të seksionit 5.1 të Programit.

3. Autoriteti menaxhues siguron se shpenzimi i çdo pjesëmarrje përfituese në një operacion është verifikuar nga një kontrollues i përcaktuar.

4. Secili vend pjesëmarrës siguron që shpenzimi i një përfituesi mund të verifikohet brenda një periudhe prej tre muajsh nga dorëzimi i dokumenteve nga ana e përfituesit në fjalë.

5. Çdo vend pjesëmarrës është përgjegjës për verifikimet e kryera në territorin e tij.

6. Kur shpërndarja e produkteve apo shërbimeve të bashkëfinancuara mund të verifikohet vetëm në lidhje me një operacion të tërë, verifikimi kryhet nga autoriteti menaxhues ose kontrolluesi i Shtetit Anëtar ku përfituesi kryesor ndodhet.

Neni 38

Sekretariati i përbashkët

Autoriteti menaxhues, pas konsultimit me Shtetet Anëtare dhe çdo përfitues IPA II që merr pjesë në një program bashkëpunimi, ngre një sekretariat të përbashkët, siç është përcaktuar në seksionin 5.2 të Programit.

Neni 39

Funksionet e autoritetit certifikues

Autoriteti certifikues i Programit kryen funksionet e përcaktuara në nenin 126 CPR.

Neni 40

Funksionet e autoritetit të auditimit

1. Shtetet Anëtare pjesëmarrëse dhe përfituesi IPA II mund të autorizojnë autoritetin e auditimit për të kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë funksionet e parashikuara në nenin 127 CPR në të gjithë territorin e mbuluar nga Programi. Ata specifikojnë se kur autoriteti i auditimit duhet të shoqërohet nga një auditues i një Shteti Anëtar ose përfituesit IPA II.

2. Kur autoriteti i auditimit nuk ka autorizimin e përmendur në paragrafin 1, ai ndihmohet nga një grup i auditorëve që përbëhet nga një përfaqësues për çdo Shtet Anëtar që merr pjesë ose nga përfituesi IPA II dhe që kryerjen funksionet e parashikuara në nenin 127 CPR, të renditura në tabelën 22 të seksionit 5.1 të Programit. Çdo Shtet Anëtar ose përfituesi IPA II janë përgjegjës për auditimet e kryera në territorin e vet.

3. Çdo përfaqësues nga një Shtet Anëtar ose nga përfituesi IPA II është përgjegjës për sigurimin e elementeve faktike që lidhen me shpenzimet në territorin e tij, të cilat kërkohen nga autoriteti i auditimit për të kryer vlerësimin e tij.

4. Grupi i audituesve duhet të ngrihet brenda tre muajve nga vendimi për miratimin e programit të bashkëpunimit. Ai harton pikërisht rregullat e procedurës dhe do të kryesohet nga autoriteti i auditimit për programin e bashkëpunimit.

5. Audituesit janë funksionalisht të pavarur nga kontrollorët që kryejnë verifikimet në bazë të nenit 37.

Neni 41

Funksionet e autoriteteve të përfituesit IPA II

1. Autoritetet dhe organet e përfituesit IPA II mbështesin Shtetin Anëtar në përgjegjësitë e tij dhe bashkëpunojnë besnikërisht me autoritetet e vetme të Programit.

2. Në përputhje me ligjin e vet kombëtar, përfituesi IPA II mund të autorizojë autoritetin e



auditimit për të kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë funksionet e parashikuara në nenin 127 CPR në të gjithë territorin e mbuluar nga një program bashkëpunimi. Ai autorizim specifikon se kur autoriteti i auditimit do të shoqërohet nga një auditues i përfituesit IPA II.

Kur autoriteti i auditimit nuk e ka autorizimin e përmendur në nënparagrafin e parë, ai ndihmohet nga një përfaqësues i përfituesit IPA II në kryerjen e funksioneve të parashikuara në nenin 127 CPR.

Në rastin e përshkruar në nënparagrafin e dytë, përfituesi IPA II është përgjegjës për auditimet e kryera në territorin e tij.

Përfaqësuesi nga përfituesi IPA II siguron që puna e auditimit merr parasysh standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht.

Përfaqësuesi nga përfituesi IPA II është përgjegjës për sigurimin e elementeve faktike në lidhje me shpenzimet në territorin e tij, të cilat janë kërkuar nga autoriteti i auditimit për të kryer vlerësimin e tij.

Përfaqësuesi nga vendi përfitues IPA II është funksionalisht i pavarur nga kontrollues/it që kryejnë verifikimet në bazë të nenit 37.

Nënseksioni 2

Menaxhimi dhe kontrolli

Neni 42

Parimet e përgjithshme të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit

1. Në përputhje me nenin 122 (1) CPR, Shteti Anëtar siguron që sistemet e menaxhimit dhe kontrollit për programin janë ngritur në përputhje me nenet 72, 73 dhe 74 CPR.

2. Në veçanti, Shteti Anëtar siguron që jo më vonë se 31 dhjetor 2015 të gjitha shkëmbimet e informacionit midis përfituesve dhe një autoriteti menaxhues, një autoriteti certifikues, një autoriteti të auditimit dhe organeve të ndërmjetme të mund të kryhen me anë të sistemeve elektronike të shkëmbimit të të dhënave.

Sistemet e përmendura në nënparagrafin e parë do të lehtësojnë ndërveprimin me kuadrin kombëtar dhe atë të Unionit, duke marrë në konsideratë që përfituesit të paraqesin të gjithë informacionin e referuar në nënparagrafin e parë vetëm një herë.

Në lidhje me shkëmbimin elektronik të informacionit zbatohen nenet 8 deri 10 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 1011/2014.

Neni 43

Menaxhimi i përbashkët dhe përgjegjësitë

Në përputhje me parimin e menaxhimit të përbashkët, Shteti Anëtar, përfituesi IPA II dhe Komisioni janë përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin e programeve, në përputhje me përgjegjësitë e tyre përkatëse të përcaktuara në Rregulloren (BE) nr. 1303/2013, Rregulloren Financiare dhe Rregulloren ETC.

Neni 44

Përgjegjësitë e përfituesit IPA II

KKIPA, siç përcaktohet në përputhje me Marrëveshjen Kuadër, është përgjegjës për koordinimin e pjesëmarrjes së përfituesit IPA II në programet përkatëse INTERREG. KKIPA mund të delegojë këtë detyrë të koordinimit tek një koordinator për bashkëpunim territorial apo strukturë operative sipas rastit.

Neni 45

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Zbatohet neni 75 CPR.

Neni 46

Bashkëpunimi midis Komisionit dhe autoritetit auditues

Zbatohet neni 128 CPR.

Neni 47

Kontrulli proporcional i programeve të bashkëpunimit.

Zbatohet neni 148 CPR.

Seksioni VII

Llogaritja bazë dhe intensiteti i ndihmës

Neni 48

Baza për llogaritjen e asistencës ERDF

Vendimi i Komisionit që miraton Programin (shih shtojcat I, II dhe III) përcakton nëse shkalla e bashkëfinancimit për secilin aks prioritar dhe për kontributin nga zëri buxhetor 1b, dhe kontributin nga zëri buxhetor 4 (IPA II) do të zbatohet për:



a) shpenzimet totale të pranueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe shpenzimet private; ose

b) shpenzimet e pranueshme publike.

Neni 49

Intensiteti i ndihmës

Shkalla e bashkëfinancimit të Unionit në nivel të secilit aks prioritar të Programit nuk është më pak se 20% dhe jo më e lartë se 85% të shpenzimeve të pranueshme.

Përfituesi IPA II respekton normën minimale të kontributit të tij të përcaktuar në shtojcat I dhe III. Në rast të kontributeve si nga përfituesi IPA II dhe Bashkimit Evropian, kontributi i përfituesit IPA II vihet në dispozicion në të njëjtën kohë si kontributi përkatës nga Unioni.

Seksioni VIII

Menaxhimi financiar, anulimi, shqyrtimi dhe pranimi i llogarive, mbyllja dhe korrigjimet financiare

Nënseksioni 1

Angazhimet dhe pagesat

Neni 50

Angazhimet buxhetore

Në lidhje me angazhimet buxhetore zbatohet neni 76 CPR.

Në veçanti vendimi i Komisionit që miraton Programin përbën një vendim financimi brenda kuptimit të nenit 84 të Rregullores Financiare, duke njoftuar Shtetin Anëtar në fjalë, i cili është angazhim ligjor në kuptim të kësaj rregulloreje.

Neni 51

Rregullat e përbashkëta për pagesat

Në lidhje me rregullat e përbashkëta për pagesat, zbatohet neni 77 CPR.

Në përputhje me nenin 27 (1) të Rregullores ETC, asistenca ERDF për Programin paguhet në një llogari të vetme pa nënlllogaritë kombëtare.

Në pajtim me nenin 21 (2) të Rregullores ETC autoriteti certifikues merr ose pranon pagesat e bëra nga Komisioni.

Në përputhje me nenin 129 CPR, Shteti Anëtar siguron që me mbylljen e Programit shuma e shpenzimeve publike që i paguhet përfituesit është të paktën e barabartë me

kontributin e asistencës ERDF paguar nga Komisioni për Shtetin Anëtar dhe përfituesin IPA II.

Neni 52

Rregullat e përbashkëta për llogaritjen e pagesave të përkohshme dhe pagesën e bilancit përfundimtar

Në lidhje me llogaritjen e pagesave të përkohshme dhe pagesën e bilancit përfundimtar zbatohen nenet 78 dhe 130 CPR.

Neni 53

Aplikimet e pagesës

1. Për sa i përket pagesës për aplikimet zbatohen nenet 79 (2) dhe 131 CPR.

2. Aplikimet e pagesave dorëzohen në përputhje me modelin e përcaktuar në nenin 6 dhe shtojcën VI të Komisionit për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1011/2014.

Neni 54

Afatet për paraqitjen e aplikimeve të pagesave të përkohshme dhe për pagesat e tyre

Zbatohet neni 135 CPR.

Neni 55

Pagesat për përfituesit

1. Në pajtim me nenin 21 (2) të Rregullores ETC, autoriteti certifikues duhet, si rregull i përgjithshëm, të bëjë pagesat për përfituesit kryesorë në përputhje me paragrafët 2 dhe 3.

2. Në varësi të mundësimit të fondeve nga parafinancimi fillestar dhe vjetor, si dhe pagesat e përkohshme, autoriteti menaxhues siguron që përfituesi të marrë shumën totale të shpenzimeve publike të pranueshme në mënyrë të plotë dhe jo më vonë se 90 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për pagesë nga përfituesi.

Asnjë shumë nuk zbritet ose mbahet dhe asnjë pagesë e veçantë apo pagesë tjetër me efekt të njëjtë nuk vendoset, që mund të zvogëlojë shumat e caktuara për përfituesit.

3. Në përputhje me nenin 132 (2) CPR, afati i pagesës referuar në paragrafin 2 mund të ndërpritet nga autoriteti menaxhues në njërin nga këto raste të justifikuara siç duhet:

a) kur shuma e kërkesës për pagesë nuk është



caktuar si duhet ose dokumentet mbështetëse të përshtatshme, duke përfshirë dokumentet e nevojshme për verifikime të menaxhimit sipas shkronjës (a) të nënparagrafit të parë të nenit 125 (4) CPR, nuk janë siguruar;

b) kur ka filluar një hetim në lidhje me ndonjë parregullsi të mundshme që ndikon në shpenzimet në fjalë.

Përfituesi në fjalë informohet me shkrim për ndërprerjen dhe arsyet përse ka ndodhur kjo ndërprerje.

Neni 56

Përdorimi i euros

1. Shumat e përcaktuara në programet e paraqitura nga Shtetet Anëtare, parashikimet e shpenzimeve, deklaratat e shpenzimeve, aplikimet e pagesës, llogaritë dhe shpenzimet e përmendura në raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit shprehen në euro.

2. Shtetet Anëtare që nuk kanë adoptuar euron si monedhën e tyre në datën e kërkesës për pagesë i kthejnë shumat e shpenzimeve të bëra me monedhë kombëtare në euro.

Kur euro bëhet monedhë e një Shteti Anëtar, procedura e konvertimit e përcaktuar në nënparagrafin e parë vazhdon të zbatohet për të gjitha shpenzimet e regjistruara në llogaritë nga autoriteti certifikues para datës së hyrjes në fuqi të normës fikse të konvertimit ndërmjet monedhës kombëtare dhe euros.

3. Shpenzimet e bëra në një monedhë të ndryshme nga euro konvertohen në euro nga përfituesit duke përdorur normën mujore të kursit të këmbimit të Komisionit gjatë muajit në të cilin shpenzimi ishte:

a) kryer;

b) paraqitur për verifikim tek autoriteti menaxhues ose kontrollues, në përputhje me nenin 42 (3); ose

c) raportuar te përfituesi kryesor.

Metoda e zgjedhur për këtë do të përcaktohet në Program dhe është e zbatueshme për të gjithë përfituesit.

Konvertimi verifikohet nga autoriteti menaxhues ose kontrolluesi në Shtetin Anëtar ose te përfituesi IPA II në të cilin përfituesi ka zënë vend.

Neni 57

Parafinancimi

Zbatohen nenet 81, 82 dhe 134 CPR.

Neni 58

Ndërprerja e afatit të pagesave dhe pezullimi i pagesave

1. Në lidhje me ndërprerjen e pagesave nga ana e Komisionit zbatohet neni 83 CPR.

2. Në lidhje me pezullimin e pagesave nga Komisioni zbatohet neni 142 CPR.

Nënseksioni 2

Anulimi

Neni 59

Parimet

1. Programi i nënshtrohet procedurës së anulimit e krijuar në bazë të shumave që lidhen me detyrimet të cilat nuk janë mbuluar nga parafinancimi ose nga aplikimi për pagesat brenda një periudhe të caktuar, duke përfshirë çdo aplikim për pagesë në të cilin një pjesë ose i gjithë aplikimi është pjesë e ndërprerjes së afatit të pagesës ose e pezullimit të pagesave, të cilat duhet të anulohen.

2. Detyrimi financiar në lidhje me vitin e fundit të periudhës anulohet në përputhje me rregullat që duhen ndjekur për mbylljen e Programit.

3. Pjesa e detyrimeve financiare ende e hapur anulohet nëse ndonjë nga dokumentet e kërkuara për mbylljen nuk i është dorëzuar Komisionit brenda afateve të përcaktuara në nenin 60.

Neni 60

Afati për anulimin

1. Komisioni anulon ndonjë pjesë të shumës së Programit:

a) që nuk është përdorur për pagesën fillestare dhe pagesat e përkohshme dhe vjetore të parafinancimit deri më 31 dhjetor të vitit të tretë financiar pas angazhimit (detyrimit financiar) të vitit buxhetor sipas programit operativ; ose

b) për të cilën aplikimi për pagesat i hartuar në përputhje me nenin 53 nuk është dorëzuar në përputhje me nenin 54.

2. Ajo pjesë e angazhimeve (detyrimeve financiare) që është ende e hapur deri më 31



dhjetor 2023 anulohet nëse ndonjë prej dokumenteve të kërkuara sipas nenit 68 nuk i është paraqitur Komisionit deri më 15 shkurt 2025.

Neni 61

Përfashtimet nga anulimi

Zbatohet neni 87 CPR.

Neni 62

Procedura

1. Komisioni informon Shtetin Anëtar, përfituesin IPA II dhe autoritetin menaxhues në kohën e duhur kur ekziston rreziku i zbatimit të rregullit të anulimit sipas nenit 59.

2. Në bazë të informacionit që ka marrë deri më 31 janar, Komisioni informon Shtetin Anëtar, përfituesin IPA II dhe autoritetin menaxhues mbi shumën e anulimit që rezulton nga ky informacion.

3. Shteti Anëtar ka afat 2 muaj për të rënë dakord mbi shumën që do të anulohet ose për të paraqitur vërejtjet e tij.

4. Deri më 30 qershor, Shteti Anëtar i paraqet Komisionit një plan financimi të rishikuar që pasqyron, për vitin financiar në fjalë, shumën e reduktuar të mbështetjes mbi një ose më shumë prioritet të Programit. Nëse ky parashtrim dështon, Komisioni e rishikon planin e financimit duke ulur asistencën ERDF për vitin financiar në fjalë. Ky reduktim alokohet për secilin prioritet në mënyrë proporcionale.

5. Komisioni amendon vendimin që miraton Programin, me anë të akteve zbatuese, jo më vonë se data 30 shtator.

Nënseksioni 3

Llogaritë

Neni 63

Përgatitja, paraqitja, shqyrtimi dhe pranimi i llogarive

1. Në lidhje me përgatitjen, shqyrtimin dhe pranimin e llogarive zbatohen nenet 84, 137 deri në 139 dhe 141 (2) CPR.

2. Llogaritë hartohen në përputhje me nenin 7 dhe shtojcën VII të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 1011/2014.

3. Në përputhje me nenin 139 (10) CPR, Shteti Anëtar ose përfituesi IPA II mund të

zëvendësojë sasi të parregullta, të cilat janë zbuluar pas paraqitjes së llogarive, duke bërë rregullimet përkatëse në llogaritë për vitin e kontabilitetit në të cilin parregullsia është zbuluar, pa cenuar nenet 73 dhe 74 të CPR-së.

4. Në përputhje me nenin 141 (1) CPR, përveç dokumenteve të përmendura në nenin 138 CPR, për vitin e fundit të kontabilitetit nga 1 korriku 2023 deri më 30 qershor 2024, autoriteti menaxhues paraqet një raport përfundimtar të zbatimit për Programin.

Neni 64

Mundësimi i dokumenteve

Në lidhje me detyrimet e autoritetit menaxhues për të mundësuar dokumentet zbatohen dispozitat e nenit 140 CPR.

Nënseksioni 4

Korrigjimet financiare dhe rikuperimet nga vendet pjesëmarrëse

Neni 65

Përgjegjësitë e vendeve pjesëmarrëse

1. Vendet pjesëmarrëse parandalojnë, zbulojnë dhe korrigjojnë parregullsitë dhe rikuperojnë shumat e paguara padrejtësisht, së bashku me ndonjë interes për pagesat e vonuara.

2. Vendet pjesëmarrëse janë në radhë të parë përgjegjëse për investigimin e parregullsive dhe kryerjen e korrigjimeve financiare të nevojshme dhe mbulimin e shpenzimeve. Në rastin e një parregullsie sistematike, vendi pjesëmarrës e shtrin hetimin për të mbuluar të gjitha operacionet që mund të preken.

3. Vendet pjesëmarrëse bëjnë korrigjimet financiare që kërkohen në lidhje me parregullsitë individuale ose sistematike të zbuluara në operacionet ose në Program. Korrigjimet financiare konsistojnë në anulimin e të gjithës ose një pjese të kontributit publik për një operacion apo në Program. Vendet pjesëmarrëse marrin parasysh natyrën dhe seriozitetin e parregullsive, humbjen financiare në asistencën ERDF dhe zbatojnë korrigjimin proporcional.

Korrigjimet financiare regjistrohen në llogaritë për vitin kontabël në të cilin është vendosur anulimi.



4. Kontributi nga asistenca ERDF i anuluar në përputhje me paragrafin 3 mund të ripërdoret nga vendet pjesëmarrëse në kuadër të programit në fjalë, objekt i paragrafit 5.

5. Kontributi i anuluar në përputhje me paragrafin 3 nuk mund të ripërdoret për ndonjë operacion që ka qenë objekt i korigjimit, kur korigjimi financiar është bërë për një parregullsi sistematike ose për ndonjë operacion të prekur nga parregullsia sistematike.

Neni 66

Njoftimi i parregullsive

1. Parregullsitë i njoftohen Komisionit në përputhje me nënparagrafin e parë, të dytë dhe të tretë të nenit 122 (2) CPR.

2. Zbatohet Rregulloja e Delegimit të Komisionit (BE) nr. 2015/1970³⁴, e cila përcakton rregulla të detajuara shtesë mbi kriteret e përcaktimit të rasteve të parregullsive që do të raportohen dhe të dhënave që do të sigurohen.

Në pajtim me nenin 3 (4) të Rregullores së Delegimit (BE) nr. 2015/1970, parregullsitë raportohen nga Shteti Anëtar apo përfituesi IPA II në të cilin shpenzimet janë paguar nga përfituesi për zbatimin e operacionit. Shteti Anëtar ose përfituesi IPA II informon autoritetin menaxhues, autoritetin certifikues për programin, autoritetin e auditimit, si dhe kontrolluesin kombëtar, siç referohet në nenin 37 (2) dhe përfaqësuesin e tij në grupin e audituesve, siç referohet në nënparagrafin e dytë të nenit 40 (1).

3. Zbatohet Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2015/1974³⁵, e cila përcakton shpeshësinë dhe formatin që duhet të ndjekin raportimet e parregullsive.

³⁴ Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) 2015/1970 e 8 korrikut 2015, që plotëson Rregulloren (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian me dispozitat specifike për raportimin e parregullsive, që lidhen me Fondin e Zhvillimit Rajonal Evropian, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Detar dhe të Peshkimit Evropian, GZ. L 293, 10.11.2015, f. 1.

³⁵ Rregullorja e Zbatimit e Komisionit (BE) 2015/1974 e 8 korrikut 2015, që përcakton shpeshësinë dhe formatin e raportimit të parregullsive në lidhje me Fondin e Zhvillimit Rajonal Evropian, Fondin e Ndihmës Sociale, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Detar dhe të Peshkimit Evropian, nën Rregulloren (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, GZ. L 293, 10.11.2015, f. 20.

Neni 67

Rikuperimet

1. Në përputhje me nenin 27 (2) të Rregullores ETC, autoriteti menaxhues siguron që çdo shumë e paguar si rezultat i parregullsive rikuperohet nga përfituesi lider ose i vetëm. Përfituesit i shlyejnë përfituesit lider çdo shumë të paguar tepër ose padrejtësisht.

2. Në përputhje me nenin 27 (3) të Rregullores ETC, nëse përfituesi kryesor nuk ka sukses në sigurimin e shlyerjes nga përfituesit e tjerë apo nëse autoriteti menaxhues nuk do të ketë sukses në sigurimin e shlyerjes nga përfituesi kryesor ose i vetëm, vendi pjesëmarrës në territorin e të cilit përfituesi në fjalë është vendosur ose është regjistruar, në rastin e një EGTC - i rimbursos autoritetin menaxhues çdo shumë të paguar tepër/padrejtësisht atij përfituesi. Autoriteti menaxhues është përgjegjës për rimbursimin e shumave në fjalë për buxhetin e përgjithshëm të Unionit, në përputhje me metodën e ndarjes së detyrimeve midis vendeve pjesëmarrëse, siç përcaktohet në Program.

3. Në pajtim me fjalinë e dytë të paragrafit të katërt të nenit 122 (2) CPR, vendet pjesëmarrëse mund të vendosin të mos rikuperojnë shumën e paguar tepër nëse shuma që do të mbulohet nga përfituesi, pa përfshirë interesin, nuk i kalon 250 euro kontribut nga asistenca ERDF.

4. Rregulloja e Delegimit të Komisionit (BE) nr. 2016/568³⁶, e cila përcakton rregulla të detajuara shtesë për kushtet dhe procedurat që do të zbatohen për të përcaktuar nëse shumat të cilat janë të pakthyeshme do të rimbursohen.

Nënseksioni 5

Korigjimet financiare nga Komisioni

Neni 68

Fushëveprimi, kriteret dhe procedura

1. Komisioni bën korigjime financiare në përputhje me nenin 85 (1), (2) dhe (3) CPR, duke

³⁶ Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) nr. 2016/568 e 29 janarit 2016, që plotëson Rregulloren (BE) nr. 1303/2013 të Këshillit dhe Parlamentit Evropian në lidhje me kushtet dhe procedurat për të përcaktuar nëse shumat të cilat janë të pakthyeshme do të rimbursohen nga Shtetet Anëtare lidhur me Fondin e Zhvillimit Rajonal Evropian, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Detar dhe të Peshkimit Evropian, GZ. L 97, 13 prill 2016, f. 1.



anuluar të gjithë ose një pjesë të asistencës ERDF për Programin dhe ndikon në rikuperimin nga Shteti Anëtar dhe përfituesi IPA II duke përjashtuar financimin e shpenzimeve nga BE, që është në kundërshtim me ligjin në fuqi.

2. Në përputhje me nenin 85 (4) CPR në lidhje me kriteret për korrigjimet financiare zbatohen dispozitat e nenit 144 (1) deri (5) CPR.

3. Nenet 30 dhe 31 të Rregullores së Delegimit të Komisionit (BE) nr. 480/2014, në lidhje me korrigjimet financiare zbatohen nga Komisioni për sistemet e mangësive.

4. Në lidhje me procedurën zbatohen dispozitat e nenit 145 (1) deri (7) CPR.

5. Për sa i përket pagesave zbatohen dispozitat e nenit 147 CPR.

Neni 69

Detyrimet e vendeve pjesëmarrëse

Në përputhje me nenin 146 CPR, korrigjimi financiar nga Komisioni nuk cenon detyrimin e vendeve pjesëmarrëse për të ndjekur rikuperimet sipas nenit 67 (2) dhe Shtetet Anëtare për të rikuperuar ndihmën shtetërore në kuptim të nenit 107 (1) TFEU dhe në bazë të nenit 14 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 659/1999³⁷.

Seksioni IX

Ndërprerja e Programit dhe problemet e zbatimit

Neni 70

Mosnënshkrimi i kësaj Marrëveshje Financimi

Kur përfituesi IPA II nuk e ka nënshkruar këtë Marrëveshje Financimi deri në fund të vitit pas vitit të miratimit të Programit ose ndryshimit të programit në mënyrë që të përfshijë edhe asistencën ERDF në favor të tij, Komisioni mund t'i propozojë KM-së një amendament për Programin, me qëllim për të ndërprerë pjesëmarrjen e përfituesit IPA II në Program në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 10 (4).

Për nenin 71 (2) deri (4) zbatohet *mutatis mutandis* (pasi të jenë bërë ndryshimet e nevojshme).

Neni 71

Problemet e zbatimit

1. Kur ajo pjesë e asistencës ERDF të Programit në lidhje me një përfitues në përfituesin IPA II nuk mund të zbatohet për shkak të problemeve që dalin në marrëdhëniet mes vendeve pjesëmarrëse, si dhe në raste të tjera të justifikuara siç duhet, Komisioni mund t'i propozojë KM-së një amendament për Programin, me qëllim për të ndërprerë pjesëmarrjen e përfituesit IPA II në Program para datës së skadimit të periudhës së ekzekutimit në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 10 (4).

2. Kur ndërpritet pjesëmarrja e përfituesit IPA II në Program, autoriteti menaxhues përcjell raportin përfundimtar brenda gjashtë muajve pas vendimit të Komisionit. Pas likuidimit të pagesave të mëparshme të parafinancimit, Komisioni paguan bilancin përfundimtar ose, kur është e nevojshme, nxjerr urdhrin e rikuperimit. Komisioni gjithashtu anulon bilancin e angazhimeve.

3. Ajo pjesë e asistencës ERDF në lidhje me një përfitues në përfituesin IPA II tashmë subjekt i një dokumenti të granteve pa asnjë kusht, në pajtim me nënparagrafin e dytë të nenit 12 (7), i paguhet autoritetit menaxhues nëse nuk është paguar në lidhje me detyrimet kontraktuale të përfituesit të kontraktuar para vendimit të ndërprerjes nga Komisioni.

4. Ajo pjesë e asistencës ERDF në lidhje me një përfitues në një Shtet Anëtar tashmë subjekt i një dokumenti të grantit mbetet në dispozicion për kohëzgjatjen e saj normale, por mund të përdoret vetëm për aktivitete që ndodhin vetëm në Shtetin Anëtar në fjalë dhe kontraktuar para vendimit të ndërprerjes nga Komisioni.

5. Si një zgjidhje alternative mund të vendoset të reduktohen alokimet e Programit në lidhje me pjesëmarrjen e përfituesit IPA II në fushën e programit, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 10 (4).

³⁷ Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 659/1999 e 22 marsit 1999, që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të KE, GZ L 83, 1999/03/27, f. 1.



Seksioni X
Dispozitat përfundimtare

Neni 72

Konsultimi ndërmjet vendeve pjesëmarrëse dhe Komisionit

1) Përfituesi IPA II dhe Komisioni konsultohen me njëri-tjetrin para se të hyjnë në ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi edhe më tej në përputhje me nenin 76 të këtyre Kushteve të Përgjithshme ose ndonjë mosmarrëveshje lidhur me interpretimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi që nuk mund të zgjidhet në përputhje me nenin 3 të Kushteve të Veçanta.

2) Kur Komisioni bëhet me dije për problematikat në kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi për sa i përket përfituesit IPA II, ai krijon të gjitha kontaktet e nevojshme me përfituesin IPA II për të përmirësuar situatën dhe për të ndërmarrë masa apo hapa që janë të nevojshëm.

3) Konsultimi mund të çojë në një amendim, pezullim ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

4) Komisioni dhe Përfituesi IPA II e mbajnë Shtetin Anëtar të informuar në lidhje me konsultimet ose kontaktet sipas paragrafëve 1 dhe 2.

5) Komisioni konsultohet me Shtetin Anëtar para se të merret ndonjë masë e listuar në paragrafin 3.

Neni 73

Amendimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1) Pa cenuar paragrafin 6, kjo Marrëveshjeje Financimi ndryshohet siç përcaktohet në paragrafët 2 deri 5.

2) Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje Financimi duhet të bëhet në formë të shkruar.

3) Në rast se ndonjë prej vendeve pjesëmarrëse kërkon një ndryshim, kjo kërkesë duhet t'i përcillet Komisionit të paktën gjashtë muaj para hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi.

4) Në rast se Komisioni vjen në dijeni të një mospërputhje midis dispozitave të Marrëveshjes së Financimit dhe akteve bazë të renditura në nenin 1 të Kushteve të Veçanta, Komisioni propozon përafrimin e nevojshëm të kësaj

Marrëveshjeje Financimi me dispozitat e akteve themelore.

Në rast të një ndryshimi në një akt themelor, Komisioni propozon përafrimin e nevojshëm të kësaj Marrëveshjeje Financimi me dispozitat e ndryshuara të akteve themelore brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e tij.

5) Ndryshimet në Rregulloren e Zbatimit (BE) nr. 2015/207, për sa i përket modeleve të ndryshme, nuk kërkojnë ndryshime në këtë Marrëveshjeje Financimi. Përfituesi IPA II informohet me shkrim për çdo amendament të tillë dhe hyrjes së tij në fuqi.

6) Autoriteti menaxhues njofton Komisionin me shkrim për çdo vendim që ndryshon [shtojca [V] [dokumenti specifik i përmendur në nenin 10 të Kushteve të Veçanta] brenda një muaji nga data e këtij vendimi ndryshues. Vendimi për ndryshimin specifikon datën e hyrjes së tij në fuqi. Komisioni do të pranojë marrjen e këtij njoftimi me shkrim.

Në rastin e një amendamenti të kësaj Marrëveshjeje Financimi në përputhje me paragrafët 2 deri 5, [shtojca [V]] [referenca në dokumentin e veçantë të përmendur në nenin 10 të Kushteve të Veçanta] zëvendësohet me versionin më të ri të njoftuar Komisionit.

Neni 74

Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1) Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Në rast se përfituesi IPA II shkel ndonjë prej detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje Financimi;

b) Në rast se përfituesi IPA II shkel ndonjë prej detyrimeve të përcaktuara në dokumentet procedurale dhe standarde sipas nenit 18, pika 2, të Marrëveshjes Kuadër.

c) Në rast se përfituesi IPA II nuk plotëson kërkesat për ngarkimin e detyrave të zbatimit të buxhetit;

d) Në rast se përfituesi IPA II vendos të pezullojë ose të heqë dorë nga procesi i anëtarësimit në BE;

e) Në rast se përfituesi IPA II shkel detyrimin lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet e demokracisë dhe të mbizotërimit të ligjit ose në raste të rënda korrupsioni.



2) Kjo Marrëveshje Financimi mund të pezullohet në rastet e “forcës madhore”, siç përcaktohet më poshtë:

“Forcë madhore” do të thotë çdo situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme ose ngjarje që shkon përtej kontrollit të palëve dhe që pengon secilën prej tyre të përmbushë detyrimet e saj, që nuk mund të lidhet me gabime ose neglizhencë nga ana e tyre (e kontraktuesve, agjentëve ose punonjësve) dhe vërtetohet të ketë qenë e pashmangshme, edhe pse është përdorur i gjithë kujdesi i mundshëm. Defektet në pajisje ose materiale, ose vonesat në sigurimin e tyre, mosmarrëveshjet e punës, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të konsiderohen si “forcë madhore”. Një nga palët nuk mund të konsiderohet të ketë shkelur detyrimet e saj, nëse ajo është penguar nga përmbushja e tyre nga rastet e “forcës madhore” nga të cilat pala tjetër është informuar në kohë. Një palë e prekur nga “forca madhore” duhet të informojë palën/palët e tjera pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, dhe të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme. Në rast se “forca madhore” ndikon vetëm pjesë të Programit, pezullimi i Marrëveshjes së Financimit mund të jetë i pjesshëm.

Asnjë prej Palëve nuk mund të konsiderohet të ketë shkelur detyrimet e saj në kuadër të kësaj Marrëveshje Financimi në rast se është detyruar nga “forca madhore”, me kusht që të marrë masa për të minimizuar ndonjë dëmtim të mundshëm.

3) Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

4) Komisioni duhet të ndërmarrë çdo masë të nevojshme para se pezullimi të hyjë në fuqi.

5) Në rastet kur njoftohet pezullimi, duhet të saktësohen pasojat mbi prokurimet ose kontratat e grantit në zbatim ose në fazë nënshkrimi, si dhe të përcaktohen marrëveshjet e delegimit.

6) Pezullimi i kësaj Marrëveshje nuk cenon ndërprerjen e pagesave në përputhje me nenin 58 dhe me përfundimin e kësaj Marrëveshje Financimi nga Komisioni sipas nenit 75.

7) Palët mund të rifillojnë zbatimin e Marrëveshjes së Financimit në rast se kushtet do ta lejojnë dhe vetëm me miratimin paraprak në formë të shkruar nga Komisioni. Kjo nuk cenon asnjë ndryshim të kësaj Marrëveshje Financimi që do të rezultojë i nevojshëm për të përshtatur Programin me kushtet e reja të zbatimit, përfshirë, në rast se është e mundur, kohëzgjatjen e periudhës së lejueshmërisë ose përfundimin e kësaj Marrëveshje Financimi në përputhje me nenin 75.

Neni 75

Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1) Në rast se çështjet që kanë sjellë në pezullimin e kësaj Marrëveshje Financimi nuk zgjidhen brenda një periudhe maksimale prej 180 ditësh, secila nga Palët mund të përfundojë Marrëveshjen e Financimit pas 30 ditëve nga njoftimi.

2) Kjo Marrëveshje Financimi duhet të përfundohet automatikisht në rastet kur brenda periudhës 2 -vjeçare nga nënshkrimi i saj:

a) nuk është kryer asnjë pagesë;

b) nuk është nënshkruar ndonjë kontratë zbatimi ose marrëveshje delegimi.

3) Në rastet kur përfundimi është njoftuar, duhet të përcaktohen pasojat për prokurimet dhe kontratat e grantit në zbatim, marrëveshjet e delegimit dhe për kontratat e grantit ose marrëveshjet e delegimit në fazë nënshkrimi.

4) Përfundimi i kësaj Marrëveshje Financimi nuk përjashton mundësinë e Komisionit për të bërë korrigjime financiare në përputhje me nenin 68.

Neni 76

Dispozitat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1) Në rast se mosmarrëveshjet lidhur me këtë Marrëveshje Financimi nuk mund të zgjidhen brenda një periudhe 6-mujore nëpërmjet konsultimit midis palëve sipas nenit 72, duhet të dorëzohen në juridiksionin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Nëse një vend përfitues IPA II nuk e pranon një juridiksion të tillë, dhe vetëm në këtë rast, mosmarrëveshja paraqitet për procedurë arbitrazhi.



2) Secila prej palëve duhet të caktojë një arbitër brenda 30 ditëve nga kërkesa për arbitrazh. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë cakton arbitrin e vet: pas kësaj, të dy arbitrat nga ana e tyre caktojnë një arbitër të tretë brenda 30 ditëve. Me përjashtim kur arbitrat vendosin ndryshe, duhet të zbatohet procedura e përcaktuar në Rregulloren Opsionale të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit që përfshin Organizatat Ndërkombëtare dhe Shtetet. Vendimet e arbitrave duhet të merren me shumicë brenda një periudhe tremujore.

3) Secila prej palëve është e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të arbitrave.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 924 lekë